SHEFKI OLLOMANI

THOTI I ATLANTIDËS

Botim i Dytë i plotësuar

Editor
Azam Dauti

Recensent
Abedin Krosi

SHEFKI OLLOMANI

THOTI I ATLANTIDËS

Botim i Dytë i plotësuar

SHKUPI
Shkup, 2019

H Y R J E

1.Atlantida – Atdheu i Thotit

Fillimi i ekzistencës së Atlantidës mendohet të ketë nisur rreth 50.000 vjet para erës sonë (p.e.s.) dhe të ketë mbaruar rreth vitit 10.000 p.e.s. Të dhënat më të plota për Atlantidën i kemi nga studiuesi i madh i Athinës, Platoni, që mendohet të ketë jetuar në vitet 428-348 p.e.s. Deri në fillim të shekullit të XX këta libra shifeshin si fantazi e Platonit, por pas zbulimit të **Pllakave të Thotit**, u shtua shumë interesimi për librat e tij. Ai në librin e vet: "Timeo dhe Krizia" bën përshkrimin e hollësishëm të Atlantidës, bazuar nga të dhënat që ligjvënësi dhe paraardhësi i tij, Soloni (638-554), p.e.s. i kishte marrë nga saçerdotët (priftërinjtë) në kryeqendrën Sais të Egjyptit. Ata i kishin thënë për Atlantidën:

- Shumë vepra më madhështore se ato të Athinës kishte atje dhe mrekulloheshe. Shumë i madh ishte zhvillimi dhe fuqia ushtarake atje dhe kishin zaptuar gjithë Europën e Azinë, duke ardhë nga oqeani Atlantik me anijet e tyne, që kalonin nëpër ngushticën ku janë Kolonat e Herkulit.

Në një ishull që ishte më i madh se Libia dhe Azia e Vogël, ekzistonte Atlantida. Nga Atlantida kaloje me lehtësi në tokën e madhe që ajo e kishte nga ana tjetër (kontinentin e Amerikës). Mbretërimi i Atlantidës shtrihej pjesërisht në kontinentin përballë (Amerikës) dhe në pjesën këndej Kolonave të Herkulit, përfshi Libinë, Egjyptin dhe gati gjithë Europën.

Soloni u ishte mburrë saçerdotëve/priftërinjve duke u treguar për zhvillimet e Greqisë, por njëri nga ata kishte qeshë duke i thënë:

- Qytetërimi grek është si një foshnjë e vogël në krahasim me atë të Atlantidës, për të cilin ata zotëronin shumë dokumenta.

Sipas tyre në Atlantidë kishte ekzistuar për shekuj me radhë nji qytetërim e një zhvillim shumë i lartë. Mendohet të ketë zgjatur për 40.000 vjet.

Është folur shumë për Atlantidën, kontinenti i supozuar i zhdukur para disa mijëra viteve. Shumë studiuesë dhe shkencëtarë të fushave të ndryshe i kanë kushtuar jetën dhe pasionin e tyre kërkimit të këtij kontinenti që për momentin mbetet imagjinar dhe pa rezultat. Ka shume teori që kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe që lidhen kryesisht jo me faktin se çfarë përfaqësonte në vetvete Atlantida dhe çfarë shkalle zhvillimi kishte, por me vendndodhjen e saj.

Dëshmia e parë që mund të quhet serioze vjen nga Platoni në njërin prej dialogjeve të dy personazheve në tragjedinë "Kritias dhe Timaios". Platoni (viti 350 p.e.s.) i referohet ligjvënësit të Greqisë së lashtë, Solonit, i cili udhëtonte shpesh. Në njërin prej udhetimeve të tij në Egjypt, gjatë takimit me një prift, ai dëgjoi për historinë e një toke të begatë, me nje madhësi sa Libia dhe Azia e Vogël të marra sëbashku. Kjo tokë shtrihej diku në afërsi të Shtyllave të Heraklitit/Herkulit (ngushtica e Gjibraltarit) dhe rreth 9 mijë vite më parë (11.500 vjet p.e.s.) u zhduk brenda nje nate dhe një dite. Kjo tokë përshkruhej nga prifti si një vend i madh në perëndim të detit Mesdhe i rrethuar nga oqeani Atlantik.

Çdo gjë në këtë tokë, që po e quajmë kontinent, ishte shumë e zhvilluar dhe e përparuar për kohën që bëhet fjalë. Atlantët përshkruhen si shumë paqësorë, punëtorë dhe të aftë për tregti dhe arte zejtarie. Kryeqendra e tyre, Oqeania, ishte dhe kryeqendra e tregtisë me vendet e tjera, ishuj dhe kontinente ku mendohet që atlantët ishin shumë të fuqishëm në marrdhëniet me vendasit. Çdo gjë nëpër qytetet e tyre përshkruhet si shumë e veçantë, pasuri të tëra që dukeshin në ndërtimet dhe në veshjet e godinave me metale të çmuara dhe të statujave. Anijet e tyre ishin të përsosura dhe të përparuara për kohën. Por çdo gjë u zhduk brenda një nate dhe dite.

Misteri i Atlantidës është bërë pikënisje për shumë studime dhe eksplorime që në kohët e vjetra. Madje dhe shtysa fillestare për Kolombin për të zbuluar kontinentin amerikan, ka qenë fillimisht legjenda për Atlantidën.

Teori të çdo lloji e vendosin Atlantidën në zona të ndryshme të globit: nga pjesa juglindore e Azisë, pjesa perëndimore e detit Mesdhe, ishujt Azorre, ishulli Bimini (Bahamas) dhe në vende të tjera. Por të gjitha kanë si pikë të përbashkët praninë e oqeanit Atlantik.

Shumë shkencëtarë kanë pretenduar që kanë gjetur vendndodhjen e Atlantidës, por deri më sot askush nuk ka mundur ta provojë. Rasti i vetëm që mund të merret në konsideratë është ai i zbulimit të një zgjatimi nënujor në ishullin e Biminit dhe që ka tërhequr shumë vëmendjen e studiuesve. Aty duken qartë gjurmë ndërtimesh nga dora e njeriut dhe e një teknike që nuk i ngjan asaj që njihet në zonat përreth, apo të ndonjë kulture të lashtë që studiohet.

Zbulimi i Atlantidës në Bimini është parashikuar edhe nga Edgar Cayce, një "Nostradamus" i shekullit të 19-20-të, që

është shprehur se në fund të viteve 60-të, Atlantida do dali nga uji ne Bimini. Natyrisht ajo gjë nuk ndodhi dhe as viti nuk përkoi me atë që tha Cayce, por sidoqoftë, gjurmët që janë gjetur janë me interes për studim.

Ndonëse shkenca ka avancuar dhe shkencëtarët arrijnë në përfundime duke u bazuar në studime dhe logjikë shkencore, parashikimi dhe sidomos personi i Edgar Cayce shpesh lidhet me Atlantidën dhe zbulimin e saj.

Hollësitë e historisë se përshkruar nga Platoni për Atlantidën, të cilat u verifikuan edhe nga nxënësit e tij që vizituan Saisen (Egjypt) dhe lexuan vetë shkrimet e lashta për kontinentin e zhdukur, apo panë hieroglifet për begatinë dhe zhdukjen e befasishme të Atlantidës, u përzien gjatë shekujve me legjendën dhe me gojëdhënën e përgjithshme të përhapur në të gjithë botën që flet për një përmbytje të madhe, nga e cila shpëtuan vetëm një pakicë e vogël banorësh.

Këtë mundohen ta argumentojnë nga ngjashmëria në gjuhët e folura në të dyja anët e Atlantikut, gjë që nuk ka shpjegim tjetër veçse me kontaktin dhe lidhjet që ekzistonin para kohës së Kolombit, që të gjitha aludojnë për një kontinent apo ishull të madh në oqeanin Atlantik prej ku qytetërimi u përhap në Europë dhe Amerikë.

Gojëdhënat për një kontinent të humbur dhe kontaktet me një qytetërim më të vjetër mbetën aq të forta në Europë dhe Amerikë, sa që spanjollët filluan gjurmimet e tyre përtej oqeanit duke shpresuar shumë se do të gjenin mbeturinat e Atlantidës gjatë rrugës për në kontinentin e ri. Kurse Actekët dhe popujt e tjerë të Amerikës prisnin njerëzit e bardhë apo "perënditë e bardha" që do të ktheheshin prej

tokës së humbur që kishte qenë origjina e tyre, të cilën shumë popuj të Amerikës e quajnë ende "Aztlan".

Ngjashmëria e emrave të përdorur prej rracave njerëzore të lashtësisë për një ishull të mbytur në oqeanin Atlantik, për një Parajsë apo tokë, nga e cila qytetërimi u shpërnda në të gjithë botën e hershme, është një faktor që kontribuon shumë në teorinë që thotë se një tokë e tillë ka ekzistuar dikur, megjithëse nuk është një provë e mjaftueshme.

Emri i Atlantidës u ruajt gjatë gjithë historisë në legjendat, kujtesën, gjuhën dhe në historinë e popujve të lashtë që jetonin përqark oqeanit Atlantik prej një periudhe disa mijëvjeçare:

Grekët – Atlantis: Popull që jetonte në një ishull në oqeanin Atlantik.

Romakët – Atlas: Vargmal ne bregun perëndimor të oqeanit Atlantik dhe që vazhdon nën det.

Fenikasit dhe Kartagjenasit - Antilia, Antihla: Ishull në oqeanin Atlantik, gjatë rrugëve të tyre sekrete në det.

Egjyptianët - Amenti, Aalu: Parajsë në mes të oqeanit perëndimor Atlantik.

Babilonasit dhe Sumerët – Aralu: Ishull parajse në perëndim të oqeanit Atlantik.

Keltikët e Uellsit – Avalon: Ishulli i Parajsës në perëndim të oqeanit Atlantik.

Nordikët – Valhalla: Parajsë në Perëndim.

Keltikët spanjollë - Antilla, Atlantida: Qytetërim në një ishull të oqeanit Atlantik pranë Spanjës.

Berberët dhe popujt e lashtë të Afrikës - Atarantes, Atlantioi, Attala: Pushtuesë që erdhën nga veri-perëndimi i Afrikës. Ishulli në veriperëndim, më parë perandori.

Arabët – AD: Toka përpara përmbytjes në perëndim të Mesdheut.

Guançet (ishujt Kanarie) – Atalaja: Perandori e mbytur në oqeanin Atlantik, në të cilin bënin pjesë ishujt Kanarie por që nuk u mbytën.

Baskët – Atalaintika: Ishull i mbytur në oqeanin Atlantik nga ku erdhën Baskët.

Actekët - Aztlan, AZ: Ishull me një mal të lartë në detin Lindor (oqeani Atlantik), origjina e Actekëve.

Maja - Actlan, Atlan: Tokë që ekzistonte me parë në detin e Lindjes nga ku erdhën Majat.

Toltekët –Tlapalan: Ishull ne Detin e Lindjes, vend i perëndive të qytetëruara.

Fiset e Amerikës Veriore, Qendrore dhe bregut Verior të Amerikës Jugore – Atlan: Ishull ne Detin Lindor nga ku erdhën stërgjyshërit e këtyre fiseve.

Megjithëse ne nuk e dimë se si e quanin atlantidasit vendin e tyre, fakti që në të gjithë emrat e mësipërm përmbahen germat A, T, L, N, nuk është pa vlerë.

Një diçka tjetër që të kujton perandorinë e zhdukur të detit plotësohet nga fjala **Atl** që do të thotë **ujësi** në gjuhën e Actekëve të lashtë dhe të berberëve të Afrikës Veriore. Një tregues për emrin e "tokës përpara përmbytjeve të mëdha", mund të na e japë edhe Bibla ku përmendet emri i Adamit që tregon njeriun e parë apo ndoshta rracën e parë njerëzore të qytetëruar.

Polemika e hapur prej 2500 vjetësh që nga koha kur Platoni shkroi dialogun e famshëm, ka sjellë si rezultat studime kolosale, mbi 25 mijë libra të shkruar për këtë subjekt dhe ekspedita të pafundme. Deri më sot hipotezat e shumta

ose s'kanë arritur të provojnë asgjë ose deri diku kanë krijuar disa ide të vagëta per vendndodhjen dhe vetë ekzistencën e dikurshme të Atlantidës.

Ajo që duhet përmendur dhe që përbën edhe shtysën më të fortë për të gjithë shkencëtarët dhe studiuesit është që, memoria e njerëzimit asnjëherë nuk ka qenë pa baza dhe thjesht fantazi. Kjo është pika më e fortë ku të gjithë mbahen dhe ushqejnë dëshirën e tyre për kërkime të mëtejshme.

Sidoqoftë, nuk ka qenë vetëm Platoni ai që ka përmendur Atlantidën. Atë e gjejmë të përmendet edhe nga Herodoti dhe Tukididi. Udhëtimi tek Atlantis, i rizbuluar dhe më pas tragjikisht i humbur në kohët moderne, ka qenë një tjetër burim i hershëm, i shkruar 150 vjet përpara lindjes së Platonit, nga Dionisi i Miletusit. Po ashtu kemi disa fragmente gjysmë të shkrumbuara që kanë shpëtuar nga djegia e Bibliotekës së Aleksandrisë. Bëhet fjalë për një fragment referues të shkrimtarit romak të shekullit të dytë, Elianus, i cili ka shkruar veprën - Historia Naturalis, ku gjejmë informacion mbi Atlantidën dhe përshkrimin se si visheshin mbretërit e saj, duke deklaruar prejardhjen e tyre direkt nga Poseidoni. Kjo histori mbështetet edhe nga filozofi Proklos, i cili tregon se si Krantori (një nga pasuesit e hershëm të Platonit) që të vërtetonte legjendën mbi Atlantët, në vitin 260 para erës sonë, bëri një udhëtim në Egjypt, në Tempullin e Saisit. Aty ai zbuloi tabelat origjinale të cilat konfirmonin shkrimin e Platonit. Pas përkthimit ato përputheshin në çdo rresht. Kjo tregon edhe një fakt tjetër që ka shumë mundësi që Platoni ta ketë marrë të gatshëm tekstin që ai përfshiu në dialogun e famshëm.

Krantori ka qenë një studiues i Librarisë së Madhe të Aleksandrisë, qendra e Edukimit Klasik, ku historia e

Atlantidës në përgjithësi konsiderohej si një episod i besueshëm i historisë njerëzore dhe në këtë konkluzion bashkohej dhe një tjetër mendjendritur i kohës, kronikani i Perandorisë Romake, Straboni. Shumë kohë përpara se të shkatërrohej, kjo librari përmbante të dhëna të shumta të cilat i bindën studiuesit e asaj kohe që materiali i Platonit ishte tërësisht i vërtetë dhe fliste për një vend që kishte ekzistuar dikur në "oqeanin e jashtëm".

Pra, të dhënat janë të shumta dhe vetëm mendjengushtësia e shkencës elitare dhe autokrate të sotme nuk do t'i marrë në konsideratë dhe të shikojë përtej hundës së saj. Natyrisht që kjo është pothuajse e pamundur pasi në këtë mënyrë do i duhet të gëlltisë teori të tëra, duke filluar nga Evolucioni, i cili nuk pranon ekzistencën e një civilizimi përpara vitit 4500 para eres son, pastaj duhet të gëlltisë (të rrëzojë) teoritë qesharake të Epokës së Akullnajave, (primitivitetin e njeriut në ato kohëra të largëta), të Epokës së Gurit të Vonë, atë të Bronzit, të Hekurit…, e kështu me rradhë.

Elita e shkencës së sotme s'ka asnjë ndryshim nga Inkuizicioni i para 500 viteve. Po të kishin mundësi do i digjnin në turrën e druve njerëz me ide të tilla. Sot, në fakt, ata zbatojnë denigrimin, poshtërimin publik dhe injorimin e plotë të shumë fakteve dhe të dhënave që vërtetojnë për ekzistencën e civilizimeve shumë të lashta dhe që fatkeqësisht janë fshirë nga memoria kolektive e njerëzve të Tokës.

Prifti jesuit, Athanasius Kircher (1601-1680), ishte i pari që pranoi legjendën si një ide historike positive dhe reale. Ky prift ishte një hetues i vërtetë për tema të ndryshme. Ai siguroi që "kishte deshifruar heroglife të referuara Atlantidës". Sipas versionit të tij, Atlantida ishte një kontinent i vogël në oqeanin

Atlantik. Ishte më mirë të thuhet një ishull se sa një kontinent. Dimensionet e saj gjeografike e vendosnin midis Amerikës dhe Afrikës. Një ishull i madh ku një varg malesh qendore vinin duke u zbutur nëpër anë dhe nëpër ujërat e shumë lumenjve që përshkonin gjithë ishullin si rrjeta e një merimange.

2.Ngritja dhe rënia e Atlantidës

Fillimi i ekzsitencës së Atlantidës mendohet të ketë nisur rreth 50.000 vjet para erës sonë (p.e.s.) dhe të ketë mbaruar rreth vitit 10.000 p.e.s. Të dhënat më të plota për Atlantidën i kemi nga studiuesi i madh i Athinës, Platoni, që mendohet të ketë jetuear në vitet 428-348 p.e.s. Deri në fillim të shekullit të XX këta libra shifeshin si fantazi e Platonit, por pas zbulimit të **Pllakave të Thotit**, u shtua shumë interesimi për librat e tij. Ai në librin e vet: "Timeo dhe Krizia" bën përshkrimin e hollësishëm të Atlantidës, bazuar nga të dhënat që ligjvënësi dhe paraardhësi i tij, Soloni (638-554), p.e.s. i kishte marrë nga saçerdotët (priftërinjtë) në kryeqendrën Sais të Egjyptit. Ata i kishin thënë për Atlantidën:

- Shumë vepra më madhështore se ato të Athinës kishte atje dhe mrekulloheshe. Shumë i madh ishte zhvillimi dhe fuqia ushtarake atje dhe kishin zaptuar gjithë Europën e Azinë, duke ardhë nga oqeani Atlantik me anijet e tyne, që kalonin nëpër ngushticën ku janë Kolonat e Herkulit.

Në një ishull që ishte më i madh se Libia dhe Azia e Vogël, ekzistonte Atlantida. Nga Atlantida kaloje me lehtësi në tokën e madhe që ajo e kishte nga ana tjetër. (kontinentin e

Amerikës). Mbretërimi i Atlantidës shtrihej pjesërisht në kontinentin përballë (Amerikën) dhe në pjesën këndej Kolonave të Herkulit, përfshi Libinë, Egjyptin dhe gati gjithë Europën.

Soloni u ishte mburrë saçerdotëve duke u treguar për zhvillimet e Greqisë, por njëri nga ata kishte qeshë duke i thënë:

- Qytetërimi grek është si një foshnjë e vogël në krahasim me atë të Atlantidës, për të cilin ata zotëronin shumë dokumenta.

Sipas tyre në Atlantidë kishte ekzistuar për shekuj me radhë nji qytetërim e një zhvillim shumë i lartë. Mendohet të ketë zgjatur për 40.000 vjet.

Në dialogun e "Timeo dhe Krizia", nga të dhënat e saçerdotëve, Platoni e përshkruan kështu kryeqendrën e Atlantidës:

- Ishulli kishte një fushë, më e bukura e më prodhuesja e të gjitha fushave. Territori kishte formë gati vezake, me përmasa 530 km me 355 km. (Shkrimi thotë: gjatësia e ishullit është e 530 km në dy anësoret), i rrethuar në tri anët nga male që e mbronin nga erërat e ftohta, ndërsa nga ana jugore e ishullit ishte kryeqyteti, i rrethuar me tre kanale rrethore. Fusha ishte e punuar dhe sistemuar me kujdes dhe e ndarë me shumë kanale, të cilët e ndanin fushën në 600 katrore, që quheshin "Klerosu" (emër i vendosur nga Platoni), në të cilët gjindeshin me shumicë bimët bujqësore të kultivuara.

- Kanali që lidhte detin me qytetin ishte i gjatë 9 km, i gjërë afërsisht 90 metra dhe i thellë 30 metra.

- Kanalet rrethore lidheshin me njëri-tjetrin me kanale të tjerë për të lejuar anijet e mëdha të kalonin nga nji pjesë e qytetit në tjetrën, deri në qendër.

Qendra e qytetit, ku kishte vendin familja mbretërore, ndodhej në nji kodrinë të bukur rrethore me diametër afërsisht 885 metra dhe lidhej me rrathët e tokës përballë me anë urash 30 metra të gjëra, poshtë të cilave kalonin lirisht anijet e mëdha.

- Kanali rrethor i brendshëm, që rrethonte qendrën e fortifikuar të qytetit, ishte i gjërë 530 metra.

- Rrethorja e tokës që rrethonte këtë kanal ishte e gjërë 530 metra, e mbushur me ndërtesa madhështore.

- Kanali rrethor që rrethonte këtë tokë ishte i gjërë 350 metra.

- Pas këtij kanali ishte përsëri nji rrethore tjetër toke po 350 metra, e gjërë edhe kjo e mbushur me ndërtime të ndryshme, shkolla, palestra, dyqane e magazina.

- Çdo unazë toke ishte i mbrojtur nga mure të fuqishëm me kulla vrojtimi e ura. Muri rrethues më i jashtëm ishte i përforcuar me veshje bronzi, tjetri më i brendshëm ishte i veshur me kallaj të derdhur. Muri i brendshëm i familjes mbretërore ishte i veshur me "orikalko", një lloj metali me ngjyrë të kuqe si të flakës, që edhe sot nuk i dihet përmbajtja, por që vinte i dyti pas arit.

- Ky rreth toke rrethohej përsëri nga kanali i fundit rrethor, i gjërë 177 metra, i cili lidhej me detin me kanalin e madh prej 9 km të gjatë.

- Në qendër të ishullit ishte ndërtuar tempulli në kujtim të themeluesve të Atlantidës, gjyshërve të Thotit, që Platoni pranon se u ka vënë për lehtësi emra grekë: Klito dhe

Poseidon. Tempulli kishte përmasa 97X170 metra (tempulli i Afërditës dhe Artemisit që është një nga 7 mrekullitë e botës është 73x141 m), i zbukuruar me flori e fildish, ku ishin vendosë statujat e gjithë mbretërve që kishin qeverisë dhe statujat me pamje hyjnore.

- Po në hapsirën e qendrës së ishullit kishte burime të bollshme uji, si të nxehtë ashtu dhe ujë të ftohtë për të pi e për t'u larë. Uji i nxehtë termal përdorej nga familja mbretërore për të bërë banjë gjatë dimërit.

Ujërat e burimeve përdoreshin, një pjesë për të vaditur kopshtin e shenjtë të gjyshit të Thotit, Poseidonit, (emër i sajuar nga Platoni), që kishte nga të gjitha bimët e lulet dhe të gjitha llojet e pemëve. Pjesa tjetër e burimeve, me anë tubacionesh, shpërndaheshin në gjithë rrathët e qytetit, në të cilin kishte shumë shkolla dhe palestra. Kishte gjithashtu dhe një pistë për gara me kuaj, e gjatë 2,78 km. (Ky informacion ndryshon historinë e zbutjes së kuajve, që mendohej ta kishin bërë në Mesopotami, 2000 vjet p.e.s.

- Muri rrethues kishte një diametër rreth 4,75 km dhe nji sipërfaqe 17,70 km katrore, nga ku vetëm 5,85 km katrore ishin të banuara, pjesa tjetër ishte me lulishte e gjelbërim. Qyteti kishte dhe një mur tjetër më të ulët, 8,85 km larg këtij muri, megjithatë banesat shtriheshin dhe jashtë mureve rrethues, me nji sipërfaqe prej 383 km katrorë. (Londra shtrihet në 300 km katrorë dhe Milano në 181 km katrorë).

Kanalet rrethore dhe ai kryesori ishin plot me anije, që shkonin e vinin ditë e natë për të transportuar mallra të ndryshme. Shumica e prodhimeve siguroheshin në vend. Vendin e parë e zinin metalet, kryesisht metalet e çmueshme dhe shumë orikalko (në italisht përkthehet ar guri gëlqeror),

që ishte shumë i kërkuar në atë kohë dhe prodhohej me shumicë në Atlantidë.

Klima ishte e ngrohët dhe me lagështi të bollshme. Vendi i mbushur me gjelbërim dhe bimët ishin aq të bollshme, saqë elefantët rriteshin me shumicë.

Fusha e Atlantidës ishte e ndarë në 60 000 lotti, ku çdo lott ishte i barabartë me 10 x 10 stadi, të barabartë me 3,15 km katrore: Të gjitha këto bëjnë 189 000 km katrore. E gjithë kjo sipërfaqe fushore ishte e populluar me një popull punëtor, por dhe luftarak. Çdo lott kishte detyrë që në rast lufte të mobilizonte një sasi luftëtarësh të drejtuar nga komandantët, të caktuar nga ata vetë. Vetëm kryeqyteti kishte mundësi që në rast mobilizimit për luftë të ngrinte këtë ushtri:

- 10.000 karro luftimi.
- 120.000 kalorës me kuaj.
- 60.000 karro lufte (biga) me dy kuaj.
- 120.000 kalorës me armatim të rëndë.
- 120.000 harkëtarë.
- 120.000 luftëtarë me hobe.
- 180.000 luftëtarë me armatim të lehtë.
- 180.000 ushtëtarë me ushta (shtiza).
- 240.000 marinarë.
- 1.200 anije lufte.

Gjithsej bëjnë 1.150.000 luftëtarë, një shifër shumë e madhe, të mendosh, që në një periudhë më të vjetër se 12.000 vjet më parë, këtë ushtri e mobilizonte vetëm kryeqyteti Keor, sipas shkrimeve të Thotit. Në fillim të shkrimeve të Thotit, Undal quhet ishulli dhe mali, të cilit i kish mbet vetëm maja jashtë ujit. Kur lexon këto gjëra për Atlantidën e për kryeqytetin e saj, ngelesh me gojë hapur, sepse kupton që një

qytet metropolitan me shumë milionë banorë, të ketë pas ekzistuar para më shumë se 12.000 vjetësh.

Të 9 shtetet e tjera kishin dhe ato sasinë e vet të ushtarëve. Një numër kaq të madh luftëtarësh, vetëm një vend shumë i zhvilluar e shumë i populluar kishte mundësi t'i siguronte në ato kohë të lashta. (Në luftën e madhe greko-persiane morën pjesë 300 anije lufte, nga këto 100 anije ishin greke, më të vogla e më të shpejta se ato persiane dhe 200 ishin persinae, shumë më të mëdha se ato greke, por më të ngadalta.)

Sipas Platonit, bujqësia dhe blegtoria ishin shumë të zhvilluara dhe përballonin të gjitha nevojat për ushqim në vend dhe exportonin edhe jasht vendit të tyre. Zotëronin pasuri që askush më parë në asnjë vend nuk ka pasur ndonjiherë e nuk do i ketë në të ardhmen. Kishin çdo gjë për të cilën kishin nevojë, si në qytete ashtu dhe në fshatra. Në bazë të fuqisë së tyre ekonomike, transportuese dhe lundruese, shumë gjëra i importonin dhe nga vende të tjera.

Në ishull jetonin me shumicë shumë kafshë të zbutura dhe elefantë, të cilëve nuk u mungonte ushqimi. Gjithashtu dhe lumenjt, liqenet dhe rezervuaret ishin plot me peshq e kafshë të ndryshme.

Përshkrimi i klimës, prodhimit ushqimor e mineral, si dhe lulëzimi i përhershëm në një vend me klimë të butë, as të ftohtë e as të thatë, por me lagështi të bollshme e me burime uji të kulluar, të bëjnë të mendosh për nji parajsë tokësore. Ma tutje Platoni vazhdon:

- Prodhonin dhe kishin të gjithë parfumet që ekzistonin, shurupe nga bimë të ndryshme e lëngje frutash të të gjitha llojeve. Atje gjindeshin të gjitha frutat që duheshin në jetë, por,

mbi të gjitha, gjindej me shumicë drithi, që shërbente për ushqimin e përditshëm. Këta artikuj i prodhonte me shumicë ishulli që lulëzonte nën diellin e ndritshëm.

Perandoria e fuqishme e Atlantidës, që shtrihej në ishujt përreth, ishte e ndarë në 10 shtete konfederale (republika), çdonjëra nga këto udhëhiqej nga nji mbret. E gjithë perandoria, bashkë me Atlantidën ishte e ndarë në gjashtëdhjetë mijë zona (provinca), ku në çdo pesë ose gjashtë vjet bëhej një mbledhje publike me pjesëmarrjen e gjithë popullit që gjykonin për drejtuesit e zonave dhe bënin zgjedhjet e reja.

Atlantidasit nuk u mjaftuan vetëm me ishujt e tyre, por u shtrinë edhe në kontinentin nga prapa, Amerikë, edhe në atë përballë, në Europë, Libi, Egjypt, Etruri (Itali), Pellazgji, Iliri e Azi të Vogël. Shtrirja e tyre u bllokua rreth 10.000 vjet p.e.s. nga shteti i Athinës, me të cilin u bënë shumë luftime, derisa një ditë u përmbytën e u shkatërruan që të dyja. Ujërat e detit thithën e mbytën ushtritë e të dy palëve, si dhe qytetet e tyre. Përmbytja përshkruhet dhe në shkrimet e THOTIT.

Qysh në fillim të shkrimeve të THOTIT thuhet shprehimisht:

- U nisëm pa zbardhë dita në drejtim të Diellit të mëngjesit (në drejtim të lindjes).

Atëherë nga Egjypti, duhet të ecet me vijë imagjinare në drejtim të perëndimit të Diellit, për të zbuluar se ku ndodhej Atlantida, që mendohet të ketë qenë në oqeanin Atlantik. Nëse marrim parasysh koordinatat e piramidave të Egjyptit, shofim se ndodhen afërsisht në paralelin verior prej 30 gradësh dhe meridianin lindor po 30 gradë dhe, po të ndjekim këtë paralele, arrijmë në ishujt Palma, Madeira e Kanaria, që

përbahen nga disa ishuj të oqeanit Atlantik përballë Marokut e që mbahet si vendndodhja ma e mundshme e Atlantidës. Atje nuk kanë ruajtur legjenda për Atlantidën, por në veri-perëndim të Spanjës, baskët e mbajnë veten si pasardhës direkt të atlantidasve, së bashku me fqinjët e tyre anglezë e irlandezë e sidomos Sardët e Sardenjës. **Këtu duhet të theksohet se nga veshjet e tyre me fustanella, Sardët, Skocezët, Shqiptarët e Grekët kanë shumë ngjashmëri.** Njëkohësisht, edhe gjermanët dhe hollandezët kanë po këtë mendim për origjinën e tyre. **Historiani i famshëm grek, Straboni, para 2000 vjetësh, shkruante se, Venetët, Toskanët, Etruskët, Sardët, Abrucët dhe gjithë Italia e Jugut në kohën e tij ishin shqipfolës.**

*****

Sipas saçerdotëve (priftërinjve) egjyptianë e indianë, Atlantida ka pësuar disa tronditje të forta:

- E para, ka ndodhur para 800.000 vitesh, kur polet magnetike ndryshuan drejtimin: Poli i Jugut u bë Pol i Veriut dhe Poli i Veriut u bë Poli i Jugut. Ky fenomen ka bërë që kontinenti i Atlantidës të fillojë shkëputjen nga kontinenti i Europës dhe të rrethohet nga uji. Këtë fenomen e pranojnë dhe shkencëtarët.

- E dyta, para 200.000 vitesh një lëkundje (tërmet) me origjinë vullkanike, bëri të fundosen pjesë të kontinentit të Atlantidës, duke e zvogëluar edhe më atë.

- E treta, afërsisht para 80.000 vitesh, lëkundja tjetër e copëtoi dhe një herë, duke e ndarë në dy ishuj: **Royto e Daitya**. Këta dy emra dhe emrat e mbretërve ose të tjerë emra që kanë lidhje me Atlantidën, nuk janë emrat e vërtetë të këtyre

ishujve, por historianët grekë shpjegojnë se e kishin më të lehtë t'i mbanin mend këta emra të përshtatur sipas gjuhës së tyre.

- E katërta dhe e fundit, ishte tronditja që ndodhi afërsisht para 12.000 (disa thonë në vitin 9564 p.e.s., kur ishulli që kishte mbet, u thith nga dallgët e detit dhe THOTI u largua bashkë me popullin e tij në drejtim të Egjyptit. Këto të dhëna janë sjellë deri në ditët tona nga saçerdotët e Egjyptit dhe të Aztekëve të Meksikës.

Për aq sa i njohim, epokat e njerëzimit mund t'i ndajmë në këtë mënyrë:

- Nga 50.000 vjet p.e.s. e deri 10.000 vjet p.e.s. ta quajmë – Era e Atlantidës, sepse 52.000 vjet më parë mendohet që të ketë nisë zhvillimin e vet qytetërimi i Atlantidës.

- Nga 10.000 vjet p.e.s. e deri në vitin zero të quhet: - Era e THOTIT, sepse ishte Thoti ai që krijoi qytetërimin e lashtë të Mesopotamisë, Egjyptit, Pellazgjisë, Ilirisë dhe greqisë antike. Mësimet dhe ligjet e tij e udhëhoqën njerëzimin dhe qytetërimin e lashtë deri në fillim të Erës së Re.

- Nga data zero e vitit zero e deri më 21 dhjetor 2012 kemi: - Epokën e Erës Sonë.

- Pas 21 dhjetorit të vitit 2012 mendoj të quhet: - Epoka e Erës Moderne.

TOLTEKËT në Meksikë dhe INKASIT në Peru ngulin këmbë se janë pasardhës të ATLAN-ëve ose AZTLAN për inkasit dhe se, Atlantida për ata, **është një ishull i largët në oqeanin Atlantik, në të cilin ngrihej nji mal i lartë e me një lulishte të mahnitshme, në të cilën banonin Zotat**.

Për vendin e mundshëm dhe për historinë e Atlantidës, përveç atyre që janë shkruajtë nga Thoti, është edhe historia e Atlantidës e shkruajtur nga Platoni i Greqisë mbi 2.300 vjet më

parë (në vitin 340 p.e.s.). Platoni aty thotë se të dhënat për Atlantidën i kishte marrë nga saçerdotët e Egjyptit, pasardhës direkt të Thotit. Edhe ata i thanë atij se Atlantida ishte mbytur për të tretën herë 9.600 vjet para Platonit. Shkencëtarët, pas disa korrigjimeve të datave, deklarojnë se mbytja e Atlantidës duhet të ketë ndodhur rreth 9.564 vjet p.e.s.

Forma e kësaj toke të mbytur i përngjan formës së një patkoi kali, që i përgjigjet asaj që thoshte Platoni: Në dy anësoret gjatësia është 530 km. Irlanda përjashtohet si vendndodhje e mundshme e Atlantidës, sepse emri i saj pellazgo-ilir ERINI është shumë i vjetër e duhet të jetë i kohës së Atlantidës. Edhe emri i vjetër i Anglisë - ZAZANA, është i kohës së Atlantidës dhe përjashtohet mundësia të ketë qenë aty Atlantida, e cila duhet kërkuar nën oqean, e mbytur, ashtu siç thonë shkrimet e vjetra. Territori fushor dhe klima e Irlandës dhe e Anglisë, e ngjashme me atë të Atlantidës, të bëjnë të mendosh që kanë qenë shumë afër me Atlantidën dhe njolla e tokës së mbytur 360 km në perëndim të Irlandës dhe Anglisë, nën oqeanin Atlantik, me dimension: gjatësia në dy anësoret është 530 km e gjerësia 355 km, u përgjigjen me saktësi përshkrimeve të Platonit, të cilat i kish marrë nga saçerdotët e Egjyptit.

Gjithashtu, qysh në Pllakën e Parë, Thoti shprehet:

Në të majtë të malit Undal, maja e të cilit qëndron ende mbi ujë, ndodhet Tempulli i Madh i Dritës.

Nëse është shkruajtë se Atlantida është e mbytur në oqeanin Atlantik, ajo është e vërtetë e nuk ka pse të kërkohet gjurma e saj nëpër kontiente të ndryshëm, por duhet të kërkohet nën oqeanin Atlantik. Nëse në shkrimet e vjetra thuhet se duhet të kalosh Kolonat e Herkulit (Grykën e

Gjibraltarit) për të shkuar te Atlantida, që ndodhej midis Europës dhe Amerikës, kjo gjë nuk duhet të diskutohet. Nëse është shkruajtë se kryeqyteti i Atlantidës është përballë me Kolonat e Herkulit, ajo aty duhet të jetë, në jug të kësaj njolle toke, që është përballë me Kolonat e Herkulit. Nëse është shkruajtë se nga aty kalohet lehtë në kontinentin e Amerikës, dhe kjo është e vërtetë, sepse kjo tokë është shumë më afër me Amerikën e Kanadanë, se sa me Europën, dhe me atë zhvillim që thuhet se ka pasë Atlantida, nuk e ka pasë të vështirë kalimin e kësaj distance me anijet e saj që bridhnin gjithë botën. Këtë e vërtetojnë dhe disa fragmente hartash të vjetra parakolombiane të botës, shumë të sakta.

Për zbulimin e Atlantidës, me gjithë atë ar e pasuri që ka pasur, besoj që kanë hy në lojë shtete të fuqishme, të cilët mund ta kenë zbuluar, por nuk tregojnë gjë, mbase e ruajnë dhe përhapin lajme të rreme, që mos shkojnë individët, derisa ta kenë zhveshë nga thesaret e të mbesin vetëm gurët.

Nga ana tjetër e botës, në Meksikë e në Peru, në ditët e sotme, në historinë e kohës së vjetër, nxënësve të shkollave atje u mësohet se banorët e parë të Meksikës kanë qenë atlantidasit. Sipas historianëve të tyre, atlantidasit u shpërngulën atje pas një përmbytjeje që pësoi vendi i tyre dhe krijuan atje kulturën e tyre dhe piramidat madhështore atje. Data e katastrofës korrespondon me atë të saçerdotëve egjyptianë. Në zbulimet e bëra në Meksikë ngelesh i mahnitur nga piramidat dhe kalendarin e tyne preçiz, që parashikon se çfarë do të ndodhë në të ardhmen në globin tokësor. Në Dakotas të anës së Nju Jorkut, të Amerikës së Veriut, banorët autoktonë atje tregojnë se e kanë origjinën nga nji popull që banonte rreth 2500 km larg në oqeanin Atlantik, në një ishull

në lindje të tyre, që brenda një dite e një nate u mbyt nga ujërat e oqeanit.

Distanca nga qendra e kësaj njolle toke (në jug të saj, ku mund të ketë qenë dhe kryeqyteti i përshkruar më sipër), deri në brigjet e kontinentit Amerikan (Kanadasë), duke ndjekur drejtimin lindje-perëndim është me preçizion 2500 km. Pushtuesit e parë spanjollë të Amerikës shihnin me habi atje dhe nji rracë të veçantë njerëzish, të bardhë, të bukur e me pamje fisnike.

Në Europë flitet për Atlantidën vetëm me shkrimet fantastiko-shkencore. Në një libër të shenjtë Maja, të ruajtur në British Muzeum të Londrës, shpjegohet data e mbytjes së Atlantidës, që ndodhi 8.060 vjet para shkrimit të atij libri, që është shkruajt para 3.400 vjetësh. Po t'i mbledhësh këto dy data, del e njëjtë me atë të saçerdotëve egjyptianë: 11.460 vjet më parë. Në atë libër thuhet se tërmetet në fillim fundosën kodrat prej argjile të qytetit MA, pastaj, mbasi u tund dhe nga dy tërmete të tjera njëri pas tjetrit, u zhduk e gjithë Atlantida brenda një nate. (Vërteton thënien e THOTIT, që shkruan se mblodhi njerëzit gjatë natës dhe pa zbardhë dita u nisën në drejtim të lindjes së diellit).

Një të dhënë tjetër të vlefshme për Atlantidën na e jep përsëri Platoni, duke shkrur se në vitin 9600 p.e.s. luftërat pushtuese të Atlantidës u ndalën në Athinë, e cila i rezistoi dhe i theu sulmet e para të atlantidasve. Gjatë kësaj periudhe lufte ndodhi dhe katastrofa, që shkatërroi e përmbyti Atlantidën dhe Athinën e vjetër.

Duke pa këto gjëra, Zeusi mblodhi Zotërat dhe vendosi t'i ndëshkojë. Kështu shprehet Platoni sipas të dhënave që i kish marrë nga saçerdotët e Egjyptit. Kjo Athinë paraelene ka

qenë Athina me banorë të një gjaku me atlantidasit, pellazgo-ilirë, dhe lufta ka qenë nji luftë civile, vëllavrasëse, gjë që vërteton se qysh në kohë shumë, shumë të lashta e deri në ditët e sotme, Greqia ka qenë territor shqipfolësish, fakt që me të gjitha mënyrat duan ta heqin nga historia.

Historia e Greqisë së lashtë jo pa qëllim fillohet në shekullin VIII p.e.s., por sipas Platonit, i cili i kish marrë të dhënat nga saçerdotët e THOTIT në Egjypt, Athina ka qenë e zhvilluar edhe në kohën e Atlantidës, para 12.000 vitesh, deri në shkatërrimin e saj nga përmbytja bashkë me Atlantidën, gjatë luftës ndërmjet tyre. Pas kësaj të dhëne ka errësirë në historinë e Athinës dhe Greqisë së lashtë deri në shekullin VIII p.e.s., kur fillojnë të zhvillohen qytetet-shtete të Greqisë së Lashtë, me Mikenën, vazhdon me Trojën, Qipron, Athinën etj., ku emrat e vendeve, të perëndive, shkrimet e para të tyre të vjetra marrin kuptim vetëm duke i krahasuar me gjuhën shqipe.

Sipas historianëve grekë, historia e Greqisë fillon vetëm atëherë kur në elementet e gjuhës atlantidase, pellazgo-ilire, filluan të futen elemente të gjuhës greke, në fillim si gjuhë e letrarëve, politikanëve dhe ligjvënësve e më vonë si gjuhë zyrtare e fesë ortodokse. E njëjta gjë shkruhet dhe për historinë e Italisë, e cila nis vetëm me historinë e Romës e vetëm atëherë kur fillojnë të futen elemente të gjuhës romake (latine) në gjuhën e popullit autokton. Populli autokton fliste gjuhën e tij atlantidase, pellazgo-ilire, ariane. Kështu injorohet lidhja e historisë së popullit të këtyre vendeve me vazhdimësinë e historisë së popullit autokton me emnin, Etruskë, Etruria (me tru) Arjanë, Arjanitas (për grekët quhen arvanitas), që e kanë

ruajtë deri në ditët e sotme gjuhën, zakonet e karakterin e tyre kryelartë të shqiptarit, të ardhur nga Atlantida e lashtë.

Sipas shkencës tradicionale, 12.000 vjet më parë njerëzit jetonin në shpella, ndërsa Atlantida kishte një zhvillim që akoma nuk e ka arritë bota, kishte hartën e botës të plotë, një kalendar që i llogariste dhe parashikonte gjërat për 10.000 vjeçarë, udhëtonte me anije kozmike dhe e njihnin botën dhe universin shumë më mirë se në ditët e sotme. Nëse bëjmë një krahasim me ditët e sotme, shohim se edhe sot, në të njëjtën epokë po rrojnë si njerëzit e egër në Amazonën e Amerikës Qendrore, në Australi e Afrikë, ashtu dhe njerëzit modernë, që udhëtojnë me aeroplanë e anije kozmike. Edhe në kohët e lashta mund të ketë ndodhë e njëjta gjë.

*****

Shkencëtarët e sotëm llogarisin se nji katastrofë e rangut të Atlantidës, kur gjithçka u përmbyt brenda një nate, krijon dallgë gjigande oqeanike (siç ndodhi me Tsunamin) e bën të përmbyten dhe shumë vende të tjera të qytetërimeve botërore të përqëndruara në territore fushore dhe afër detrave.

Historia bën hapa prapa e çdo gjë nis nga fillimi, kështuqë edhe në legjenda ruan shumë pak gjëra, ruhet sidomos kujtesa e përmbytjes së madhe që e kanë të gjithë popujt e botës. Njerëzimit i duhen 4.000 deri 5.000 vjet të tjera, që të fillojë të dalë nga primitiviteti e të fillojë të marrë format e qytetë-shteteve, të cilët në vazhdim të historisë së tyre krijojnë shoqërinë e sotme moderne. Këtë gjë e shpjegojnë me zhvillimin e Egjyptit, që filloi të marrë formë vetëm 5.000 vjet pas zhdukjes së Atlantidës, sigurisht, me ndihmën e

saçerdotëve të THOTIT, përndryshe edhe sot do ishim nëpër shpella. Pas Egjyptit filloi të zhvillohej dhe qytetëimi i Mikenës, i Azisë së Vogël, Greqisë e Ilirikutt, që kishin ruajtë nga Atlantida gjuhën e saj, gjuhën shqipe.

Në fund të vitit 2012 (21 dhjetor), sipas kalendarit Maja të Meksikës, (siç e kemi thënë më parë, saçerdotët e tyre ishin pasardhës direkt të saçerdotëve të Thotit), thuhet se mbaron era e pestë e njerëzimit, që zgjati afërsisht 5.125 vjet.

Viti 2013 do jetë vit i ri, i veçantë, sepse në këtë vit sistemi ynë diellor vihet në pozicionin e fillimit dhe ngjarjet do fillojnë të përsëriten: do fillojë epoka e akullnajave, toka do ketë spostime të reja aksi dhe polesh, që do shoqërohen me tërmete e përmbytje. Vini re se si thuhet:

- Do të riketë spostime aksi dhe polesh.

Pra, vini re: në të kaluarën ka pasë spostime aksi dhe polesh dhe kjo gjë do përsëritet. Atëherë shkencëtarët duhet ta kenë parasysh këtë gjë, që në kërkim të vendndodhjes së Atlantidës të marrin parasysh dhe spostimin e poleve.

Në Erën e Gjashtë planetet do kenë ndryshime trajektoresh. Këto ngjarje nuk do të ndodhin në një ditë, por në të gjithë Epokën e Gjashtë të Njerëzimit, e cila, sipas kalendarit Maja, do të ecë më shpejtë se epokat e para. Dikush, duke iu përmbajtë shkrimeve të Thotit, thotë që ekzistenca materiale do të zhduket e do të fillojë ekzistenca shpirtërore, dikush tjetër thotë se botët dhe dimensionet paralele do të takohen dhe do të jemi dëshmitarë të fenomeneve të pabesueshme.

Globi do të rrojë në paqe e pa luftëra për 400 vjet etj. Sipas këtyre shkrimeve, THOTI nuk ka caktuar datë për këto ngjarje.

*****

Sipas mitologjisë së lashtë pellazgo-ilire, "Plaku i Detit", Nereu, që jetonte bashkë me të bijat nereidat e oqeanidat, në një shpellë nënujore të Detit Jon, e dinte "Sekretin e rrugës për te Atlanti dhe Atlantida, në fund të Tokës në Perëndim" dhe ishte ai, që ia tregoi këtë rrugë eksploratorit Herakli...

Në kërkim të Atlantidës, hidhen disa hipoteza se ndoshta Atlantida duhej kërkuar në hapësirën ishullore vullkanike mesdhetare, si në Kreta, madje deri edhe në Trojën e famshme etj. Ndër hipotezat kandidate ka pasur supozime edhe për ishujt Britanikë, për ishujt vullkanikë të Kanarieve dhe Azoreve, për një zonë në Meksikë etj. Duke u bazuar tek Platoni se Atlantida ndodhej përtej "Shtyllave të Herakliut" – Grykës së Gjibraltarit, hipoteza më e fundit, të cilës i kushtohet më shumë vëmendje, është ajo se, Atlantida dhe kryeqendra e saj mund të kishin qenë edhe në hemisferën perendimore, në kontinentin amerikan. Atje janë gjetur edhe rrënojat arkeologjike të një qyteti "me mure të larë në ar" dhe të një perandorie gjigante.

Sipas mitologjisë helene, e cila kishte përvehtësuar nga mitologji më të lashta egjyptiane, asiro-babilonase, fenikase, pellazge etj, Atlanti/Atlasi ishte bir i Japetit dhe i Oqeanisë (Klimenes ose Asia në një variantë tjetër). Atlasi (At-Lashti) ishte mbreti i parë i Atlantidës. Emri **Atlantidë** do të thotë: **Bija e Atlasit**. Atlasi, i rracës së gjigandëve, kishte tre vëllezër: Menezin, Prometeun dhe Epimeteun. Një variantë tjetër e sjell Atlasin si birin e Uranit, dhe vëlla me Kronin, pra si xhaxhai i Zeusit. Kur Zeusi u shpalli luftë gjigandëve dhe e fitoi luftën ndaj tyre, Atlasin e dënoi të mbante "globin qiellor në fund të

botës në perëndim", diku atje te Gjibraltari e te shkretëtira marokene. Po atje, me sa duket e kishte "internuar-dëbuar" edhe bazileusin e lashtë, Gerionin e Trefishtë të Epirit me kopetë e tij, madje e kishte ngarkuar të ruante edhe Hesperidat e Bukura, Pemën e Hesperidave me mollët e arta, ku kishte edhe një gjarpër tinzar. Po ashtu edhe Prometeun e famshëm, që ua vodhi zjarrin perëndive për njerëzit, Zeusi e dënoi të lidhur në një majë shkëmbore në Kaukaz, ku një shqiponjë i hante mëlçinë. Njihet pastaj mitologjia, se si Herakliu (Herkuli) shkoi të vizitonte Atlasin, dhe la si shenjë "Shtyllat e Herakliut" në ngushticën e Gjibraltarit. Në mitologjinë helene njihej ideja se duke shkuar në drejtim të perëndimit arrihej në lindje! Ish mitologjitë e hershme, të përziera edhe me dijenitë më të hershme gjeografike njerëzore u reflektuan të shkruara edhe në një varg autorësh të mëvonshëm antikë, si edhe në arte të tjera, sikurse vërtetohet nga shumë zbulime të objekteve arkeologjike.

Është thënë se vepra "Odiseja/Uliksi" e Homerit realisht, ishte edhe një lloj hartë detare mesdhetare, në të katër kordinatat. Aristoteli më vonë do t'a përkufizonte: se në saje të hegjemonizmit helen, koloni-qytetet helene kuaknin, përreth detit Mesdhe, si bretkocat rreth një pellgu.

Detarët ilirë e dinin rrugën që të çonte në Atlantidë!

Në temën e Atlantit dhe Atlantidës, në mitologjitë e lashta të gadishullit Evropa, një vend zënë edhe territoret e popullsitë iliro-epirote, madje një vend edhe me pikënisjen e hulumtuesit Herakli! Dhe të vjen mjaft hidhur që kjo temë, sado e modës mitologjike, nuk duhej lënë në harresë nga autorët tanë dhe as në errësirën e fundit të detit, për mungesën e kërkimeve arkeologjike nënujore.

3.Atlantida dhe Shqiptarët

Thonë të tjerët, por e themi edhe ne, se Shqiptarët janë populli më i vjetër jo vetëm i Ballkanit dhe i Europës, por edhe i botës. Thonë e shkruhet se Zanafillën e kemi nga Parahistoria njerëzore, kurse me origjinë jemi nga **Atlashtët** (Etërit e Lashtë) të Atlantidës, nga **Pellazgët** e Pellazgjisë, nga **Ilirët** e Ilirisë, nga **Arëbërit** e Arbërisë dhe deri te **Shqiptarët** e Shqipërisë. Kështu, ***populli ynë si zinxhirë i drejtë e i çelikt, ka çarë muzgjet e historisë njerëzore, duke ndërruar, kohë pas kohe, emrin e tij, emrin e atdheut të tij, por kurrë nuk e ndryshoi gjakun, gjuhën, kulturën dhe identitetin e tij kombëtar***.

Thonë e thuhet, por edhe dihet, nga studjuesë shqiptarë dhe të huaj, se të Parët e Shqiptarëve "u lindën" nga dheu (u krijuan prej dheut nga ZOTI – KRIJUESI i Universit), duke i dhënë emrin Tokës – Dheut dhe "Perëndive" të para njerëzore. Ata krijuan dhe zhvilluan kulturën e parë njerëzore, atë të Atlantidës dhe kulturën e dytë njerëzore, atë të Piramidave të Faraonëve (Faraon - Fara jonë).

Pas fundosjes dhe zhdukjes së kontinentit të Atlantidës, pas Përmbytjes së Madhe biblike (rreth 15.000 vite p.e.s.), me "Barkën e Noes" Atlashtët, të prirë nga Profeti i tyre THOTI, u shpërngulën dhe u vendosën rreth brigjeve të detit Mesdhe, pjesa më e madhe e tyre në Egjyptin e sotëm, të cilin atlantidasit e quanin KHEM (KTHEM= Toka e Kthimit), ku themeluan dhe zhvilluan njërën nga kulturat dhe qytetërimet më të vjetra e më mahnitëse të botës njerëzore, e cila ishte dhe është vazhdimësi e kulturës dhe e civilizimit të Atlantidës.

Thuhet e shkruhet nga historianë, arkeologë, filologë dhe etnologë anglezë, amerikanë, gjermanë, italianë, turq, etj.

se, **Hieroglifet** e famëshme të Piramidave egjyptiane kanë domethënie shqipe, flasin shqip, deshifrohen më lehtë e më saktë përmes Gjuhës Shqipe dhe janë të përpiluara nga Thoti pellazgo-ilir, i cili ishte "perëndia" e shkencës dhe e diturisë së Egjyptit të lashtë 6.000 vjet p.e.s. Sipas këtyre shkencëtarëve shqiptarët, hebrenjtë dhe arabët kanë origjinë të njëjtë: nga Atlashtët e Atlantidës, kurse gjuha dhe alfabeti pellazgo-ilir i Hieroglifeve është baza edhe e alfabeteve të mëvonshme, si atij hebrait, samarit, asirik, arabik, grek, etj. Ata pohojnë gjithashtu se, shtrirja gjeografike e pellazgo-ilirëve në kohë tepër të lashta, përfshinte gjithë hapësirën tokësore rreth detit Mesdhe, duke filluar nga Irani (Persia) në lindje, deri në Atlantik në perëndim dhe nga siujdhesa Ilirike, Apenine dhe e Azisë së Vogël në veri, deri në brigjet mesdhetare të Afrikës veriore në jug.

*****

Në qarqet e historiografisë botërore, ekziston një tendencë serioze e dëshmimit të mundshëm të një hipoteze tejet të guximshme se, shqiptarët dhe baskët, janë 2 popuj specifik të Evropës që kanë një prejardhje të lashtë historike, ku zanafillat edhe më të hershme të tyre mund të kërkohen aq larg, deri tek civilizimi i lashtë misterioz botëror, i njohur si Atlantida.

Mundësia e prejardhjes së shqiptarëve nga Atlantida e lashtë legjendare, kuptohet, është totalisht në suazat e një hipoteze të së mundshmes, me tendenca serioze akademike edhe të dëshmimit të saj të afërt materialo-shkencor.

Ashtu siç do të shohim në vazhdim, prejardhja e lashtë e shqiptarëve, ka mundësi të mos fillojë me civilizimin e hershëm pellazg-ilir, por i ka rrënjët shumë thellë e më thellë se sa realisht mendojmë ne vetë.

Se pellazgët dhe ilirët e kanë një prejardhje të lashtë në këto troje dhe se ne jemi pasardhës të denjë të këtyre civilizimeve, flasin shumë studime jo vetëm të studiuesve shqiptarë, por numri më i madh i tyre është nga ata të huajt. Në suazat e shkencës së mirëfilltë, teoria tanimë e dëshmuar e prejardhjes së shqiptarëve të sotëm nga pellazgët dhe ilirët e lashtë, askund nuk kontestohet. Gjurmët e para materiale dhe më të vjetra të ekzistimit të jetës në këto troje, janë zbuluar në fshatin XARRË(afër Sarandës) . Këto janë: vegla pune, armë, stoli, enë nga dheu etj. Prejardhja e tyre daton që nga koha e paleolitit të lartë, që vazhdon afërsisht 40.000 – 6.000 vjet p.e.s. Poashtu është interesante zbulimi në shpellën e Shën Marinës (në Bogaz të Konispolit) të eshtrave të një dhie të egër e cila i takon llojit "Capra Ibex", lloj ky i cili është zhdukur dhe nuk ekziston më, gjë që dëshmojnë mbi ekzistimin e lashtë të jetës në këto troje, me një gjueti të zhvilluar.

Por, hipoteza mbi mundësinë e prejardhjes së shqiptarëve dhe baskëve nga Atlantida legjendare, është diçka krejtësisht tjetër. Diçka më e guximshme dhe më sfiduese e cila, sigurisht gjatë do të mbetet në kornizat e një hipoteze atraktive kureshtare parashkencore. Në fillim të gjetjes së një mbështetje logjike të kësaj hipoteze, kishte për qëllim, që së pari, ta bindi veten time në një mundësi të tillë, e tek pastaj, nëse do të ketë arsye të mjaftueshme, edhe ta argumentoj para të tjerëve.

Baskët janë një popull që jetojnë në pjesën veriore të Spanjës dhe kufizohen me Francën. Sikur shqiptarët, edhe baskët janë një popull që kanë ngjashmëri të ndërsjellët me virtyte të përbashkëta nacionale, sikurse bie fjala: gjuha specifike në krahasim me gjuhët e popujve tjerë të Evropës, pastaj, instinkti i fortë kolektiv i ruajtjes së identitetit etnik, trimëria dhe luftërat e shpeshta për ekzistencë dhe pavarësi. Jo vetëm kaq!

Por, këta popuj i karakterizon deri vonë tendenca e kultivimit të marrëdhënieve fisnore dhe instinkti i fortë i ndjenjës për bashkësi që ishte mjeti i fuqishëm dhe vendimtar të mbrojtjes së gjertanishme të tyre nga kthetrat e pashmangshme të asimilimit gjatë historisë. Andaj, pse pra të mos ketë mundësi dhe bazë logjike, të argumentohet hipoteza se shqiptarët dhe baskët mund të kenë një prejardhje nga Atlantida e lashtë?!

Kuptohet, dëshmi të forta dhe bindëse materiale ende nuk ka. Përveç atyre njohurive të përcipta se: Atlantida ishte një civilizim tejet i përsosur, gjurmët materiale të Atlantidës si civilizim të lashtë edhe sot e kësaj dite nuk ekzistojnë. Vetëm supozohet se ka qenë një ishull i rrethuar nga të katër anët me ujë dhe shtrihej në mes të Oqeanit të sotëm Atlantik, midis pjesës perëndimore të kontinentit të Evropës dhe Afrikës, si dhe pjesës lindore të kontinentit të Amerikës Jugore. Si karakteristikë e popullit të Atlantidës ka qenë inteligjenca e lartë kolektive si dhe sundimi tejet i përsosur i të urtëve që ka zgjatur 13.900 vjet.

Pas lëvizjeve të mëdha tektonike që kanë ndodhur në rruzullin tokësor, janë bërë shumë rivendosje të sipërfaqeve të shumta kontinentale, ku një pjesë e madhe e sipërfaqes së

tokës është zhytur në ujë, kure pjesët tjera janë paraqitur mbi sipërfaqen e ujit, duke krijuar kështu, ujdhesa dhe hapësira tjera të reja tokësore. Shkenca e jonë bashkëkohore, disponon me shumë fakte se para disa mileniumeve toka nuk e ka pasur këtë sipërfaqe sikur e kemi ne tani. Andaj, ka gjasa se një gjë e njëjtë ka ndodhur edhe me Atlantidën e cila mbulohet me ujë, kurse një pjesë e popullatës së saj të mbetur gjallë, për t'i ikur përmbytjes, është shpërndarë në katër anët e botës. Në këtë kontest, duhet të jetë logjike se atdheu i ardhshëm i tyre gjatë ikjeve shpëtimtare të zgjidhet pikërisht bregdeti i rrethuar me vise të larta malore, sepse përherë ka ekzistuar frika nga ndonjë përmbytje tjetër eventuale. Nisur nga njohuria se populli i Atlantidës ka disponuar me një inteligjencë të lartë kolektive (paralelisht,duke mos dyshuar në lëvizjet e mëdha tektonike të sipërfaqes së atëhershme tokësore dhe ujore) atëherë, atlantidasit sigurisht duhet të dispononim me pajisje të përsosura të lundrimit, andaj, edhe mundësia e arritjes së tyre në brigjet e gadishullit ballkanik ka qenë e realizueshme.

Për Atlantidën si paracivilizim i të gjitha civilizimeve, në veprat e veta për herë të parë flet filozofi i madh i Greqisë Antike, Platoni (427 – 347 para e.s.) të cilin e cilëson si një vend (ishull) të madh dhe të fuqishëm, që 9000 vite para kohës së tij, ishte përmbytur në Oqeanin Atlantik.

Ndër popujt e lashtë të botës të cilët me krenari e kanë pranuar dhe kultivuar bindjen se janë pasardhësit e atlantidasve, kanë qenë egjiptasit e lashtë. Nga një papirus i vjetër të zbuluar në muzeun e Petrogradit (Rusi), e cila datonte që nga koha e sundimit të faraonit SENTA, nga dinastia e II-të, përafërsisht para 457 vite para e.s. Ky papirus i ruajtur mirë, qartë dëshmonte se si faraoni Senta ka dërguar ekspeditën

detare kah perëndimi, të pajisur me marinarë të aftë, që ta zbulojnë vendin Atlantida., prej kah, para 3550 viteve pas lindjes së tij, kanë ardhur të parët e egjiptasve, duke sjell me vete urtësinë dhe shkathtësinë fantastike të atdheut të vjetër. Ekspedita detare, pas 6 viteve bredhjeje nëpër det të hapur, është kthyer pa gjetur as këtë popull, dhe as ndonjë të gjallë që do të dëshmonte ekzistimin e asaj toke të zhdukur. Në dorëshkrimin tjetër të gjetur në të njëjtin muze, të shkruar nga historiani i vjetër egjiptas, MANATHON, thuhet: "sundimi i të urtëve në Atlantidë ka zgjatur 13.900 vjet…"

Egjiptasit e vjetër, pra, veten e kanë konsideruar si pasardhësit e atlantidasve, e që kjo për ne do të ketë rëndësi të veçantë gjatë shtjellimit të mëtejshëm të kësaj lënde.

Kush ishte THOTI apo TOTI?

Thoti, tek egjiptasit e vjetër ishte perëndi e mësimit, e shkathtësisë të të shkruarit, e shkencës dhe magjisë; pastaj ishte matës i kohës dhe zbulues i numrave dhe përpilues i hieroglifëve (alfabetit të egjiptasve të vjetër) Pamja e tij përshkruhet si qenie me trup njeriu dhe me kokë të ibis-it (shqipes-shqiponjës). Sipas Katapanos, edhe emri i Thotit ishte fjalë shqipe sepse ka domethënie të qartë shqipe: me thanë, thua, lajmëtarë, besim, mësues, ose me domethënie më komplete: "lajmëtari i Zotit", "Mësues nga Zoti" etj. Sipas tij, nga Atlantida, buron edhe emri i sotëm i Oqeanit Atlantik dhe ATLLASIT (libri hartave të tokës), e që janë fjalë shqipe, sepse Atlantida, gjegjësisht Atllasi, burojnë nga rrënjët e dy fjalëve shqipe: AT-LASH, që do të thoshte: AT-baba dhe LASH-i lashtë, pra stërgjyshi i lashtë. Përveç këtij fakti, Atlantida në shumicën e rasteve emërtohet si "BOREA", e që edhe ky nocion, rrënjën e vetë e ka në shqipen. Bore do të thotë e

bardhë, nga fjala "borë" e shqipes. Nga ana tjetër, BOREA në Egjipt, identifikohet me sfingën. Sfinga ishte në emblemë guri, adhurues i dritës që e personifikonte Zotin. Prandaj, THOTI, sipas gjykimit të Katapanos, nuk i takonte erës së egjiptasve, por asaj të "BOERO-s", d.m.th. të erës së Atlantidës. Sepse, THOTI konsiderohej krijues i doktrinës VRBALO-DRITËS, që u manifestua në tokë. Poashtu, Dielli, ishte simbol i një PERËNDIE, "ATUM ISE TEM", terme këto që kanë shpjegimin ilir-shqip:

Edhe prejardhja e nocionit Ilir, Katapano e konsideron se buron nga shqipja: "me qenë i lirë", sikurse edhe emri shqiptar, burimin e sheh nga termi shqip: SHQIPONJA, e cila e simbolizon dritën, Thotin, Zotin.

Vepra e Katapanos, nuk mbetet me kaq, por ajo shkon me dëshmime edhe më larg. Në të, më tej ai konstaton dhe argumentohet gjerësisht, se i tërë alfabeti i egjiptasve të vjetër (hieroglifët)j si alfabet i parë i përpiluar për shkrim dhe lexim, e ka bazën dhe domethënien e shqipes, nga e cila u formuan edhe bazat e alfabeteve që dihen sot si shkronja latine, shkronja hebraishte, samaritano-palestineze, sirianishtes, arabishtes dhe greqishtes. Të gjitha të theksuarat, Katapano, në studimin e vetë, dëshmon gjerësisht dhe të argumentuar me fakte bindëse, prezantimi i të cilëve, në këtë shkrim revyal, do të ishte tejet i gjatë.

Së fundi, edhe disa fakte historiografike që dëshmojnë lashtësinë e madhe të popullit tonë.

Të gjithëve na është e njohur vepra e Homerit "ILIADA", ku përshkruhet lufta 10-vjeçare e akejve kundër trojanëve, udhëhequr nga komandanti legjendar i fiseve të bashkuara të POLISAVE (qytet-shteteve) të Pellazgjisë - Agamemnoni. Kjo

vepër epike, e shtjelluar shumë mirë dhe me mjaft elemente mitologjike, shkaktoi bujë të madhe jo vetëm në qarqet e historisë letrare botërore si një krijimtari e vlefshme artistike që dëshmonte shkallën e lartë të kulturës antike, por nisur nga përshkrimi tejet i qartë i hapësirës gjeografike të vendndodhjes, ngacmoi historianët dhe arkeologët që të mbështeten në një hipotezë tejet të guximshme se Lufta e Trojës vërtetë ka ndodhur në një kohë dhe hapësirë të caktuar.

Më i zëshmi dhe më këmbëngulësi në këtë hipotezë ishte arkeologu dhe helenisti i madh gjerman Hajnri Shliman (1822-1890), i cili, pas gjurmimeve të bëra arkeologjike arriti të dëshmoj shumë fakte se Troja ekzistonte dhe se e tërë ngjarja nga Epi i Homerit "ILIADA" ka ndodhur me të vërtetë në histori. Duke i bërë gjurmimet arkeologjike, të udhëhequra drejtpërdrejt nga vetë ai, në pjesën perëndimore të Azisë së sotme, ku tani shtrihet shteti i Turqisë, konkretisht, në rrafshnaltën e vendit HISARLIK, arriti të zbuloj gërmadhat e këtij qyteti, dhe kështu, një herë e përgjithmonë e largoi dyshimin se Lufta e Trojës ka ndodhur vërtetë dhe se Epi i famshëm i Homerit "Iliada" e përshkruante pikërisht këtë ngjarje historike.

Pas këtij zbulimi arkeologjik sensacional, me gjurmime të mëvonshme është vërtetuar se Lufta e Trojës është zhvilluar ndërmjet viteve 1194-1184 p.e.s.

E tërë ngjarja rreth Luftës së Trojës për ne fare nuk do të ishte e rëndësishme sikur në vitet e 70-ta, nga ana e studiuesit dhe arkeologut brazilian S. PRAJS, nuk u paraqit vepra e tij e famshme "PUBLIKU I VERBËR I HOMERIT". Në këtë vepër, Prajsi kundërshtonte si me fakte logjike ashtu edhe materiale-shkencore teorinë e gjertanishme dhe zbulimin arkeologjik të

pranuar të Shlimanit se, Troja e vërtetë gjendet në rrafshnaltën e sotme të Turqisë Perëndimore HISARLIK, por ajo shtrihet 180 shkallë në anën e kundërt të rruzullit, saktësisht në gjirin e Bokës së Kotorit, vendosur në mes të trekëndëshit të megjeve të kufirit, Mali i Zi, Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë. Pra, Troja e vjetër shtrihej në territorin e ish-Jugosllavisë. Kjo hipotezë në qarqet e atëhershme shkencore dhe publicistike të Jugosllavisë, bëri një bujë të madhe dhe arriti popullaritet fantastik në opinionin e atëhershëm, për tu zbehur dhe heshtur më vonë në tërësi.

Çka ka ditur ai në të vërtetë për Atlantidën?

Më 20 tetor 1912, në revistën shkencore "NJU YORK AMERIKEN" u botua artikulli sensacional me titull: " SI E KAM ZBULUAR ATLANTIDËN-PARACIVILIZIMIN E TË GJITHA CIVILIZIMEVE?". Autori i këtij dorëshkrimi ishte PAUL SHLIMAN. Dr. Paul Shliman është nipi i Henri Shlimanit të famshëm.

Teksti i artikullit në fjalë ishte: "Disa ditë para vdekjes, në Napoli, më 1890, gjyshi im, Henri Shliman, i ka dorëzuar një mikut të tij të ngushtë zarfin e mbyllur, ku me dorëshkrimin e vet personal ka shkruar : – Le ta hapi këtë letër vetëm ai anëtar i familjes sime i cili do të betohet se tërë jetën e vet do t'ia kushtojë hulumtimeve që janë të përcaktuara në të.

Një orë para vdekjes gjyshi im kishte kërkuar lapsin dhe letër, dhe në të, me një dorëshkrim të lodhur, kishte shtuar edhe një porosi: – Shtesa e fshehtë e asaj që gjendet në zarfin e mbyllur: Thyeje vazon me kokën e sorrës dhe hulumtoje përmbajtjen e saj. Ka të bëj me Atlantidën. Varri, në lindje të gërmadhave të tempullit në Saisu dhe në varrin që gjendet në

rrafshnaltën ÇAKUNA. Me rrëndësi! Do të gjesh dëshmitë mbi vërtetësinë e hipotezës sime. Nata vjen. Lamtumirë!…

Këtë porosi në besim, gjyshi im ia jep një mikut të besueshëm të cilës ia bashkëngjit edhe zarfin e mbyllur, dhe ky të gjitha këto i deponon në një bankë franceze.

Kur i mbarova studimet në Rusi, Gjermani dhe në Lindje, kisha vendosur që t'i vazhdoj gjurmët e gjyshit tim të lavdishëm. Në vitin 1906 veprova ashtu sikurse kishte kërkuar gjyshi, dhe e hapa zarfin. Në te kam hasur në dokumente të ndryshme dhe fotografi, por edhe porosinë: - Ai i cili do ta hapë këtë zarf, së pari duhej të zotohet se do ta vazhdoj rrugën e veprës sime të pakryer… kam ardhur në përfundim se Atlantida e hershme nuk ka qenë vetëm një gërmadhë e qytetit të vjetër që shtrihej ndërmjet kontinentit të Amerikës së sotme dhe brigjeve perëndimore të Evropës dhe Afrikës, por ajo ishte një paracivilizim mbi të gjitha civilizimet ekzistuese që dihen gjer më tani. Në materialet që kam grumbulluar, do të gjenden skica, shënime dhe dëshmi tjera që shpiejnë në zbulimin definitiv të Atlantidës.

Ai që do ta vazhdon veprën time të pakryer, së pari duhet t'i shfrytëzoj të gjitha aftësitë e veta që disponon dhe, së dyti, do ta ketë si obligim që ta publikoj të vërtetën se unë kam qenë iniciator i vërtetë i këtij aksioni.

Banka franceze disponon në trezorin e vet mjete të konsiderueshme financiare që do t'i vihen në dispozicion atij që vendos ta përfundoj këtë iniciativë, e ato mjete sipas mendimit tim duhet të jenë të mjaftueshme për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të këtij aksioni.

4.Zef Katapano: "THOTI FLISTE SHQIP"
(Fragment nga Parathënia e Librit të tij)

Të nderuar lexuese dhe lexues,

...hulumtimet e mëdha që kam kryer me ndihmën e sistemit kritik të krahasimit shkencor të *rrënjëve* të shumë gjuhëve tepër të lashta, si "ESKUERA" baske (E SHKUERA do të thotë në shqip, pikërisht: *gjuha e së shkuarës*), **Shqipes, gjuhëve: Hitite, Hebraike, Aramaike, Arabe, e të tjerave, si dhe veçanërisht të gjuhës Kopte – gjuhës kishtare/liturgjike të të krishterëve të Egjyptit; si dhe studimet shumëvjeçare të rendit filozofik, teofizik, historiko-arkeologjik, etnografik, mitologjik, matematik, kimik, fizik, natyralist, -** *më kanë çuar në përfundimin se duhet përmbysur tradita, që e paraqet qytetërimin* nilotik *si një fryt kryqëzimesh, - në fillim mes racës* lëkurëkuqe *dhe të* zezë, *kurse më pas si kryqëzim i frytit të kësaj "përzierje" të parë me racën e* bardhë *dhe të* verdhë.

*****

Pasi kisha qëndruar gjatë, në persiatje të thellë, në të madhërishmen dhe të shenjtën **Thëna** (Teba, Theva), "*Arkë me njëqint porta*" – siç e përcakton dhe e përshkruan mrekullisht Homeri (Iliada, IX, 381-383), - përpara Pan-Amen-it, vendqëndrim i zotit Amon (emër i përbërë nga fjalët shqipe: A = At, baba; M = Mëmë, nënë; On=Onë=Jonë=Yn, ynë, pra ***AMON=Ati dhe Mëma Jonë***. Dhe mos harroni se **Zoti Një** është mashkull dhe femër në të njëjtën kohë.

Pasi kisha qëndruar për një kohë të gjatë në këtë atdhe mistik të ***besimit më të lashtë,*** dhe ***pas inicimit*** (thellimit, ushtrimit) ***të vështirë të mendjes e të vullnetit***, arrita të kap e

të përvetsoj rrezet më të pastra të ***asaj filozofie të parë shpëtimtare të botës***, ***dlirësia*** së cilës tregon, në mënyrë të patjetërsueshme, të pakundërshtueshme, prejardhjen dhe natyrën e burimit të ndritshëm: **ZOTIN**, menditmin e Tij, të shfaqur brenda relativitetit të asaj kohe dhe hapësire, si ***dritë bardhësore***.

Prandaj, mendoj se shkenca ezoterike e lashtë, e pandryshueshme, e saktë, e mësuar në tempujt e Egjyptit të lashtë – qendër e botës - dhe e rrezatuar ngado në të gjitha drejtimet, është me origjinë ***boreale*** (atlantidase), pikërisht ashtu siç e cilëson ai mbiemër tepër i lashtë, i mbijetuar prej gjuhës së parë amë. Në të vërtetë etimoni (rrënja) ***borea*** vjen nga **borë** – ilirie-shqipe, e cila përgjithëherët (në të gjtha kohërat) ka patur dhe ka ende sot kuptimin ***borë, dëborë***, gjithmonë njësohet, barazohet me bardhësinë, me dritën e bardhë, me ***dlirësinë e zemrave***. Prandaj mbiemërtimi, në rastin e racës sonë, nuk i referohet ngjyrës së lëkurës – që nuk është e bardhë, ***por bardhësisë së papërlyer*** të borës, që përjetësisht mbulon malet e larta, prej të cilëve, në kohë tepër të largëta dhe me valë, zbritën paraardhësit tanë duke pushtuar pak nga pak të gjitha trevat e Europës dhe shumë pjesë të Azisë. Edhe ***arianët*** i përkasin këtij soji të lashtë dhe emri që i cilëson pa përsëri etimonin (rrënjën) e vet në fjalët iliro-shqipe:

a) Ar-i = ar;

b) Arë = të korra, elb, grurë;

për të shprehur dy gjëra: 1. ngjyrën e flokëve të verdha, ngjyrimin e artë të lëkurës, si dhe 2. verdhimin e drithërave, të korrave kur piqen.

Pra, **Arianë = Verdhanë**.

Këto ngjyra (e arta, e verdha), shprehje e niveleve të ndryshme të vibrimit të valëve dritësore, simbolizojnë kushtet dhe pikësynimin e natyrshëm të njeriut, i njejtë për të gjithë: ***mirësinë,*** por vijimësia e të cilit ***është e lehtë vetëm për të paktit, tepër e vështirë për të shumtit.*** Kjo do të thotë, siç na mëson qartë **Thoti**, se ***jeta është ligj i sakrificave*** dhe që për t'u përfshirë si melodi kryesore në kompozimin e harmonishëm të gjithësisë, duhet ditur si të ushtrosh forcë mbi vetveten, duhet ditur si të mirëpërdoret *kontrapunktistika* hyjnore, ligj i pagabueshëm i *matematikës ezoterike*, kumtuar fillimisht nga **Thoti** në tempujt dhe faltoret e Egjyptit, dhe më pas nga dishepujt e tij: ***Hosarsifi*** (Moisiu) tek hebrenjtë; ***Pitagora*** tek kalabro-lukanë-sikulë-puljezët; ***Platoni*** te grekët.

Kjo disiplinë kërkonte një periudhë të gjatë studimi, ushtrimesh, provash tepër të vështira dhe persiatjesh 22-vjeçare, pas të cilave ithtari ishte në gjendje të ngrihej nga toka lart në yje, prej nga edhe vjen fjala e urtë: **Per aspera ad astra** (Prej vështirësishë tek yjet).

Njeriu, i krijuar sipas shembëlltyrës së Zotit, ***zotëron një fuqi krijuese reflektive të pamatë, e aftë për të realizuar gjëra mahnitëse dhe të jashtëzakonshme, që kanë përbrenda të mrekullueshmen;*** **ai** ***ka të rrënjosur thellë fuqinë për kthyer në të mirë të gjitha të këqiat, për të shndërruar çdo ndodhi të papëlqyeshme në një ngjarje lavdie;*** **për t'u shkëputur nga toka e për të fluturuar përherë e më lart, me forcat e veta, drejt ndriçimit të pastër të cikleve më të larta.**

*****

Të gjithë e dimë, se Thoti quhej, nga egjyptianët: "***kumtari i zotave***" apo "***shkruesi hyjnor***". Grekët, gjegjësisht

Pellazgët, e bartën në Olimpin e tyre, ia ndërruan emrin në **Hermes** dhe, mirënjohës për shkencën e lartë që ai i kish përcjellë Solomonit, Pitagorës dhe Platonit, i dekretuan titullin: **"Tre herë i Madh"** ***(Trismegjist/Tresmegistus)***, duke ia ruajtur thuaj të pandryshuara funksionet. Por ia hoqën tiparet tradicionale të ***ibisit*** të shenjtë **– *zogut simbol të shkencës***.

Thoti është themeluesi i ***shkencës së lashtë***: fetare sa edhe laike, krijuesi i muzikës, shpikësi i lirës dhe i shkrimit, autoritet i papërsëritshëm i notës së duhur, i shenjës së saktë, i fjalës së përpiktë të pagabueshme, i këshillës së urtë shpëtuese.

Ai, qoftë te egjyptianët, qoftë te pellazgët emë vonë te helenët, kishte edhe funksionin e ***ndërmjetësit*** mes **Zotit Një – Atum** ose **Zeusit** dhe njerëzve. (.....)

Vetëm mbi kryefjalën e fjalisë: **"Thoti fliste shqip"** mund të shkruash një traktat tepër të vëllimshëm, por nuk është kjo detyra ime. Megjithatë kjo nuk më shkarkon nga detyra për të dhënë një përshkrim në vija të përgjithshme për të, ngaqë bëhet fjalë për ***udhërrëfyesin më të lartë*** të njerëzimit, për themeluesin e shkencës NJË, krejt të përplotësuar, pasi nuk ka mangët asnjë prej degëve apo disiplinave, të cilat përbëjnë krejt dijen.

Thot! Cila është etimologjia e emrit të tij?

Emri përkon përpikmërisht me kuptimin e vet etimologjik (burimor): ***thot-ë***, veta e tretë e të tashmes dëftore të foljes shqipe ***thom, thua***, **thot**'(ë).

(.....)

Thoti është quajtur edhe **TAT.** Emri i parë – Thot shpreh ***natyrën*** dhe ***funksionin***, pra pikërisht ato që kemi mësuar në shkollë.. I dyti – TAT tregon ***ndërtimin*** e tij. Në të vërtetë "TAT" përbëhet nga hieroglifet: , që

fonetikisht tingëllojnë si shkronja: t – a – t, por kuptimi ezoterik i të cilave është ky:

= TORË-A shqip, TORÁ hebraisht

(shpesh e zëvendësuar nga hieroglifi - i, j, y) = e kulluara Dritë Fillestare, Fillesa e Përjetshme e Jetës, ZOTI, njësoj si për Pellazgët e Ilirët, edhe për Egjyptianët dhe Hebrenjtë.

Hieroglifi fundor, i njëjtë me atë të fillimit ( ), tregon gjithmon ***ligjin***, por me kuptimin e relativitetit, pra shpreh ***mënyrësjelljen*** e frymëzuar nga Ligji i Parë; mënyrën se si duhet të sillet njeriu mbi Tokë, si kusht që të ***arrijë qëllimin e tij natyror:*** përplotësimin, ***plotërinë e qenies***, ngritjen e sigurt drejt Qiellit.

Por, edhe duke i anashkaluar këto vlerësime, qoftë edhe vetëm vërtetimi se, ***Thoti e ka ndërtuar alfabetin hieroglifik fonetik duke patur si çelës gjuhën shqipe,*** domethënë, duke marrë për çdo hieroglif tingullin e parë, zanor apo bashkëtingëllor, të ***emrit shqip*** të sendit apo konceptit të përfaqësuar, do të thotë se kam ***zbuluar***, në mënyrë të sigurt dhe pa frikë përgënjeshtrimin se:

1.Zanafilla e ***Ilirishtes*** zbret në kohë mjaft më të hershme se ato që Historia ka përcaktuar; të dhëna që duhet të kthehen në ***neolitik*** dhe ndoshta edhe në kohë të mëparshme, të afërta me origjinën e ***qytetërimit të Nilit*** , i cili, sipas rezultateve më të kujdesshme të hulumtimeve të fundit dhe studimeve të kryera, fillon me zhdukjen e Atlantidës (rreth 12.000 vjet më parë); epokë në të cilën duhet të vendoset pashmangshmërisht shfaqja e parë e vërtetuar e ***Thotit*** në Egjypt.

2.Kjo sjellë si rrjedhojë të pashmangshme korrigjimin e të dhënave historike, kronologjike, etnologjike, filologjike, me rëndësi spikatëse.

3.Të rizbulosh ***Thotin***, do të thotë, të zgjerosh kufijtë e shkencës që, me dashje apo pa dashje, shpien pashmangshmërisht në ***metafizikë***; dhe kjo është tepër e rëndësishme për njeriun e për njerëzimin. Sepse, duke rifituar pas shqyrtimit të çështjes kuptimin e vërtetë të jetës, që është në thelb me natyrë shpirtërore, njeriu do të jetë në gjendje të shijojë sërish gëzimet e shijes, aromave dhe kundërmimeve të ***papërlyera***, brenda vezullimit të lavdishëm të Dritës Fillestare.

Megjithëse kanë arritur në kufijtë e ***Burimit*** të përdritshëm Zanafillor, tek ***Gurra*** e ujit të Gjallë, thuajse përballë fronit të Shkakut Fillestar, shkencëtarët vazhdojnë të enden nëpër terr, *"qui Eam non comprehendérunt"* dhe, të verbuar prej kokëfortësisë, të çorientuar, rrezikojnë të bien përsëri në honin kërcënues, të tërhequr nga materializmi banal. Kjo është pamja e *shkencës moderne*, rezultati i *çarjes* së hapur nga Koperniku midis ***fizikës*** (dijes relative) dhe ***besimit*** (njohjes së Zotit). Dhe në këtë *çarje* përsëritet britma kryelartë e *Luciferrit* kundër ***Zotit***, të xhuxhit kundër titanit, të *kalimtares* dhe *shtegtares*, kundër të përjetshmit realitet thelbësor NJË, duke krijuar brenda të ashtuquajturës *"shkencë laike"* kushte për armiqësi ndaj jetës.

Shkenca, që në kohët tona është bërë aq arrogante sa edhe vanitoze, na ofron vërtetë një *mundësi vigane*, por aq *shumë groteske!* Cilën? Është gjithnjë fizikanti i madh Hajter, që flet:

"Mundësinë për ta asgjësuar krejtësisht jetën mbi këtë tokë, qoftë nëpërmjet shpërthimesh bërthamore, qoftë

nëpërmjet bakterieve, ndërkohë që nuk jemi në gjendje të krijojmë as edhe një qelizë të vetme të gjallë".

Sigurisht që nuk mund të përfytyrohet një dalldi më e kobshme! Por a nuk ka qenë pikërisht kjo ***shkencë laike***, **pa Zot**, ajo që ka krijuar mjete reale për këtë mundësi?!

(.....)

*****

Filozofia e ***Thotit*** ngrihet mbi shtatë parime, që këtu vetëm do t'i parashtroj.

1.Parimi i Mendorësisë (Principio del Mentalismo)

"Gjithçka është shpirtërore; gjithçka është mendore".

2.Parimi i Përkitshmërisë
(Il Principio della Corrispondenza)

"Ajo që është Lart është si ajo që është poshtë; ajo që është Poshtë është si ajo që është Lart".

3.Parimi i Vibrimit (Il Principio di Vibrazione)

"Asgjë nuk është në gjendje pushimi; gjithçka lëviz; gjithçka regëtin".

4.Parimi i Polaritetit (Il Principio di Polaritá)

"Gjithçka është dyshe; ;cdo gjë ka dy pole; gjithçka ka dy skaje; e ngjashmja dhe e pangjashmja kanë të njëtin kuptim; polet e kundërt kanë natyrë të njëjtë, por shkallë të ndryshme; skajet takohen; të gjitha të vërtetat, në relativitet, janë gjysëm të vërteta; të gjithë paradokset mund të të pajtohen".

5.Parimi i Ritmit (Il Principio del Ritmo)

"Gjitha rrjedh, brenda dhe jashtë; çdo gjë ka kohëzgjatjen e vet; gjithçka zhvillohet dhe pastaj degradon; lëkundjet e

lavjerrësit shfaqen në gjithçka; masa e një lëkundje në të djathtë përgjason me atë të lëkundjes në të majtë; ritmi është konstant (i përhershëm)".

6.Parimi i Shkakut dhe Pasojës

(Il Principio di Causa e d'Efetto)

"Çdo shkak ka pasojën e vet; gjithçka ndodh dhe realizohet në përputhje me Ligjin; ka shfaqje të shumta rastësie, por asgjë nuk i shpëton Ligjit".

7.Parimi i Gjinisë (Il Principio del Genere)

"Ka një gjini në të gjitha gjërat; gjithçka përmban qoftë parimin mashkullor, qoftë atë femëror; Gjinia shfaqet në të gjitha rrafshet; në botën Fizike, Qiellore apo Shpirtërore".

*****

Mbi këtë parim të fundit i ngre themelet e gjithë fizika, kimia moderne, gjithë teoria e *energjive.* Ndryshon vetëm emërtimi: energjinë e *elektronit* modernët e quajnë *negative*, ndërkohë që ithtarët e Thotit e quanin *femërore*; energjia e *protonit* quhet *pozitive* nga modernët, ndërkohë që ithtarët e Thotit e quanin *mashkullore.*

Mbi këto ***shtatë parime*** mbështetet e gjithë *shkenca moderne;* por kjo nuk është veçse një anë, më pak e rëndësishmja, ***e krejtë shkencës NJË*** të Thotit. Prej asaj *dije isiake* (isiake = ***prej Isës*** = ***prej Dritës***); (si përherë, edhe këtu, futet në valle gjuha shqipe, ngaqë ***isë*** në arbërisht do të thotë pikërishtë ***dritë),*** kemi zbuluar fare pak, për shkak të materializmit tonë agnostik, të pandiesisë sonë shpirtërore përpara të **Vërtetës Një**, ndonëse fare të dukshme, verbuese.

(.....)

Unë, ngaqë përkundër të gjithëve, jam *optimist*, plot mirësjellje ju bëj thirrje të gjithëve që t'a zgjasin pësëri veshin ndaj zërit të ***Lajmëtarit të Parë të Fjalës***, **Thotit**:

"Shikoni me kujdes te vetvetja dhe në Pafundësinë e hapësirës e të kohës. Aty jehojnë kënga e Yjeve, zëri i Numrave dhe harmonia e Rruzujve. Çdo diell është një mendim i Zotit dhe çdo planet është një formë e këtij mendimi. Dhe pikërisht për të njohur *Mendimin Hyjnor* njerëzve u janë hapur rrugët e Qiellit. *Ç'bëjnë Yjet? Ç'thonë Numrat? Ç'vlerë kanë Rruzujt?"*.

Këto fjalë realizojnë një mendim, shprehin një trajtshmërinë e Ligjit, vlejnë për të treguar se shestimi i Zotit është i harmonishëm, i dashur, i patregueshëm, i dhembshur; që synon t'i japë njeriut, të bërë sipas shembëlltyrës së Tij, *të gjithë dijen,* nga e cila zbresin si rrjedhojë e pashmangshme lumturia e plotë dhe pavdekësia e lavdishme.

Thoti ka hedhur mbi botë lumenj drite; dritë që synon të kumtojë, që në zanafillë të kohërave, ardhjen e *Fjalës*, së Cilës nuk i caktoi ndonjë emër, pasi emri i të Patregueshmes me gojë, në lashtësi ishte *i ndaluar të shqiptohej*. Si një emërtimi që i përafrohet disi, Hebrenjtë konsiderojnë fjalën ***Shehinah = prania e Zotit mes nesh.*** (**Shehinah** vjen nga folja shqipe: ***shoh, sheh***. **Sheh – I - nah = Sheh – Zoti – na**, "Zoti na sheh", metaforikisht: **"*Zoti është midis nesh*"**). Dhe Zoti është mishëruar, ka ardhur vërtetë mes nesh dhe na ka dhënë dëshmi të pafundme të Dashurisë, ashtu si vetëm Zoti mund të japë, *pa kundërshpërblime.*

"Drita e vërtetë ka ardhur mes nesh, por ne nuk e kemi dalluar", pasi ngulmojmë që të shohim vetëm me organin lëndor të

shikimit, ndërkohë që, për të hyrë në thelbin e gjërave, duhet vështrim i brendshëm i Shpirtit; pra është e nevojshme t'i japim krahë shpirtit. Vetëm kështu, siç na paralajmëron një i inicuar "laik" i shkencës së Thotit, ***Pindari,*** do të mund t'i arrijmë të fshehtat dhe t'i kuptojmë ato; vetëm kështu do të njohim zanafillën dhe fundin e jetës.

(.....)

*****

Në veprën **"Thoti Fliste Shqip"** kam parashruar, përtej zbulimeve gjuhësore, filologjike, ***një të vërtetë të rendit sipëror***: i kam hequr Thotit maskën shumëmijëvjeçare të ***ibisit*** dhe i kam kthyer fytyrën e vërtetë: ***fytyrën boreale të Ilirit (Ilir është i njëvlershëm me Shqiptar,*** domethënë Bir i LIRISË dhe i DRITËS. Në të vërtetë, **ilir** në shqip do të thotë **i lirë** dhe ***shqiptar*** do të thotë ***bir i shqiponjës;*** dhe ju të gjithë e dini se shqiponja, zog i lartësive të mëdha; simbolizon që në lashtësi: ***dritën.***) I kam rikëthyer pra, Thotit, shembëlltyrën e tij të njëmendtë të ***Udhërrëfyesit më të Lartë, të themeluesit të shkencës së lashtë***, që përfshinte të gjitha degët e shkencës moderne, madje edhe të tjera, ende të parizbuluara nga kjo e fundit.

Për këtë arsye, titulli: ***"Thoti fliste Shqip"*** mund të zëvendësohej nga një tjetër, i njëvlershëm por më i qartë:

- THOT-i BOREAL, ILIRO-SHQPTAR,
I DHA BOTËS KUMTIN E PARË TË LIRISË DHE TË DRITËS

Zef Katapano
Romë, 10 shkurt 1984

5. Maurice Doreal:
Origjina e Pllakave prej Smeraldi të Thotit

Historia e pllakave që janë të përkthyera në faqet e mëposhtme, është e çuditshme dhe përtej besimit të shkencëtarëve modern. Lashtësia e tyre është e mahnitshme, ato datojnë larg rreth 36.000 vjet para Krishtit. Autori është Thoti, një Mbret-Prift Atlantidas, i cili, pas fundosjes së vendit amë, themeloi një koloni në Egjiptin e lashtë. Ai ishte ndërtuesi i Piramidës së Madhe të Gizës, e cila gabimisht i është atribuar Keopsit. Në të përmbahet dija e tij e mençurisë antike, gjithashtu dhe dokumentat dhe instrumentat sekrete të Atlantidës së lashtë. Për rreth 16.000 vjet, ai mbretëroi racën e lashtë të Egjiptit, afërsisht nga 52.000 para Krishtit deri më 36.000 para Krishtit. Në atë kohë, raca barbare e lashtë mes të cilëve u vendos ai dhe ndjekësit e tij, u ngritë në një shkallë të lartë qytetërimi. Thoti ishte një i pavdekshëm, domethënë, ai kishte fituar mbi vdekjen, duke kaluar vetëm kur ai e dëshironte, madje dhe atëherë jo nëpërmjet vdekjes. Mençuria e tij e madhe e bëri atë kreun e kolonive të ndryshme të Atlantidës, midis të cilave edhe të atyre që emigruan në Amerikën Qendrore dhe Jugore. Kur erdhi koha që ta linte Egjiptin, Thoti ngriti Piramidën e Madhe përmbi hyrjen për te Sallat e Mëdha të Ament-it, vendosi regjistrimet e tij në të, dhe caktoi, midis më të zhvilluarve nga njerëzit e tij, roje për të ruajtur sekretet e Piramidës. Në kohët e mëvonshme, pasardhësit e këtyre rojeve, u bënë priftërinjtë e piramidës, në të cilën Thoti adhurohej si Zoti i Mençurisë, Dokumentuesi i tyre në epokën e errësirës që pasoi kalimin e tij. Sipas legjendës, Sallat e Amenti-t u bënë bota e nëndheshme, Sallat e

zotave, ku shpirti kalonte për gjykim pas vdekjes. Gjatë epokave të mëvonshme, egoja e Thotit kaloi në trupat e njerëzve në mënyrën siç është përshkruar në pllakat. Kështu, ai u rimishërua tre herë, në të fundit njihet si Hermes, treherë-i linduri. Në këtë mishërim, ai la dorëshkrimet që nga okultistët modern njihen si Pllakat e Smeraldta, një paraqitje më e vonë dhe nga më të paktat e mistereve antike. Janë dhjetë pllakat e përkthyera në këtë punim, të cilat iu lanë priftërinjve të piramidës në ruajtje në Piramidën e Madhe. Të dhjetat janë ndarë në trembëdhjetë pjesë për komoditet. Dy të fundit janë kaq madhështore në rëndësinë e tyre, që për momentin është e ndaluar ta publikojmë për të gjithë botën. Megjithatë në këto fakte të këtij libri ndodhen sekrete, të cilat, për studentin serioz, do të dëshmojnë vlera të paçmuara. Ato duhet të lexohen jo një herë, por qindra herë, sepse vetëm në këtë mënyrë mund ta zbulojnë kuptimin e vërtetë. Një lexim i rastësishëm do të japë rreze bukurie, por një studim më intensiv do të hapë kanale të mençurisë dhe të dijes kurrë të njohura nga mendja njerëzore. Ja tani dy fjalë për mënyrën se si këto sekrete të fuqishme iu zbuluan njeriut modern, pasi ishin mbajtur të fshehura për një kohë të gjatë. Rreth 1300 vjet para Krishtit, Egjipti, Khemi i lashtë, ishte në trazira dhe shumë dërgata priftërinjsh u dërguan në pjesë të tjera të botës. Midis tyre ndodheshin disa priftërinj të piramidës të cilët morën me vete Pllakat e Smeraldta si një hajmali nëpërmjet të cilës ata do të ushtronin autoritetin e tyre mbi klerikët më pak të zhvilluar, pasardhës gjithashtu të kolonive të tjera të Atlantidës. Sipas legjendës, Pllakat i jepnin mbartësit autoritetin e Thotit. Grupi i veçantë i priftërinjve, që mbarti pllakat, emigroi në Amerikën Jugore ku ata gjetën një racë të

zhvilluar, Maya-t të cilët kishin ruajtur shumë nga mençuria e lashtë. Priftërinjtë u vendosën dhe qëndruan midis tyre. Në shekullin e dhjetë, Mayat ishin të vendosur në krejt Yukatan-in, dhe pllakat ishin vendosur poshtë altarit të njërit prej tempujve të mëdhenj të Zotit Diell. Pas pushtimit të Maya-s nga Spanjollët, qytetet u braktisën dhe thesaret e tempullit u harruan. Duhet të kuptohet se Piramida e Madhe e Egjiptit ka qënë dhe është akoma një tempull i fillesës i njohjes me ritet e shoqërisë së fshehtë për tek misteret. Jezusi, Solomoni, Apolloni dhe të tjerë i kanë atje fillesat e tyre. Autori i këtyre rreshtave (i cili është i lidhur me Lozhën e Madhe të Bardhë e cila gjithashtu punon nëpërmjet priftërisë së piramidës) u udhëzua t'i gjente dhe t'i kthente pllakat në Piramidën e Madhe. Pas aventurash të cilat nuk është e nevojshme të citohen këtu, kjo punë u krye. Para se t'i kthente, atij iu dha leja t'i përkthente dhe të mbante një kopje të mençurisë së gdhendur në pllakat. Kjo ndodhi në vitin 1925, dhe vetëm prej pak kohësh është dhënë leja për t'i publikuar. Është parashikuar që shumë njerëz do t'i përqeshin. E megjithatë student i vërtetë, që do të lexojë përmes rreshtave, do të fitojë mençuri. Nëse drita është tek ti, drita që është gdhendur në këto pllaka do të të përgjigjet. Ja tani dy fjalë për aspektin material të pllakave. Ato përbëhen nga dymbëdhjetë pllaka smeraldi të gjelbër, të formuar nga një substancë e dalë prej shndërrimeve alkimike. Ato janë të pashkatërrueshme, iu rezistojnë të gjithë elementëve dhe substancave që njohim. Në fakt, struktura atomike dhe molekulare është e qëndrueshme, nuk pësojnë asnjë ndryshim, proceset e kohës nuk ndikojnë mbi to, meqenëse nuk ndikojnë proceset kimike mbi to. Një fenomen i tillë hedh poshtë ligjin e jonizimit. Mbi të janë

gdhendur shenja në gjuhën e lashtë të Atlantidës: shenja të cilat iu korrespondojnë valëve të caktuara të mendimit, që çlirojnë vibrimin korrespondues mendor në mendjen e lexuesit. Pllakat janë kapur së bashku më rrathë të një aliazhi (lloj lidhje) ngjyrë të artë, e varur në një purtekë prej të njëjtit material. Kaq për sa i takon aspektit material.

Mençuria që ndodhet në to është themeli i mistereve antike. Kushdo që do t'i lexojë me zemër dhe mendje të hapur, mençuria e tij do të rritet në mënyrë të ndjeshme. Lexo! Beson apo jo, por lexo! Dhe vibrimi i rigjetur do të rizgjojë një përgjigje në shpirtin tënd.

Në faqet e mëposhtme, unë do t'ju zbuloj disa nga misteret të cilat vetëm sa janë prekur lehtë si nga unë, por edhe nga të tjerë mësues apo studentë të së vërtetës. Është i pafund kërkimi njerëzor për kuptimin e ligjeve që rregullojnë jetën, e megjithatë e vërteta ekziston gjithmonë mbas pëlhurës që mbron planet më të larta të ekzistencës nga vizioni material i njeriut, e gatshme të asimilohet nga kushdo që zgjeron vizionin e vet për nga brenda, dhe jo drejt asaj që ndodhet jashtë. Në heshtjen e shqisave fizike ndodhet çelësi për zbulimin e mençurisë. ***Ai që flet, nuk di; ai që di, nuk flet.***

Dija më e lartë është e pashqiptueshme, që s'mund të përshkruhet me fjalë, ajo ekziston si një realitet në pista e cila kapërcen të gjitha kufijtë e logjikës së fjalëve apo simboleve fizike. Të gjitha simbolet janë veç çelësa te dyert që çojnë te të vërtetat, dhe, shumë herë, dera nuk hapet sepse çelësi duket kaq i madh saqë gjërat, të cilat janë përtej, nuk mund të jenë të dukshme. Kur ne të kuptojmë se të gjitha çelësat dhe të gjitha simbolet fizike janë manifestime, shtrirje të një ligji e të vërtete të madhe, atëherë do të fillojmë të zhvillojmë vizionin që do të

na lejojë të çajmë errësirën. Të gjitha gjërat, në të gjitha universet, lëvizin në përputhje me ligjin, dhe ligji, i cili rregullon lëvizjen e planeteve nuk është më i pandryshueshëm se ligji që rregullon qënien fizike të njeriut. Një nga ligjet më të mëdha nga të gjitha Ligjet Kozmike, është ai që është përgjegjës për formimin e njeriut si një qënie fizike. Objektivi i madh i shkollave të misterit të të gjitha kohërave ka qënë të zbulojë funksionimet e Ligjit që lidh njeriun si trup fizik dhe njeriun si qënie shpirtërore. Njeriu intelektual është hallka lidhëse ndërmjet njeriut si trup fizik dhe njeriut si qënie shpirtërore, sepse mendja bën pjesë si në cilësitë fizike ashtu dhe në cilësitë jofizike. Kandidati për dije më të larta duhet të zhvillojë anën intelektuale të natyrës së tij dhe kështu forcon vullnetin e tij në mënyrë që të jetë në gjendje t'i përqëndrojë të gjitha fuqitë e qënies së tij dhe në planin e ekzistencës që ai dëshiron. Kërkimi i madh për dritë, jetë dhe dashuri vetëm sa fillon në planin material. Duke u mbartur në absolutin e vet, qëllimi i tij final është të jetë plotësisht një me ndërgjegjen universale. Hapi i parë është vënia e themeleve në nivelin material; pastaj vjen qëllimi më i lartë i arritjes shpirtërore.

Në faqet që vijojnë, unë do të jap një interpretim të Pllakave të Smeraldta dhe sekretin e tyre, kuptimet e fshehta dhe ezoterike. (Bashkë me publikimin e përmbajtjes së pllakave, Doreal ka dhënë edhe një interpretim të tij mbi kuptimin e secilës pllakë – shënim i përkthyesit.) Në pllakat, shumë fjalë të Thotit fshehin kuptime që nuk duken në një lexim sipërfaqësor. Drita e dijes, e aplikuar në Pllakat, do të hapë kanale dhe forma të reja mendimi.

"Lexo dhe bëhu i zgjuar!" "Lexoni dhe do të jeni të mbushur me dituri", por kjo do të ndodhë vetëm nëse **Drita** e

ndërgjegjes suaj do të rizgjojë mirëkuptim të thellë dhe vlera reale të shpirtit.

6.Disa fjalë nga Alessandro Marcon

Shkenca e ka të pamundur t'i pranojë Pllakat e Thotit, sepse po t'i pranojë, do t'i duhet të rishikojë të gjitha teoritë e saj, studimet dhe përfundimet e tyre, aq fort të propaganduara deri në këtë moment. Për shkencën dhe për krerët e diturisë së gënjeshtërt, do të nënkuptonte kthimin në bankat e shkollës, por kësaj radhe si nxënës e jo më si profesorë të nderuar. Personalisht nuk kam besuar kurrë që piramidat të jenë ndërtuar nga egjiptianët. Është po aq e vërtetë se kanë dështuar të gjitha tentativat e arkitektëve më të mëdhenj të kohës sonë për të ndërtuar një piramidë të tillë. Dhjetë pllakat janë ndarë në trembëdhjetë pjesë për komoditet. Për komoditetin e kujt dhe përse? Duhet patjetër t'i ndryshojnë gjërat edhe kur nuk është absolutisht e nevojshme. Pllakat u shfaqën për herë të parë në Mesjetë, por është e panjohur mënyra si u rigjetën. Asnjë nuk e di me saktësi si u gjetën. Disa kërkues hipotezojnë se janë gjetur në një nga dhomat e Piramidës së Keopsit, por janë thjesht supozime, mbetet vetëm fakti që Thoti figuron si një Zot në zbukurimet pikturore të Egjiptit të lashtë. Shkenca nuk e merr në konsideratë faktin që Pllakat nuk pësojnë asnjë ndryshim me kalimin e kohës, njësoj siç bën papa që nuk do që të flitet për ungjillin sipas Judës Iskariot, sepse po ta pranojë si autentik, do të shemben të gjitha gënjeshtrat për Jezusin dhe, bashkë me to, do të shemben edhe ungjijt e Biblës.

I.ZANAFILLA JONË KOMBËTARE

1.Historia jonë e fshehur dhe e cunguar!

Shumeria dhe Sumerianët janë djepi i vërtetë i kulturës botërore pas Atlantidës, kurse gjuha e tyre është Shqipja.

Në librat e shkollës 8-vjeçare apo të mesme kemi mësuar se Lajbnici, matematikani e filozofi gjerman i shekullit të 17-të, ishte njëkohësisht edhe albanolog i madh. Ndokush pyeste se ç'lidhje ka albanologjia me matematikën, por nuk gjente përgjigje në ato libra. Asnjëherë nuk është përmendur thënia e tij se: "**nëse doni të zbuloni historinë para Krishtit dhe shkencat e asaj kohe, duhet të studioni gjuhën shqipe".**

Ndërsa i madhi profesor Eqrem Çabej thotë se "historia e gjuhës është historia e popullit që e flet".

Krenaria kombëtare, identiteti kombëtar apo patriotizmi kërkon një mbështetje të fuqishme e reale, përndryshe ajo nuk mund të jetë një shtysë drejt përparimit kombëtar, por kthehet në parullë pa vlerë. Krenaria kombëtare është baza më e thellë morale e njeriut, stimulimi moral më i natyrshëm në gjithë aktivitetin e tij. Formimi i personalitetit të çdonjërit prej nesh bazohet në radhë të parë në respektin ndaj vetes dhe kombit, prandaj njohja e historisë së kombit është elementi fillestar i kulturës.

Ne shqiptarët duhet të mësojmë nga fqinjët një gjë: presioni është art më vete dhe, si i tillë, duhet patjetër të përdoret vazhdimisht, e sidomos kur raporti i forcave nuk është në anën tonë. Për këto arsye, identitetit tonë kombëtar duhet ti hiqet mbulesa e rëndë mijëravjeçare e mosdijes dhe e

harresës dhe media e shkruar dhe ajo vizive duhet t'u bëjnë një reklamë të madhe studimeve dhe zbulimeve të fundit apo të mëparshme për gjuhën shqipe dhe identitetin tonë kombëtar. Gjithashtu historianët e gjuhëtarët tanë duhet të jenë shumë më aktivë sot.

GJUHA është themeli i kombit, ajo që na bën të veçantë nga të tjerët. Ne shqiptarët krenohemi mjaft me Heroin tonë Kombëtar Skënderbeun, si pjesë madhore e mozaikut tonë të identitetit, që shpesh përpiqen të na e vjedhin, sidomos t'ia ulin vlerat. Megjithatë, duhet pasur parasysh se Skënderbeu i përket një periudhe mjaft më të vonshme kohore se sa zanafilla e kombit tonë, e cila shtrihet në mijëvjeçarë. Pra, aftësia konkurruese që nevojitet për të shërbyer si shtyllë qendrore e krenarisë kombëtare, e identitetit tonë kombëtar kufizohet, për arsye se i duhet të përballet me identitetin e kombeve të tjera, që janë bazuar përgjithësisht në periudha kohore mjaft më të hershme dhe në vazhdimësi. Në mënyrë që krenaria kombëtare të ulet këmbëkryq në subkoshiencën tonë për të na dhënë qetësinë, forcën dhe stimulimin e pakrahasueshëm dhe aq të nevojshëm sot, na duhet të bazohemi në një shtyllë mjaft më të vjetër në kohë, rreth së cilës të mund të mblidhet e të qëndrojë fort i gjithë mozaiku gjigant i historisë sonë, i identitetit tonë kombëtar.

Historia është politikë, krenari dhe unitet, forcë shtytëse e kombit. Prandaj çdo shtet dhe çdo klasë politike duhet të investojë më shumë për zbulimin e saj. Dikush thotë: "Ç'na duhet historia?!" Le të shohim Amerikën, që me pak histori, vetëm 200 vjet, ka arritur majat, dhe të ecim përpara pa u interesuar për historinë. Por njëkohësisht ata thonë edhe se nuk ka dokumente historike në shqip, se ne nuk paskemi as

histori, as heronj, pra jemi kot! Por të gjithë e kuptojmë se, kur mendon se je kot, vetëm demoralizohesh e nuk shkon përpara. Arrijnë deri aty sa anashkalojnë paturpësisht shqiptarizmën!! "Do të hyjmë në Europë", - thonë. Por aty duhet hyrë me dinjitet e identitet, jo nga derëza e pasme.

Gjithashtu duhet të kuptojmë se për shkak të ndarjes së kufijve që kemi sot ne shqiptarët kemi ndjesi e koncepte më të ngushta apo më të ulëta për veten, krahasuar me ato të shekullit të 19-të e më parë. Ndarja jo e favorshme e kufijve siç janë deri sot solli nevojën për korrigjimin, në fakt dëmtimin e vetëdijes sonë kombëtare.

Pse na pranon me vështirësi Europa, vetëm për nivelin e sotëm, apo sepse ajo dhe ne vetë nuk e njohim prejardhjen tonë, historinë dhe zanafillën tonë, me të cilën të prezantohemi në Europë? Edhe në një prezantim të thjeshtë midis njerëzve të panjohur ne kërkojmë të dimë për prejardhjen e personit që kemi përballë. Mosnjohja sjell frikë dhe pasiguri. E njëjta logjikë vlen për marrëdhëniet midis shteteve.

E pra, Europa nuk na pranon, nuk na jep vizë, nëse nuk njohim dhe nuk ia tregojmë asaj historinë tonë, elementin fillestar të kulturës. Arma jonë kryesore, shtylla e identitetit tonë, me të cilën do të përballemi me konkurrentët tanë për të rivendosur historinë, duhet dhe do të jetë veçoria bazë e ekzistencës së një kombi, pra GJUHA. **Shqipja është GJUHA E PARË E SHKRUAR NË BOTË, është GJUHA E FILLIMIT!** Po, po, mos çuditeni, provat janë të shumta dhe sistematike. Ato gjenden në mbi 200 000 "libra" (pllaka me shkrim kuneiform) të kulturës më të lashtë të botës - asaj **sumere**. Pasardhësit akkadianë e babilonas e kanë quajtur atë vend Super (Shumer) apo "Shumë Erë". Vetë shumerët e quanin KI

E NGIR, që do të thotë **"tokë e ngirë", e nginjur, e ngopur, e begatë.**

Provat gjenden edhe në 3-4 miliardë kopje të Biblës në të gjithë botën. Besohet se tregimet biblike, veçanërisht kapitulli i parë, zanafilla/genesis, janë me prejardhje nga shkrimet e pllakave sumere si "Eposi i krijimit".

Bibla është përkthyer në mbi 2000 gjuhë të ndryshme, por pjesa e parë e 39 librave përbërës të "Dhiatës së Vjetër", e quajtur "Zanafilla", paragrafi 6:4, e përmban provën SHQIP me fjalët "në fillim". Ajo ka qenë problem i madh për përkthyesit, të cilët përfundimisht e kanë lënë në gjuhën origjinale dhe kështu shprehja "në fillim" është një nga provat më të rëndësishme për prejardhjen nga gjuha shqipe edhe të tregimeve biblike.

Një provë tjetër, përsëri në Bibël, është fjala "mallkim", e shkruar si "Malakhim", në "Zanafilla" – 18:20, 19:12.

Prova më e fuqishme për zanafillën e identitetit shqiptar është e lidhur me popullsinë e lashtë **Sumere** e përqëndruar midis lumenjve Tigër dhe Eufrat në Mesopotami apo Irakun jugor të sotëm. Të mbiquajturit sumerianë janë realisht gjeneza apo zanafilla e njerëzimit, djepi i gjithë kulturës botërore. Shumëkush e pranon tezën se Bibla është histori e njerëzimit dhe ajo thotë se FILLIMI është në Mesopotami. Mos jemi ne pasardhësit e sumerëve? Po atëherë nuk qenkemi autoktonë? Jo, ne jemi po aq autoktonë sa gjithë europianët. Jemi këtu që nga periudha parahistorike, që nga koha e dyndjeve indoeuropiane, që nga koha e shkatërrimit të **Shumerit**.

Vini re gjithashtu se nga materialet e shumta figurative, edhe tredimensionale të zbuluara e analizuara del se nga pikëpamja racore sumerianët nuk ishin afrikanë me buzë të

trasha, siç mund të aludojë ndokush, por kishin tiparet mesatare të racës së pastër shqiptare.

Në hierarkinë e historisë antike shumerët vendosen përpara akkadianëve, babilonasve apo egjyptianëve. Sumerët kanë lënë një trashëgimi mjaft të gjerë e mjaft të pasur në të gjitha fushat, e shkruar në mbi 200 000 "Libra"/ pllaka me shkrimin në formë ***kunji*** ose ***kuneiform***, i gdhendur mbi argjilë, e cila më pas piqej e kështu ka mbërritur deri në ditët tona në materialet e shumta arkeologjike që gjenden në shumë muze dhe universitete të botës. Gjuha sumeriane është gjuha e parë e shkruar në botë me shkrimin kuneiform piktografik e më pas me kuneiform abstrakt. Sa u përket periudhave kohore ka mendime të ndryshme, ku përmenden fillimi në vitet 13000 p.e.s., pas Përmbytjes së Madhe, ose periudha e quajtur "klasike" midis 5300 deri 2900 p.e.s. Gjuha sumeriane mendohet se u fol deri nga fundi i mijëvjeçarit të tretë para Krishtit, midis 2300-2100 p.e.s., kohë kur ka një shkëputje dhe vendin e saj e zënë perandoritë akkadiane dhe babilonase. Shkrimi kuneiform u përdor edhe nga Akkadët e Babilonasit dhe gjuha sumeriane besohet se është shkruar në fjalorët e ndryshëm deri në vitet 200 të erës sonë..

Gjatë mijëvjeçarit të tretë p.e.s. duhet të ketë ndodhur edhe shkatërrimi i kulturës së madhe sumere, ngjarje e cila rezulton e vërtetuar nga dy fakte: shkatërrimi i qyteteve të Sodomës dhe Gomorës, sipas Biblës, dhe dy dokumentet e gjetura në pllakat sumeriane, të cilat flasin për shkatërrimin e Shumerit:

1) "Erra Epic" ose "Eposi i Erës" (sumerian = "Erra") dhe

2) "Lamentation over desolation of Shumer", -"Vajtimi për shkatërrimin e Shumerit".

Nga përkthimi i tyre në anglisht kuptohet se aty flitet për një erë të fortë shkatërrimtare dhe vrasëse e sëmundjesjellëse, e cila çoi në zhdukjen përfundimtare të të gjithë kulturës dhe jetës në Shumer. Ky shkatërrim duhet të jetë shoqëruar edhe me dyndje të popullsisë së mbetur gjallë në drejtim të veriut e veriperëndimit. Pranimi si realitet i këtij migrimi, i mbështetur edhe në gjetjet arkeologjike, konfirmon konceptin e dyndjeve dhe të gjuhëve indoeuropiane, ku shqipja bën pjesë si dega e parë dhe e pavarur e pemës Indoeuropiane.

Studiuesi dhe shkrimtari i njohur azerbajxhano-amerikan Zecharia Zitçin, ka studiuar kapitullin "Zanafilla" (Genesis) të Biblës dhe që aty ka kaluar në kulturën greke, hebraike e deri në studimin e shkrimeve sumere, të cilat, sipas tij, shërbyen si burim për tregimet Biblike. Nga ana tjetër, librat "Kronikat e tokës" të Zitçinit janë të mbushur plot me shembuj fjalësh apo shprehjesh sumeriane, analiza historiko-logjike e të cilave tregon se ato zbërthehen etimologjikisht ose mund të LEXOHEN SHQIP. Ndryshimet fonologjike midis dy gjuhëve: shqip dhe sumeriane, janë shumë të pakta, shpesh inekzistente. Gjuha sumeriane mendohet se është aglutinative ose me fjalë që formohen nga bashkimi i fjalëve më të thjeshta, pra nuk pranohet që ajo të jetë e lidhur me grupin indoeuropian.

Nga studimi i përkthimeve të shkrimeve sumere në anglisht rezulton se nga leksiku prej afër 700 fjalësh, që në fakt janë shprehje dhe fjali, të gjuhës sumeriane, të standartizuara deri më sot në fjalorët sumerian-english, të paktën 30-35% zbërthehen në fjalë shqip apo lexohen thjeshtë SHQIP, edhe me shqipen e sotme, kryesisht me dialektin gegë, por ka raste edhe atë toskë.

Ndarja e të ashtuquajturave "fjalë", në fakt shprehje apo fjali sumeriane, në fjalë më të thjeshta shqipe vërteton se gjuha sumeriane është aglutinative, por njëkohësisht është edhe indoeuropiane, sepse zbërthehet apo është e barabartë me shqipen. Në këta fjalorë sumerian-anglisht mund të ketë edhe përzierje me gjuhën e mëvonshme akkadiane e babilonase, duke i konsideruar si vazhdim të asaj sumere, kjo sepse akkadët dhe babilonasit vazhduan të përdorin shkrimin kuneiform.

Prezenca e shqipes është plotësisht e dukshme në të gjitha pjesët e kulturës materiale e shpirtërore të shkruar në pllakat shumere, si në astronomi e astrologji, në toponime dhe emra zotash, gjysmëzotash, mbretërish e prijësish, në emërtime objektesh, pajisjesh, në fjalë të përdorimit të përditshëm, përfshirë emra, folje, ndajfolje, nyja etj. Pas konsiderimit edhe të metodave krahasimore të pranuara botërisht, rezulton se gjuha dhe identiteti shqiptar shtrihen dhe e kanë zanafillën në Shumer, në kulturën më të vjetër të botës, midis 13000-2300 vjet p.e.s.

Le të analizojmë tani provat e përmendura më sipër:

Nefilim = Në fillim

Do të flasim më tepër për të, sepse dihet se ajo përdoret tepër shpesh në të folurin e përditshëm. Vini re se Zecharia Zitçin e ka përkthyer nga hebraishtja e vjetër "Nefilim" = "ata që u rrëzuan".

Në fakt, zbulimi është bërë jo duke analizuar studimet apo librat e Zitçin, por duke krahasuar versionet shqip dhe anglisht të Biblës të botuara në vitin 2005 e që përputhen edhe me botime të tjera të saj.

Lexoni paragrafin përkatës të Biblës në shqip e anglisht si dhe shpjegimin që vijon:

5:32 Dhe Noeja u bë pesëqind vjeç. Pastaj Noesë i lindi Semi (Shem), Kami (Ham), dhe Jafeti (Ja pheth).

Tani njerëzit nisën të shtoheshin mbi faqen e tokës dhe u lindën bija.

Bijtë e Perëndisë (engjëjt) filluan të vinin re që bijat e njerëzve ishin të bukura. Kështu, nisën të merrnin për gra të gjitha ato që zgjodhën....

Nefilim-ë kishte në tokë në ato ditë, madje dhe më pas, kohë kur bijtë e Perëndisë patën marrëdhënie me bijat e njerëzve dhe ato u lindën bij. Ata ishin të fuqishmit e kohëve të lashta, (Herkuli etj.), burra me famë.

Dihet se në çdo shkrim apo gojëdhënë që përkthehet në një gjuhë tjetër, emrat dhe toponimet, normalisht, nuk ndryshohen nga përkthyesi, mbeten në gjuhën origjinale. Në rastin e tregimeve Biblike, për ta kuptuar duhet të dimë se asokohe "emri" ishte një fjalë apo shprehje që tregonte cilësitë e personit apo të vendit që emërtonte. Aty flitet për fillimin e njerëzimit, koha kur engjëjt (ndoshta bijtë e "vizitorëve nga kozmosi"/ Zotave) pëlqyen gratë e tokës dhe fryti i lidhjes së tyre ishin gjigantët apo të famshmit e kohës së fillimit. Duke e analizuar me kujdes këtë paragraf të Biblës, kuptojmë se "Nefilim" në fakt nuk janë vetë gjigantët, po nefilimët ishin prezent në tokë para e pas kohës së gjigantëve. Sipas Z. Zitçin "Nefilim" ishin zotat e parë që erdhën në planetin Tokë, ata që krijuan njeriun e sotëm, "Homo Sapiens", dhe i mësuan atij gjithçka, ndoshta edhe cilësinë bazë njerëzore, të folurën - në gjuhën e tyre. Ndoshta "gjigantët", për ekzistencën e të cilëve ka edhe gjetje të freskëta arkeologjike në Indi, u shërbyen

nefilimëve për ndërtimin e piramidave të Egjyptit, që sot mendohet se janë ndërtuar rreth 10.450 vjet para Krishtit. Përmendim këtu se edhe shkrimi egjyptian i vjetër duket të jetë bazuar në gjuhën shqipe, germat egjyptiane janë germat e para të fjalëve përkatëse nga gjuha shqipe. Ato germa janë vizatime simbolike të objekteve, emërtimet e të cilave vetëm në shqip e kanë germën e parë të njëjtë me simbolin/germën përkatëse të alfabetit egjyptian, si p.sh. germa "D" paraqitet në alfabetin egjyptian me një skicë të pëllëmbës, dorës, pra D-dora etj.

Përfundimisht, rezulton se shprehja **"Nefilim / Në fillim"** lidhet plotësisht me brendinë e paragrafit 6:4 të "Zanafillës" dhe është thjesht "SHQIP", shihni fjalorin e gjuhës shqipe me rrënjën "fil" (filiz, fill, filloj, fillim, zanafillë, etj).

Shpjegimi i mësipërm është shumë më logjik se ai që jepet në përkthimin shqip nga anglishtja të këtij paragrafi të Biblës, që e shpjegon fjalën "Nefilim", nga hebraishtja e vjetër me fjalën "rrëzues", që nuk ka asnjë lidhje me brendinë e atij paragrafi dhe as me pjesën tjetër të tregimeve Biblike.

Fjala "në fillim" ka mbetur në gjuhën origjinale-SHQIPE,- sepse nuk është kuptuar lidhja e saj me brendinë e paragrafit, duke mbetur e papërkthyer.

2. "Malakhim" = Mallkim, - në zanafilla 18:20, 19:12, – paralajmërimi i zotit për shkatërrimin e Sodomës dhe Gomorës. Kjo fjalë mund të jetë formuar nga dy fjalët shqipe "mal" dhe "ikim", duke shpjeguar edhe etimologjinë e fjalës "mallkim", që do të thotë "të ikësh në mal", larg nga e keqja, dhe dihet se "mal" dhe "ik" apo "hik" janë thjeshtë shqip. Kjo fjalë është përkthyer në versionet e ndryshme të Biblës si "paralajmërim". Zecharia Zitçin, thotë se në hebraishten e

vjetër fjala "Malakhim" do të thotë "të dërguar" (engjëjt, të dërguarit e Zotit), por ky kuptim nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë logjike në ata paragrafë dhe përkthyesit e kanë zëvendësuar me fjalën "paralajmërim" dhe e kanë hequr fare këtë fjalë në mjaft raste. Kuptimi shqip "Mallkim" është plotësisht i lidhur me logjikën e ngjarjeve në ata paragrafë dhe shumë afër me kuptimin e fjalës "paralajmërim".

Etimologjia "mal ikim" e fjalës "mallkim" na vjen në ndihmë për vërtetimin e shpërnguljes së sumereve "larg nga e keqja" drejt zonave më të sigurta e të mbrojtura malore, dhe njëkohësisht konfirmon tezën e dyndjeve Indo-Europiane. Në këtë logjikë mund të konfirmohet se etimologjia e emrit "Pellazg" vjen nga "Pe Larg". Pe-Largët ishin popullsia parailire që erdhi nga vendi i shumerëve rreth mesit të mijëvjeçarit të tretë p.e.s., pas shkatërrimit të kulturës shumere.

Arrijmë kështu në vargun plot muzikalitet:

Nephilim - Në fillim sumerianë, pastaj pelazgë - pelargë, më pas ilirë e arbër, e sot SHQIPTARË.

Etimologji e disa fjalëve e shprehjeve shumere, ku janë zgjedhur ato më të kuptueshmet dhe nga fusha të ndryshme të kulturës, sipas kërkesave të metodologjisë krahasuese gjuhësore:

SUMER/SHUMER = Shumë Erë

KI = Ki = Ky, dheu, planeti Tokë

KIENGIR = Ki e Ngir = tokë e ngirë, e nginjur, tokë e begatë, e quanin vetë sumerianët

EDIN (Eden) = E din, ka dituri. Kujtoni pemën e dijes në kopshtin e Edenit

NIBIRU/NIBIRA = Ni Bir a = Planeti i 12-të (Z.Zitçin e përkthen "a son")
KINGU= Ki nguc = Ky ngjitur/nguc, Hëna
ANNUNAKI = Arnun a ki = ardhun a ki
ENGIZ = E ngiz = e ngjiz, gatuaj
KASHI = Ka shi, bën shshsh…= Birra
KUR = Mal, Gur
MA = Ma = Mban, mjet transporti
ME = Me = (me) vegël, mjet
MAGUR = Ma Gur = anije transport minerali (gurësh)
NARU = Na ruan, na kujton, neron/nderon = Memorial
ESERU = E she e ru = burgos
KASADU =Ka sa du = u mbush, arriti
KURNUGIA = "Gur në gji a" = minierë
KURNUGIA = Kur nuk ja = kurrë nuk kthehet
KIINDAR = Ki i ndar = dhe/tokë e ndarë, plasaritje
KAGAL/ABULLU= Ka kalim ose a mbyllur = Porta
EMUQA = E Muqa, E mujta
DAKU = Gjaku = gjaku, ekzekutoj, vras (sipas fjalorëve Sumerian-English)
HURASAM = MASARUH = Masa a Rujt = para, lek
NISILIMZAKARU = Ni Qilim Za Ka Ru = nji qëllim fjalë ka rujt = Betim
DIMTU = Dimtu = dëmtuar
KUNUKUM = Ku nuk um (humb) = mbyll hermetikisht, vulos
IZZAKKARA= I Za ka ra = një fjalë ka dalë = thonë, thuhet
RIKISTU = Ri Kishtu = e lemë kështu = marrëveshje
EPESU = E peshoj = e trajtoj, e diskutoj, e vlerësoj
MASKIM = Ma shkrim = shkrues, inspektor

ISHTAR, ESHDAR, ASTARTE = Ishte Ar, Esht Ar, Asht e Arte = emra të Afërditës

BABBAR = Ba Bardh = Zot i drejtësisë, zbardh, ndriçon, sqaron, vendos

EBABBAR = E Babbar = e Babbar-it = (tempulli, shtëpia) e Babardh-it

SIPPAR = Si i Par / Sipër = qytet kryesor (si i parë) në Shumer

Zbërthimet etimologjike të mësipërme janë bërë sipas fjalorëve sumerian-anglisht të standardizuar, pra të pranuar botërisht. Pjesërisht janë zbërthime me mbështetje historiko-logjike që nuk gjenden në ata fjalorë. Të bën përshtypje se sumerologjia botërore (sumerologjia shqiptare çuditërisht nuk ka ekzistuar deri më sot) në asnjë rast nuk ka marrë në studim ndonjë lidhje të shqipes me gjuhën sumeriane. Shpresoj që tani e tutje të rritet vëmendja në këtë drejtim këtu në Shqipëri, sepse realisht do të duhet një punë mjaft e madhe që këto përfundime të kuptohen e të pranohen nga sumerologët e huaj, sepse kjo gjë që do të sillte mjaft ndryshime në gjuhësinë botërore e cila ka sot një histori rreth 150-200-vjeçare.

Pra, shqipja është vërtet gjuha e fillimit, gjuha e nefilimëve.

Në fillim ishim **Sumerianë,** pastaj **Pellazgë,** më pas **Ilirë** e **Arbër,** dhe sot **Shqiptarë.**

Ndoshta me shqipen do të lexohen saktë edhe shkrimet apo sekretet e vjetra, për të cilat interesi po shtohet çdo ditë e më tepër në të gjithë botën. Le ta kenë shqiptarët meritën e zbulimit të tyre. Të dish do të thotë "të kesh fuqi".

ZOTI e ka bekuar Shqipen dhe Shqipërinë, e vërteta vonon, por nuk harron...

II. THOTI I ATLANTIDËS DHE I PELLAZGJISË

1.THOTI – Profeti i Parë i Njerëzimit

Që nga zanafilla e krijimit të tij, njeriu ka qenë gjithnjë në kërkim të gjetjes së formave të mundshme transformuese, si për shpirtëroren ashtu dhe për materialen, në kërkim të një mrekullie e cila do t'i mundësonte atij jetë parajsore, jetë të amshueshme! Sado që duket paradoksale, megjithatë, këto përpjekje nuk kanë reshtur deri në ditët e sotme, dhe do të vazhdojnë, ndoshta me intensitet edhe më të shtuar, derisa të frymoj kjo specie, ky lloj, kjo krijesë e quajtur Njeri.

Thoti ka shkruar:" **Ajo që është poshtë, është e njëjtë me atë që është lartë. Dhe ajo që është lartë, është e njëjtë me atë që është poshtë, për t'i përmbushur veprat e mrekullueshme të një gjëje të vetme**."

Energjia, materia dhe jeta janë tri shikime të manifestimit ekzistencial - harmoni universale e hyjnores dhe tokësores, Krijuesit dhe Njeriut – m'u ashtu siç thotë edhe Ligji i Hermesit: **"Si poshtë, është lartë, si lartë është poshtë". "Si është makrokozmosi, ashtu është edhe mikrokozmosi"** - një lidhshmëri ndërmjet pjesëve më të imëta të materies dhe atyre më gjigante që lëvizin në gjithësi. Çdo lëvizje provokohet padyshim nga një lloj energjie, sepse energjia është vetia themelore e materies, burimi i një aksioni, i një veprimtarie.

"**Tërë përpjekjet e shkencës nuk janë asgjë tjetër përpos kërkime për jetën e amshuar, e gjithashtu edhe tërë përpjekjet e religjioneve nuk janë asgjë tjetër përveç kërkim për jetën e amshuar**" - thoshte edhe filozofi i madh indian, Osho.

*****

Filologu i shquar nga Roma, Giuseppe Catapano (Xhuzepe Katapano), botoi si rezultat të punës së tij kërkimore - shkencore 40 vjeçare, një vepër kapitale nga fusha e shkencave filologjike, të cilës i vuri një titull mjaft interesant:

Thot - Tat parlava Albanese (Thoti - Tati fliste Shqip).

Është hartuar në italishte në formë proze dhe poezie, madje edhe në arbërishte. Siç shihet nga vepra, autori, për studimin e vet delikat dhe të vështirë, është mbështetur kryesisht në veprat e shkrimtarëve antikë dhe në përmendoret e egjyptianëve, hititëve, grekëve dhe romakëve të vjetër, respektivisht edhe në shkrimet e ilirëve - shqiptarëve të lashtë. Duhet theksuar që në fillim se pohimet e Giuseppe Catapanos janë në harmoni me pohimet e shumë filologëve, historianëve dhe arkeologëve anglezë, francezë, turq, arabë dhe shqiptarë.

Sipas mendimit të Catapanos, shqipja, më drejtë, ilirishtja, flitet tash e më se 12.000 vjet. Ndërsa, sipas Horald Whitehall-it, profesor i linguistikës anglo-gjermane në universitetin Indiana (SHBA), shqipja është dega më e vjetër e trungut të familjes së gjuhëve indoevropiane. Si e tillë, ajo nuk është degëzuar më tutje, por ka mbetur si gjuhë e parë dhe e vetmuar. Kemi lexuar dhe dëgjuar për Hieroglifet e egjyptianëve të lashtë, të cilët si skalitje të shenjta, janë krijuar para 4000 vjetëve p. e.s., por deri vonë nuk kemi ditur se Hieroglifet egjyptiane kanë domethënie shqipe. Këtë dukuri na e zbuloi filologu Giuseppe Catapano në veprën e vet "**Thoti – Tati fliste shqip".**

Po kush ishte THOT – i (në shqip), ose TOT-i (në italisht), THOTH-i (në greqisht), apo TEHUTI në arabisht?

THOTI ishte: "Perëndia" e mësimit, e shkathtësisë së të shkruarit, e shkencës dhe e magjisë së egjyptianëve të lashtë. Pastaj ishte: matës i kohës, zbulues i numrave dhe përpilues i Hieroglifeve. Ai përshkruhej si qenie me trup të Njeriut e me kokë të Ibisit - Shqiponjës. Ndërkaq, sipas Giuseppe Catapanos, ***"Thot-i, i cili e "fliste shqipen", i përpiloi Hieroglifet, alfabetin fonetik të egjyptianëve të lashtë, duke u mbështetur në gjuhën e vet amtare - në gjuhën shqipe".***

Giuseppe Catapanoja konstaton se, nga Hieroglifet egjyptiane u formuan edhe alfabetet dhe shkronjat tjera të popujve të tjerë përreth, si dhe natyrisht edhe alfabeti e shkronjat latine shqipe. Thoti ishte edhe krijues i shkencës antike. Ai dhe dijetarët tjerë, flitnin shqip qysh para 12.000 vjetëve, meqë ajo periudhë historike (parahistorike) konsiderohej si erë ilire, apo kulturë pellazgjiko - ilire e shqiptarëve të lashtë. Sipas Giuseppe Catapanos, emërtimi Thot, padyshim, rrjedh nga folja e shqipes: thom, thua, thotë = me thënë, besim, lajm, etj., me kuptim "lajmëtar i zotave" ("messagero degli dei"). Për më tepër, emri Thot, në gjuhën shqipe ka edhe domethënien: me i thënë, të gjitha dituritë (urtësitë) e Atlantidës - Atlasit - Atlashit, e cila, poashtu, shpjegohet, nga autori në fjalë, me shqipen: AT = at - baba, dhe LASH(TË) = i vjetër, që do të thotë: AT I LASHTË - STËRGJYSH.

Por, çfarë paraqiste ATLANTIDA? Ajo sipas Platonit (427 - 347 p.e.s.) ishte vend i madh dhe i fuqishëm, i cili, 9000 vjet para tij, ishte mbytur në Oqeanin Atlantik. Sipas G.Catapanos, Atlasi - Atlashti - Atlantida ishte një nga vendet

më të zhvilluara të stërgjyshërve të shqiptarëve të sotëm, të cilët, pas zhdukjes së saj (Atlantidës) para 12000 vjetëve, atlantidasit e mbetur gjallë kaluan në luginën e Nilit, ku e krijuan një kulturë të re, kulturën e egjyptianëve të lashtë, e cila, si duket, qe vazhdim i kulturës së Atlantidës. Përveç këtij fakti, Atlantida në shumicën e rasteve emërtohet si "BOREA", e që edhe ky nocion, rrënjën e vetë e ka në emrin shqip: BORË, që do të thotë BOREA = e BARDHA=BARDHANA.

Në të mirë të këtij mendimi flasin edhe rezultatet shkencore të punës shumëvjeçare të G.Catapanos, i cili, përkitazi me këtë çështje, thotë: ***"Atlantida quhej edhe Borei, d.m.th. e bardhë, nga fjala iliro-shqipe: Borë. Kjo fjalë përdorej te egjyptianët e lashtë në formën Borea, në frëngjishte të vjetër si Bore, kurse në italishte si Borea. Nga ana tjetër Borea në Egjyptin e lashtë identifikohej me Sfingën. Sfinga në Egjypt ishte një amblemë guri, adhurues i DRITËS, që e personifikonte ZOTIN. Prandaj Thoti,*** sipas gjykimit të Catapanos, ***nuk i takonte erës egjyptiane, por asaj të Boreo-s, d.m.th., të erës së Atlantidës".***

Edhe prejardhjen e emërtimit ILIR, Catapano e konsideron se buron nga shqipja: I Lirë, me qenë i lirë, të qenurit i lirë. Sikurse edhe emrin Shqiptar, burimin e sheh nga termi shqip për IBIS: SHQIPONJA, e cila e simbolizon Dritën, Thotin, Zotin.

Më tej, Giuseppe Catapano konstaton dhe argumenton gjerësisht se, i tërë alfabeti shqip i egjyptasve të vjetër – HIEROGLIFET, si alfabet i parë i përpiluar për shkrim dhe lexim, e ka bazën dhe domethënien e Shqipes, nga e cila u formuan edhe bazat e alfabeteve të tjera si: alfabeti latin,

hebraisht, samaritano-palestinez, sirianisht, arabisht, greqisht,...etj..

Thoti konsiderohej krijues i doktrinës së FJALËS - DRITËS, që u manifestua në Tokë. Kurse DIELLI, ishte simbol i NJË PERËNDIE - ATUM ose TEM, terma këto që kanë shpjegim me anë të gjuhës iliro - shqipe:

• AT = at (babë), U = unë, M = më = mëmë
ATUM = AT UNË MËMË = UNË (JAM) AT E MËMË

• T = tatë (babë), E = e, M = më = mëmë
TEM = AT E MËMË

Pitagora, vazhduesi në Perëndim i doktrinës së **Thotit**, thoshte se:

"ZOTI, lënda e padukshme, ka për numër NJËQENËSINË, e cila përmban pafundësinë; ka për emër atë të Atit, të Krijuesit apo të Mashkullores së përjetshme; ka për shenjë *Zjarrin* e gjallë, simbol të *Shpirtit*, thelb i gjithçkaje. (…..) Monada e madhe vepron si ***Diadë krijuese***. Nga çasti në të cilin ZOTI shfaqet, ajo është e dyfishtë: thelb i pandashëm dhe përmbajtje e ndashme, parim frymëzues ***mashkullor aktiv*** dhe parim ***femëror pasiv***, apo lëndë plastike e gjallë. Diada, pra, përfaqësonte bashkimin e së *Përjetshmes Mashkullore* dhe së *Përjetshmes Femërore* tek ZOTI, dy veti hyjnore thelbësore dhe korresponduese, pikërisht të përmbledhura në emrin: ATUM ose TEM."

Orfeu, në vargun e tij poetik shprehej:

"ZOTI është Dhëndrri qiellor dhe Nusja hyjnore"

Borealët (Atlantët), në Egjypt, me më të lartin inicues të tyre – **Thotin**, të dehur prej *Lirisë* (për këtë u quajtën më vonë Ilirë) dhe *kaltërsisë* e konsideronin *Jetën* të bukur e të denjë, dhe duke kremtuar lavdinë e Diellit, pohonin *pavdekësinë* si rrjedhojë e pashmangshme e *përjetësisë* së Zotit.

Prandaj kumti i Sfinksit, i nxjerrë nga papiruse të ndryshme egjyptiane, shpallë me madhështi:

Unë jam *TEM-i*, i vetmi NJË, arsyeja e Jetës, Burimi i Vetëm i çdo ekzistence.

Unë jam NJËSHI, që ekzistonte edhe përpara se koha të ishte. Përpara se Dielli të lindte për herë të parë për të ndriçuar botën, Unë ekzistoja.

RA është Fjala ime, që unë e kam përhapur për të ndriçuar botën dhe për të kthjelluar arsyen e njerëzve.

Unë thashë Fjalën e parë dhe Drita nisi të jetojë në formën e Diellit që lartësohej mbi horizont; rrezet e tij përballin jetën dhe dritën, ngaqë janë përhapur nga fjala ime.

Unë jam NJËSHI që ekziston gjithherë dhe jeta ime është përjetësia.

Shembëlltyra ime qëndron në çdo shfaqje të jetës; Unë kam krijuar Njeriun sipas shembëlltyrës sime.

Pasqyrimi im është në këtë shembëlltyrë guri prej kur bota ekziston, të modeluar nga ata që jetuan për të më nderuar mbi Tokë dhe unë dëshiroj të jetoj në këtë shembëlltyrë timen deri në mbarim të kohëve.

Por mos lejoni që njerëzit ta ngatërrojnë këtë shembëlltyrë timen me mua vetë, ngaqë ajo nuk është Unë dhe Unë nuk jam ajo. Ajo është pasqyrimi i dukshëm i lavdisë Sime dhe lartësohet mbi Tokë për t'u mësuar njerëzve që të më shërbejnë dhe të më adhurojnë.

Nuk do të vdesë njeriu që beson tek Unë dhe më adhuron; ai do të jetojë përherë tek Unë, ngaqë ai është shembëlltyra ime e gjallë.

*****

Thoti, emri i të cilit padyshim është *shqip,* konsiderohet si ***"Lajmëtari i Zotave".*** Emri i është vënë në bazë të kritereve shumë të rrepta të *shkencës së lashtë*, që merr parasysh thelbin dhe rolin e subjektit të cilit i ngjitet.

Në shqip, *të vesh emër* thuhet ***emëroj*** (më saktë: ***ëmërronj,*** që do të thotë fjalë për fjalë: ***"prej ëmës rroj, ekzistoj"***, duke saktësuar kështu prejardhjen e *qenies në relativitet* dhe të disa kushteve për *të ekzistuar*.

Thoti, - të cilit i atribuohet e gjithë *shkenca e lashtë*, e cila që nga Lugina e Nilit u përhap plot dritë në mbarë botën, siç është vënë në dukje me të drejtë në më shumë se 1000 vepra antike dhe bashkëkohore, - e çoi në Egjypt, nga një *Vend i huaj,* një qytetërim të zhvilluar. Sipas studiuesit e shkrimtarit Endrju Tomas (australian), duke u nisur nga titujt që i janë atribuar Thotit te ***"Libri i të Vdekurve"*** dhe në disa mbishkrime faraonike si: "*Kryezot i ardhur nga deti*" dhe "*Kryezot i dy Tokave*", na lind e drejta të mendojmë se ai ishte një *Prijës Atlantidas*. Në fakt, sipas një legjende kuptimplote: Ai *i mbarti mbi krahë* perënditë e tjera që nga ana tjetër e ***Liqenit Qa*** (nga folja shqip ***qaj,*** vajtoj). E interpretuar sipas kodit të *shkencës së fshehtë*, kjo legjendë do të thotë se ka ndodhur një shpërngulje e *elitës kulturore,* nga një regjion tjetër i rruzullit tokësor për në Egjypt.

Thoti përherë është konsideruar si figura më e ditur, "*dijetari i dijetarëve*" i gjithë lashtësisë, nga doktrina e të cilit

morën fill *Inicuesit e Mëdhenj* të njerëzimit, si: RAMA (cikli arian), KRISHNA (inicimi brahmanik), MOISIU (misioni izraelit), ORFEU (misteret dionisiane), PITAGORA (misteret e Delfit dhe themelimi në Krotone i Shkollës Italike), PLATONI (misteret eleuziane). Të gjithë këta ishin *lajmëtarë, kumtues*, ***sub velo***, të DRITËS QË VJEN.

Thoti është *themeluesi* i besimit (fesë, religjionit) të DRITËS dhe të shkencës okulte të mistereve, është gjithashtu *botërisht* i njohur si shpikës i **shkrimit**.

Thoti, i quajtur nga Helenët "Hermes Trismegjist", ishte më i madhi i të gjithë inicuesve të lashtësisë, i quajtur *themelues i shkencës së fshehtë, lajmëtari i natyrës hyjnore* më të lartë. Në të vërtetë emri i tij tregon pikërisht këtë *funksion.*

Thot – i – ë, në shqip ka kuptimin edhe sot e kësaj dite: ***"Ai thotë"***; dhe në fakt *Ai thotë* (kumton) fjalën e Zotit, atë çka njeriu duhet të bëjë mbi tokë (në *relativitet*) me qëllim që *jeta njerëzore* t'i gjasojë *asaj hyjnore*, pra që të jetë e denjë të synojë fluturimet më të larta, rrugët flakëruese të paana të qiellit, pikësynimi i tij i përcaktuar, ku realizohet *qenia* në *plotës*i dhe *pavdekësi*. Në tempullin e vogël, kyçur mes kthetrave luanore të Sfinksit, në kriptën e thellë, pushon brenda sarkofagut të artë, mbështjellë me pëlhura të bardha borë, trupi i balsamosur i **Thotit**, i të "Diturit të të diturve", i Atij që shqiptonte ***fjalët krijuese të gjithësisë***, dhe ishte i pranishëm gjatë ***"peshimit të zemrës"*** në sallën e Gjykimit, në prani të ***Maat*** apo ***Mát***, *Perëndeshës së të Vërtetës dhe të Drejtësisë*. (***Mát*** përkon plotësisht me foljen homonime në shqip dhe do të thotë: *të peshosh, të matësh, të shqyrtosh me kujdes, të peshosh me urti për një vlerësim të drejtë të qenieve.*)

*****

Thoti ishte themeluesi i alfabetit fonetik egjyptian – *Hieroglifeve*, në hartimin e të cilave Ai iu referua fjalëve të ***ilirishtes,*** duke marrë prej tyre, në skicimin e gjërave apo koncepteve të përfaqësuara, shkronjën nistore, dhe prandaj ideograma e *Shqiponjës*, që i përgjigjet shkronjës **A**, rrjedh prej fjalës ilirishte/shqipe: AIN (Shqiponjë). Ideograma e Dorës, që i përgjigjet shkronjës D, rrjedh prej fjalës ilirishte/shqipe: DORË. E kështu me rradhë deri në fund të alfabetit thotian shkronja e parë e objektit në shqip i përgjigjet shkronjës zanore apo bashtingëllores në alfabet/hieroglif. Është kështu sepse gjuha *Iliro-Shqipe* është gjuha e vetme e cila ruan dhe i përdorë ende *rrënjë-fjalët* e Gjuhës së Parë të folur nga Njeriu mbi Tokë.

Gjenialiteti i ***Thotit***, gjatë përpilimit të *alfabetit hieroglifik,* qëndron pikërisht në aftësinë e përfshirjes në të njëjtën fjalë të disa kuptimeve: atij që i referohet nevojave të njeriut në *relativitet*, ose më mirë në këtë botë kalimtare të provës; dhe atij që i referohet *hyjnores,* në jetën e shpirtit, në pavdekësinë.

Studiuesit dhe deshifruesit të hieroglifeve, Shampolionit, i ka rënë në sy menjëherë ky fakt: gjithçka që ka të bëjë me letërkëmbimin privat, me marrëdhëniet e tregëtisë, me hartimet poetike letrare; me një fjalë gjithçka që ka të bëjë me *tokësoren,* përkthehet lehtësisht nëpërmjet gjuhës fonetike; në të kundërt, të gjitha tekstet që i përkasin *hyjnores, të pavdekshmes, absolutes, jetës së shpirtit,* të gjitha tekstet që përbëjnë të famshmin ***Libri i të Vdekurve*** (sipas konceptit të ***Thotit*** ky është ***Libri i Jetës së përtej Varrit***), e mbi të gjitha të ashtuquajturit *kapituj magjikë*, shfaqen të errët dhe të papërkthyeshëm për këdo që u përmbahet vetëm rregullave të

gjuhës fonetike. Në këta kapituj fjalët duken të pakuptimta dhe pa asnjë domethënie. Egjyptianët, të mësuar nga ***Thoti***, i shkruanin emrat e perëndive të tyre në tri mënyra të ndryshme: *1.fonetikisht, 2.figurativisht, 3.simbolikisht.*

Thoti konsiderohej, pranë Egjyptianëve, si "lajmëtari i zotave", "shkruesi hyjnor", themeluesi i shkencës së lashtë, fetare dhe laike; shpikësi i shkrimit; inicuesi më i madh i lashtësisë. Babilonasit e thirrnin **Enok**. Pellazgët/Grekët ia ndërruan emrin në **Hermes**, kurse Romakët në **Mërkur**, ndërsa Masonët dhe Iluminati modern e thërrasin **Kybalion**.

Kohë të ndryshme, popuj të ndryshëm, emra të ndyshëm për ***Thotin***, por vepra dhe dituria e Tij mbeti e njëjta, porosia e Tij për Njerëzimin mbijetoi në të gjithë popujt dhe mbeti e pavdekshme në të gjitha kohërat.

THOT, në gjuhën ilirishte (shqipe) ka kuptimin: ***Thotë, Flet, Tregon.*** Pra, ***Thoti*** ishte një boreal (lëkurëbardhë nga Veriu) i rracës ilire. Por Katapano pohon se zanafilla e Ilirikut nis me qytetërimin e Nilit, rreth 12.000 vjet para erës sonë..

Egjyptianët e simbolizonin ***Thotin*** me maskën e ***ibisit***, sikur donin t'ia fshehnin popullit prejardhjen etnike borealo-ilire të Mjeshtërit të tyre të Madh. Por arbëreshi Zef Katapano, me hulumtimin, punën dhe zbulimin e tij, i ka hequr ***Thotit*** maskën e *ibisit* dhe i ka kthyer fytyrën e vërtetë veriore, të bardhë, të ***Ilirit*** (Shqiptarit). Kjo shpreh faktin se ***Thoti*** solli në Egjypt, 12.000 vjet para Krishtit (p.e.s.), nga një vend i huaj, i largët e verior, një qytetërim të përparuar, që doemos duhet të ketë qenë ai i Atlantidës (Boreas), përfaqësues i rangut të lartë të të cilit ishte Ai.

Thoti, si krijues i doktrinës së ***Fjalës-Dritë,*** është Profeti i Parë i Fjalës së **ZOTIT**.

2. Alfabeti/Hieroglifet e THOTIT

	AIN	**A,a**		**BROF**	**B**		**DORË**	**D**
	GATH	**G**		**FJERË**	**F**		**HJETË**	**H**
	KUFË	**K**		**MIRË**	**M**		**GJI**	**GJ**
	NU	**N**		**U**	**U**		**PLIS**	**P**
	QULL	**Q**		**BUZË**	**R**		**STOL-i**	**S**
	SIXHIR	**S**		**TËRË**	**T**		**TËRË**	**T**
	ISË	**I**		**ASHIM**	**A, O**		**ZVARANIK**	**Z,ZH**
	SHI	**SH**						

Në hartimin e Hieroglifeve të alfabetit fonetik, Thoti u mbështet gjithmon tek fjalët e gjuhës shqipe; vargu i ideogrameve që e përbëjnë, në këtë rast, *kanë një vlerë të vetme fonetike*: përfaqësojnë vetëm ***tingullin nistor*** – *zanor* apo *bashkëtingëllor* – ***të fjalës shqipe***, së cilës i referohen. Kjo do të thotë se 12.000 vjet më parë, në Tokat e Nilit, dhe jo vetëm atje, flitej ***Shqip,*** nga ky fakt rrjedhin dy gjëra të vërteta, se:

1.ILIRISHTJA është shumë më e vjetër nga sa besohet zakonisht, dhe

2.KULTURA e sjellë në Egjypt nga POPULLI I LIRISË (**Ilir** do të thotë I LIRË), është e lashtë edhe ajo së paku 12.000 vjet.

Si shumica dërrmuese e ilirologëve, edhe G.Katapano është i mendimit se emri ***Ilir*** rrjedh nga ***I lirë***, dhe ***Shqiptar*** nga ***Shqiponja***, d.m.th. ashtu siç e shpjegon tradita shqiptare,

sepse shqipja (shqiponja) e simbolizon DRITËN, THOTIN, ZOTIN. Kështu edhe hieroglifi i parë, të cilin Thoti e quajti në shqip: AIN = IBIS = SHQIPE, e simbolizon vet THOTIN, d.m.th. ZOTIN, dhe ka këtë shpjegim në shqip:

• A = ATË, fillimi i premierës, ZOT, At i përjetshëm.

• I = fjalë (folje) krijuese (themeluese) e fillimit: ZOT, KRIJUES.

• N = (N = NU = Në ujë) materie e parë (uji) për të gjitha krijesat, Zot i përhapjes së dashurisë.

AIN-i - , pra, ishte simbol që tregonte edhe lindjen, vitalitetin e burrërisë, i cili frymëzonte krijesën. Në të vërtetë Thoti, me këtë hieroglif, i cili qe i pari dhe më i rëndesishmi në sistemin e hieroglifeve, e simbolizoi vetveten, sepse ishte krijues i tij, pra ishte perëndi - Zot. Ky hieroglif në alfabetin e shqipes paraqitet me A.

• Hieroglifi - , të cilin Thoti e quajti me fjalën shqipe BROF, me kuptim në këmbë, paraqiste tingullin e shkronjës shqipe B. Tregon qëndrimin karakteristik të njeriut inteligjent krijuar nga periudha në pozite drejtë, me kokë lart, i cili është duke e ruajtur fuqinë lart në qiell e në mënyrë të përhershme. Tregon se ky qëndrim është njelëzor e vet njeriu, si qenie, është i përsosur. Fjala ***brof*** në shqipen e sotme ka këto kuptime: Ngrihem menjëherë në këmbë. Brofi ne këmbë. U ngrit (u çua) brof. U ngritë me vrull në këmbë.

• Hieroglifi - , të cilin Thoti e quajti DORË, si simbolikë paraqiste punën e dorës së njeriut, apo të gjitha intervenimet e njeriut për pronësi, me qellim që puna të jetë e begatshme e dobishme për njeriun. Ky hieroglif në shqip mori formën D.

• Hieroglifi - , të cilin Thoti e quajti GATH (GARDH), e si simbolikë paraqiste ndalesën - pengimin - gardhin në afërsi të faltores, në alfabetin shqip e mori formën G.

• Hieroglifi - , të cilin Thoti e quajti FJERË, paraqiste shlingën ose nepërkën, gjarpërin helmues, me kokë të shtypur në trajtë trekëndëshi, me dy dhëmbë në gojë dhe bisht të shkurtër. Edhe sot e kësaj dite nepërka quhet Fjerë, në Malësi, në dialektin gegë. Në shqip mori formën F.

• Hieroglifi - , të cilin Thoti e quajti HJETË, d.m.th. ashtu siç e quajnë edhe sot arbereshët bishtalecin e flokëve, thurrjen, nyjen, lidhjen. Në shqipen mori formën H.

• Simbolin - , Thoti, në sistemin e hieroglifeve, e quajti KUFË, d.m.th. nga shqipja KOFË (KOVË), e cila si simbolikë paraqiste enën ku bëhej përzierja e fuqisë për krijimin e materies. Në shqip mori formën K.

Është në interes të vihet në pah edhe një dukuri. Shkronja KAF e arabishtes, jo vetëm që ka ruajtur formën dhe shqiptimin e hieroglifit KUFË, por çdo pjesë (sure) e Kur'anit fillon me shkronjën KAF ( ), që supozohet se KAF-at paraqesin vet Kur'anin, d.m.th fjalët e Perëndisë – ALL'LLAHUT.

• Hieroglifin - , Thoti e quajti GJI, emërtim shqip i gjinjve të femrës, nga i cili u lind shhronja GJ në shqip.

• Hieroglifin - , Thoti e quajti NU, fjalë kjo e përbërë nga: NË UJË. Nga ky hieroglif doli shkronja N. Shqiptarët e Veriut (Gegët) fjalën NË UJË e shqiptojnë: N'UJË. Kurse këtë shkronjë Hebrenjtë e shqiptojnë: NUM. Dhe Arabët: NUN, d.m.th. nga shqipja: N'UJË. Poashtu, në Biblën e Shenjtë thuhet: ***"Në fillim perëndia mori frymë n'ujë".*** Do të thotë

krijesat u krijuan në fillim n'ujë, në dete. Kjo filozofi e stërgjyshërve të Shqiptarëve aprovohet nga shkencat bashkëkohore. Në të vërtetë, hieroglifi NU simbolizonte materien e parë - ZOTIN dhe përhapjen e dashurisë.

• Hieroglifin - , Thoti e quajti U. Nga shqipja unë, kështu që edhe në shqip mori formën U.

• Hieroglifin - , Thoti e quajti PLIS, që në shqip do të thotë: tullë, copë e madhe dheu që ngre pllugu kur çan tokën; copë e tillë dheu me bar, e prerë me bel apo me ndonjë mjet tjetër; plisat e arës; plis me bar. Në shqip mori formën P.

• Hieroglifin - , Thoti e quajti QULL, nga shqipja: materie pa formë, brumë, baltë, lloç, materie kjo që mund të transformohet me përzierje nga puna e njeriut. Ky hieroglif në shqip mori formën Q.

• Hieroglifin - , Thoti e quajti BUZË, për tingullin R, sepse buzët, me këtë rast, përfaqësonin gojën, respektivisht, buzët që bënin rojë, ruanin fjalën, gjuhën, dhëmbët.

• Ndërkaq, për tingullin S, Thoti përdori dy hieroglife: , të cilin e quajti STOL, STOLI, dhe , të cilin e quajti SIXHIR, term ky që përdoret edhe sot e kësaj dite te shqiptarët gegë në formën: sinxhir, apo zinxhir.

• Edhe për tingullin T, Thoti përdori dy hieroglife: dhe , nga fjala shqipe TERË, me kuptim fitim.

• Për tingullin I dhe J,Thoti përdori hieroglifin , të cilin e quajti ISË, që do të thotë DRITË, e me kuptim: FILLIMI I JETËS. Simbolizon DIELLIN, i cili rrezaton forcë kreative. Shkronja I qe emër i parë që iu dha perëndisë së njeriut; PERËNDIA E DRITËS SË PËRHERSHME. Nga fjala ISË doli

emri IDISË - simbol i dritës. Kështu, pra, shkronja I te shqiptarët hyn në tingullin e fjalëve që shpreh dritën, bukurinë, stolinë. Pra kjo urtësi ISIAKE (isiakë = nga isë = DRITË), në arbërishte do të thotë DRITË.

• Hieroglifin - , Thoti e quajti ASHIM ose ASHËR, me kuptimin degë, filiz, dru i çarit (i plasaritur, i ndarë). Hieroglifi në fjalë paraqet veprimin ose aktivitetin e njeriut në natyrë. Zaten edhe në gjuhën e sotme shqipe fjala ASHËR do të thotë ashkë,-l, dru i vogël, i çarë për zjarr. Copë druri i çarë si dërrasa e hollë, që përdoret si petavër ose për të mbuluar çatinë, pullazin. Çati me ashra. Çaj (bëj) ashra. Me fjalë të tjera hieroglifi "ashër" i paraqiste tingujt **â**, tinguj këta që janë guturalë, por të zhdukur te toskët. Në shqip mori formën **à**.

• Për hieroglifin - , Thoti e përdori shprehjen shqipe ZVARANIK ose ZHVARANIK = zvarranik i tokës. Simbolizonte vuajtjen e shfrenuar, por zvarraniku konsiderohej frymëzim i tërbuar e sentimental. Hieroglifi në fjalë në shqipe dha tingullin Z dhe Zh.

• Kurse hieroglifin e fundit , Thoti e quajti me fjalën shqipe SHI. Si hieroglif paraqiste një liqe me ujë të shiut origjinal. Për më tepër, jeta, vdekja, rilindja, gjithmonë janë të lidhura me ujin "NU" ose "SHI", sepse në "NU" krijohet jeta. Nga ky hieroglif u krijua shkronja shqipe SH.

Është shumë interesant edhe dukuria e kësaj shkronje, meqë në hebraishte dhe arabishte quhet SHIN, dhe forma e tyre është e njëjtë me hieroglifin SHI: "bazeni me pika të shiut", që do të thotë se gjuha, kultura dhe prejardhja e shqiptarëve, hebrejve dhe e arabëve është identike, si duket, është nga Ilirët e lashtë, apo nga stërgjyshët e shqiptarëve – Pellazgët. Mendimi mbi prejardhjen e njëjtë të Shqiptarëve,

Hebrejve dhe Arabëve është vallë fakt historik, apo fantazi? Në vështrim të pare duket si ëndërr, por nëse merren parasysh burimet historike, kërkimet arkeologjike, të dhënat gjuhësore dhe Bibla e Kur'ani, atëherë mund të bindemi edhe për këtë pohim jo aq të zakonshëm. Këto lidhje të shqiptarëve me popujt më të lashtë të Afrikës dhe të Azisë së Afërme janë shumë të hershmë, më të hershme se sa është menduar deri tash, çka tregon fakti se "perëndia" THOT (stërgjysh i shqiptarëve), e barti, pas katastrofës së Atlantidës, që ndodhi para 12.000 vjetëve, kulturën ilire - shpiptare në Afrikë, sigurisht edhe në Azi. Kurse, para 6.000 viteve, Thoti e krijoi edhe sistemin e hieroglifeve në bazë të ilirishtes - shqipes, sistem ky që shërbeu si mostër për përpilimin e sistemeve të tjera të alfabeteve si, ai i shqipes, që gabimisht e njohim si alfabet latin, i hebraishtes, samarito - palestinishtes, sirianishtes, arabishtes dhe i greqishtes!

Ky fakt tregon se Ilirët, si stërgjyshër të Shqiptarëve, nga gjuha e zakonet shtriheshin që moti, jo vetëm në gjithë Siujdhesën Ballkanike, por edhe në Siujdhesën Apenine, në ishujt e Detit Mesdhe, Egje, në Azinë e Vogël, në Siujdhesën Arabike, në Gadishullin e Pirinejeve. Shkurt, kultura iliro - shqiptare, si kulturë e qytetërimit të parë të këtij ambienti, shtrihej nga Irani në Lindje, deri në Atlantik në perëndim, dhe nga Alpet në veri, deri në Afrikën Veriore në jug.

*****

Nga ky vështrimi, - nënvizon Catapanoja, - u demonstrua vetëm THOTI, i cili e krijoi alfabetin hieroglifik fonetik, me çelës të Shqipes së Vjetër – Ilirishtes, që u muar për

çdo hieroglif të tingullit të parë, zanorja ose bashkëtigëllorja, e qenies së emrit shqip, kuptim ky që zbulon shpjegimin e sigurt, i cili nuk mund të mohohet:

1. Që origjina ilire na shpie në kohë më të vjetra, histori kjo e cila na mahnit, apo histori që na shpie në neolit (koha e re e gurit). Ndoshta origjina e civilizimit neolitik fillon me zhdukjen e Atlantidës (para 12.000 vjetëve), epokë kjo që solli nevojën e krijimit të Hieroglifeve nga THOT-i në Egjypt, si mënyrë e shpjegimit të fillimit të punës.

2. Ky studim, si pohim i së vërtetës, korrigjon datën e historisë, korrologjisë (disciplinë që studion ndarjen gjeografike), etnologjisë dhe filologjisë.

3. Rishikimi i Thotit zgjeron kufinjtë e shkencave, që deshëm s'deshëm, ndikon në metafizikën e cila është me rëndësi për njeriun dhe njerëzimin, sepse arrihet rishtazi në kuptimin e mendimit të ndjenjës së të vërtetës për jetën që është vërtetë natyrë shpirtërore, është erë e vërtetë e shkëlqimit të lavdishëm të DRITËS SË PARË, përfundon G. Catapano.

Rezultatet shkencore të arkeologëve anglezë, amerikanë, gjermanë dhe turq: J.E. Gauter më 1894, R. Campbell - Thompson më 1910, E. Pitard më 1927, Kurt Bittel më 1831, Shevket Aziz Konsu, Kiliç Kokten, Enver Bostanci, Muzaffer Shanyurek, Fikret Ozansoy, që nga viti 1936 e tutje, Halet Çambel John Brandwood më 1968, etj., pasqyrojnë në mënyrë plastike në veprat e tyre këtë çështje. Sipas mendimit të këtyre dijetarëve kuptojmë:

- se vala e parë e furishme e dyndjes së Hititëve, të cilët përfaqësonin, një fis të veçantë të Ilirëve, ose i takonin njërit nga fiset e shumta të Dardanëve, u shpërngulën, kuptohet në

disa faza, nga Ballkani i Epërm, apo nga Dardania, kah brigjet perëndimore dhe veriore të Detit të zi, kah Kaukazi për në Anatolinë (Anadollinë) Qendrore;

- se kjo shpërngulje u bë në kohën e paleolitit, mezolitit, neolitit dhe halkolitit;

- se Hititët e sollën teknologjinë e xehetarisë dhe të metalurgjisë nga Iliriku në Anatoli (nga Ballkani në Anadoll);

- se kah viti 2000 p. e.s., filloi periudha historike në Anadoll, e cila nga shkencëtarët u quajt "periudhë e hititëve" (2000 - 700 p.e.s.);

- se në shekullin XII p. e.s., përmenden tre perandorë me emrin Arnuvanda I, II, III, prej të cilit emër si duket, u krijua, sipas ligjit të metastezës, njëri nga sionimet për shqiptarët - arnavudë;

- se në vitin 3000 p.e.s., shkaktohet vala e dytë e furishme e dyndjes së Dardanëve ilirë, prej të cilëve u krijua Troja, dhe me emrin e dardanëve u emërtuan: njëra derë e Trojës Dardanos, ngushtica detare mes Anadollit dhe të Ballkanit - Dardanelet, dhe një qytet Dardania apo Dardanos në veri të Trojës.

- se bë vitin 1200 p.e.s., ndodh vala e tretë e dyndjes së Ilirëve frigas nga Dardania e Ballkanit, prej të cilëve u krijua Mbretëria Frigase (750 - 546 p.e.s.) në Anadollin Perëndimor;

- dhe se, me sa duket, nga koha e dyndjes së Hititëve daton historia e një krahine në Kaukaz, e cila quhej në kohën antike ALBANIA, kurse banorët e saj Albanë, sigurisht nga emri i fisit të Albanëve ilirë të Ilirikut (Ballkanit).

Tani për tani, do t'i vëmë në pah edhe disa fjalë Hitite që kanë lidhje me Shqipen e sotme, fjalë këto që janë zbuluar në plisat (tullat) e pjekura, të cilat kanë shërbyer si mjet për të

shkruar, me shkronjat e veta karakteristike kunjore dhe hieroglifike:

Ní	=	tani	Asht	=	asht-i
Ata	=	ati, baba	Maje	=	ngritje, rritje
Mat	=	mas, matje	Njoj	=	njoh
Wit	=	vit-i	Ane	=	anë,-a
Gjun	=	gju-ri	Qend	=	qind
ili	=	yll-i, zoti	Bait	=	oborr,-i
Et	=	etje,-a; etjeje	Lule	=	lule,-ja
Est	=	është	Dor	=	dorë
Gurta	=	kala, fortifikatë	Mial	=	mjaltë
Wesha	=	veshje,-a	Miel	=	miell,-i
Shur	=	ranë, ranishtë	Urirn	=	urim,-i
Turija	=	turi,-ri	Nakt	=	natë
Ara	=	të lashtat	Sojoti	=	sitë,-a
Shkal	=	shpoj, shërthej	Hur	=	Uri,-a
Leiht	=	lehtë (i,e)	Lissi	=	lis,-i, sh,-a

Sipas G. Catapanos edhe vet Moisiu e ka folur shqipen e Thotit dhe se emri hebrej - jevrej, për izraelitët rrjedh nga shqipja iliro-hitite: JHVE = TI JE VET, JE VE(T). H e cekur, në hebraishten e vjetër është shqiptuar edhe si E.

Disa historianë arabë mendojnë se shqiptarët dhe arabët kanë prejardhje të përbashkët qysh nga kohët më të hershme. Kurse Evlia Çelebiu (1611 - 1682) vë në pah se nga fisi Kurejsh,

nga i cili rrjedh Muhamedi, profeti i islamizmit, rrjedhin edhe Shqiptarët. Mirëpo, origjinën e përbashkët të shqiptarëve dhe të arabëve, nëse këto pohime kanë bazë shkencore, duhet kërkuar qysh nga koha e lashtë ilire, së paku para 4000 vjetëve, d.m.th. qysh nga koha e profetit Ibrahim (Abraham), prej të cilit, thuhet në botën arabe e hebreite, rrjedhin arabët dhe hebrejt. Ndërsa Willy Borgeaud-i thotë se palestinezët (filistinët) kanë emër ilir, dhe se Argolida dhe Elida në Greqi janë vatra të rëndësishme ilire në pjesën e Mesdheut. E sipas mendimit të Faik Reshit Unatit, palestinezët (filistinët) u tërhoqën nga Kreta për në Palestinë rreth vitit 1200 p.e.s. Palestinezët ishin banorët e ish qytetit ilir Paleste - Palasa e sotme në Himarë.

*****

THOT-i, profeti, i dërguar i parë i Zotit, tri herë i shfaqur (mishëruar), shpjegohet me fjalën shqipe: Me mat, me peshue, me u mat, me u mendue mirë para se të kryesh nji veprim. (Të shpjegueme dhe nga z.Giusepe Catapano). ER-MES, ER-MET – mishërimi (shfaqja) e fundit e THOTIT në Greqi, shpjegohet me shqipen ERMES=Erë Mbes, ERMET= Erë Mbet.

Në Kuran quhet **Idriz** dhe mësimet e Thotit trashëgohen nga sufitë e bektashinjtë deri në ditët tona.

Abumasar, klerik i lartë Islam, studiuesi i fesë Islame në shekullimin VIII të Erës së Re, e përshkruan kështu lidhjen e Idrizit me Thotin:

- Idrizi ka lindur në një kohë që nuk ishte kohë. Jetoi në Egjypt me emrin Thot dhe krijoi atje qytetërimin e parë egjyptian, shkrimin si dhe piramidat me Sfinksin. Herën e

dytë Idrizi shfaqet në Babiloni pas përmbytjes së madhe bashkë me Noen, me emrin Enok. Herën e tretë shfaqet në Greqi me emrin **Ermes** (Hermes) dhe po udhëheq njerëzimin deri në kohën e tij (Abumasarit) në shekullin VIII. Pasuesit direkt të Idrizit janë sufitë e bektashinjtë.

Qysh në fillim, gjuha e rrathëve (sidomos në arat, livadhet dhe grunajat e Anglisë) me kombinacione të bukura është quajtur si **Gjuha e THOTIT**, që në këto vitet e fundit po vjen nga qielli. Disa studiues që po i vrojtojnë ato dhe janë shtri e kanë pushuar në qendër të tyre, thonë që kanë ndier e parë gjëra të çuditshme dhe arrijnë në konkluzion se ekzistojnë botë paralele, të njëjtën gjë që e ka thënë THOTI para shumë mijëvjeçarësh. Kohët e fundit këta rrathë po bëhen gjithnjë e më të ndërlikuara e gjithnjë më të mëdhenj, që arrijnë mbi 300 metra diametri. Figurat e bëra nga njerëzit janë më të vogla, më pak të ndërlikuara dhe njifen, sepse i kanë kërcejt e grurit të shkelur e të thyer.

Në një vend në Angli, pas shfaqjes së një figure me rrathë në arën me grurë, u zbulua aty afër një gërmimi arkeologjik me të njëjtën formë. Një figurë tjetër thonë se shpreh PI (3.141592 etj.), ka figura që shprehin kode sekrete, kodin gjenetik, ka nga ata me figura aliene, por, ka dhe rrethore të krijuara nga njerëzit. Një pjesë nga ata i bëjnë për mburrje, një pjesë për reklamë e një pjesë për të përfituar nga këta rrathë. Siç bëri Mojsiu/Musai para 3300 vjetëve, ashtu po veprojnë edhe në ditët tona. Në albumet që paraqesin rrethoret në arat me grurë, janë futur dhe shumë figura fetare si: forma kryqi, forma e yllit me gjashtë cepa dhe e mbajtëses së qirijve ebrej, që janë simbole ebreje e plot figura të tjera përfituesish nga ky fenomen.

Thotit nuk i duhej mbajtësja e qirijve, sepse ai përdorte ndriçimin me llampa, gjë që është vizatuar dhe në piramida. Gjuha e Thotit është kryesisht gjuha e rrathëve, sepse dhe jeta, universi e çdo gja në univers, lëviz në formë rrethore e të pësëritur, në harmoni e rregullsi me njëra-tjetrën e jo në formë yjesh e figurash me pesë, gjashtë ose me më shumë cepa.

Nëse studiohen me kujdes shkrimet e THOTIT, aty flitet vetëm për gjuhë rrathësh dhe rrethoresh, që sigurisht se do të gjendet mënyra për t'i lexuar.

Derisa ekzistojnë shkrimet në pllakat prej smeraldi me figura rrathësh e rrethoresh të pashpjegueshme, atëherë dhe një pjesë e këtyre rrethoreve në arat me grurë do të kenë lidhje me gjuhën e THOTIT, që gradualisht, duke eliminuar figurat e përfituesve dhe të atyre që i bëjnë për t'u krenuar, do arrihen të lexohen edhe këto rrathë dhe do të zbulohen mistere shpirtërore dhe kozmike, ashtu siç janë shkruajtë në shkrimet e THOTIT në pllakat prej smeraldi.

Në besimin ebre thuhet që i dërguari i Zotit pritet të vijë, kristianët thonë që Krishti do të rikthehet, për Thotin thuhet se është mishëruar tri herë, në fund u shfaq në Greqi me emnin ERMES=Er-mes (Erë mbes), e mund të mishërohet, shfaqet përsëri. Ku i dihet!

Vetëm feja myslimane e quan të mbyllur këtë gjë, sepse pas profetit Muhamed, që sipas tyre është i fundit, ata nuk pranojnë se do të ketë tjetër Profet që do t'i shfaqet njeriut si i dërguar i Zotit. Ku ta dijsh, Thoti, me emër tjetër, mund të shfaqet, mund të dërgohet përsëri nga Zoti në tokë, aty rreth viteve 2012-2013, por tani, sigurisht, me një emër tjetër, dhe në një vend tjetër. Por, si duket, të katër Kryeprofetët e deritanishëm të Njerëzimit të dërguar nga

ZOTI/ALLAHU/PERËNDIA janë i njëjti person, i njëjti i dërguar i Zotit, por me emra të ndryshëm, në kohë të ndryshme dhe në vende të ndryshme në Tokë. Kjo është mister, që njeriu kurrë nuk do ta mësojë derisa të jetë Njeri.

Kryeprofetët, të Dërguarit Kryesorë të ZOTIT, për udhëheqjen e Njerëzimit, që njihen deri sot janë:

1.THOTI (në Atlantidë, Pellazgji /Iliri, Egjypt),
2.ENOKU (në Shumeri, Babiloni)
3.ERMESI (në Greqinë antike),
4.BUDA (në Indi)
5.KRISHTI (në Izrael)
6.MUHAMEDI (në Arabi)

I Shtati Kryeprofet i rradhës është për udhë për në Tokë që të shfaqet midis Njerëzve dhe për Njerëzimin, të shohim në cilin vend apo kontinent do të zbresë dhe me cilin emër. Por, me kusht që të mos ndodhë shkatërrimi i botës, kijameti, apokalipsa,…etj., siç parathonë shumë teza, hipoteza, teori, teoricientë, ideologë e filozofë anë e kënd botës, duke filluar që nga shkrimet Biblike e Kuranore e deri te populli Maja.

*****

Në fund do t'i vëmë në pah edhe disa konstatime të Giuseppe Catapanos (Xhuzepe Katapano) lidhur me lashtësinë e gjuhës shqipe. Sipas tij, kërkimet e ndërgjegjshme apo studimi komparativ i gjuhëve të vjetra të llojllojshme, na shpien te "ESKUERA", baskisht E SHKUERA, që në shqip do të thotë Gjuhë e Shkuar - e kaluar), d.m.th. na bien te shqipja, hititishtja, hebraishtja, arabishtja, arameikishtja (gjuhë semite

perëndimore e folur në kohën e lashtë në Siri, Mesopotami, Palestinë) dhe Koptishtja - gjuhë liturgjike (kishtare) e të krishterëve të Egjyptit, që do të thotë gjuhë e THOTIT.

Këtë e dëshmojnë edhe faktet që vijojnë:

- Shprehja PAN - AMEN, përbëhet nga Zoti Amon, emër i përbërë nga fjalët shqipe:

A = AT = babë

M = MË = mëmë

ON = Onë = Yn = Yni (joni)

Kjo shprehje përdorej te të gjithë popujt dhe në të gjitha gjuhët në tri forma, gjatë lutjeve Zotit:
AMON (Pellazgët), AMEN (të krishterët) dhe AMIN (myslimanët). Pra: Amon – Amen – Amin, – është e njëjta fjalë me të njëjtën përmbajtje.

- THOTI, që është atribut i të gjitha shkencave antike, nga Nili e shtriu dritën në gjithë botën, sepse në Egjypt u krijua civilizimi i përparuar.

- Prania e Ilirëve në Egjypt mund të datohet para 12.000 vjetëve, periudhë kjo që përputhet me zhdukjen e Atlantidës, e cila u përshkrua nga Platoni në dialogun e "TIMEO"-s dhe "CRIZIA"-s.

- Shqipja flitej para 12.000 vjetëve, jo vetëm në tokën e Nilit, por edhe gjetiu, duke qenë se:

1. Ilirishtja ishte shumë më e vjetër se sa që mendohej deri më sot.

2. Kultura e lashtë e POPULLIT TË LIRË (I lirë) në Egjypt ishte e vjetër, së paku 12.000 vjet.

- Emri POSEIDON, emërtim i zotit të deteve dhe të tërmeteve, i cili ishte vëllau i Zeusit (Zojsit), shpjegohet me shqipen: PO - SI - E - DON = me kuptim: shumë e dëshiron.

- Emri FARAON, me kuptim I NJERËZISHËM, poashtu rrjedh nga gjuha Shqipe: FARA - JONË.

- THOTI është lajmëtar i perëndive.

- THOTI konsiderohet, gjithashtu, si personalitet më i ditur, "më i urti prej të urtëve" i të gjitha kohërave më të vjetra, nga doktrina e të cilit dolën fillet e mëdha të humanizmit, sikurse RAMA, KRISHNA, MOISIU, ORFEU, PITAGORA, PLATONI, ishin të gjithë: LAJMËTARË TË DRITËS SË ARDHSHME, ekzistues të përhershëm, - DIVIN LOGOS FIGLIO DI DIO (ARSYEJA HYJNORE E BIRIT TË ZOTIT), që do të mishërohej për çlirimin e njeriut dhe shpëtimin e botës.

THOTI është themelues i religjionit të DRITËS dhe i shkencave sekrete (okulte) të mistereve dhe është gjithashtu, në përgjithësi, shpikës i shkrimit.

Prandaj, bazuar në shënimet e sipërshënuara mund të konkludohet:

- se Pellazgët - Ilirët ishin stërgjyshërit e Shqiptarëve;

- se Pellazgët - Ilirët, me emra të ndryshme, d.m.th. me emra të fiseve pellazgo - ilire (gegë, toskë, albanë, arbër, arnautë, dardanë, maqedonë, hetitë ose hititë, trojanë, egjyptianë, etruskë, etj. etj.) jetonin në një sipërfaqe shumë të gjerë në tri kontinente: në Evropë, Afrikën Veriore dhe në Azi, deri në Iran dhe Indi;

- se Ilirishtja - Shqipja, si degë më e vjetër e familjes së gjuhëve indoevropiane, është çelës i qytetërimit njerëzor;

- se nga gjiri i Ilirëve dolën shumë "perëndi", profetë, perandorë e dijetarë;

- se stërgjyshërit e Shqiptarëve, Pellazgët-Ilirët, me kulturën e tyre të lartë kontribuan jo vetëm në civilizimin e popujve tjerë, të cilët i sundonin, por, me anë të

vetëasimilimit, kontribuan në krijimin e shumë kombeve dhe kulturave (feve, gjuhëve, shkrimeve) të veçanta në tri kontinente;

- se shkatërrimi i Pellazgëve - Ilirëve të shumtë dhe të kulturuar u shkaktua jo vetëm nga katastrofat natyrore, por edhe nga luftat e brendshme që u zhvilluan mes fiseve të tyre, luftë kjo që vazhdoi, tradicionalisht, deri në ditët tona;

- se nga bërthama e Pellazgëve - Ilirëve shumë të lashtë, vetëm Shqiptarët mbetën pa u shkrirë në popuj apo kombe të tjera: në grekë, hebrej, arabë, italianë, austriakë, sllavë të jugut, turq, etj.;

- se vetëm Gegët, në një masë të konsiderueshme, e kanë ruajtur shqiptimin e Ilirishtes - Shqipes së Lashtë;

- dhe se fjalën vendimtare, lidhur me çështjet e shtruara, duhet ta japin, në radhë të parë, filologët, arkeologët dhe etnologët.

Gjuha me të cilën janë shkruajtur veprat origjinale Iliada dhe Odisea të Homerit ka qenë SHQIPJA. Disa të dhëna për këtë janë tek libri me autor Aristidh P. Kola, AVANITASIT DHE PREJARDHJA E GREKËRVE, Tiranë 2002, faqe 171-173:

	Shqip	**Homerike Bizantine**	**Greqishtja e sotme**
1	Ai që nëm, nëm (folje)	Neme-sis, neme-sao	Katara
2	Anda, ënda	Andha-no	Efkharistisi
3	Arë, ara	Arura	Horáfi
4	Bashkë ec	Vask ithi	Porevume
5	dera	Thira	Porta
6	deti	Theti-s	Thalasa

7	Dhe, dheu (tokë)	Jea, dhor, dha	Ji
8	Dor-ë, dor-a-	Ekedeka-dor-o	Qheri
9	Dru	Dris, drimos, driti	Ksilo
10	Edhe, dhe	Idhe, te	Qe
11	Elbë, elbi	Alfiton	Krithari
12	Enë (veshje)	Enimi	Ruho
13	Errët, errësirë	Ere-vos	Skotos
14	Ethe (kam ethe)	Ethir, ethae	Piretos
15	Flas	Flio, fliarae	Milao, omilae
16	Fryma, frima (dial. j.)	Frimao	Fisima
17	Hedh-	Heo	Rhino, tinazo, sio
18	Heq (helkj = tërheq)	Elko	Travae
19	Iki, ike	Iko	Fevgo
20	Kale, kali	Kelis-tos	álogo
21	Kall (djeg)	Kileo	Qeo
22	Korr	Kiro	Thiro
23	Krua, kroi	Krunos	Vrisi
24	Krye, krie	Krithen	Qefali
25	Lehem (lind)	Leho, lohia	Jenieme
26	Lepur	Leporis	Lagaes
27	Lesh	Lasios	Malå
28	Lig (i lig)	Lig-ios, lig-aes	Adhinatos
29	Loz, ljoz (arbërisht)	Lizo	Pezo
30	Lutem	Litome	Parakalae
31	Marr, mar	Mar-pto	Perno
32	Marrë (i marrë)	Margos	Trelaes

33	Më duket	Dhokei mi	Nomizo Medhome
34	Mend, mendoj nus	Mendohem	Sqeftome, nus
35	Mëri, mëni (dial. v.)	Minis	Thimos
36	Mi, miu	Mis	Pondå
37	Mjeshtër	Mistor	Tehnitis
38	Mjet	Mitos	Nima hondrae
39	Ndaj, daj (dial. v.)	Dheo, deo	Horizon
40	Ne (neve)	Noi	Emis
41	Nisem	Nisome	Ksqinae
42	Nuk	Ni uk	Dhen
43	Nuse	Nisos, nios	Nifi
44	Para (përpara)	Paros	Mbrostá
45	Për ty	Par ti	Ja sena
46	Për-hapa, për-hapsh	Apsh, aps	Piso
47	Punë, puna	Ponos	Dhuliá
48	Qas, kias	Qio, kio	Simono
49	Qen, qeni	Qion	Sqilos
50	Re, retë	Rea (perëndia e reve)	Sinefo
51	Rrah	Rahso, raso	Dherno, htipae
52	Rri (qëndroj)	e-ri-dhome	Kathome
53	Rronjë (rroj, jetoj)	Rronio, rronimi	Zo, akmazo
54	Ruaj, rojtar	Rrio, rritor	Filáso
55	Shkel	Skel-os	Patio, patae
56	Shkop	Skipon, skiptro	Ravdhi

57	Sy	O-se	Máti
58	Tata, ati, i jati	Tata, ata, jetas	Pateras
59	Ter (thaj)	Ter-so	Stegnaeno
60	Thërres,thrres, thrras	Threo, throos	Fonazo
61	Torrë	Tornoo	Jiro
62	Udhë, udha	Udhos	Dhromos
63	Vanë (shkuan)	Van	Pigan
64	Vend, ved	Ved-os, vedh-os	Edhafos, topos
65	Verë (stina e Verës)	Vear	Kaloqeri
66	Vesa, versa	Versi	Dhrosos
67	Vesh, vishem	Ves-this, vesnimi	Forae, foráo
68	Zien	Zei	Vrazi

Iliada dhe Odisea janë shkruar në gjuhën shqipe, gjuhë e cila ishte e vetmja në të gjithë konitnentin europian në atë kohë. Kjo gjë vërtetohet sa herë që një studiues merr në analizë Iliadën dhe Odisenë, përveç studiuesve të cilët e kanë quajtur veten gjuhëtarë dhe nuk kanë kuptuar gjuhën shqipe.

Odisea = udhë-sheu. Etimologjia e këtij emri është e lidhur direkt për një njeri i cili nuk sheh rrugën, ngatarrohet etj. Dhe e vërteta është se Odisea, u end nëpër dete për një kohë të gjatë, pasi nuk gjente rrugën e kthimit në Atdheun e tij. Kjo, ka lidhje edhe me Poseidonin (perëndia i detërave), i cili ishte babai i Polifemit, ciklopit të cilit Odisea i nxorri syrin e vetëm. Sa për emrin Iliada, nuk kemi asgjë tjetër përveç fjalën shqipe "Yll".

Sot grekët Diellit i thonë Helios, kurse yjeve u thonë "asteri". Në shqip, atyre që dalin natën dhe ndriçojnë, u thonë

"Yje". Atij që na ngroh dhe na jep jetë i thonë "Diell". Ne dialekt, kemi dhe fjalen "Dill". Shtesa e germes "d" ka bërë që Dielli të ndahet nga yjet e zakoshme që dalin vetëm natën, sepse rrënja e fjalës tek termi "dill" eshte "ill". Pikërisht këtë fjalë gjuha greke e ka marrë duke emërtuar Diellin = Ilios. Nga këtu dalim se edhe vetë titulli i Iliadës (Ylliadës) nuk është asgjë tjetër vetëm një titull shqip.

Po përse qenka shqip ky titull?

Sepse pikërisht shqipja ka qenë gjuha e atëhershme. Dhe vetë poeti Homeri (I mjeri) ka kënduar në gjuhën e tij amtare, e cila ka qenë Shqipja. Fakte që flasin vetëm shqip.

Iliada dhe Odisea u kënduan në pellazgjisht. Origjinali i veprës fillon me fjalën shqipe **mëni = mëri** . Aty tek origjinali i veprës kemi fjalët: **Tin mëni**.

Pjesa "tin" është artikull, ashtu siç e kanë italianët **"la"** apo anglezët **"the".** Por, sidomos në dialektin e jugut, thuhet edhe në ditët tona përemëri vetor i vetes së dytë: **ti = tinë** ose **ty = tyja = tynë**. Por fjalën nuk e kemi këtu. E kemi tek fjala **mëni/mëri** që ti dhe unë e përdorim edhe sot e kësaj dite.

Por, çfar kishte poeti Homeri që e filloi kështu këtë kryevepër? (Homeri = I mjeri...ka qenë i verbër.) Mos vallë neve këtu na duhet ta sjellim të gjithë librin dhe ta analizojmë? E kanë bërë të tjerët këtë punë.

Librin e Homerit, që e kanë greqizuar komplet, blegërima e deleve të Polifemit është: vi-vi-vi-vi, në një kohë që e dimë shumë mirë se delet nuk blegërinë në këtë mënyrë, por: beee-beee-beee. Si shpjegohet që emrat e heronjve tek Homeri, zbërthehen me gjuhën shqipe? Kush kanë qenë këto emra të kësaj bote në lashtësi dhe se çfarë gjuhe kanë folur ata? Kjo gjë nuk është e shpikur nga mendja jonë. Cezari fliste

shqip dhe i vuri emrin kryeqytetit të Rumanisë, Bukureshtit (Bukur-është). Ka folur shqip Cezari, mos t'ju duket hiperbolë kjo gjë. Nuk është Cezari si Perëndia, por ka qenë një njeri që hante bukë dhe pinte ujë. Nuk duhet idealizur atë si Mbinjeri, si figurë e pa kapshme, jashtë fuqive njerëzore, por ishte si ne edhe ai! Ishte një pellazgo-ilir i madh.

Ndoshta, shumë këtu nuk janë dakord me mua, sepse kanë një të keqe, një mangësi, nuk u besohet që i përkasin një populli të lashtë, nga i cili kanë dalë shumë emra që atyre u duken si të largët, të mistershëm, të huaj dhe legjendarë deri në mitikë dhe në këtë mënyrë, nuk kanë guximin dhe fuqinë që ta mbajnë mbi supe këtë peshë kaq të madhe, kaq të vjetër, kaq të fortë, kaq madhështore.

Kjo vjen nga shtypja psiqike që i kanë bërë këtij populli, Shqiptarëve, që ende flet Pellazgjishten e Vjetër; që ende zona "toske - etruske" ka si dialekt të saj etruskishten, që studiues të pa aftë nuk ngurruan të thonin që Etruskët nuk kanë ekzistuar. Thanë kështu, pasi ata nuk kishin as idenë më të vogël të gjuhës shqipe. Shumë nuk janë dakord me këto teori, por asnjëri nuk po i hedh poshtë. Të kuptohemi, studiuesit e aftë në këtë fushë, në bazë të fakteve të pa kundërshtueshme, e kanë sjellë si në pjatë të vërtetën, duke deshifruar "rebuse" të vjetra mijëravjeçare me ndihmën e kësaj gjuhe "të mallkuar" Shqipe.

Ky popull - Kombi Shqiptar ende nuk e di se kush është, ndaj edhe ka skepticizëm për të kaluarën dhe mosbesim për të ardhshmen!

III. PLLAKAT E THOTIT PREJ SMERALDI

Po japim të plotë përmbajtjen e Pllakave të Thotit, të përkthyera nga Skënder Hushi dhe të paraprirë nga një Parathënie nga vetë përkëthyesi:

PARATHËNIE

Mora shtytje për përkthimin e librit me Pllakat e Thotit, pas leximit të librit "THOTI FLISTE SHQIP" të z.Xhuzepe Katapano (Giuseppe Catapano), që u përkthye nga z.Qemal Velia dhe u botua në vitin 2007 në shtëpinë botuese "Botimet ENCIKLOPEDIKE" në Tiranë. I mrekulluar nga kjo dritare që po i hapej historisë së vendit tim vendosa të përkthej nga italishtja shkrimet në Pllakat prej Smeraldi të saçerdotit/priftit/dijetarit THOT (Në shqip: AI QË THOTË, THOTËSI, FOLËSI). Në disa shkrime të tjera që kam lexuar në italisht, emri i Thotit shkruhet: MTH ose PTHA, që përforcojnë të njënjtin shpjegim në shqip: **MTH=Më tha** ose **PTHA=Po, tha**. Që të kuptohet më mirë ky përkëthim imi, mendoj që të lexohet bashkë me librin "THOTI FLISTE SHQIP", ku THOTI paraqitet shqipfolës dhe krijues i shkrimit egjyptian, me anën e hieroglifeve, e ku çdo simbol paraqet gërmën e parë të fjalës në shqipen e vjetër të atij simboli.

Historitë e shkrimeve të THOTIT në pllaka prej smeraldi, të përkthyera në faqet në vazhdim, janë të çuditshme dhe jashtë çdo mendimi të shkencës moderne. Vjetërsia e tyre është e mahnitshme: të datuara mbi 10.000 vjet Para Erës së Re, periudhë në të cilën arkeologët mendojnë që popujt ishin akoma primitivë. **Ai që i shkroi ishte Thoti, një**

saçerdot/prift/dijetar, ish mbret nga Atlantida, që formoi nji koloni në Egjyptin e vjetër pas përmbytjes së Atlantidës. Ai ka qenë konstruktori i Piramidës së Madhe të Gizës, gabimisht thënë e Keopsit.

Në Piramidën e Gizës, THOTI ka trupëzuar njohuritë, urtësinë, shkencën dhe shumë sekrete nga Atlantida e vjetër. THOTI ishte i pavdekshëm, d.m.th. ai ka fituar mbi vdekjen. Shfaqej para popullit sa herë ai donte, pa kaluar nëpërmjet vdekjes dhe lindjes. Në një papir që ndodhet në Torino, përshkruhen të gjithë faraonët dhe perënditë që drejtuan Egjyptin, sipas rradhës dhe trashëgimisë faraonike. Për çdo sovran shkruhet viti i marrjes së pushtetit dhe i mbarimit të tij, edhe nëse ka qeverisur për pak muaj ose pak vite. Për THOTIN, aty thuhet se ka drejtuar Egjyptin për plot 31.236 vjet.

Përsosmëria e tij ka bërë që t'i transmetojë njohuritë e veta në shumë koloni të ndryshme me origjinë nga Atlantida, përfshirë edhe emigrimet e atlantidasve në Amerikën Qendrore e Jugore. Kur arriti koha e përshtatshme që ai të linte Egjyptin, THOTI filloi ndërtimin e Piramidës së Madhe dhe hyrjen e Sallës (Odës) së Madhe të Amentit, vend ku ai filloi shkrimet e tij dhe ruajti (arkivoi) sekretet më të famshme të tij me roje.

Edhe sot është jashtë përfytyrimit tonë të mendohet se si janë ngritë dhe transportuar blloqet gjigande të gurve me të cilët është ndërtuar kjo Odë, të cilët peshojnë nga 20 deri 80 ton, kur edhe sot është e zorshme të gjesh vinç për t'i ngritur. Jashtë piramidave janë dy statuja të bëra vetëm nga dy blloqe gurësh, të transportuara nga një gurore që gjindet shumë larg nga aty dhe secila peshon 1200 ton. Gjithashtu edhe piramidat

datohen më të vjetra se 12 000 vjeçare e jo 4000-5000 vjeçare, siç na kanë mësuar gabimishr apo me qëllim nëpër shkolla.

Në kohët e mëvonshme, pasardhësit e këtyre rojeve të sekreteve të THOTIT, bëhen saçerdotë/priftërinj të piramidës, ku Thoti deklarohet si **Zot i Diturisë dhe Urtisë** dhe shkrimet e tij i ruajtën nga brezi në brez, deri në ditët tona.

Në legjendë Odat e Amentit quheshin Odat ku kalonte shpirti pas vdekjes për t'u gjykuar. Sipas legjendës, THOTI për herë të parë është shfaqur 36.000 vjet para Erës së Re e ka jetuarr 16.000 vjet, duke u shfaqur e mishëruar në periudha dhe epoka të ndryshme. Unë në fillim mendoja se kësaj shifre duhej t'i hiqeshin dy zero, kështuqë shifra 160 vjetëshe duket më reale, por duke u thelluar në studimin e shkrimeve të THOTIT, u dhashë të drejtë këtyre studimeve dhe i besoj asaj që THOTI ka rrojtur 16.000 vjet, sepse profetët nuk shfaqen çdo vit e çdo shekull. Që të rishfaqet një profet duhet të kalojnë shumë mijëvjeçarë e shumë epoka. Edhe sot në kohët moderne, në shumë besime fetare, pritet rikthim profeti.

Gjatë kësaj kohe mendimet dhe shpirti i Thotit u trupëzuan në mënyra që janë të përshkruara dhe në shkrimet e tij. Sipas kësaj ai është trupëzuar tri herë dhe herën e fundit është njohur në Greqinë e lashtë, si **Ermes**, tri herë i lindur. (Ose: **Ermet**, që shpjegohet me shqipen: **Erë Mbet** ose në dialekt: **ERMES=Erë Mes=Erë Mbes**). Ai kalonte sa herë donte në gjendje **transi - as i gjallë e as i vdekur**, dhe zgjohej kur e shihte të nevojshme.

Shkrimet e tij në pllakat e smeraldit duhet të lexohen jo vetëm një herë, por dhjetëra herë, sepse vetëm kështu mundet të zbërthehet kuptimi i vërtetë i tyre. Një lexim i rastësishëm

të jep një ndriçim të bukur, por një studim i thelluar të hap rrugët e diturisë dhe të kërkimit.

Po shkruaj pak fjalë për këto sekrete kaq të fuqishme që i janë mbajtë të fshehta njerëzimit për shumë kohë dhe po deklarohen tashti.

Afërsisht në vitet 1300 p.e.r. në Egjypt (emri i vjetër "**Khem**") filluan turbullirat dhe shumë delegacione të saçerdotëve filluan të largohen në pjesë të tjera të botës.

Disa nga këta saçerdotë të piramidave transportuan me vete dhe pllakat prej smeraldi si gjëra të shenjta me të cilat ushtronin autoritet më të madh mbi saçerdotët që nuk ishin nga rraca e Atlantidës. Pllakat prej smeraldi ishin të shpjeguara nga legjenda si autoritet shumë i madh i saçerdotit Thot.

Një grup i veçantë i saçerdotëve merr me vete pllakat prej smeraldi dhe emigron në Amerikën e Jugut, ku krijojnë një rracë të fuqishme, rracën Maya, që na kujton shumë atë egjyptiane. Nga këta saçerdotë nji pjesë ngelën dhe u stabilizuan atje dhe në shekullin e dhjetë popullsia Maya vendoset në Jukatan dhe pllakat prej smeraldi u vendosën poshtë nji altari të tempullit më të madh: atë të zotit Diell. Mbas pushtimit të shtetit Maya nga spanjollët, qytetet u braktisën dhe thesaret e tempujve u harruan.

Prezenca e shkrimeve në pllakat prej smeraldi është mbajtë sekret deri në vitin 1925 dhe vetëm në këtë vit është dhënë leja provizore për botimet dhe përkthimet e tyre. Vendndodhja e pllakave prej smeraldi mbahet sekret. Ata hyjnë në pasurinë botërore dhe mbrohen në fshehtësi. Është e parashikuar që shumë njerëz nuk do t'i besojnë, por do të theksojmë një fjali nga ato pllaka:

“Se drita është brenda teje, drita që është gdhend në këto shkrime do të përgjigjet”.

*****

Tani pak fjalë për ndërtimin dhe përmbajtjen e pllakave prej smeraldi:

Janë të përbëra nga **12 pllaka prej smeraldi jeshil**, të formuara nga një substancë që nuk i dihet përmbajtja. Ato janë të paprishura dhe u rezistojnë të gjithë elementeve dhe substancave të natyrës që njihen deri sot. Në fakt struktura atomike dhe molekulare është fikse dhe asnjëherë nuk ndryshon. Mbi pllakat e smeraldit janë gdhendur shenjat e gjuhës së vjetër të Atlantidës: shenja që përgjigjen dhe hyjnë në rezonancë me valët e mendimeve, duke lënë vibracione mendimesh në kokën e lexuesit.

Pllakat prej smeraldi kanë të gdhendura dhe shenja rrathësh ngjyrë ari, domethënia e të cilave hyn në sekretet e vjetra. Kuptimin e këtyre rrathëve dhe atyre që po shfaqen në arat me grurë, po mundohen t’i japin një shpjegim e një lidhje shkencëtarët. Çdo njeri që i lexon me vëmendje pllakat prej smeraldi, domethënia dhe urtësia e gdhendur në to, do t’i kthehet lexuesit e shumëfishuar. Aty thuhet:

“Beson o nuk beson, por kur i lexon ato, vibracionet që gjen atje do të përgjigjen në shpirtin tënd.”

Të gjithë simbolet dhe rrathët janë çelësa për të hyrë tek e vërteta, por shumë herë porta e së vërtetës nuk hapet, sepse çelësi nuk është i saj. Në qoftë se ne do t’i kuptojmë të gjithë çelësat, të gjithë simbolet që janë manifestuar aty, do të mundim të futemi në sekretet e pllakave prej smeraldi.

Në faqet në vazhdim do të jepet përkthimi i **Shkrimeve në Pllakat prej Smeraldi**. Janë fiksuar me fjalët e Thotit shumë domethënie që nuk shfaqen në sipërfaqe. Drita e njohurive të gdhendura në pllakat prej smeraldi të hap shumë fusha mendimesh. Aty thuhet:

"Lexo dhe mëso", por vetëm në qoftë se drita brenda ndërgjegjes tënde rizgjon shpërthime në thellësinë e shpirtit tënd dhe ndërthurret me të. Se sa të fuqishme kanë qenë shkrimet e THOT-it nga Atlantida, mjafton të mendojmë se u kanë mbijetuar mijëra viteve, siç do mundohem ta zbërthej sipas përkthimeve të tij, që i kam marrë nga disa variante në italisht e këto të përkthyera nga anglishtja. Për hapsirë-kohën aty flitet mijëra vjet para Anjshtajnit.

Një tjetër profete e kohës së THOT-it, që ishte femër, quhej **MAT** (shpjegohet me fjalën shqipe MAT=**me mat, me peshue**) disa mijëra vjet para profetit ebre MOJSI (Musai), e cila krijoi 42 ligje të shenjta që populli dhe faraonët i rrespektonin. Mojsiu i ka marrë të gjitha të gatshme, i ka kopjuar e përshtatë sipas kërkesave të popullit të vet e, për t'ia bërë të besueshme atij populli (disa qindra) analfabet e të sapodalë nga Egjypti, i deklaronte se ia kish dërguar Zoti, gjë që nuk ishte e vërtetë.

Mbi bazën e shkrimeve të Mojsiut (Musait) u zhvilluan pjesa më e madhe e rrymave fetare monoteiste, nga ebraizmi, ortodoksët, katolikët, protestanët, etj., e deri tek pjesë të besimit mysliman, që, megjithëse kanë shumë gjëra të përbashkëta, shumica e luftërave është bërë për ato pak ndryshime që ata kanë me njëra-tjetrën.

Përktheu: Skënder Hushi

PLLAKA – I

HISTORIA E THOTIT NGA ATLANTIDA

Unë, Thot Atlantidasi, zot i mistereve, roje i regjistrave, madhështori mbret, magjistar, që po jetoj nga njëri brez në tjetrin, jam shpirti që kalon muret e Amentit, i ulur atje për të drejtuar të gjithë brezat që do të vijnë pas këtij regjistrimi të të gjitha mendimeve të fuqishme të Atlantidës.

Në qytetin e madh Keor, në ishullin Undal (në një tjetër kapitull, shkruhet: UNAL. Duket si fjala shqipe U NDALOVA, ashtu si shpjegohet dhe emri i vjetër i Irlandës, ERINI, në shqip: E RINI, atje bie shiu sa herë e don toka dhe e rinon atë.) shumë kohë më parë, unë kam filluar këtë mishërim, jo si njerëzit e vegjël të epokës që po jetojmë, por si një i mbifuqishëm, i gjallë dhe i vdekur, por gjithmonë nga epoka në epokë duke rigjallëruar jetën në Odën e Amentit, (edhe kjo fjalë në dialektin gegë ndahet: A=Asht dhe fjalës Ment=Mendje, e gjithë fjala mund të thuhet: **asht e mendve**, d.m.th. **vendi i mendimeve të mëdhaja)** ku lumi i jetës gurgullon përjetësisht. Me qindra herë unë kam zbritë në rrugën e errët që të çon në dritë dhe kështu me qindra herë kam ngjitur nëpërmjet errësirës së frikshme në dritë, forcën time, fuqishëm rimëkëmbur.

Tash, për pak kohë, unë po zbres dhe njerëzit e Khem-it (Egjypti i vjetër) nuk do më shohin më, por në një kohë që nuk ka lindur akoma, unë do të buroj (rilind) madhështor dhe i fuqishëm, duke kërkuar kujtimet që kisha lënë pas. Atëherë kujdes, njeriu i Khemit, nëqoftëse ti ke falsifikuar tradhëtisht mësimet e mia, unë do të hedh poshtë nga aty ku je dhe do të

përplas në errësirën e frikshme të greminave nga ke ardhë. Mos ua zgjo sekretet e mia njerëzve të veriut dhe as njerëzve të jugut, frikësohu nga mallkimet e mia që do të bien mbi ty! Kujtoji gjithmonë dhe bë kujdes nga fjalët e mia, sepse me siguri do të rikthehem përsëri dhe do të kërkoj llogari për ato që duhet të ruajë. Përgjithmonë, dhe në qoshen më të humbur të kohës, dhe matanë vdekjes të jemë, unë do të kthehem, do të ripaguaj ose të dënoj sipas qëndrimit dhe besnikërisë tënde.

I madh ka qenë populli im në kohët e moçme, e fortë ishte fuqia e shkëputur nga flakët e përjetshme e mbi gjithë këto, më i madhërishmi ndër bijt e njerëzimit ishte baba im **THOTME** (në shqip **MË THOT MUA**), roje i tempullit të madh, i cili lidhte Bijtë e Dritës që qëndronin në tempull me rracën njerëzore që banonin në të dhjetë ishujt. Zëdhënës, pas Treshes të banorëve të UNDAL-it, i flisja mbretit me zë të denjë e me respekt që duhet të dëgjohej. Qysh fëmijë, unë u rrita e u burrërova duke përfituar nga baba im të fshehtat e lashta, derisa më brumosën me Flakën e Diturive, derisa të digjem në këtë flakë e të tretem.

Asgjë nuk dëshiroj, përveçse të jemë i përndjekur nga përvoja, njohuritë, dituritë, maturia e urtësia, (këto fjalë përsëriten shpesh dhe unë mendoj se janë të barazvlerfshme me fjalën PLEQSI), derisa të vijë dita e madhe, që të urdhërohem nga Banorët e Shenjtë të Tempullit, para të cilëve jam i dërguar.

Të pakët ishin disa fëmijë të njerëzve që kishin mundur të shihnin këtë pamje madhështore, prandaj Fëmijët e Dritës që jetojnë në këto ambiente, nuk janë si fëmijët e njerëzve, derisa ata nuk janë mishëruar në një trup fizik. (Fëmijët e Dritës është një nga të panjohurat më të mëdhaja të njerëzimit.

Flitet se janë pa nga njerëz të ndryshëm në formë femrore, shumë të bukura e të ndritshme). Unë isha zgjedhë midis fëmijëve të njerëzve, u pranova nga Banorët e Mësimdhënies kështu dhe qëllimi i Tyre është kryer, qëllim ky që u mendua në barkun (mitrën) e kohës. Për shumë epoka banoj në Tempull, duke mësuar vetëm diturinë e urtësinë, derisa më afrohet Drita e Flakës së Madhe, që më mëson si të përshkoj Amentin nga nëntoka, ku Mbreti i Madh rrin në fronin e tij të forcës. Nga thellësia e shpirtit tim përkulem përballë Zotit të Jetës dhe Zotit të Vdekjes, duke pranuar me rrespekt si dhuratë Çelësin e Jetës. Nga ky çast isha i lirë nga Salla e Amentit, i çliruar nga vdekja e i mbërthyer në rrathët e Jetës.

Udhëtoj larg deri ke yjet e në pafundësi, deri ku hapësira dhe koha ndalen, atëherë, duke pirë me fund gotën e diturisë dhe urtësisë, shoh në zemrat e njerëzve e zbuloj të fshehtat e mëdhaja, sepse vetëm në kërkim të së Vërtetës shpirti im mund të jetë i mbushur me flakën e të vërtetës.

Jetova nëpër shumë epoka, duke shikuar rreth meje ata që po shijonin Gotën e Vdekjes dhe riktheheshin në Dritën e Jetës. Ngadalë e ngadalë nga Mbretëritë e Atlantidës kaluan valë të ndërgjegjes që ishin bë Një me mua, vetëm për të qenë të ndërrueshëm me lindjen e nji ylli më të vogël.

Dëgjoj me bindje ligjet, fjalët që lindin nga ZOTI. Gradualisht zbresin në errësirën e ATLANTIDËVE, derisa më në fund zemërimi del nga AGWANTI (Gjendje e pavetëdijshme, gjendje transi. Diku shkruhet AGUANTI e nëse është shqipe fjala: AGOI dita, AGON TI, AGUAN ata, kjo fjalë bëhet e kuptueshme nëpërmjet gjuhës shqipe). Banorët thonë Fjalën, duke thirrë Fuqinë.

Nga thellësia e zemrës së tokës, fëmijët e Amentit dëgjojnë, e duke dëgjuar, drejtojnë ndryshimet e lules së flakës që djeg në përjetësi, duke u ndryshuar e duke udhëtuar, përdorën Fjalën, derisa kjo flakë e madhe ndryshon drejtimin e saj. Nëpër botë hyjnë ujëra të mëdha, duke mbytë e përmbytë ndryshojnë ekuilibrin e Tokës, derisa vetëm Tempulli i Dritës ngel në këmbë, në të majtë të malit të madh të UNDAL-it, që vazhdon të burojë nga uji. Kishte mbetë ndonjëri gjallë aty, i shpëtuar nga ndërhyrja e ujit.

Më thërret paskësaj ZOTI e më thotë:

Mblidh bashkë me ty këta njerëz të mi! Zgjidhi sipas punëve që bën secili e çoji larg nëpërmjet ujit, derisa të arrini në tokën e të egërve leshatorë, që banojnë nëpër shpella të shkretëtirës! Ndiq planin tim që ti e din!

Kështu mblodha njerëzit dhe i ngarkova në anijen e madhe të Zotit. U zgjuam e u nisëm pa zbardhë dita. I zi shtrihej poshtë nesh Tempulli. Papritmas nga Ai ngrihet uji. Zhduket nga toka dhe, kur arrin koha, shohim madhështorin Tempull. Ne shkojmë me të shpejtë drejt diellit të mëngjesit, derisa poshtë nesh takojmë tokën e bijve të KHEM-it (Egjypti i vjetër). Ata me të gjithë shpejtësinë e tyre, vijnë drejt nesh me topuzë e me ushta dhe ne u ngritëm të zemëruar kundër atyre që donin të shkatërronin Bijtë e Atlantidës. Unë ngrihem personalisht dhe drejtoj me skeptrin tim nji rreze me vibracione, duke i qëlluar në shenjë, derisa i shkatërroj si copat e gurit nëpër mal.

Pastaj unë u flas me fjalë të qeta e të matura, duke u shpjeguar forcën e Atlantidës dhe që ne ishim bijtë e Diellit dhe lajmëtarët e tij. Të frikësuar nga këto ngjarje të çuditshme

të shkencës magjike, ata ngrijnë të përmbysur sipër këmbëve të mia, derisa unë i lë të lirë.

U ngulëm gjatë në tokën e KHEM-it, shumë e shumë kohë, derisa për të rrespektuar fjalën e ZOTIT, që edhe kur flen, rron përjetësisht, ngrita Fëmijët e Atlantidës dhe i çova në shumë drejtime, derisa në barkun (mitrën) e kohës mençuria e urtësia do të burojë e rilindur nga bijtë e tyre. (Me këtë thënie vërtetohen zbulimet e shumta nëpër botë, të cilat kanë stilin e Atlantidës). Ngulem për shumë kohë në tokën e KHEM (Egjyptit), bëj shumë punë të mençura e të mëdhaja. Bijtë e KHEM-it u rritën me Dritën e Diturive, të spërkatur nga shiu i pleqësive të mia. Pastaj prisha korridoret (rrugicat) për ke AMENTI, kështuqë unë mund t'i mbajë fuqitë e mia e të bëj që të jetoj nga njëra jetë në tjetrën Dielli i Atlantidës, duke mbajtë urtësinë e maturinë dhe duke ruajtë kujtimet.

Një pjesë e vogël e bijve të KHEM u bashkuan me personat përreth meje, duke rritur shkallë-shkallë besimin ke forca e shpirtit. Tashti, për pak kohë po largohem nga këta, në sallat e errëta të Amentit, shumë poshtë, në barkun e Tokës, përballë Zotit të Gjithfuqishëm, Ai dhe unë, banor i tij. Buron e lartësuar një hyrje, një hyrje që të drejton poshtë ke Amenti. Duhet guxim për ta përballuar në errësirë hyrjen e vogël që të çon në sallën e errët të Amentit.

Sipër, mbi korridor, unë ndërtoj nji piramidë madhështore, duke përdorur forcën time, më të fortë se ajo e tokës (gravitetit). Në një vend më të thellë, unë i forcoj hyrjet nëpër oda dhe hap nji tjetër tunel rrethor, që arrin gati në majë. Atje në kulm, unë vë kristalin, që jep rrezatimin në hapsirën-kohë, i ndryshoj drejtimin e forcës që vjen nga hapësira duke e përqëndruar mbi hyrjen e Amentit. Ndërtoj të

tjera oda dhe i lë që të gjitha të duken si ajo e vërteta dhe atje fsheh Çelësat e Amentit. Çdonjëri që guxon të përballojë këtë mbretëri të errësirës, duhet që në fillim të pastrohet duke ndejtë për nji kohë të gjatë pa ngrënë e pa pirë.

Kush shtrihet në sarkofagun e odës time, atëherë unë i zbuloj atij sekretet e mëdhaja. Shpejt ai njeri do të ndjekë rrugën në thellësi të errësirës së Tokës, ku do të takohet me mua - THOTIN, Zotin e Pleqësive. Do ta takojë, do ta mbajë e do të rri gjithmonë me të.

Unë ndërtova Piramidën e Madhe, të projektuar sipas modelit të forcës piramidale të Tokës, që digjet përjetësisht, kështuqë mund të rezistojë për shekuj. Tek ajo unë kam mbështetë njohuritë e mia të shkencave magjike.

Unë mund të jemë përsëri këtu, kur të kthehem përsëri nga Amenti. Përgjithmonë, ndërkohë që unë fle në Sallën e Amentit, Shpirti im, që është i lirë, mund të mishërohet, duke banuar në trupin e njerëzve, në njërën formë apo në tjetërën (si ke HERMESI i kohëve të lashta, tre herë i lindur). Unë jam i dërguar në Tokën e Njerëzve, zbatoj urdhërat e tyre, kështuqë shumë nga njerëzit do të lartësohen. Tash po kthehem në Sallën e Amentit, duke lënë pas meje pjesë të pleqësive të mia. Duke ruajtë e duke dërguar urdhërat e Njerëzve, unë do të ngre përherë lartë sytë e tyre drejt Dritës. Ndërkohë sigurisht do të bëhesh njëlloj si Mësuesi, sigurisht do të jesh i barabartë në gjykime me Mësuesin, sigurisht do të jesh i njëllojtë me të Gjithë. Tash po largohem nga ty (i drejtohet Njeriut). Ndiq urdhërat e mia, mbaji e ruaji dhe unë do të jemë me ty, do të ndihmoj e do të drejtoj drejt Dritës!

Tash përballë meje hapet porta. Unë po zbres në errësirën e natës.

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën I -

Kalimi i Thotit në drejtim të **Sallës së Amentit** nuk ishte shndërrim i ashtuquajtur *vdekje.* Ai thjeshtë e vinte trupin e tij fizik në rrezatimin e forcës, më vonë i njohur si i *Ftohti* i **Lules së Jetës,** ku ngelet i ruajtur për gjithmonë. Nuk besoj të jetë kthyer më si Thoti. (Në kuptimin: Në trupin e Thotit S.H). Ndërkohë, trupi i tij ngelet me jetën pezull, ndërgjegja e tij kthehet e shkon në shumë trupa të tjerë njerëzorë dhe jeton shumë vite.

Në Atlantidë:

Keor ishte qyeteti i *priftërinjve të Atlantidës*. **Undal** ishte një ishull përballë qytetit **Unal** dhe ishin dy qytete, ose ndryshe, dy pjesë të një qyteti që shtrihej në të dy ishujt, të lidhur me ura, që e bënin të dukej një ishull. Ky lloj ishulli ishte i tërë i rrethuar me mure dhe ndërtesa me taracë, që në mes kishte një mur të lartë.

Keor ishte përballë Unalit dhe ishte qytet i priftërinjve, ndërsa pjesa tjetër e ishullit ishte e njohur si **Chien (Kien**) dhe ishte vendbanimi i shkencëtarëve dhe fillozofëve. Askush nuk mund të kalonte nga një pjesë e ishullit në tjetrën, nëse nuk ishte i pajisur me një leje kalimi të firmosur nga kryetarët e grupeve përkatëse. Këta kryetarë shin mendimtarët e fuqishëm të Atlantidës dhe ishin persona. **Thotme**, *baba i Thotit*, ishte kryetar i tyre ose **Guvernator i të Tremëdhjetëve**. Praktikisht, më vonë bëhet **Lozha e Madhe e Bardhë**. Njihnin jetën në **Sallën e Amentit**, ku për një periudhë kohe qëndronin nën **Lulen e Jetës** për të rinovuar (ripërtrirë, rinuar) trupin e tyre. (Lulja e Jetës, ishte vendi te Piramida e Madhe ku shkonin për të rinuar trupin S.H). Edhe Thoti kishte zbritur ke

Salla e Amentit rreth njëqind herë për të rinovuar trupin e tij. Të mendosh se ishte e nevojshme të shkojë atje çdo 50 vjet, na rezulton që Thoti të ketë jetuar afërsisht 50.000 vjet në atë epokë kur shkruhen këto pllaka. Ishte 40.000 vjeç në epokën e fundosjes së Atlantidës, kështu që shkrimi i pllakave prej smeraldi të jetë ba rreth 20 000 vjet ma parë.

Thoti e pushonte trupin e tij të vërtetë nën **Lulen e Jetës**, që të lëvizte lirisht e ta përdorte sipas dëshirës dhe ndërkohë hynte në trupat e të tjerëve dhe e çonte ndërgjegjen e tij te ata. Ka deklaruar se me siguri do të rilind edhe një herë në një tjetër trup, në periudhat që do të vijnë. Në Pllakat e Smeraldit është thënë se do të rikthehet në një të ardhme, kur pushtuesë që do të vijnë nga hapësirat qiellore do të mundohen të pushtojnë globin e Tokës. I len sekretet e **Piramidës dhe Anijen e Madhe të Luftës** nën **Sfinks.**

Pasardhësit e Khem, sot Egjypt, janë lënë si roj. Kanë ndjekë me besnikëri urdhëresat dhe i ruajnë edhe në ditët e sotme sekretet. Këta zotëruesë të **Mistereve e Diturive** që i kishte mësuar, i ka lejuar të ruajnë sekretet nga njerëzit që erdhën më pas atje. Pasuesit e Thotit nuk ishin banorë të Atlantides, një grup që jetonte në qytetin **Undal**, që bënin pjesë në klasën e shkencëtarëve, fillozofëve dhe priftërinjve. Kishin mësuar të kërkonin njohuri nëpërmjet **Dëshmive Akashe.**

Bijtë e Dritës, kishin ardhë në mesin e tyre në kohë shumë të vjetra dhe u kishin mësuar dituritë dhe kishin pranuar të shkonin përpara në: **Fuqinë e përjetshme** të **Ndërgjegjes Universale**. **Thotme,** baba i **Thotit,** ishte nji prift i lartë i qytetit Undal**,** transmetues i **Bijve të Dritës** e të **Banorit të Undalit,** për mbretin dhe për njerëzit e ishullit. **Thoti** mësoi nga arkivat sekrete që ndodheshin në Tempull. Në të kaluarën

kishte mësuar aq shumë, sa ishte në gjendje të mësonte menjiherë të vërteta që i jepeshin për tu mësuar. Dëshira për njohuri të larta i ngjallnin forca mendimi aq të mëdha e të thella, sa e vinin në një plan vibracionesh (dridhjesh) shumë të larta, dhe e bënin **Banor** të ndërgjegjshëm të ekzistencës së tij.

Banori nuk kishte trup e pamje njerëzore, por nji trup të njëjtë me atë të përdorur nga **Ndërgjgjja** përgjatë nisjes fillestare të të parit cikël, kishte nji **Trup Sferik. Drita** dhe **Forca** e nxjerrë nga ky lloj trupi ishin aq të mëdha për nivelin mesatar të njeriut, saqë vetëm nji ndërgjegje e nivelit të lartë të vibracioneve mundej ta mbante e të qëndronte ende në gjendjen materiale (*mos vdiste*). **Banori** shihte se Thoti ishte gati të pranonte **Shkëndinë e Dritës,** të dhënë nga **Flaka.** Rritja e shpejtë e Flakës e çon Thotin në një jetë më të fuqishme e më të lavdishme nga ajo e njerëzve të zakonshëm. Ndërsa rritej bashkë me njohuritë e marra, iu tregua rruga për te **Salla e Amentit,** ku është e përqëndruar forca e **Lules së Jetës** në këtë planetë**.** Përballë **Zotërinjve të Jetës dhe të Vdekjes,** pranon çelësat e **Jetës dhe të Vdekjes** me fuqinë, që nëse donte, t'i merrte ose jo ato, sipas dëshirës. Pas marjes së fuqive mbi **Jetën** dhe **Vdekjen, Thoti** filloi të përgatitej për të lënë trupin e tij, dhe me dëshirën e tij të udhëtonte në shtrirje (plane) të ndryshme të Hapësirë-Kohës. Duke poseduar dituritë (njohuritë) e Universit, zbulon se ishte i bazuar në zemrën dhe në mendjen njerëzore, domethënë se atje gjen misteret më të mëdha, sepse nëpërmjet njeriut, Universi shtrihet në hapësira të pa zbuluara. Thoti kishte lindë 40 000 vjet para përmbytjes së Atlantidës, por më vonë kishte pranuar si detyrë të veçantë, që të mos rikalonte ashtu si të tjerët që kanë arritë te **Ndriçimi i Parë**. Ata që kishte qenë me atë, në rini, shkonin te ylli

Afërdita për të qenë të zëvendësuar me valë përgjegjësie të ardhura nga Marsi. Valët e mëvonëshme të ndërgjegjes ishin të atilla, sa që nuk ishte e mundur t'u besohej **atyre** shkenca dhe dituritë e të parëve Atlantideas, sepse mund të përfitonin nga kjo gjë. Banori thotë **Fjalën e Forcës**, që u bë të dëgjohej nga **Zotërinjtë e Cikleve**, që qëndronin te Amenti, të cilët, me ta dëgjuar, ndryshuan drejtpeshimin e Tokës në kanale të reja, duke shkaktuar kështu fundosjen e Atlantidës, duke tërheq me vete edhe shkencën dhe njohuritë që populli zotëronte. Këto njohuri, edhe pse të errësuara (të cekta, të pakta) në krahasim me ato që zotëronin **Bijtë e Dritës**, ishin shumë të mëdha për të mbetur në duar të primitivëve (të paditurëve).

Lulja e Jetës nuk gjendet në **Lulen e Flakës së Jetës,** por në piramidë, në të **Ftohtën Flakë,** që është ekuilibri i kësaj Toke. **Tempulli i Dritës** nuk ishte Tempulli i qytetit Unal, por tempull i jashtëm i priftërinjve të qytetit Undal. Tempulli i Unalit nuk ka qenë i përmendur si Tempull, por si Portë ose më mirë të themi, vendqëndrimi i Banorit. Duke ditur se nga çfarë ishte i përbërë, nuk mund të përmbante forcën e tij shkatërruese, kështu që nuk ishte marrë parasysh se do të shkaktonte përmbytje. Vetëm pak njerëz të ditur të Undalit shpëtuan kur ajo tokë u përmbyt. Ata shkuan në Egjypt që quhej Khem dhe u bë e para qendër e lulëzuar me kulturë të themeluar nga atlantideasit. Nga aty iu bë thirrje disa të parëve të fiseve primitive të shumë vëndeve nëpër tokë. Ishte ky plan i diktuar që përdori Khem për tu bërë një qendër kulture, për një gjeneratë të re.

Anija e Mësuesit ishte një anije kozmike në gjendje të udhëtonte midis planeteve dhe ishte e armatosur me armë që mundeshin të shkatërronin çdo gjë të gjallë në Tokë, nëse

përdoreshin me të gjithë kapacitetin e tyre. Në hapësirë ishte e drejtuar me motorë atomikë, por jasht pjesës së gravitetit (jashtë Tokës apo sistemit tonë diellor) mundej të lëvizte me anë të mendimeve, jo vetëm midis planeteve, por në çdo hapësirë që mendja e drejtuesit mund të mendonte e të parafytyronte. Struktura e saj ishte e atillë, që substancat e saj e bënin të ngrihej e të ulej, në harmoni me dëshirat e pilotit.

Kur **Thoti** e la qytetin **Unal,** edhe **Tempulli i Dritës** dhe Vendqëndrimi i **Banorit** u mbytën, por nuk u shkatërruan. Kur shkon në Egjypt, njerëzit e egër atje, me të pa njerëzit e Atlantidës, u munduan t'i vrisnin, por u mpinë e u dorëzuan të detyruar nga një rreze paralizuese që ua lëshoi Thoti nëpërmjet shkopit (spektrit apo purtekës) së tij. Ky shkop apo purtekë ishte në gjendje të transmetonte me qindra lloje forcash, që buronin nga forca e atij që e mbante në dorë (Thotit). Kjo forcë e shfaqur nga Thoti bëri që të egërit të dorëzohen. Deklarata e tij se ishte **Biri i Diellit** u bë themeli i admirimit të Diellit nga racat e vjetra. Natyrisht, Thoti kishte parasysh **Diellin Shpirtëror**. U deshën vite për të krijuar ndërtesën e re të Bijve të Diellit. Kur u përfundua, filluan të dërgohen emisarë që të edukonin e drejtonin racat e tjera të pazhvilluara në të gjithë Botën.

Me kalimin e kohës, **Thoti** e sheh të arsyeshme që të hapte një kalim për te **Amenti,** që të mundej të ripërtrinte/rinonte trupin e tij, që, edhepse ishte ende i fortë, pas qindra vitesh kishte filluar të dobësohej. Ishte e nevojshme, sepse detyra e tij nuk ishte çuar deri në fund. Pas një periudhe të gjatë, të pazhvilluarit e Egjyptit (Khem) zhvilluan ndërgjegjen, derisa arritën të ishin në gjendje të ecnin përpara pa ndihmën e Thotit, kështuqë Thoti planifikoi

të kthehej në **Sallën e Amentit** dhe ta pushonte trupin e tij nën **Lulen e Jetës,** ndërkohë që ndërgjegjja e tij mund të ikte në vende të tjera. Hyrja për te Amenti gjindet nën **Piramidën e Madhe të Keopsit** (ose Khufu), që u ndërtua duke ndryshuar strukturën atomike të gurëve, ato u bënë shumë të lehtë dhe, pasi viheshin në vend, u kthehej pesha e vet. Nën Piramidë gjendet një **Dhomë e Energjisë,** e lidhur me majën e Piramidës me nji kanal ose pus. Në pjesën e sipërme të kanalit apo pusit, ndodhet një lente (shirit) kristali, që i nxjerr rrezet e drejtuara nga dhoma e energjisë. Këto rreze janë në drejtim të hapësirë-kohës që duke u përthy, hapin një shteg të një dimensioni tjetër nën Piramidë në drejtim të **Sallës së Amentit,** në lëvizje të njëkohshme hapësinore me tokën, që ekzistojnë pikërisht në hapësirë. Dhomat sekrete janë ato për të cilat flitet në librin e **Piramidës së Madhe**. Sarkofagu është i lidhur me kanalin kryesor. Kur shtrihesh brenda për një periudhë të caktuar kohe, trupi transportohet poshtë në kanal, në qendër të dhomës së energjisë. Kjo njohuri u konservua në vitet në vazhdim, por duke i ra vlera ritit të fillimit. Në fillim duhej ly trupi me një pomadë, derisa ai që e ka të jetë i transportueshëm e të mishërohet më vonë. Kjo njohuri nuk u ruajt nga egjyptianët.

Piramida e Madhe është e paprishëme. Nëse pjesët e saj ma të fshehta prishen, do të lirohen forcat e **Rojeve**, që do të shkatërrojnë çdo gjë e çdo person, të cilët do të bahen skllevërit e tyre. **Thoti** më vonë u mishërua me emrin **Hermes** te Mësuesit e Medhej, por jo përherë në globin e Tokës. Thoti vërteton qysh në kohën e tij, se të tjerë do të ecin në shtegun e tij të **Dritës.**

PLLAKA – II

ODAT E AMENTIT

Në thellësi, në zemër të tokës, shtrihen Odat e Amentit, larg, poshtë ishullit të përmbytur të Atlantidës, Odat e Vdekjes dhe Odat e Jetës, në banjën e flakëve të përjetshme.

Larg, në kohët e kaluara, humbur nëpër hapësirën-kohë, Bijtë e Dritës hodhën shikimin poshtë në Tokë. Shihnin Fëmijët e Njerëzve, të lidhur në zinxhirët e skllavërisë. E dinin ata se, vetëm duke iu heqë Njerëzve të Tokës skllavërinë, Dielli do të ndriçonte Tokën e Njerëzit. Njerëzit e Dritës zbritën dhe krijuan trupin, duke marrë si shembull trupat njerëzorë. **Mësuesi i Madh** zbriti i fundit e tha:

- "Ne jemi ata që jemi formuar nga pluhuri i hapsirës kozmike dhe do të marrim pjesë në jetë deri në pafundësi, duke jetuar në këtë tokë si fëmijtë e njerëzve, të ngjashëm dhe jo të ngjashëm me njerëzit!"

Pastaj, në një vend të banuar, poshtë kores së tokës, me anë të forcës së tyre, krijuan hapësira të bollshme, larg fëmijëve të njerëzve. Aty qëndronin, të rrethuar nga forca të fuqishme, të mbrojtur nga influenca shkatërruese e Odës së Vdekjes. Pak e nga pak u vendosën në hapësira të tjera, që i mbushën me Jetën e me Dritën nga sipër. Pastaj ndërtuan Sallën e Amentit, ku Ata do të mund të banonin përjetësisht në një jetë të përjetshme.

Tridhjetë e dy ishin Bijtë, Bijtë e Dritës, që kishin ardhë midis njerëzve dhe kishin kërkuar t'i lironin ata nga zinxhirët e errësirës, të gjithë ata që ishin të lidhur nga forca që vijshin nga ana tjetër.

Poshtë, në Odën e Jetës, rritet nji lule verbuese, shpërthyese, flakëruese që e kthen mbrapsht natën. E vendosur në qendër, nji rreze me fuqi të madhe i jep Jetën, i jep Dritën duke i mbushë me fuqinë e tyre të gjithë ata që i afroheshin. Aty përqark qëndrojnë fronet e tyre, tridhjetë e dy vendndodhje për çdonjërin nga Bijtë e Dritës, në këtë botë që mund të jenë spërkatë nga rrezatimi, mbushur me Jetën e Dritës së përjetshme.

Atje, kohë pas kohe, ata vendosën trupat e parë që krijuan, kështu që mund t'i mbushnin me Shpirtin e Jetës. Flaka e Dritës, që jep Jetën, duhet të ndriçojë para trupave të tyre, duke shpejtuar rizgjimin e Shpirtit të Jetës.

Atje, nga njëra epokë në tjetrën, të gjithë bashkë, ulen Zotërinjtë e Mëdhenj, që jetojnë një jetë të panjohur nga njerëzit. Atje, në Odat e Jetës, ata shtrihen të fjetur, por shpirtërat e tyre fluturojnë të lirë nëpërmjet trupave njerëzorë. Kohë pas kohe, ndërkohë që trupat e tyre shtrihen të fjetur, ata mishërohen në trupat e njerëzve, duke i mësuar e drejtuar në rrugë të drejtë. Atje në Odat e Jetës, të mbushura me dituritë dhe mençuritë e tyre, të panjohura nga rraca njerëzore, jetojnë përgjithmonë në flakën e ftoftë të jetës, të ulur rrijnë Bijtë e Dritës. Vjen një kohë kur nga aty ata burojnë, vijnë nga thellësitë, për të qenë drita midis njerëzve, të liruar nga Odat e Amentit, të lirë nga Lulja e Dritës së Jetës.

Çuditërisht fuqishëm, Ata, të mbështjellë me velin e forcës së tyre, qetësisht, të gjithëdijshëm, drejtojnë forcën e jetës, ndryshe nga bijtë e Njerëzve.

Po, ndryshe është edhe **Njëshi me Bijtë e Dritës**. Roje e vrojtues i forcës që lidh me zinxhirë njeriun, gati për t'i shkri lidhjet kur Drita të jetë arritë. Më përpara dhe më e fuqishme

rri Paraqitja (Pamja) me Vel, **Zoti i Zotave**, i përjetshmi **NANDA**, sipër çdonjërit nga Zotat e Cikleve: Tre, Katër, Pesë e Gjashtë, Shtatë e Tetë, çdonjëri me misionin e tij, çdonjëri me fuqinë e tij, duke drejtuar e udhërrëfyer njerëzimin drejt qëllimit të fundit. Aty qëndrojnë Ata, fuqishëm e autoritarë, të liruar nga hapsirë-koha. Nuk janë të kësaj bote Ata, por i barabartë me Ata është Vëllau më i Vjetër i fëmijëve të njerëzve (Banori). Duke gjykuar e peshuar, me pleqësitë e tyre shohin përparimin e Dritës midis njerëzve. Atje, përballë me Ata, më çuan ke Banori ku unë pashë që u bëra një me Ata, sipër tij (Banorit).

Pastaj nga Ai (Banori) vjen një zë i madhërishëm që më thotë: - *I madh je ti, Thot, midis bijve të njerëzve. Erdhi ora tani të lirohesh nga Odat e Amentit, Zot i Jetës, midis fëmijëve të njerëzve.*

Nuk do ta shijosh vdekjen, vetëm kur ti ta kërkosh, pije ti Gotën e Jetës deri në Pafundësi! Nga ky çast para teje ke jetën, sa të duesh ti. Tash e tutje Vdekja do të jetë nën urdhërat tuaja. Rrin ose nisesh, si të dëshirosh.

Merre jetën në formën që ti dëshiron, Fëmijë i Dritës që je rritë midis njerëzve! Zgjidh detyrën tënde, për të gjithë duhet të punosh, pa u larguar asnjëherë nga rruga e Dritës (Zotit, Perëndisë, Allahut = KRIJUESIT).

Tani ke lëvizur një hap drejt rrugës së përpjetë, i pafund mali i Dritës. Çdo hap që ti bën, të lartëson drejt malit të Dritës. Çdo gjë që ti përparon, është pak, sepse shumë e largët është gjysma e rrugës. Sa herë i afrohesh maturisë e diturisë së pafund, aqë herë të ngelet gjysma për të bërë.

Tash ti je i lirë nga Odat e Amentit, për të ecë dorë për dorë me Zotërinjtë e kësaj bote, me të vetmin qëllim: të punoni bashkë për t'i çuar në Dritë fëmijët e njerëzve.

Pas kësaj, nga froni i tij më afrohet një Zotëri, më merr dorën e më drejton përpara, nëpërmjet të gjitha Odave të tokës së thellë e të panjohur. Më drejton nëpër Odat e errëta të Amentit, duke më treguar të fshehtat e mëdhaja, të panjohura nga njerëzit. Më drejton nëpër kalimin zbritës e të errët, në Odën ku qëndron e riqëndron Vdekja. E gjërë shtrihej në hapsirë përballë meje Oda e Madhe e Amentit, e rrethuar nga muret e errësirës, por e mbushur plot me dritë. Përballë meje qëndronte një fron i errësirës dhe mbi të ishte ulë, me velin sipër, Figura e Natës. Figura e madhe e ulur aty, ishte më e errët se errësira, e zezë si errësira, që nuk ka qenë në asnjë natë. Pastaj prej fronit të tij erdhi njëri nga Zotat, më mori dorën dhe më çoi përpara, përmes të gjitha Sallave të tokës së panjohur dhe të thellë. Më udhëhoqi përmes Sallave të Amentit, duke më treguar misteret që janë të panjohura nga njerëzit. Më udhëhoqi, përmes kalimit të errët zbritës, për në Sallën ku ndodhet Vdekja e errët. E pamatë si hapësira shtrihej përpara meje Salla e madhe, rrethuar prej territ, e megjithatë, plot e përplot me Dritë. Përpara meje u shfaq një fron i madh i errësirës, mbi të ishte ulur një figurë e mbuluar me natë. Figura e madhe e ulur ishte më e errët se errësira, e errët me një errësirë që nuk ishte e natës. Pastaj Zoti, përpara tij, bëri një pauzë e shqiptoi Fjalën që prodhon Jetën e tha:

"Oh, zot i errësirës, udhëheqës i shtegut nga Jeta në Jetë, përpara teje po sjell një Diell të mëngjesit. Mos e prek kurrë me fuqinë e natës! Flakën e tij mos e thirr në errësirën e natës! Shikoje dhe njihe, një nga vëllezërit tanë, i ngritur nga errësira në Dritë! Çliroje flakën e tij nga skllavëria e saj! Lere që ajo të ndizet, e lirë le të flakërojë përmes errësirës së natës!"

Figura, atëherë ngriti dorën, erdhi papritmas një flakë që rritej në mënyrë të qartë dhe të shndritshme. Perdja e errësirës u rrokullis mbrapsht me shpejtësi, duke e zbuluar Sallën nga errësira e natës. Pastaj të tjera u rritën në hapësirën përpara meje, flakë pas flake, nga perdja e natës. Miliona të panumërta u shfaqën papritur përpara meje, disa flakërues si lule prej zjarri. Disa të tjera shpërndanin një rrezatim të zbehtë që rridhte dobët nga jashtë natës. Disa të tjera dobësoheshin me shpejtësi; të tjera që rriteshin nga një shkëndijë e vogël drite. Secila e rrethuar nga veli i vet i zbehtë i errësirës duke flakëruar sërish me një dritë që nuk do të mund kurrë të shuhet. Ecejak duke ardhur e duke shkuar si xixëllonjat në pranverë, mbushnin hapësirën me Dritë dhe me Jetë. Pastaj u shqiptua një zë, i pushtetshëm dhe solemn duke thënë:

"Këto drita janë shpirtrat mes njerëzve që rriten dhe dobësohen, duke ekzistuar përgjithmonë, e megjithatë duke ndryshuar jetë nëpërmjet vdekjes në jetë. Kur ata të kenë lulëzuar, të mbërritur në zenitin e rritjes në jetën e tyre, me shpejtësi atëherë unë dërgoj velin tim të errësirës, duke e mbështjellë të vdekurin në qefin dhe duke e ndryshuar në forma të reja të jetës. Vazhdimisht ngjiten, përmes të gjitha kohërave, duke u rritur, duke u zgjeruar në një flakë gjithmonë e më të madhe, duke e ndriçuar errësirën me një fuqi akoma më të madhe, duke u fikur e megjithatë të pashuar nga veli i natës. Kështu rritet gjithmonë shpirti i njeriut, duke u fikur, e megjithatë i pashuar në errësirën e natës. Unë, Vdekja, vij, dhe nuk mbetem, sepse jeta ekziston përjetësisht në të Gjithën; thjesht një pengesë, unë, në rrugëtim, gati për t'u pushtuar nga drita e pafundme. Ngrihu o flakë që digjesh gjithmonë në brendësi, flakëro dhe pushtoje velin e natës!"

Atëherë, në mes të flakëve në errësirë, bëri përpara një që ndriçoi natën, duke flakëruar dhe duke u përhapur, gjithmonë e më i shndritshëm, derisa, më në fund nuk mbeti gjë tjetër përveç Dritës. Atëherë udhëheqësi im foli me zërin e Zotit: ***"Shihe shpirtin tënd si rritet në dritë, tani i çliruar përgjithmonë nga Zoti i natës".***

Ai, pastaj, më udhëhoqi përmes shumë hapësirave të mëdha të mbushura me misteret e Bijve të Dritës; mistere të cilat njeriu nuk do të mund t'i dijë kurrë derisa të mos jetë edhe ai një Diell i Dritës. Pastaj Ai u kthye mbrapsht e më udhëhoqi në Dritën e sallës së Dritës. Unë u ula në gjunjë para Zotave të mëdhenj, Zota të të Gjithë kohërave të cikleve të sipërm. Ai, pastaj, shqiptoi fjalë të një fuqie të madhe e tha:

"Ti je i çliruar prej sallave të Ament-it. Zgjidh punën tënde midis bijve të njerëzve! **Atëherë unë i thashë:** ***O, mjeshtër i madh, le të jem unë një mësues i njerëzve në mënyrë që t'i udhëheq përpara dhe drejt së lartës, derisa edhe ata të bëhen dritë midis njerëzve, të lirë nga veli i natës që i rrethon, dhe të flakërojnë me një dritë që do të shkëlqejë mes njerëzve.*** **Pastaj zëri më tha:** ***Vazhdo si të dëshirosh! Qoftë e bërë! Ti je Padron i fatit tënd, i lirë të marrësh apo të refuzosh siç ti dëshiron. Merre fuqinë, merre mençurinë! Shkëlqe si një dritë mes bijve të njerëzve".***

Pastaj Banori më udhëhoqi drejt lartësimit. Unë banova sërish mes bijve të njerëzve, duke u mësuar dhe duke treguar pjesë të mençurisë sime; Diell i Dritës, një zjarr mes njerëzve. Tani sërish po përshkoj shtegun zbritës duke kërkuar dritën në errësirën e natës. Mbrojini dhe mbajini, ruajini dokumentat e mia, në mënyrë që të jenë udhërrëfyes për bijtë e njerëzve.

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën II -

Sallat e Amentit janë hapësira të veçanta të fshehura të **Tokës**, sepse nuk gjenden në këtë oktavë (shkallë muzikore) vibracionesh/dridhjesh materiale, por në një kthesë të hapësirës, e ndodhur e veçuar nga gjitha të tjerat. Kanë nji polaritet pozitiv ose negativ të **Yarkimas** (*Rrymë ndër speciale).* Pozicioni i tyre i përafërt në raport me tokën është nën Atlantidë, por për të hy aty, duhet të dalësh në kthesën, në vendin ku thyhet hapësira. Janë disa vende ku mund të bëhet kjo gjë: **Burimet me squfur në Oklahoma; Mali Shasta ne Kaliforni; Miktolan në Amerikën e Jugut; Shamballa në Tibet; Piramida e Madhe e Keopsit në Egjypt; Pylli i Zi në Gjermani; Benares në Indi; Malet Atlas në Afrikën veriperëndimore**. (Unë do të shtoja edhe shumë vende në Shqipni si: **Mali i Tomorrit, Dodona, vende të shenjta në Lezhë** dhe vende të tjera që do të konstatohen në të ardhmen – S.H).

Epoka e largët e kaluar, është cikli i parë, i fiksuar në të kaluarën e hapësirë-kohës dhe është kjo periudhë e veçantë që ndjek të këqijat që zbresin mbi njerëzit, të cilët bëhen skllevër të planit material. **Mësuesit** e kësaj kohe, ose **Bijtë e Dritës**, krijuan trupat e tyre nga materia e parë dhe i ndërfutën te jeta. Edhe pse nga jashtë këto trupa ishin të njëllojtë me trupat njerëzorë, përbërja e brendshme ishte e ndryshme, kishin organe që i përfitonin vetëm nga njësi të dyfishta të njohurive, mashkullore dhe femrore. Nuk ishin të lidhur me papërgjegjshmërinë dhe papërqëndrimin, siç ishte njeriu dhe ishin të lirë të bënin vepra që pjesa tjetër e njerëzimit nuk ishte në gjendje t'i bënte. Ndërkohë që trupi fizik i Thotit duhej të

ripërtrihej çdo 50 vjet, trupi i tyre origjinal kërkonte një rinovim çdo njëqind vjet.

Në periudhën e **Ciklit të Parë** filluan të ndërtohen **Sallat e Amentit** nga **Bijtë e Dritës,** që zbritën në këtë planet. Me forcat që ata kontrollonin, ndyshuan hapësirën dhe ndërtuan **Sallat e Amentit** dhe i përfshinë te **Toka. Sallat** dimensionale, përreth Sallës së Amentit, ia mbronin hyrjen nga kushdo që nuk ishte i pajisur me një ndërgjegje të pjekur. **Hapësira e Madhe** ishte e ndarë me të tjera hapësira më të vogla ku përqëndrohej esenca e forcave direkte të **Yarkima-s**. Në tokë ishin 32 **Bij të Dritës**, të ngarkuar me problemet tokësore.

Nëpër Salla u përcaktua një pikë e përqëndrimit të **Forcës Jetësore** ose të **Shpirtit.** Në atë vend riderdhet kjo **Forcë Jetësore** që furnizon Jetën në planet. Kur e njëjta materie në Planet ndryshohet (vdes), shpirti që lirohet, tërhiqet ke **Lulja e Jetës ke Amenti,** për t'u ripërdorë. Vepron për tokën, njëlloj sikurse gërshetimet diellore që veprojnë me trupin njerëzor.

Froni i **Bijve të Dritës** ishte aq shumë i gatshëm për të bërë gjetje në prurjet e mëdha të shpirtit, saqë kujdeseshin për trupat e atyre që sapo e kishin lëshuar (shpirtin - S.H). Kështuqë, një trup i vendosur nën **Lulen e Jetës** nuk kalonte në jetë drejtperdrejt nga burimi jetësor, por ishte lyer, i ndërfutur me rrezatimin e saj. Ekuilibri ishte mbajtë i përsosur, ndërkohë që ndërgjegjia ishte larg edhe për shekuj me radhë. Forca e jetës është aq e madhe, rezerva e grumbulluer në trupin e vendosur nën Lulen e Jetës për 100 vjet, ishte aq shumë e plotësuar, saqë duheshin 1000 vjet për ta rinovuar. Kështuqë për 10 vjet çdo njiqind vjet, mund të mbante trupin të ri dhe me plot energji. Në shumë raste, linin trupin e tyre

për shumë kohë dhe **Bijtë e Dritës** hynin në trupa njerëzore qysh në lindje. Rastësisht paraqiteshin edhe me formën e tyre të vërtetë, por jo shpesh. Kur dikush nga ata arrinte në të **Tretin Dritësim,** mbetej i lirë nga **Amenti** dhe mundej, nëse dëshironte, të vendoste trupin e tij nën **Flakën e Jetës, d**he ta rinovonte nga epoka në epokë.

Të **Shtatë Zotërinjtë** janë shpërthye drejtpërdrejt nga zgjënimi i ndërgjegjes të shtatë kozmoseve (qiellnave). Punojnë të pamvarur nga njëri-tjetri dhe në harmoni me atë ndërgjegje. Kontrollojnë disa forca nga bota tjetër (aldilà), rregullojnë parregullsitë negative dhe kanë pjesëmarrje në të gjithë planetet e banuar në kozmos. Tjetër detyrë e **Zotërinjve** është që të kontrollojnë hapësirë-kohën, ndarjen e **Katër Kohëve** dhe përmbajtjen nga goditjet e çrregullsive të kufizimeve negative në drejtim të flakëve të ndërgjegjes që kanë zhvilluar. Është fuqia e tyre që drejton jetën në pikën e bashkimit të **Lules së Jetës,** që në atë botë e përmban.

Zoti i Zotërave është në përbërjen e **Ciklit të Nëntë Kozmik** dhe përmban titullin e tij, sepse është më i zhvilluari e më i largëti shpërhapje e **I.Yob - Vendburimi i Zanafillës së Krijimit**. Është fuqia që kontrollon të gjitha të këqiat, negativet e të gjithë cikleve kozmike. Nën **ATË** ndodhen të **barabartit** në fuqinë e vaçantë, Zotërinjtë, që kontrollojnë gjashtë ciklet e tjerë sipër nesh. Edhe pse nuk jan pjesë e kësaj ndërgjegje kozmike, janë të bashkuar për të gjitha epokat, të formuara nga i njëjti material bazë dhe janë të lindur nga i njëjti burim: **I.Yob - Vendburimi i Parë i Krijimit.**

Thoti u suall përpara **Zotërinjve** nga **Horlet**, **Banor i Unalit** dhe admiroi **Banorin** duke krijuar një Zotëri, me fjalë të tjera, hyjnë aq mirë në harmoni me njëri-tjetrin, sa që bahen

një, njësohen. Nga **AI (Zoti)** arrin nji zë. **Zotërinjtë**, duke mos pasë formë dhe vibracione njerëzore, nuk mund të merreshin vesh me anën e zërit dhe fjalëve. Fuqia e tyre u ripërbë, sa që **Thoti** mundej t'i dëgjonte e t'i ndiente. Në vazhdim u aftësua që të ngrente vibracionet e tij, sa që të ndiente të heshturin zë të **Zotërinjve.** Për atë çast nuk mundej t'i provonte, sepse duhej të kalonte ende në të tjera prova të forta.

Thotit iu dha liria nga **Amenti,** dhe çelësat, me të cilët, sipas dëshirës, mund të hapte çdo hapësirë, dhe duke qenë se kishte të drejtë të hynte te Lulja e Jetës, mund të vdiste kur të donte. Thoti mësoi ligjet e krijimit, në mënyrë që të merrte çdo lloj forme të çdo trupi që dëshironte. Sipas **Ligjit,** do të duhej të zgjidhte detyrën e veçantë që ishte i ngarkuar për të ndjekë, sepse arritja e dritësimit ia bën më të madhërishme mundësinë e fuqishme të punës. Lartësia që **Thoti** kishte arritë ishte vetëm një kodrinë e maleve të larta të **Dritës** ndërkaluese (në botët e tjera), drejt të cilave të gjitha njohuritë kozmike po punonin. Kur **Thoti** arrinte në një cak, mundej të vazhdonte me atë që kërkonte cakun e sipërm fare. Ishte njëri prej 32 **Bijve të Dritës** dhe jo një nga zotërinjtë që e drejtoi Thotin në të parën xhiro nëpër **Sallën e Amentit**, vendi ku mbretëronte e kundërta e jetës (që është vdekja).

Kjo forcë, duke qenë një gjë e ngjashme me atë gjënë që quhet **Jeta**, gjendet në vendin e Jetës. Mundet të duket e çuditshme (paradoksale) të emërtohet vdekja e njëjtë me jetën, por, nëse konsiderojmë që jeta është në veprim me vdekjen, në pjesën negative që jeta lëshon, mundemi të vrejmë ngjashmërinë e saj. **Zotëria i Vdekjes** nuk është një nga zotërnjtë e cikleve më të larta, por bën pjesë në këtë cikël kozmik. Ka përgjegjësinë të veprojë me forcë te vdekja, në

negativen që e rrethon çdo shkëndijë të ndërgjegjes. Kjo errësirë, që është humbja e ndërgjegjes, ose vdekja, asht quajtë **Natë**, sepse në atë, ndërgjegjja e humb kujtesën e asaj që ka qenë. I është kërkuar **Zotërisë së Vdekjes** që mos takojë më Thotin me anën e humbjes së ndërgjegjes dhe ta shohë e ta njohë si një **Zotëri të Dritës,** kështuqë nuk duhej ta trajtonte ose ta takonte me vdekjen. Dora e **Zotërisë së Vdekjes** është e ngritur, duke çburgosë flakën, simbolin e **Dritës**, shpërfytyruar nga errësira e vdekjes. **Drita** e internon errësirën.

Thotit i shfaqeshin miliona të panumërt flakërimesh, çdonjëra një shpirt që paraqitej në këtë plan. Ndriçimi ose errësira e flakëve zbulon gradacionin e çrregullsisë negative, në të cilën është lidhë. Zotëria i Vdekjes i zbulon Thotit të fshehtat e jetës dhe të vdekjes, duke i shpjeguar se si mishërohet shpirti në një trup fizik, arrin në lartësinë më të madhe, në zenit të rritjes së tij, dhe më pas kalon nëpërmjet ndryshimeve të vdekjes për të vazhduar me më shumë dritë. Vdekja arrin (vjen), por vetëm përkohësisht. Jeta në vetvete është e pavdekshme, ekziston nga fillimi deri në fund.

Më në fund, gjithmonë, **Jeta dhe Drita** duhet të fitojnë mbi Vdekjen dhe Errësirën. **Vdekja** dëshiron që **Drita** ta heqë forcën e saj, sepse edhe Vdekja vjen nga Drita. Thotit iu tregua se si i njëjti shpirt ecën nga errësira dhe flakëron me Dritë të plotë. Udhërrëfyesi (Zotëria i Vdekjes) e drejton Thotin në të tjera hapësira të Amentit, duke i treguar në çdo vend të fshehtat që u zbulohen vetëm bashkëmendimtarëve, idhtarëve. Midis të tjerave, iu treguan hapësira më të brendshme të dimensionit të katërt. Thoti u suall përsëri përpara Zotërinjve, që i kishin folë në fillim dhe u urdhërua që

të zgjidhte përgjegjësinë e tij. Thoti, rastësisht, zgjedh që të jetë një mësues për të drejtuar shpirtërat nga errësira në dritë. Iu dha zgjedhja që bëri nga Zoterinjtë dhe u urdhërua të vazhdonte punën për atë që sapo kishte zgjedhë.

Thoti u suall në **Tokë** për të zbatuar zgjedhjen e bërë. Ai në fund e deklaron se donte të shkonte përsëri te **Amenti**, duke i lënë njerëzit për një farë kohe.

PLLAKA – III

ÇELËSI I PLEQËSIVE/MENÇURIVE/DITURIVE

Unë, Thot Atlantidasi, e jap mençurinë time, jap dijet e mia, jap pushtetin tim. Lirisht ua jap bijve të njerëzve. E jap që edhe ata të mbushen me mençuri për të ndriçuar nëpër botë mbi velin e natës. Mençuria është fuqi dhe fuqia është mençuri, dhe të dyja bashkë e bëjnë gjithçka të përsosur. Mos ji krenar, o njeri, për mençurinë tënde! Fol me injorantin me të njëjtën dashamirësi siç flet edhe me të diturin! Nëse dikush vjen tek ti i mbushur me dije, dëgjoje dhe verja veshin fjalëve të tij, sepse mençuria është gjithçka. Mos hesht kur të keqen e flasin si të Vërtetë, sepse drita e diellit shkëlqen mbi të gjitha gjërat!

Do të ndëshkohet kushdo që shkel Ligjin, sepse liria vjen vetëm nëpërmjet Ligjit. Mos shkakto frikë, sepse frika është robëri, një zinxhir që i lidh njerëzit në errësirë. Dëgjoje zemrën tënde gjatë gjithë jetës! Bëj më shumë nga sa të është urdhëruar të bësh! Edhe kur të kesh fituar pasuri, dëgjo prapë zemrën tënde, sepse të gjitha pasuritë nuk kanë asnjë vlerë, nëse zemra jote është e vakët.

Mos e zvogëlo kohën e gjërave që i bën me qejf; për shpirtin kjo gjë është e neveritshme (të bësh gjëra pa dëshirë). Nuk devijojnë ata që udhëhiqen, por ata që kanë humbur, nuk mund ta gjejnë dot rrugën e drejtë. Po të shkosh tek njerëzit, shko me Dashuri nga thelbi i zemrës tënde. Nëse dikush vjen të të lypë një këshillë, lëre të shprehet lirshëm, derisa ta thotë gjithçka për të cilën ka ardhur tek ti. Nëse ai heziton të ta hapë zemrën, do të thotë se ti, gjykatësi, ke vepruar gabim.

Mos përsërit diskutime ekstravagante, dhe as mos dëgjo diskutime të tilla, sepse janë fjalë të njeriut që nuk është në ekuilibër. Mos fol në mënyrë të tillë, kështu që ai, para teje të mund ta njohë mençurinë. Heshtja është flori. Fjalët e shumta janë fukarallëk. Mos të të rritet mendja mbi bijtë të njerëzve, që mos të të bjerë ajo më poshtë se pluhuri!

Po qe se njerëzit të nderojnë e të respektojnë, qofsh i nderuar për mençuri dhe njerzishmëri! Nëse do ta njohësh karakterin e një miku, mos pyet shokun, por rri në shoqëri me të! Bisedo me të, vëzhgoje zemrën e tij nga fjalët që thotë dhe nga veprimet që bën. Duhet të jetë e dobishme çfarë hyn në qilar, dhe gjërat, që janë prona jote, duhet t'i ndash me miq!

Budallai, dijen e konsideron si injorancë, dhe gjërat fitimprurëse, budallait i duken të dëmshme. Ai jeton në vdekje. Prandaj dhe ushqehet me ushqimet e saj. Njeriu i mençur e lejon zemrën e tij të rrjedhë e të dalë nga shtrati, por e mban gojën të heshtur. O njeri, dëgjoje zërin e mençurisë, dëgjoje zërin e dritës! Ka mistere në Kozmos, që kur zbulohen, e mbushin botën me dritën e tyre. Kushdo që dëshiron të jetë i lirë nga vargonjtë e errësirës antike, le të bëjë fillimisht ndarjen e materiales prej jomateriales, të zjarrit nga toka; sepse dijeni se ashtu si toka zbret në tokë, po ashtu edhe zjarri ngjitet përpjetë tek zjarri dhe bëhet një me të. Kushdo që e njeh zjarrin që ka brenda, ai do të ngjitet tek zjarri i përjetshëm dhe do të jetojë përjetësisht në të. Zjarri, pikërisht zjarri i brendshëm, është më i fuqishmi, sepse i kalon të gjitha gjërat dhe depërton në të gjitha gjërat e Tokës.

Njeriu e mbështet veten vetëm mbi atë që i reziston. Kështu Toka duhet t'i rezistojë njeriut duhet t'i rezistojë Tokës, në të kundërt ai nuk ekziston dot. Jo të gjithë sytë shohin me

të njëjtin vizion, sepse njërit një objekt i duket me një formë dhe ngjyrë të caktuar, kurse një syri tjetër i duket tjetërlloj. Po kështu edhe zjarri i përjetshëm ndryshon ngjyrën dhe nuk është njësoj si një ditë dhe tjetrën.

Kështu flas unë Thoti, prej mençurisë sime, sepse njeriu është një zjarr që digjet duke ndriçuar në natë; asnjëherë nuk është shuar në velin e errësirës, asnjëherë nuk është shuar nga errësira e natës. Përmes mençurisë sime pashë në zemrat e njerëzve, dhe i gjeta të burgosur nga skllavëria e konflikteve. Liroje, o vëlla, zjarrin tënd, nga mundimi! Nga frika ajo konsumohet në hijen e natës!

Dëgjo o njeri dhe vere vath në vesh këtë mençuri nga goja ime: ku rreshtin së ekzistuari emri dhe forma? Vetëm në vetëdije, në të padukshmen, shndrit një forcë e pafundme rrezatimi. Format, që krijon me shkëlqimin e vizionit tënd, janë në të vërtetë pasoja që ndjekin shkakun tënd.

- Çdonjëri që njeh flakën që është brenda saj, shkon në flakën e përjetshme dhe jeton përjetësisht në të.

- Flaka, flaka e brendshme, është më e fuqishme nga të gjitha fuqitë. Nga ajo rrjedhin të gjitha gjërat dhe hyjnë të gjitha gjërat e Tokës.

- Njeriu mbahet vetëm nga ato që rezistojnë. Kështu njeriu duhet të shtyjë Tokën, edhe pse nuk mundet.

- Jo të gjithë sytë shohin me të njëjtin shikim, sepse njërit i duket një send në një formë e ngjyrë tjetër nga një njeri tjetër. Kështu edhe flaka e përjetshme ndryshon nga ngjyra në ngjyrë dhe nuk është e njëllojtë nga dita në ditë. Kështu flas unë, THOTI, nga pleqësia ime, sepse çdo njeri është nji flakë që digjet e ndritshme nëpër natë; përherë zhduket në velin e errësirës, përherë zhduket në velin e natës. Nëpërmjet

pleqësive të mia kam shikuar në zemrat e njerëzve, i gjeta të burgosur në skllavërinë e mundimeve. Liroje nga vështirësitë, flakën tënde, o Vëllau im, që mos të varroset në hijen e natës! Dëgjo, o Njeri, e merri parasysh këta pleqësi: ku mbaron emri e forma?

- Vetëm në ndërgjegje, e padukshme, një forcë e përjetshme me rrezatim të shkëlqyeshëm. Format që janë krijuar nga mrekullia, parashikimi yt, janë me të vërtetë efekte që ndjekin arsyen. Njeriu është një yll i kufizuar nga trupi, derisa më në fund, ia arrin të lirohet nga lufta e brendshme. Vetëm nga lodhja në mundime, ylli mund të lulëzojë në një jetë të re. Për çdonjërin që njeh zanafillën e të gjitha gjërave, ylli i tij do jetë i lirë nga mbretëria e natës. Kujto, o Njeri, se të gjitha gjërat që ekzistojnë, janë vetëm një tjetër formë e asaj që nuk ekziston. Të gjitha gjërat që kanë ekzistuar po ndryshojnë në gjëra të tjera dhe ti nuk bën përjashtim.

Konsideroje ligjin si ligj për të gjithë. Mos kërko atë që është jashtë ligji, sepse kjo gjë ekziston vetëm në shpresa të kota të mendimeve tuaja. Pleqësitë u vijnë të gjithëve, derisa ata të shkojnë drejt pleqësive.

Nëpërmjet të gjitha kohërave, drita mbetet e fshehtë.

Zgjohu, o Njeri, dhe bëhu i ditur e i matur!

Kam udhëtuar thellë në të fshehtat e jetës, duke pyet e kërkuar atë që ishte e fshehur.

Futi në llogari të gjitha e bëhu i matur dhe i ditur.

Larg, poshtë sipërfaqes së tokës, në Odat e Amentit, ndodhen sekretet që u janë fshehë njerëzve. Shpesh kam udhëtuar në hyrjen e panjohur nëntokësore, kam pa Dritën, që është Jeta midis njerëzve. Atje, poshtë Lules së Jetës që përherë jeton, unë kërkoj zemrat dhe të fshehtat e njerëzve. Aty gjejë

njërin, por ai jeton në errësirë, sepse Drita e Flakës së Madhe i është fsheh nga brenda. Përballë zotërive të së panjohurës së Amentit, unë mësoj pleqësitë që i çoj te njerëzit.

Ata janë Zotërit e Sekreteve të pleqësive, të përçuara qysh nga pafundësia. Ata janë Shtatë, Zotërit e Amentit, Zotërit më të lartë të Fëmijëve të Mëngjesit, Diej të Zhvillimit, Zotër të Pleqësive. Ata nuk janë bërë si fëmijtë e njerëzve! Tre, Katër, Pesë e Gjashtë, Shtatë, Tetë e Nëntë janë emërtimet e Zotërive të njerëzve.

Larg nga e ardhmja e pa formë ose duke u formuar, ata bëhen si mësues për fëmijtë e njerëzve. Ata jetojnë përgjithmonë, edhe kur nuk jetojnë, të palidhur nga Jeta e të lirë dhe nga Vdekja.

Ata mbretërojnë përherë me pleqësitë e tyre të pafund, të kufizuar, por edhe të lirë nga Odat e errëta të Vdekjes.

Ata kanë me vete Jetën, ose, mund të thuhet, jetën që nuk është jetë, të lirë nga çdo gjë janë Zotat e çdo gjëje.

Më para nga Ata arrin Fjala, vegël për fuqitë e tyre mbi të gjitha. E gjërë është shprehja e tyre edhe e fshehur në vogëlsira, e krijuar në krijim, e njohur dhe e panjohur.

TRESHI mban çelësin e të gjitha magjive të panjohura. Ai është krijuesi i Odave të Vdekjes, duke e çuar gjithnjë përpara fuqinë e tij, duke mbështjellë të vdekurin me qefinat e errësirës, lidh shpirtërat e fëmijëve të njerëzve, duke i dhënë drejtim të keqes nga fëmijët e njerëzve.

KATRA është ai që shkrin fuqitë. Ai, Zot i Jetës të fëmijëve të njerëzve: Nga drita është krijuar trupi i tij, flakë është shprehja e tij, çlirues i shpirtit të fëmijëve të njerëzve.

PESA është Zotëria, Zot i gjithë çelësave magjikë, është fjala që jehon midis njerëzve.

GJASHTA është Zot i Dritës, kalimi i panjohur, i përshkuar nga bijtë e njerëzve.

SHTATA është ai që është Zot i gjërësive, Zot i hapsirës dhe i çelësit të Kohërave.

TETA është ai që vë në rregull zhvillimin, peshon dhe vë në baraspeshë udhëtimin e njerëzve.

NËNTA është baba, i gjërë në shprehjetë e tij, formon e ndryshon nga jashtë çdo gjë të paformë.

Mendohu rreth këtyre simboleve që po të jap, këta janë çelësat, të fshehtat për njerëzit!

Shko gjithnjë në drejtim të anës së lartë, o Shpirti i Mëngjesit!

Ktheji mendimet tuaja në drejtim të anës së lartë të Dritës e të Jetës! Kërko në çelësin e numrave që po të jap, dritën, në kalimin nga një jetë në tjetrën!

Kërko me urtësi e maturi! Ktheji mendimet tuaja nga brenda teje! Mos ia mbyll mendjen tënde Lules së Dritës!

Vendos në trupin tënd një parafytyrim të formë-mendimit. Mendohu për numrat që do të drejtojnë nëpër jetë.

I kthjellët është mendimi i atyre që janë të urtë e të matur. Hapi portën Mbretërisë së Dritës!

Drejtoje flakën tënde si Dritën e Mëngjesit.

Mbylle jashtë errësirën dhe jeto dritën! Merre ti, o Njeri, këtë si pjesë të ekzistencës. Të Shtatët që janë, nuk janë ashtu si duken.

Hapu ti, o Njeri! Ke pleqësitë e mia. Ndiq udhëtimin nëpër botë që të kam treguar! Zotër të pleqësive, Diell të Dritës së Mëngjesit e Jeta për fëmijtë e njerëzve.

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën III -

Çelësi i diturive përmban disa rregulla, që **Thoti** ua kishte dhënë barbarëve, bijve të **Khem,** që iu besuan atyre, përderisa u bë i humbur **Çelësi i Dritës.**

Mençuritë dhe fuqia ecin përkrah njëra-tjetrës. Së bashku, të domosdoshme, njëra pa tjetrën nuk kanë vlerë, sepse fuqia nuk krijohet pa mençuritë e dituritë dhe pleqsitë nuk marrin të vetme fuqinë dhe përdorimin e forcës. Një person krenar nuk është i pjekur por i metë, sepse krenaria bën që të kundërshtosh mësimmarrjen, që më vonë të shoqëron dhe çdo gjë e mat me atë nivel e gradacion.

Heshtja është flori. Të flasësh për të keqen, kanalizon forcën krijuese dhe i jep jetës realitetin. Të tentosh të ngresh krye ndaj **Ligjeve**, prodhon ndëshkimin tënd, sepse nuk është asgjë pa **Ligjet.** Kush mundohet të punojë në kundërshtim me **Ligjet**, do të përplaset. Frika nuk duhet të hyjë brenda te ti dhe nuk duhet tu shtijmë frikën të tjerëve, sepse është një skllavëri. Nëse në zemrën tonë do të kemi dashuri, atëherë kush dashuron harmoninë, është i pëlqyer nga ne. Nëse këto gjëra nuk janë, atëherë tjetri është i qeverisur nga çrregullsia. Të mundohemi të ndjekim vetëm rregullat e **Mësuesit** që është brenda te ne. Mos u mundo të bësh më tepër se qëllimi (arsyeja).

Pasuria është një mjet për një fund, por nuk është fundi. Kur nevojat materiale janë të kënaqshme, mendimet duhet të adresohen në drejtim të mbretërisë së lartësuar. (Ashtu si zemrat e të vjetërve të ditur). Kur do të bësh një udhëtim, është i nevojshëm dhe një udhërrëfyes, përndryshe, kush humbet rrugën, duhet të kërkojë rrugën më të lehtë. Dashuria është

fillimi dhe fundi i udhëtimit, sepse bashkimi është përgjigjja e dashurisë për njëri-tjetrin: këtë gjë ua rekomandonte Thoti popujve, duke i përçuar mësimet e vllazërisë dhe të bashkimit.

Një njeri i preokupuar që kërkon këshilla, gjen ngushëllim në shprehje. Nëse është i lëkundur, është sepse kush e dëgjon, ka ndonjë defekt dhe është jo tërheqës. Këto miratime kanë një vlerë të madhe. Diskutimet e mendjemadhësisë kanë mungesë ekuilibri dhe është i damshëm, si kur e thua, ashtu dhe kur e dëgjon, sepse në këtë rast, ata që i dëgjojnë do të humbin drejtpeshimin. I vetmi qëllim është përsosmëria. Nuk duhet të kënaqeni për gjërat që ju mungojnë (Flitet për mësimet- S.H). Është vetëm mungesa e njohurive që të pengon të përçosh vellon, prapa të cilit ndriçon dituria.

Heshtja është çelësi më i madh për tu zhvilluar. Mbaje fuqinë përbrenda në heshtje. Nuk duhet të mrekulloheni, sepse të njëjtën fuqi e kanë edhe të tjerët. Lenia të tjerëve që ta njohin madhështinë tënde dhe gatishmërinë (për të bërë të mira) në drejtim të të tjerëve. Çdo person gjen reflektimin e natyrës së tij në atë që ka përballë, kështuqë mos dëgjoni gjëra që ndonjëri u thotë të tjerëve, por analizoni mendjen e atij dhe veprimet e tij në drejtim të shokëve të tjerë, kështuqë të njiheni me natyrën e vërtetë të tij. Nëse e zotëron diturinë, mos ia moho atë atij që ka nevojë dhe ta kërkon me afsh. Janë miqtë e tu të gjithë ata që ndjekin të njëjtën rrugë me ty. Mos lejo që fjalët e një budallai të pagdhendur të ndikojnë te ti, sepse vetëm i pagdhenduri rrin me të pagdhendurin. Nëse vibrimet e mendimeve të një personi janë të kapshme, fjalët nuk janë të nevojshme.

Thoti jep nji mësim për ata që janë gati me çelësat dhe me simbolet. Pjesa jomateriale e natyrës njerëzore, shpirti, duhet të jetë i ndarë nga natyra materiale, nga mishi, para se të shkojë në ***Dritën e Diellit Kozmik.***

Shpirti është flaka, ndërsa mishi është i ngjashëm me tokën. **Që të dyja kthehen në origjinë, ke vetja e vet.** Flaka e brendshme depërton në të gjithë planet, në të cilët është shfaqë **Flaka e Madhe**, së bashku me planin material. Toka, duke qenë e dendur, përmban në një shkallë më të ulët edhe flakën e shpirtit. Përndryshe, shpirti, duke qenë i pafund, mundet të ndyshojë tokën nga zero deri në infinit/pakufi. Është **evolucioni** i ndërgjegjes që lejon sytë të shohin ngjyrën dhe **dritën**. Flaka e pafundme, e zhvilluar dhe e ndryshueshme përjetësisht, bën të evolojë edhe këndvështrimi.

Njeriu është një flakë që ndryshon, nuk është asnjëherë po ai. Zhvillohet gjithmonë nga dita në ditë, gjersa ngrihet përmbi errësirën, e cila nuk ndryshon dhe ngelet gjithmonë e errët. Megjithatë, errësira e kombinuar me flakën e mbyll ekzistencën e saj.

Mundimi, urrejtja dhe frika janë rezultat i errësirës. Lirimi nga errësira i zhduk ato. Emri dhe forma, ndryshe nga shkëputja personale, ndalojnë së qeni në **Dritën e plotë të Ndërgjegjes së Rizgjuar.** Njeriu mëson vetëm me sprova të vështira, sepse këta janë shkaku pastrues që heqin ndryshkun e errësirës nga shpirti.

Materializimi nuk është gjë tjetër, veçse një formë e pavetëdijshme e shfaqjes së ndërgjegjes, kështu që në nji analizë të fundit, pjesa materiale dhe jomateriale janë të njëjta. Asgjë që është materiale, s'është fikse, por lëviz vazhdimisht në drejtim të ndryshimit. (Këto thënie po i rithotë fizika

kuantike e sotme). Ky është vazhdimi i krijimit të mëvonshëm. Njeriu bashkon ndërgjegjen me këtë Ligj të natyrës. Ligji, në analizë të fundit, është çdo gjë që ekziston. E gjithë mbetja është fantazi dhe iluzion, që formohen në mëndjen e atij që nuk ka njohuri. Dituritë dhe pleqsitë (mençuritë) merren vetëm duke i kërkuar. Duhet të bëni hapin e parë dhe pastaj të shkoni përpara duke u përmirësuar.

Salla e Vdekjes, nën **Sallën e Lules së Jetës**, ka brenda refleksin e shpirtit të njerëzve. Pikërisht atje, Thoti mundi të lidhë historinë e progresit të njeriut nga errësira në **Dritë**. Një paradoks i njëjtë është në përmbajtjen e fjalëve: **"I dërguar nga e ardhmja e të pafundmes fund". Flaka e Pishtarit** të "**Ndriçimit të pazëvendësueshëm**", është fillimi dhe fundi i të gjitha gjërave, sepse; siç lindin gjëra nga kjo, më në fund duhet të rikthehen, duke kompletuar kështu rrethin. Në Flakën e Pishtarit është arsyetuar përmbushja, kështu që plani është i njohur te shpërbërja direkte nga **Zotërinjtë.** Të **Shtatët** janë po **Zoërinjtë e Ciklit**, në botën tjetër tonën, dhe çdonjëri, i përfunduar në numrin e **Ciklit** të tij, në raport me **I.Yob.** Të ardhur nga ciklet e botës tjetër, janë pjesë e ekzistencës absolute të çdonjërës nga këto njohuri kozmike. Nuk janë të lidhur as me jetën dhe as me vdekjen, sepse aktiviteti i tyre është i kontrolluar drejtpërdrejt nga **Yarkima**. Kështu që jeta e tyre nuk është jetë e avulluar, e rrezatuar nga ndonjë cikël kozmik, duke menduar që nuk varen nga shpirti për shfaqjen e tyre.

Logos, term tregues ose **Arsyeja**, është një rrezatim i Z**otërinjve** të çdo cikli (Kujtoni gjithmonë që është një **Zot** i këtij cikli, edhe pse nuk përfshihet te të shtatët), sepse, nga ana letrare, është një rrezatim i arsyes tonë, që vjen nga **I.Yob**. Nga

këtu na arrin **Yarkima** (nuk e shpjegon çfarë është), kështu që ata janë qeliza kryesore, nga ku rrjedhin. (Logos është arsye, por është edhe Fjala dhe nëpërmjet fjalës përcillet mendimi në botën materiale). Janë të mëdhenj në përkrahje, sepse janë të përhapur në të gjitha hapësirat kozmike, më mirë të themi, janë edhe të vegjël, të përqëndruar në forma.

Treshi, Zoti i Ciklit, pikërisht në botën tjetër, është roje e atyre gjërave që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me njerëzimin. Është përgjegjës i hyrjes së negatives dhe nëpërmjet fuqisë së tij, reflekset e shpirtërave munden të përqëndrohen në **Sallën e të Vdekurve**.

Fluksi dhe drejtimi i kësaj force, që e njohim si forca e jetës, është e kontrolluar nga **Zotëria i Katrës**. Disa nga **Forcat Madhore**, si vdekja, janë tërheqë, thithë nga **Katra,** një cikël ku ndalon së qeni jeta, ashtu si e njofim ne. Çdo **Zotëri** ka funksionin e vet, duke i dhënë hyrjen në **Hapësirën Kozmike** të forcës që kanë zhvilluar pikërisht me progresin e tyre nëpërmjet hapësirës. Kjo zbret e i transmetohet bashkë me **Zotërinjtë**, çdonjëri u jep atë që ka atyre të botës së poshtëme.

I Pesti është roje i **Foljeve**, që hap portën e fundit, kur njeriu të jetë gati. **Gjashta, Shtata** dhe **Teta** kanë në ngarkim disa nga strukturat fikse esenciale të kohës së ardhshme, ndërsa **Nënta** ka në ngarkim rrëmujën që më vonë bahet rregull. Mund të kuptohen si ndihmës të **Ndërgjegjes Kozmike,** që ndjek aspektet e nevojshme të zhvillimit të ndërgjegjes, që kjo **Ndërgjegje Kozmike** nuk është aq e zonja ta përdorë. Në këto numra gjindet edhe Ç**elësi i Foljeve,** edhe pse nuk mund të jetë i shfaqur. Sigurimi, përparimi i saj është me të vërtetë arritje e **Jetës** dhe e **Dritës.**

PLLAKA – IV

LINDJA E HAPËSIRËS

Dëgjoje, o njeri, zërin e mençurisë, kushtoji vëmendje zërit të Thotit, Atlantidasit! Lirisht ta jap ty mençurinë time, mbledhur në kohën dhe në hapësirën e këtij cikli; zot i mistereve, Diell i mëngjesit, që jeton përgjithmonë, një bir i Dritës që shkëlqen ndritshëm, yll i mëngjesit, Thoti, mësuesi i njerëzve, është i të Gjithëve.

Shumë kohë më parë, kur isha fëmijë, shtrihesha nën qiellin me yje, në Atlantidë, që prej shumë kohësh është e mbytur. Ëndërroja misteret e largëta që rrinin mbi njerëzit. Në zemrën time u rrit një dëshirë e zjarrtë për të përvetësuar shtegun që të drejton për te yjet. Vit pas viti, kërkoja dituri e njohuri të reja, derisa më në fund Shpirti im, me mundime e vuajtje të mëdhaja, theu skllavërinë dhe u lirua nga zinxhirët.

Unë isha i lirë nga skllavëria e tokës së njerëzve: I lirë nga trupi, shkëlqeja nëpër natë. Më në fund për mua ishte çelë hapsira ndëryjore. Unë isha i lirë nga skllavëria e natës, më në fund. Nga hapsira kërkoja dituritë, që i mbikalonin njohuritë e njerëzve: Shpirti im udhëtonte lirisht larg në hapsirë, në rrathët e të pafundmes dritë. Të jashtzakonshëm, matanë njohurive, ishin disa yje, të mëdhenj e gjigandë mbi çdo parafytyrim të njerëzve. Atëherë unë zbulova Ligjet, me të gjithë bukurinë e tyre, ku yjet bashkëveprojnë midis tyne, si këtu me njerëzit. Shpirti im shndriti përpara nëpërmjet të pafundmes bukuri, me mendimet e mia fluturova larg, nëpërmjet hapsirës. Unë qëndrova atje mbi një planetë të bukur.

Shkëmbime të harmonisë mbushnin të gjithë hapsirën. Ishin forma që lëviznin me rregull, të mëdhej e të madhrishëm si yjet e natës; rriteshin në harmoni, në ekuilibër të rregullt, simbolet e Kozmosit, si Ligjet. Në mjaft nga yjet ku kalova në udhëtimin tim, pashë shumë rraca njerëzish në botët e tyre; dikush që përparonte në drejtim për së larti si yjet e mëngjesit. Të tjerë që binin në errësirën e natës: çdonjëri nga ata që luftonin për t'u ngjitë për së larti, fitonin lartësinë e binin në thellësi, lëviznin nganjëherë në mbretërinë e ndriçimit, duke jetuar nëpër errësirë, fitonin dritën.

Duhet të dish, o njeri, që kjo dritë është trashëgimi e përjetshme që pret çastin për të fituar lirinë, duke pritë që të çjerrë velin e natës. Gjeta ndonjërin që kishte pushtuar hapsirën kozmike. Ata ishin të lirë në hapsirë, ndërkohë që ishin akoma njerëz. Duke përdorë forcën që është bazamenti i të Gjitha gjërave, larg nëpër hapsirë, ata po ndërtonin një planetë, përvijonin forcën nëpërmjet të cilës rrjedh Gjithësia; dendësonin, njehsonin hapsirën kozmike në forma që rriteshin si të donin ata. Duke sipërkaluar shkencën, ata nga të gjitha rracat, nën pushtetin e pleqësive, ishin bijtë e yjve.

Për një kohë shumë të gjatë, bëra nji pushim aty dhe shihja pleqësitë e tyre. Aty shihja të krijoheshin nga jashtë hapsirës kozmike, qytete gjigante të kuq e prej ari, të formuar nga elemente të paralindur, bazë e të gjithë materjes, në të largtën rrjedhë të hapsirës kozmike. Në një kohë shumë të largët, ata kishin pushtuar kozmosin, duke liruar veten e vet nga shërbimet dhe vështirësitë. Duke formuar me mendime vetëm një shembëllim më të shpejtë, ata krijoheshin, ata rriteshin.

Pastaj shpirti im përparoi me të shpejtë, nëpërmjet të gjithë kozmosit, duke parë gjëra të papara më parë, gjëra të vjetra e të reja; mësoja që njeriu është me të vërtetë i lindur nga të parët: një Diell i Diellit, një Bir i yjve.

Dije, o njeri i yjeve, se çdo gjë që banon brenda teje, me të vërtetë është e njëjtë me yjet.

Trupat tuaj, nuk janë gjë tjetër veçse planete që rrotullohen përqark diellnave qendrorë. Kur të kenë fituar dritën e të gjithë pleqësive, do të jenë të lirë të ndriçojnë në hapsirën kozmike, do të jenë një nga diejt që ndriçojnë jashtë nga errësira, do të jenë të lindur nga haësira e të rritur në Dritë. Pikërisht si yjet që në kohë humbin shkëlqimin e tyre dhe drita kalon nga ata te burimi i madh, kështu, o Njeri, shpirti shkon para, duke lënë prapa errësirën e natës. Të formuar nga haësira primitive, të mbushur me shkëlqim, që rrjedh nga burimi, të kufizuar nga hapësira përreth, ndriçoni derisa më në fund të jeni të lirë!

Ngreje flakën tënde, jashtë nga errësira, fluturo, dil jashtë nga errësira dhe ti do jeshë i lirë!

Unë udhëtoj nëpër hapësirë-kohën, duke e ditë që shpirti im është i lirë, duke e ditë që tash mund të arrij pleqësitë. Më në fund kaloj në këtë nivel, të fshehur nga njohuritë, i panjohur nga pleqësitë, që shpërndajnë në çdo anë, çdo të fshehtë, çdo gjë që ne nuk dijmë. Tashti, o njeri, kur kam këto njohuri, shpirti im rritet i lumtur, sepse jam i lirë.

Dëgjo, Ti i lindur nga hapësira, shpejt dëgjo nga pleqësitë e mia: nuk e dini që edhe ju do jeni të lirë. Mbaji parasysh, o Njeri, pleqësitë e mia, sepse duke i dëgjuar ato, edhe ti mund të jetosh e të jesh i lirë.

Ti nuk je bir i tokës, por bir i Dritës Kozmike e i Pafundësisë. Nuk din gjë, o Njeri, për trashëgiminë tënde? Nuk e din me të vërtetë që je Dritë Dielli në Diellin e Madh, kur ti fiton nga pleqësitë? Me të vërtetë do të jeni të ndërgjegjshëm për familjaritetin tuaj me Dritën. Ty tashti po të jap njohuritë, lirinë për të udhëtuar te kalimi ku kam ecë, duke të treguar me të vërtetë se si me të gjitha sforcimet e mia kalova rrugën që të drejton te drita. Dëgjo, o njeri, dhe njihe skllvërinë tënde, mëso si të lirohesh nga kjo peshë e rëndë. Ti do të rilindësh jashtë nga erësira, i njëjtë me Dritën e i njëjtë me yjet. Ndiq përherë kalimin për te pleqësitë. Vetëm nëpërmjet tyre do të mundesh të rilindësh. Fati yt, o Njeri, të drejton përherë para në Përkuljet (valëzimet) e Pafundme të Gjithësisë. Vetëm nëpërmjet këtyre ligjeve e rregullave mund të jesh i njëjtë me Gjithësinë. Çdonjëri që ndjek shtegun e pleqësive, duhet të jetë i hapur te lulja e jetës dhe duhet t'i shtrishë njohuritë tuaja jashtë errësirës, duke rrjedhë te Gjithësia nëpërmjet hapësirë-kohës.

Duhet të ndalosh pak në Heshtjen e Thellë, derisa më në fund ti do të jesh i lirë nga dëshirat, i lirë nga lakmia që të flasësh në heshtje. Pushtoje qetësinë, shërbyesen e fjalës. Hiq dorë nga ushqimi derisa ta zotërosh dëshirën për ushqim, që është në shërbim të shpirtit. Pastaj rri në errsirë. Mbyllja sytë tuaj rrezeve të Dritës. Përqëndroje forcën e Shpirtit tënd në njohuritë tuaja, duke u liruar nga lidhjet me natën.

Vëre në një qoshe të mendve, përfytyrimin e dëshirave tuaja. Figuroje vendin që ti dëshiron të shohësh. Vibro para e prapa me forcën tënde. Çliroje shpirtin jashtë nga nata. Me energji duhet të tundesh, e me të gjithë forcën, derisa më në fund shpirti yt të jetë i lirë.

Flaka e kozmosit është e pushtetshme përmbi gjithë fjalët, pezull, në nivele të panjohura nga njeriu, e pushtetshme dhe e ekuilibruar, lëviz në ekuilibër, muzikë e harmonisë (rregullit), larg jetës së njeriut. Flet nëpërmjet muzikës, këndon me ngjyra, flakëron që në fillim të së Përhershmes Gjithësi. Ju jeni një Shkëndijë e flakës, o fëmijtë e mi, që digjeni me ngjyrat e jetoni me muzikën. Dëgjoni Zërin dhe do të jeni të lirë!

Vetëdija e lirë shkrihet me Kozmosin, Një me Rregullin dhe me Ligjin e Gjithësisë. Nuk e ke ditur, o njeri, që Drita do të shkëlqejë jashtë errësirës, drita do të flakërojë përpara, një simbol i Gjithësisë. Recitoje këtë lutje për të arritur mençurinë!

Lutu për ardhjen e Dritës tek Gjithësia!

Shpirt i fuqishëm i Dritës, që shkëlqen përmes Kozmosit, tërhiqe flakën time më pranë harmonisë tënde! Ngrije lart zjarrin tim, jashtë errësirës, magnet i zjarrit që është Një me Gjithësinë! Ngrije lart shpirtin tim ti, Bir i fuqishëm dhe i pushtetshëm. Bir i Dritës, mos u largo! Më tërhiq në mënyrë që unë të kem fuqi të shkrihem në furrën tënde; Një me të gjitha gjërat dhe të gjitha gjërat në Një, zjarr i tendosjes së jetës dhe Një me Trurin.

Kur ti ta kesh çliruar shpirtin tënd nga skllavëria e tij, dije se, për ty, është zhdukur errësira. Gjithmonë përmes hapësirës ti mund të kërkosh mençuri, jo më i kufizuar nga zinxhirët e farkëtuara në mish. Do të lëvizësh përpara dhe lart në mëngjes, si një flakëronjës i lirë, o Shpirt, për në mbretëritë e Dritës! Lëviz ti në Rregull, lëviz ti në Harmoni, lirisht ti do të lëvizësh me Bijtë e Dritës. Kërko dhe njihe ti Çelësin tim të Mençurisë! Në këtë mënyrë, o njeri, ti, sigurisht që do të jesh i lirë.

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën IV -

Thoti, në këtë pllakë, kujton disa eksperienca në kërkim të diturive. Jep edhe një demonstrim precis të zotësisë së tij. Lirimi i shpirtit të tij nga zinxhirët u bë e para shfaqje e ndërgjegjes së tij. Pasi zhvilloi këtë fuqi, **Thoti** ishte në gjendje të hulumtonte të fshehtat e hapsirë-kohës. Hulumton planete të tjerë dhe në fund arrin në ciklin e brendshëm të **Dritës**, në **Dimensionin e Parë.** Planeti me një bukuri të madhe ishte njëri nga shtatë planetet që rrethonin ndërgjegjen në Dimensionin e Parë. Format që lëviznin me rregull ishin trupa të rrumbullakët të **Dritësuarve**.

Thoti shkoi në të gjithë sistemet diellore dhe sheh evolucione të ndryshme të arritur në planetet më të afërt e më të largët të Diejve të tyre. Njerëzit i përcaktonin këto forma të jetës si aktive të ndërgjegjes kozmike, edhe pse rrallë, forma e tyre bëhej si e njerëzve. Zotëruesit e eterit kozmik ishin banorë të **Antares** (nuk e shpjegon çfarë asht- S.H), e njëjta rracë e madhe që vinte edhe në tokë në epoka të kaluara. Kishin përfshi, kishin marrë sekretet e udhëtimeve ndërplanetare disa shekuj më parë, sepse ishin më të dritësuar nga sistemi diellor i tyre. Materia dhe forma ishin zotërimi i tyre. Nga **Nana Universale**, ishin në gjendje të krijonin çdo gjë që dëshironin.

Thoti mëson se njeriu është universal, ekzistues në çdo pjesë të hapësirës dhe pjesë përbërëse e ndërgjegjes kozmike. Forma njerëzore, përsa i përket anës materiale, është e njëjtë me materialet bazë të yjeve (gjë që po e thotë dhe fizika kuantike sot -S.H). Ashtu si planetet rrotullohen rreth diejve të tyre, ashtu edhe trupat materialë njerëzorë rrotullohen përreth diellit të qendrës, që është shpirti. Kur ndonjëri e liron

ndërgjegjen e tij nga errësira e parregullsive, bëhet një nga mësuesit që punon nga brenda pjesës negative. Trupi njerëzor është i formuar nga substanca origjinale, nga pluhurat kozmikë, që është edhe eteri në të cilin planetet pluskojnë (fluturojnë, notojnë). Zgjidhja e misterit të hapësirës shpjegon shkaqet e shumë shfaqjeve të **Ligjit,** që përndryshe nuk mundet të kuptohet. **Thoti** e dinte që do të mundej të hulumtonte pambarimisht embrionin, sythin e çmueshëm të së vërtetës, gjersa pastaj të kalonte në rrethrrotullimin (ciklin) kozmik që do të vinte më pas. Pastaj, nëpërmjet pafundësisë, mundohej të ndiqte njohuritë.

Njeriu, në realitet, nuk i përket vetëm Tokës që është realisht materiale, por, sipas analizave të fundit, është edhe një flakë e përjetshme. Thoti jep çelësat e lirisë së njohurive nga materialja dhe kjo liri hap shtegun e të tjera botëve dhe planeve (dimensioneve) paralele. Menjëherë, sapo i përvetëson, njeriu nuk është më i lidhur, por i lirë. Ashtu si edhe hapësira është e gatshme të ndjekë **Ligjin**, ashtu edhe njeriu duhet të krijojë rregull për tu lartësuar përmbi ekzistencën e tij. Kur rregulli dhe mbarëvajtja e të gjitha pjesëve të ekzistencës së tij të jenë përsosë, atëherë ai nuk do të jetë asnjëherë i lidhur me planin material. I zhvilluar nëpërmjet rregullit të tij, në harmoni me Ligjin, mundet të ngjitet, apo të kapë planin kozmik.

*Për ta liruar ndërgjegjen nga trupi, gjëja më e mirë për të bërë është, që njeriu ta zgjërojë, ta shtrijë gërshetimin diellor (**Lulen e Jetës të trupit**) e të bëjë të fluturojë forca jetësore, gjersa trupi të rigjallërohet, duke përgatitë ndërgjegjen për largimin, përndryshe kjo e fundit do të ngurrojë, do ta kundërshtojë këtë lirim. Pas kësaj ndiqet izolimi nga shprehitë ndijuese të jashtme që duhet të jenë të*

bllokuara, të zëna në mënyrë të menjihershme. Pasi të ketë arritë qetësinë, të arritur me dëshirë, duhet të përqëndrojë ndërgjegjen në embrionin e saj dhe duhet të krijojë parafytyrimin në mendje dhe skenarin e vendit ku ka dëshirë të shkojë. Atëherë, me nji sforcim të fuqishëm të dëshirës, direkt drejt harkëzimeve të përshtatshme të universit, do të jeni të lirë nga trupi. (Thoti këtë lloj veprimi nuk ua rekomandon njerëzve pa përvojë -S.H)

Ndërgjegjja kozmike, nëse shprehemi në mënyrë letrare, gjendet në të parin dimension, apo në planin e parë. Harmonia dhe rregulli aty janë të atilla që njeriu, edhe pse është fizikisht, nuk mundet t'i ndjejë lëvizjet e përsosura.

Shpirti i njeriut është një flakë e përjetshme, një flakë e rrezatuar nga e madhja flakë, edhe pse e bashkuar me veten e vet. Njeriu është Drita në errësirë, pse jo, i ndarë nga forca dhe rregulli. Lutja e vërtetë është një rregull dhe është një kushtim për të stabilizuar, për të rehatuar një harmoni ose lidhje midis shpirtit ose ndërgjegjes dhe **Ndërgjegjes Kozmike.** Kur njeriu të ketë liruar përfundimisht shpirtin e tij nga lidhjet me anën materiale, nuk është më objekt i rrëmujës apo i të këqijave, kështu që mundet t'i kërkojë dituritë dhe përsosmëritë te burimet e tij.

PLLAKA – V

BANORI I UNDALIT

Shpesh ëndërroj për Atlantidën e varrosur, e humbur në moshat që kanë kaluar në errësirë.

Epokë pas epoke Ai ekzistonte nëpër bukuri, një dritë që shndriste nëpërmjet errësirës së natës. I fortë në fuqinë e tij, sundues i të lindurve në tokë, Zot i Tokës në ditët e Atlantidës, Mbret i kombeve, pronar i Dritës së pleqësive, që shkëlqen nga SUNTAL Roje i Jetës, rrin përjetë në Tempullin e tij, Zotëria e UNALIT. Pronar Ai, nga një periudhë tjetër jashtë jetëve tona, ku po jetojmë në trupat e fëmijëve të njerëzve, jo si të lindurit në tokë, Ai, që nga jeta tjetër, është Dritë e një periudhe, më të përparuar nga ajo e njerëzve.

Dije, o njeri, se HORLET, mësuesi, nuk ishte asnjëherë i njëjtë me fëmijët e njerëzve. Larg, në një kohë të kaluar, kur Atlantida filloi të rritej e fuqizohej, shfaqet njëri me Çelësin e pleqësive dhe u tregon të gjithëve shtegun për te Drita. Ai u tregon të gjithë njerëzve shtegun e realizimeve, në çfarë mënyre drita do të rrjedhë midis njerëzve. Duke kontrolluar errësirën, drejton shpirtin e njeriut në drejtim për së larti, në lartësi, që janë të gjitha një me Dritën. Ai ndan mbretëritë me pjesë. Dhjetë ishin ata që mbretëruan nëpërmjet fëmijëve të njerëzve. Në një mbretëri Ai ndërton nji Tempull, por jo i ndërtuar nga bijtë e njerëzve. Jashtë nga hapësira, Ai thërret substancat që i duheshin, modelon e krijon formën që Ai ndërtoi me përqëndrimin e tij, me fuqinë e YTOLAN.

Rregullim pas rregullimi e mbulon ishullin, hapësirë pas hapësire rritej forca e tij. E errët, por jo e zezë, ama e errët si në

hapësirën-kohë, thellë në zemrën e tij, është Esenca e Dritës. Me shpejtësi rritej Tempulli në formën e tij, që ish modeluar e merrte formë nga Fjala e Banorit, që thirri të paformën e i dha formë. Ai ndërton, pas kësaj, oda të mëdhaja, i mbush me forma (shpirtëra) të thirrur nga Hapësira Kozmike, i mbush me pleqësitë (dituritë) e dala nga mendja e Tij. Ai ishte i paformë në Tempullin e tij, atëherë fillon të formohet në përfytyrimin e njerëzve. Duke banuar akoma me ata, por duke mos qenë si ata, Ai ishte i ndryshëm e larg nga bijtë e njerëzve. Ai ndërkohë zgjedh disa persona, tre që bëhen lajmëtarët e tij. Ai zgjedh tre nga më të zhvilluarit, që bëhen lidhja e tij me Atlantidën. Ata ishin lajmëtarët e tij, që i çonin këshillat e tij, mbretit të fëmijëve të njerëzve, Ai mori të tjerë pranë Tij e u mësoi atyre pleqësitë, duke i mësuar ata për fëmijët e njerëzve. Ai i vendos ata në ishullin UNAL, si mësues të dritës të njerëzve. Çdonjëri nga ata të zgjedhur kështu, duhet t'i mësonte njerëzit për pesë vjet herë dhjetë (50 vjet). Vetëm kështu Ai mundte t'i jepte njohuri për të çuar Dritën te fëmijët e njerëzve. Kështu, ato hyjnë e bëjnë pjesë në Tempull, një banesë për mësuesit e njerëzve.

Unë, THOTI, kam kërkuar pleqësitë, kam kërkuar në errësirë e i kam kërkuar në Dritë. I etur për studime, kur isha i ri, udhëtoja përgjatë shtigjeve të reja në kërkim të njohurive të reja: më në fund, pas shumë mundimesh, një nga të Tre më çon në Dritë. Ai më sjell urdhëresat e Banorit, më thërret nga errësira në Dritë. Ai më çon para Banorit, në thellësi të Tempullit, përballë me Zjarrin e Madh. Atje në fronin e madh, unë shoh Banorin të veshur me Dritë, që shkëlqen nga flaka. Unë u gjunjëzova përballë kësaj të madhe pleqësi dhe ndieva

valë Drite që vërshuan brenda meje. Unë pas kësaj dëgjoj zërin e Banorit:

- O Errësirë, hyn në Dritë! Për shumë kohë ke kërkuar në shtigjet për te drita. Çdo shpirti, që ti i liron zinxhirin në tokë, shpejt do të jetë liruar nga shërbimet nëpër natë. Nga jashtë errësirës ti je i lartësuar, fundi i Dritës të afrohet më afër. Këtu ti do të mbahesh si një nga fëmijët e mi, roje të dokumentave, mbajtës i pleqësive, vegël e Dritës së largët. Të jesh i gatshëm për çdo gjë që Ai ka nevojë, ruajtës i pleqësive nëpërmjet jetës së errësirës që do të vijë shpejt te bijtë e njerëzve. Jeto këtu, shuaje etjen me pleqësitë (dituritë)! Sekrete dhe të fshehta do të të zbulohen.

Pas kësaj unë i përgjigjem Zotërisë së Ciklit duke i thënë:

- O Dritë, që po zbret midis njerëzve, m'i jep pleqësitë tuaja, derisa mund të jemë një mësues i njerëzve! Më jep nga Drita jote e fuqishme, që unë të jem i lirë!

Pas kësaj flet prap Zotëria:

- Jetë pas jete do të rrosh me pleqësitë tuaja, po, kur valët e detërave do të valëzojnë sipër Atlantidës, duke fsheh në errësirë Dritën, mbërtheje Dritën, edhe pse e fshehur në errësirë, të jesh gati që sipër të vish, kur të jesh i thirrur. Tash shko dhe mëso nga më të mëdhajat pleqësi! Rritu nëpërmjet Dritës së pafundmes Gjithësi!

Për shumë kohë, unë banoj në Tempullin e Banorit, derisa më në fund bëhem Njësh me Dritën. Kështu, unë ndjek rrugën e niveleve yjore, ndjek shtegun e Dritës. Thellë në zemër të Tokës, ndjek jetën, shtigjet e dijes dhe mësoj sekretet, si në botën e poshtme, ashtu dhe në të sipërmen; duke mësuar rrugët e dijes të Odës së Amentit, duke mësuar Ligjet që baraspeshojnë botën. Të fshehtat e odave të Nëntokës unë i

kam përshkuar me pleqësitë e mia, në thellësi, nëpërmjet kores së tokës, brenda në shtegun e fshehur për jetë nga bijtë e njerëzve. Më zbulohen përherë e më shumë pleqësi, derisa arrij në të tjera njohuri. Zbuloj që çdo gjë është pjesë e Gjithësisë, e madhe dhe ende më e madhe nga sa ne të gjithë e dijmë. Kërkoj zemrën e Pafundësisë nëpërmjet të gjitha kohërave. Poshtë edhe më poshtë, unë gjejë më shumë të fshehta. Tash, duke pa nga prapa kohërave, unë e di që pleqësia/dituria është e pakufizuar, e rritur përherë e më shumë në të gjitha kohërat. NJËSHI (Krijuesi, Zoti) me PAFUNDËSINË janë më të mëdhatë nga të gjitha.

Na ishte një Dritë në Atlantidën antike, edhe errësirë, që i ishte fsheh të gjithëve. Disa që kishin ardhë midis njerëzve nga lart, ranë nga drita në errësirë. Ata ishin krenarë për njohuritë e tyre, ata ishin kryelartë për pozitën që kishin midis njerëzve: në thellësi ata kërkonin të ndaluarën, hapën hyrjen që i drejtonte për poshtë botës tjetër. Kërkuan të fitonin më shumë njohuri, të dërguara lart, që ama të ishin larg nga të padenjat. Çdonjëri që zbriste, duhej të kishte ekuilibër, përndryshe ai do të largohej e do t'i mungonte drita jonë. ATA pastaj hapën me mendimet e tyre shtigje që u ishin ndaluar fëmijëve të njerëzve. Në Tempullin e tyre, nga ku Gjithësia shihet, Banori vihet në gjendje AGWANTI, ndërkohë, nëpërmjet Atlantidës, shpirti i tij ishte i lirë. Ai shihte Atlantideasit, që me magjinë e tyre po hapnin një hyrje që do të sillte në Tokë një dhimbje të madhe. Me të shpejtë shpirti i tij vrapon e i hyn te trupi. Ai zgjohet nga Agwanti. Thërret ai tre lajmëtarët e fuqishëm e u jep atyre urdhëra që tronditën botën. Me të shpejtë Banori zbret në thellësi poshtë kores së tokës, për te Odat e Amentit. Thërret ai forcën e Shtatë

Zotërive; kështu ai ndryshoi ekuilibrin e Tokës. Atlantida zhytet poshtë valëve të errëta. Prishet hyrja që kish ngelë e hapur. Prishet rruga e hyrjes që të drejtonte poshtë për në atë botë. Të gjithë ishujt u shkatërruan, i miri UNAL e pjesë të ishullit të Banorit. Ai i shpëtoi ato me qëllim që të mund të vazhdonin të ishin mësuesit, Dritë në shtegun e diturisë, për ata që do të vinin më prapa, dritë për bijtë e vegjël të njerëzve. Pas kësaj, Ai më thërret mua, THOTIN, e, përballë me mua, më dorëzon urdhëresat për ato që do të duhej të bëjsha, duke më thënë:

- Merri ti, o THOT, të gjithë pleqësitë tuaja! Merri të gjithë regjistrat dhe njohuritë Tuaja, merri të gjitha magjitë Tuaja! Ec përpara në jetë si një mësues i njerëzve! Shko ti e ruaji dituritë, derisa ndërkohë Drita do të rritet midis njerëzve! Ti do të jesh Drita nëpër të gjitha kohërat, i fshehur derisa të gjindet nga njerëzit e ndritur. Në të gjithë Tokën mund të të japim fuqi, në mënyrë të pavarur, e japim ose e hedhim matanë. Mblidhi tash bijt e Atlantidës. Merri me vete, vrapo e largohu nga populli i gurëve të shkëmbinjve, shko drejt njerëzve të shpellave! Fluturo ke toka e bijve të KHEM (Egjyptit).

Mblodha të gjithë bijtë e Atlantidës brenda në anijen kozmike, i çova të gjithë dokumentat e mia, çova dhe dokumentat (arkivin) e Atlantidës së mbytur. Mblodha të gjithë fuqitë e mia e shumë vegla të magjive të fuqishme. Kështu që u ngritëm në krahët e mëngjesit. Lart ne ngrihemi, sipër tempullit, braktisim të TRE dhe BANORIN, në thellësi në Odat, atje poshtë Tempullit, u mbyllim hyrjen Zotërijve të Ciklit. Dhe në çdo kohë, kush ka njohuri, mund t'i hapë shtigjet për te Amenti. Aty, me ndihmën e fuqive të mia, i

përvetëson e i zotëron. Me të shpejtë arratisemi në krahët e mëngjesit, arratisemi në tokën e bijve të KHEM-it. Aty bëj që t'i rilindë Drita bijtë e KHEM-it. Në thellësi, poshtë gurëve, kam fsheh anijen time kozmike, që pret kohën kur njerëzit e rinj të jenë të lirë. Sipër, anijen kozmike e vulosa duke lartësuar një simbol me formën e luanit e të ngjashëm me njeriun. Aty poshtë pushon akoma anija ime kozmike. Atje, poshtë kësaj Figure Simbolike (Sfinksit), akoma qëndron anija ime kozmike, gati për t'u ngritë, kur të jetë nevoja. Dije, o njeri, se larg në të ardhmen pushtuesë do të vijnë nga barku i tokës, prandaj zgjohu ti që i ke pleqësitë. Merre anijen time dhe do të fitosh me lehtësi. Në thellësi, poshtë asaj Figure Simbolike (Sfinksit), shtrihen sekretet e mia. Kërko e do të gjesh ke piramida që kam ndërtuar. Njëri sipër tjetrit janë çelësat: çdonjëri është hyrja që të drejton për te jeta. Ndiq çelësin e hyrjes që po lë pas meje. Kërko dhe rruga e hyrjes për te jeta do të jetë jotja! Kërko në piramidën time, në thellësi, në kalimin që mbaron me një mur. Përdor çelsin e të Shtatëve dhe ty do të rihapet kalimi.

Tashti të kam dhënë pleqësitë/njohuritë e mia. Tashti të kam dhënë mënyrën e veprimit tim. Ndiq shtegun! Zgjidhe sekretin tim! Ty ta tregova mënyrën.

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën V -

Kjo pllakë mund të them sa është më mistikja, sepse përmban edhe të dhëna që gjer më sot kanë qenë mbajtë të fshehura. Thoti vëzhgon lavdinë e Atlantidës nga kulmi i saj, duke e krahasuar me botën që kishte përreth në kohën e tij.

Banori i Unalit, Mësuesi **Horlet,** ishte drejtues i të gjithë dheut (globit), dhe me gjithë atë fuqi kozmike që kishte, nuk ndërhynte në qeveritë e ndryshme, përveçse kur ishte e nevojshme. **Horlet** nuk ishte i vetmi i këtij cikli, i kësaj epoke, por ishte një dëshmitar i **Zotërinjve të Cikleve** (Epokave), të shfaqur në Tokë për të kryer disa funksione të nevojshme: ***Për të ndifmuar në forcimin e njohurive dhe në mirëkuptimin midis njerëzve.*** Themeloi mbretërinë e Atlantidës, duke e nda midis racave dhe ata më të mençurit i cakton si sunduesë në pjesë të ndryshme të botës.

Kur ndërtoi **Tempullin e Unali**, modeloi materialin e përjetshëm ose substancën e parë për ta vendosë sipas dëshirës së tij ku të donte, duke përdorë fuqinë **Ytolan** për t'i dhënë e për ta bërë që ta mbajë formën. Tempulli, si katror, ishte nga tri milje çdo brinjë dhe një milje lartësia (një milje romane = 1480 metra). Në realitet, nuk gjendej në hapësirën tredimensionale, por në të nëntin dimension, në errësirë të plotë. Asnjë armë e Dimensionit të Tretë nuk mundej ta dëmtonte dhe as mundej ta takonte, sepse çdo gjuajte, çdo sulm që i bëhej, do humbiste forcën në harkëzimet, dallgëzimet e këtij Dimensioni të Nëntë. Kishte në zemër të saj **Esencën e Dritës,** sepse atje gjendej porta e hyrjes për te **Amenti,** ku **Lulja e Jetës** shndërit e flakëron përjetësisht.

Banori përdor **Verbon** për të modeluar formën e **Tempullit. Verbo** pastaj qartësohet si **Ytolan**. Në **Tempull, Banori** ndërtoi makineri të stërfuqishme të shumëllojshme, duke i formuar nga lënda e parë e duke i aktivizuar sipas dëshirës së tij. Të realizuara kështu, funksionojnë përjetësisht, sepse dëshira që i furnizoi me fuqinë lëvizëse është një gjë e përjetshme.

Në **Tempull, Banori** zakonisht nuk shfaqej: me fjalë të tjera, trupi fizik, të cilin e pushtonte herë pas here, qëndronte në brendësi të **Tempullit,** ndërkohë që ndërgjegjja e tij ishte në vende të tjera. Ishin zgjedhë **TRE** midis njerëzve më të mençur për të qenë transmetuesit, ndërmjetësit e **Banorit**. **AI** i udhëzoi me kujdes ata për qëllimin e tij dhe nëpërmjet atyre zgjedh të tjerë e i sistemon në qytetin **UNDAL**, përballë **UNALIT,** që të bëhen edukatorë e priftërinj dhe në anën tjetër bëhen shkencëtarë e filozofë të **Atlantidës.**

Thoti u dërgua për herë të parë përballë me **Banorin** nëpërmjet një prej ndërmjetësve të tij. E drejtuan përpara në Tempullin e **Flakës së Madhe.** Kjo flakë nuk ishte **Flaka e Jetës,** por ishte rrezatimi i shkaktuar nga bashkimi i **Hapësirës së Tempullit** me atë të **Amentit. Thotin** e prunë përballë **Banorit,** që, i ulur në fron, shpërndante **Dritën** përtej portës së hyrjes. **Thoti** shfaqet lehtësisht i veshur me flakë. **AI** (Banori) e vë në dijeni se ishte zgjedhë për të qenë mbrojtësi i dëshmive, meqenëse **Banori** mundej të shifte në të ardhmen e njerëzve dhe e dinte që ndryshimet e ndërgjegjes do të çonin në një ulje, pakësim të evolucionit në Tokë. E dinte edhe që do të ndodhnin shkatërrime të disa zonave në siperfaqen e Tokës, kështuqë duhej të merreshin masa që kur të ndodhte

katastrofa, asgjë mos humbiste. Thoti do ta kishte këtë privilegj, pikërisht për meritën e tij.

Përcaktimi i Banorit si **Mësuesi i Ciklit (Epokës),** është një përcaktim për ciklin e Tokës dhe jo i cikleve kozmike. Ishte ruajtës i zhvillimit të njerëzimit nga një cikël tokësor në tjetrin. Thoti kërkon që të ketë iditu, që të mundej t'i shpërndante njohuritë midis njerëzve. Thotit iu dha përjetësia gjersa të mundej të çonte detyrën e tij drejt qëllimit të caktuar. Mbetet në Tempull gjersa të kompletohet me dritë (iluminato, ndriçim). Atij iu dhanë njohuritë për të ndërhy në hapësirë-kohën dhe në materie, dhe me këto zbulime i jepet mundësia të hyjë në sekrete përherë e më të mëdha.

Në ditët e fundit të Atlantidës, valët e mëdha të ndërgjegjes që kishin pasur trupat e njerëzve të Tokës, kishin shkuar te ylli Afërdita dhe njohuritë e reja që u derdhën në trupat njerëzorë, erdhën nga Marsi; këto ishin më materiale se sa ato të parat. Duke shikuar në errësirë, në vend që të shohin **dritën,** shkaktohet një hapje e tipit **Yog-Sog-Thoth** (!!?? -S.H), porta e ciklit të ulët. Pak nga ndërgjegjja e valëve paraardhëse u thith nga fuqia e materiales dhe u zhyt në pllakën (tokësore); ndoshta ishte kjo pjesa e natyrës së saj, që e përpunoi qëllimin me shokët e tyre. Kush hap portën e cikleve ma të ulta, duhet të jetë një mësues, përdryshe fuqia e tij nuk mund të jetë aq e baraspeshuar që të ndihmojë ata që shkojnë nga poshtë-lart. Ndërkohë që njerëzit realizojnë këtë, Banori ishte larg nga trupi i tij dhe njëkohësisht ishte i ndodhur në vendin ku po ndodhte ajo gjë. Kur Banori e sheh këtë që po ndodhte, kthehet menjëherë në trup të tij, thërret ndërmjetësit dhe i dërgon në Atlantidë, ndonjërin në qytetin Undal. **Banori** pastaj zbret te **Amenti** për të forcuar hyrjet e dhomave, në kanalet e të cilave

kalon ekuilibri i Tokës. Kur, nëpërmjet piramidës së forcës, tërheq sipër fuqinë e të **Shtatëve**, ndryshon ekuilibrin e Tokës, nga një kanal në tjetrin, duke mbyllë dyert e mëparshme.

Si rezultat i përmbytjes së Atlantidës, prishet hyrja, duke eliminuar makineritë që ndryshonin haësirën e që drejtoheshin nga atlantideasit. Thoti thërritet nga **Banori** dhe urdhërohet që të veprojë në tokat e mbetura mbi ujë, të grumbullonte njerëzit e Undalit, të mblidhte e të merrte dëshmitë e diturive të lashta. (Atlantida, sipas historianëve të lashtësisë, u fundos me disa etapa: në fillim u fundos zona fushore, më vonë ajo kodrinore dhe malore, ku shpëtoi pa u mbytë vetëm maja e malit Undal. -S.H). Emërohet edukator dhe **përhapës i Dritës**. Thoti mbledh dëshmitë, veglat shkencore dhe makineritë dhe bashkë me të parët dhe të diturit e Atlantidës, hyn në një anije kozmike dhe fluturon në drejtim të Khem (Egjyptit). Fuqia e motorave të anijes kozmike ishte dhënë nëpërmjet energjisë diellore të mbledhur e të grumbulluar. Elektriciteti i krijuar ishte forma e asaj energjie që rridhte nga rrezatimi i piramidës së forcës. Kur anija hapësinore niset, Banori mbyll mirë Tempullin dhe e fundos bashkë me Undalin nën ujë. Pastaj **Ai** dhe të **TRE** shkuan në vend tjetër. Thoti arrin në **Egjypt (Khem)** dhe zotëron mbi njerëzit e paditur atje. Më vonë, fsheh anijen hapësinore dhe materialet e tjera të luftës, nën një shkëmb të madh, të cilit i jep formën e Sfinksit. Kur të arrijë tjetër moment, që pushtuesë nga hapësira kozmike të sulmojnë Tokën, këto makineri do të nxirren mbi sipërfaqe dhe do përdoren për t'i thyer ato.

Thoti len një çelës për të hapë kalimet e fshehta të **Piramidës dhe të Sfinksit**. I njëjti çelës hap portat e odave dhe hyrjen për te **Amenti.**

PLLAKA – VI

ÇELËSI I MAGJIVE

Dëgjoni o njerëz, pleqësitë e magjive! Dëgjoni njohuritë e fuqive të harruara!

Shumë kohë më parë, në ditët e njerëzve të parë, filloi lufta midis Errsirës dhe Dritës. Njeriu, si po ndodh tash, u mbush me errësirë e me dritë dhe, ndërkohë që disa anonin nga errësira, të tjerëve drita u kish mbushë shpirtin. Po, është shumë e vjetër kjo luftë, lufta e përjetshme midis errësirës dhe dritës. Me egërsi të gjithë luftonin përgjatë kohërave, përdornin forca të çuditshme të panjohura nga njerëzit. Ata që i shkonin pas, u mbushën me errësirë, në luftë të përhershme kundër dritës, kurse të tjerët, të mbushur me shkëlqim, e mundën errësirën e natës. Në çdo epokë a nivel kohe që ti do të jeshë, është e qartë që don të dish për luftën me natën:

Shumë epoka më parë, Drita e Mëngjesit, kur zbriste, gjente tokën të mbushur me errësirë. Atje, në këtë kohë të shkuar, filloi lufta e lashtë, lufta midis Errësirës e Dritës. Kështu, për shumë kohë bota u mbulua nga errësira, ku e dobët dridhej drita e natës. Dikush nga ata që ishin zotër të errësirës, kërkonin t'i mbushnin të gjithë me errësirën e tyre, kërkonin të tërhiqnin të tjerët në errësirën e natës së tyne. I përballonin me burrëri Zotërinjt e Dritës. Me ashpërsi luftonin errësirën e natës, duke kërkuar të çlironin zinxhirët, zinxhirët që lidhnin njerëzit me errsirën e natës.

Zotërinjt e errësirës përdornin gjithnjë magjinë e zezë, e ardhme te njerëzit nëpërmjet errësirës së natës, magjia që mbështillte njerëzit me qefinat e errësirës. U bashkuan të gjithë bashkë, Vllëzërit e Natës, nëpër të gjitha kohërat, për t'iu

kundërvu bijve të njerëzve. Udhëtuan përherë tinës e të panjohur, merrnin trajtë ose jo nga bijtë e njerëzve. Gjithmonë ato udhëtuan e punuan në errësirë të fshehur nga drita në errësirën e natës. Me qetësi, tinës, përdorën sekretet e tyre, skllavëronin e lidhnin shpirtërat e njerëzve. Të padukshëm ata vijnë e të padukshëm ata shkojnë. Njerëzit, me paditurinë e tyre, i thërrasin nga bota e poshtme. E errët është bota ku udhëtojnë Vllëzërit e Errët, të errët nga errësira, jo nga nata, udhëtojnë nga Toka për në botën tjetër, nëpërmjet ëndrrave të njerëzve. Ata e marrin forcën nga erësira përreth tyre për të thirrë banorë të tjerë jashtë nga niveli i tyre, në mënyra që janë të panjohura e të errëta për njerëzit. Vllëzërit e Errët janë në aftësinë mendore të njerëzve. Përreth njeriut, ato mbyllin velin e natës së tyre dhe, përgjatë jetës tokësore, kur shpirti përulet në skllavëri, e kufizojnë me zinxhirët e Velit të Natës. Ata janë të fuqishëm në njohuritë e ndaluara, të ndaluara, sepse janë një me natën. Dëgjo, o i vjetri njeri, dhe mbaje parasysh paralajmërimin tim: bëhu i lirë nga skllavëritë e natës! Mos ia dorëzo shpirtin tënd Vllezërve të Errsirës! Mbaje gjithnjë shikimin tënd të drejtuar drejt dritës! Nuk e din, o njeri, se dhimbja jote vjen vetëm nga Veli i Natës? Po, Njeri, merri me kujdes paralajmërimet e mia:

- Stërmundohu përherë në drejtim për së larti, drejtoje shpirtin tënd drejt Dritës! Vllezërit e Errësirës i kërkojnë për vllazërit e tyre ata që udhëtojnë në shtigjet e dritës. Ata e dinë mirë se, që njerëzit që kanë udhëtuar larg drejt Diellit, në shtegun e tyre të Dritës, kanë më shumë fuqi për t'i lidhë me errësirën bijtë e Dritës. Bëj kujdes, o njeri, çdonjëri që të paraqitet, peshoja me peshore fjalët e tij, nëse janë të Dritës ose jo. Sepse janë shumë që udhëtojnë në Dritën e Errët e nuk janë

bijtë e Dritës. Është e kollajshme të ndjekësh shtegun e tyre, e lehtë është të ndjekësh drejtimin që ata të thonë. Por akoma, o njeri, u bë kujdes paralajmërimeve të mia: Drita i vjen vetëm atij që stërmundohet. I vështirë është shtegu që të drejton ke Pleqsitë, i vështirë asht shtegu që të drejton ke Drita. Të shumtë janë gurët (pengesat) që mund të gjesh në shtegun tënd: të shumta malet për t'u ngjitë drejt Dritës. Dhe, dije, o njeri, që çdonjëri që bëhet i lirë do të jetë në shtegun e Dritës, sepse, dije, o njeri, Drita më në fund do të fitojë dhe errësira e nata do të jenë përzënë nga Drita që do rrjedhë. Dëgjo, o njeri, dhe merri kujdesjet e këtyre pleqësive: nga errësira merr Drita. Kur errësira të jetë evituar e i gjithë veli të jetë çjerrë, jashtë nga errësira do të vezullojë Drita.

Si edhe te njerëzit ka Vllezër Ezmerë, kështu ka dhe Vllezër të Dritës. Ata janë e kundërta e Vllazërve të Errësirës, kërkojnë t'i lirojnë njerëzit nga errësira e natës. Ata kanë forcë, forcë e fuqi kur njohin Ligjet, rrespektojnë planetet. Ata punojnë gjithnjë në mirëkuptim, duke liruar shpirtërat e njerëzve nga skllavëria e natës. Ata i kanë luftuar gjithnjë Vllezërit e Errët, duke i pushtuar kohën e pafundme. Përgjithmonë drita do të jetë më në fund Zonjë e do ta largojë tutje errësirën e natës. Po, o njerëz, duhet ta dini se përherë, ngjitur me ju, udhëtojnë dhe bijtë e Dritës. Ata janë zotër të forcës së Diellit, përherë të padukshëm e roje të njerëzve. Është i hapur shtegu i tyre, i hapur për çdonjërin që ecën nëpër Dritë. Ata janë të lirë nga e errta AMENTI, të lirë nga Odat, nga ku Jeta mbretëron e madhërishme. Ata janë diej dhe zotërinj të mëngjesit, Bij të Dritës që shkëlqejnë midis njerëzve. Bijtë e Dritës janë si njerëzit ose të ngjashëm. Në të kaluarën nuk ndaheshin kurrë. Ata kanë qenë Një me Njëshin e

Gjithësisë, në të gjithë hapsirën nga fillimi i Kohës. Ata ishin lart të bashkuar me Gjithësinë e pashoqe, me prejardhje nga Hapësira e Parë, me formë dhe pa formë. Ata u dhanë njerëzve sekrete që të mbroheshin nga çdo e keqe. Çdonjëri që mund të udhtojë në shtegun e Mësuesit, mund të lirohet nga shërbimet e natës. Ai mund të jetë sipër të patrajtave e të paformuemve, mund t'i zotërojë fantazmat (hijet) e frikës. Duke pasë Njohuritë, ai mund të arrijë të gjithë sekretet, duke udhëtuar dhe në shtegun e errësirës, duke mbajtë në ballë, dritën e mendve të tij. Ai takon pengesa të mëdha në këtë shteg, por u tregon atyre Dritën e Diellit.

Dëgjo, o njeri: Dielli është simbol i Dritës që shkëlqen në fund të rrugës tënde.

Tash po të zbuloj një sekret:

Kur të takosh forcën e errët, fito mbi frikën e natës! Vetëm me njohuritë mund të fitosh, vetëm me njohuritë mund ta kesh Dritën. Tash po të jap njohuritë, të njohura nga Zotërinjt, njohuritë që fitojnë mbi të gjitha frikat e errëta. Përdori këto, pleqësitë që do të jap, ti do të jeshë sipër Vllezërve të Natës. Kur të të vijë një ndjeshmëri, që të drejton më afër portës së errët, kontrolloje zemrën tënde e zbulo nëse kjo ndjeshmëri të vjen nga brenda. Nëse ti gjen errësirë në mendimet tuaja, përzeni nga mendja juaj. Fito nëpërmjet trupit tënd valë vibracioni, në fillim të parregullta, pastaj të rregullta, duke i përsëritë rregullisht kohë pas kohe, derisa të lirohesh. Forca e valëve fillon nga qendra e trurit. Drejtoje valën nga koka jote ke këmbët. Ama, nëse ti sheh që zemra jote nuk është errësuar, të jesë i qartë se një forcë po vjen drejt teje. Vetëm me anë të njohurive ti mund ta mbikalosh. Vetëm duke qenë i mbushur me pleqësi, mund të shpresosh të jeshë i lirë. Njohuritë të sjellin Pleqësitë e pleqësitë të japin forcë. Shko ke ato e ti do keshë fuqi mbi të gjitha. Kërko në fillim një vend në kufi të errësirës.

Bëre një rreth përqark teje. Vendosu e rregullohu në qendër të rrethit. Përdore këtë rregull e ti do jesh i lirë. Ngrehi duart tuaja në hapsirën e errët përqark teje, mbylli sytë e vizato nëpër dritë. Thirr Shpirtin e Dritës nëpërmjet kohës e hapsirës e do jeshë i lirë pas përdorimit të këtyre fjalëve: - *Mbushe trupin tim, o Shpirt i Jetës, mbushe trupin tim, o Shpirti i Dritës! Ec ke unë nga Lulja që shkëlqen nëpër errësirë! Ec nga odat ku të Shtatë Zotërinjtë mbretërojnë! Po ju thërras në emër unë, o Ju të Shtatë: TRESHI, KATËRA, PESA e GJASHTA, SHTATA, TETA - NËNTA. Nëpërmjet emrave, po ju thërras për ndihmë, duke ju kërkuar që të më lironi e të më shpëtoni nga errësira e natës: UNTANAS, QUERTAS (Kuertas), CHIETAL (Kietal) e GOYANA, HUERTAL, SEMVETA – ARDAL. Nëpërmjet këtyre emrave, të lutem, më liro nga errësira e më mbush me Dritë!* (Duken si fjalë në shqip që unë po mundohem t'i shpjegoj sipas mënyrës time: UN TA NGAS, KUR O TASH, KY (KI) E TALL, GOJ HANA, KUR E TALL ose HU E TALL ku HU ishte dhe emri i Sfinksit, ose UN E TALL e në fund SE MË PYTE-AR DAL – Shën. im.).

Dije, o njeri, që kur të keshë bërë këtë gjë, ti do të jeshë i lirë nga zinxhirët që të lidhin, e hedh tutje zinxhirin e vllezërve të natës. Nuk e sheh që emrat kanë forcë që të lirojnë me vibracione zinxhirët që të lidhin? Përdori me qëllim që të lirosh dhe vllaun tënd, kështuqë edhe ai të mund të dalë nga nata. Ti, o njeri, të jesh ndihmës për të liruar vllaun tënd. Mos e len që ai të qëndrojë në skllavërinë e natës!

Tashti po të jap magjinë time. Merre dhe mendo shtegun e Dritës. Drita është brenda teje, Jeta është brenda teje, Dielli mund të bëjë që të ngjitesh në nivele ma të larta.

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën VI -

Në këtë pllakë, Thoti flet për magjinë, duke përshtatë fjalët që përshkruajnë përdorimin e fuqisë së zhvilluar në luftën midis forcës së Rregullit dhe të Rrëmujës. Kjo luftë është ndjekë nga rënja e njeriut në Cikëlin (Epokën) e Parë, dhe do të vazhdojë derisa **Ndërgjegja Kozmike** të jetë gati për të kaluar nëpërmjet **Suntal**. Ekzistojnë pjesëtarë që përdorin fuqitë e mëdha të kozmosit për ta shkatërruar në vend që ta rindërtojnë e ta çojnë përpara, sepse Ligji punon, si për të mirë, ashtu edhe për të keq, pozitivisht edhe negativisht. Këta pjesëmarrës që përdorin forcat kozmike për të shkatërruar, ishin **Vllazëria e Errësirës**, magjistarë të zinj, që luftojnë kundër **Bijve të Dritës**. U munduan t'i tërheqin drejt vetes ata, kurse **Bijtë e Dritës** po mundoheshin t'i çonin në drejtim të **Dritës**.

Vllazëria e Zezë është e kundërta e **Vllazërisë së Bardhë:** E para shkatërron, e dyta ndreq e ndërton. Vllazëria e Zezë ka tani një organizatë të quajtur: **Dugpas e Zezë**, sepse pjesëtarët aty kanë "chelas", kelas, (nuk e kuptoj- S.H) ashtu si **Pjesëtarët e Bardhë**. Organizata e tyre është e ndërtuar ashtu si **Loxha e Bardhë.** Ndihmojnë njerëzit për të mbajtë disa gjëra e disa fuqi, derisa t'i shtien në kurth, pastaj, kur nuk kanë mundësi ku të fshihen, i dënojnë. Për të mbajtë qëllimet e tyre, kanë fuqi të përforcuara e të veçanta, si p.sh. mund të hapin Dimensionin e Shtatë e të thërrasin atje **Elementaren**. Kanë fuqi që të kontrollojnë mendjen nëpërmjet transferimit të mendimeve dhe hipnozës. Kështu e mbajnë kontrollin dhe nxisin rrëmujën (kaosin). Nëse ndonjëri dorëzohet në **Vllazninë e Zezë** dhe firmos me emrin e tij te libri i tyre, është

i lidhur me ata për të gjithë periudhën kur është i mishëruar. Shpirti i njeriut nuk duhet të jetë i lidhur, nëse don të shkojë drejt Dritës. Tu dorëzohesh forcave të zeza, ngatërrohesh në ndalimin e Dritës. Njeriu është i penguar vetëm nga zinxhirët e errësirës dhe të rrëmujës.

Vllazëria e Zezë mundohet gjithmonë të shkatërrojë njerëzit që kanë arritur zhvillimin gjatë udhëtimit drejt dritës, sepse i ka të përforcuara fuqitë. Është për këtë arësye që një person mjaft i zhvilluar (shpirtërisht) duhet t'i rezistojë më tepër se sa një person pak ose aspak i zhvilluar. Sa më shumë të mësosh për **Dritën**, çuditërisht kupton për ndërhyrjet dhe ndryshimet e rrëmujës dhe më shumë je i respektuar edhe nga **Vllazëria e Errët.**

Është e nevojshme të përmirësohen arsyetimet dhe ekuilibri derisa të mundemi të ndajmë **Errësirën** nga **Drita**, **Rregullin** nga **Rrëmuja** te faktet që arrijne tek ne. Vetëm duke kapërcyer pengesat dhe me mundime të vazhdueshme, arrihet qëllimi. Në kundërshtim me **Vllazërinë së Zezë** është **Loxha e Bardhë**, që stërmundohet gjithmonë të lirojë njerëzit nga rrëmuja dhe të largojë fuqinë e Vllazërisë së Zezë. Nëse kërkuesi ka me të vërtetë dëshirë për Dritë dhe jo për fuqi e pushtet, **Loxha e Bardhë** vendoset midis atij dhe **Vllazërisë së Zezë,** sepse ka shumë më tepër fuqi se sa ata.

Të **Zinjtë** janë lejuar të ekzistojnë sepse bëjnë pjesë në **Errësirën,** të cilën njeriu duhet ta mbikalojë. Lufta midis **Vllazërisë së Zezë** dhe **Loxhës së Bardhë** ka nisë qysh në fillimet e çdo gjëje. **Mësuesit** dhe **Pjestarët e Mëdhenj të Loxhës së Bardhë** përdorin forcën e **Diellit,** të rizgjuar te njerëzit për t'i mbajtë e për t'i ruajtë.

Fëmijët e Dritës (Engjujt) janë ata që nuk e kanë humbë bashkimin e tyre të zanafillës - janë edhe ruajtësit e njerëzimit, vëllezërit e tyre. Janë ruajtës të sekreteve që largojnë Errësirën e u është dhënë atyre që ndjekin rrugën e mjeshtrave. Kush dëshiron të jetë master, mjeshtër, duhet ta mësojë mjeshtërinë e Ligjeve që rregullojnë shfaqjet. Duhet ta mposhtë frikën e të udhëtojë (hapërojë) i patrembur në shtegun e **Dritës**.

Thoti vë në dispozicion sekretet që përman vepra e Ligjeve të mbrojtjes. Vetëm duke i njohtë ato, mundeni t'i përvetësoni. Duhet të përdorni njohuritë e dhëna, përndryshe çdo gjë është e kotë. Shumë nga vibrimet që duken negative, në të vërtetë janë pjesë e juaja dhe nuk janë shkaktuar nga jashtë. Mungesa e ekuilibrit mendor shpesh varet nga burimet e këtyre mendimeve negative, që i ndjejmë sikur të veprojnë te ne forcat e jashtme. Përdore dritën e arsyetimit në dridhjet e këqija, duke kërkuar të kuptosh nëse është e brendshme apo jo. Nëse është e brendshme, nis një vibracion të **pineales** dhe drejtohu drejt valëve të parregullta në të gjithë trupin, që don të thotë: në fillim dërgo valët, numëro një, më vonë dërgo një tjetër dhe numëro dy, një tjetër valë dhe numëro tre, e kështu me radhë. Mbasi të keni bërë për pak kohë, nisni me valë të rregullta në këtë mënyrë: Nis një valë dhe numëro një, nis tjetrën dhe numëro dy, e kështu me radhë.

Nëse analizon, kupton që bëhet fjalë për një forcë të jashtme dhe duhet të shkosh në një dhomë të errët e të bëjsh një rreth përqark vetes, mos e mbyll atë nëse nuk je brena atij rrethi, dhe ndiq formulat e dhëna nga Thoti. Formula është e vlefshme për ty dhe për të tjerët. Forcën e dhënë mundet ta përdorësh.

PLLAKA – VII

SHTATË ZOTËRINJTË

Dëgjo, o njeri, e mbaje parasysh zërin tim, hapi mendimet e tua hapësinore dhe pi nga pleqësitë/dituritë e mia! E errët është rruga e jetës që ti përshkon. Shumë pengesa ke në rrugën tënde. Kërko përherë që ta marrësh sa më të madhe pleqsinë/diturinë e Drita do të vijë në rrugën tënde. Hapja shpirtin tënd, o njeri, Kozmosit e lëre atë të rrjedhë i tëri bashkë me Shpirtin tënd. Drita është e përjetshme, kurse errësira është e largueshme.

Ti kërko përherë Dritën, o njeri! Dije se përherë, në çastin kur Drita do të të mbushë, errësira për ty do të zhduket shpejt. Hapjua Shpirtin tënd Vllezërve të Ndriçimit! Lëri që ATA të hyjnë e të të mbushin me Dritë. Ngreje shikimin tënd drejt Dritës së Kozmosit! Ktheje përherë shikimin tënd në qendër. Vetëm duke fituar dritën e gjithë pleqësive (diturive, mençurive), ti do jesh një me qendrën e Pafundësisë. Kërko gjithmonë të përjetshmen e Vetme. Kërko përherë Dritën e Vetme!

Dëgjo, o njeri, shpejt dëgjo zërin tim që të këndon me melodinë e Dritës. Në të gjithë hapësirën Drita është universale dhe i rrethon të gjithë me shenja si flaka. Kërko përherë e përherë në velin e errësirës, në ndonjë vend me siguri do të gjesh Dritën.

E fshehur dhe e mbuluar, e humbur nga njohja e njeriut, thellësisht në fund, ekziston pafundësia. E humbur, por ekzistuese, rrjedhëse në të gjitha gjërat, jetësore në Gjithësi është Mendja e pafundësisë. Në të gjithë hapsirën ekziston

vetëm Një pleqësi. Nëpërmjet një paraqitjeje të pafundme **AI (ZOTI) është i VETMI në njësinë e VETME**.

Çdo gjë që ekziston, vjen nga Drita, dhe Drita vjen nga Gjithësia e kjo është e bazuar në Rregullin: Ligji është mbi Hapsirën ku Pafundësia banon. Nga ligji i baraspeshës (ekuilibrit) vijnë ciklet e mëdha që lëvizin në rregullsi, deri në fund të Pafundësisë.

Dije, o njeri, që larg në Hapsirën-Kohë, e njëjta Pafundësi ndryshon. Dëgjo dhe shkruaj Thëniet e Pleqësive: Dije se përjetësisht Gjithësia është e Gjithësisë. Dije se nëpërmjet Kohës ti mundesh që përherë të ndjekësh Pleqësitë e të gjesh përherë e më shumë Dritë në rrugën tënde. Po, ti do ta gjesh këtë gjë me vuajtje, gjysma jote do të të varrosë nga dita në ditë.

Shumë kohë më parë, në Odat e Amentit, unë THOTI, rrija në këmbë përballë Zotërinjve të Ciklit. Të mbifuqishëm ATA, në gjendjen e tyre të forcës; të mbifuqishëm ATA në Pleqësitë e zbuluara. I dërguar nga Banori, i pashë për të parën herë, pas kësaj unë isha i lirë nga prania e tyre, i lirë të hyja në mesin e tyre me dëshirë.

Shpesh udhëtoj për teposhtë nëpër shtegun e errët për ke Odat, nga ku Drita shkëlqen përherë: unë mësoj nga Zotërinjtë e Ciklit pleqësitë e ardhura nga nivelet më të larta. ATA shfaqen në këtë periudhë si udhërrëfyes të njeriut në njohuritë për Gjithësinë. Ata janë shtatë, të gjithëpushtetshëm në fuqi, u flasin njerëzve nëpërmjet meje, nëpërmjet këtyre fjalëve të shkruara këtu. Kohë pas kohe, rrija në këmbë, përballë me ata, duke dëgjuar fjalë që nuk erdhën nëpërmjet zërit.

Një herë Ata më thanë:

- O njeri, don ti të përfitosh sa më shumë nga Pleqësitë? Kërko në zemër të flakës! Don ti njohuri për të përfituar Fuqinë? Kërkoje në zemër të flakës! Don të jeshë një me zemrën e flakës? Atëherë kërko veten tënde në flakën e fshehur!

Shumë herë më flasin, duke më mësuar Pleqësitë, jo të botës; përherë më tregojnë shtigje të reja për te e ndritura; më mësojnë pleqësitë e zbritura nga nivelet e sipërme, duke më dhënë njohuri si të punoj, më msojnë Ligjet, rregullat e Gjithësisë. Më flasin përsëri të Shtatët duke më thënë:

Shumë herë Ata më folën, duke më mësuar mençurinë, por jo atë të botës; duke më treguar gjithmonë rrugë të reja për tek përndritja; duke më mësuar mençurinë e sjellë nga lart. Duke më dhënë dijen si të veproj; duke më mësuar Ligjin, rregullin e Gjithësisë. Të Shtatët më folën edhe njëherë duke më thënë:

"Ne vijmë nga larg, o njeri, nga përtej kohës. Ne kemi udhëtuar nga përtej Hapësirë-Koha, po, nga vendi i fundit të së Pafundmes. Kur ti dhe vëllezërit e tu ishit të paformuar, Ne tashmë ishim formuar prej rregullit të Gjithësisë. Ne nuk jemi si njerëzit, edhe pse njëherë e një kohë edhe Ne ishim si njerëzit. Konform Ligjit, Ne u formuam jashtë Zbrazëtisë së Madhe. Sepse dije se ajo që ka formë, në të vërtetë është pa formë, duke patur formë vetëm për sytë e tu."

Të Shtatët më folën sërish duke më thënë:

"Fëmijë i Dritës, o Thot, ti je i lirë të udhëtosh në shtegun e përndritjes drejt së lartës, deri ku, përfundimisht, Çdonjë bëhet Një. Në fillim ne u formuam sipas rendit tonë: Tre, Katër, Pesë, Gjashtë, Shtatë, Tetë-Nëntë. Dije se këto janë numrat e cikleve prej të cilave Ne zbresim deri tek njeriu. Çdonjëri këtu ka një detyrë për të përmbushur; çdonjëri këtu ka një forcë për ta kontrolluar. Dhe sërish ne jemi Një me

Shpirtin e ciklit tonë. E megjithatë, Ne jemi edhe ata që kërkojnë një qëllim. Larg përtej konceptimit të njeriut, Përjetësia zgjerohet në Një diçka që është më e madhe se Gjithçka. Atje, në një kohë, që nuk është as kohë, ne Të Gjithë do të bëhemi Një me diçka më të madhe se Gjithësia. Koha dhe hapësira po lëvizin në rrathë. Mësoje ligjin e tyre, dhe, edhe ti do të jesh i lirë. Po, do të duhet të jesh i lirë që të lëvizësh përmes cikleve – të kapërcesh rojet që banojnë tek pragu!"

Pastaj më foli Ai, i quajturi Nëntë, e tha:

"Prej shekujsh të panumërt kam ekzistuar unë, duke mos e njohur Jetën, dhe, duke mos e shijuar Vdekjen. Sepse dije, o njeri, që larg, në të ardhmen, jeta dhe vdekja do të jenë Një me Gjithësinë. Në këtë mënyrë njëra ekuilibron tjetrën, saqë asnjëra prej të dyjave nuk do të mund të ekzistojë e vetme në Unitetin e Të Gjithës. Tek njerëzit e këtij cikli, forca e jetës është e papërmbajtur, por jeta në rritjen e saj bëhet një me Gjithësinë. Unë manifestohem këtu, në këtë ciklin tënd, e megjithatë unë jam atje në kohën tënde të ardhme. Nga ana tjetër, për mua nuk ekziston koha, sepse, në botën time, koha nuk ekziston, sepse Ne jemi pa formë. Ne nuk kemi Jetë, e megjithatë ekzistojmë, më të plotë, më të mëdhenj e më të lirë se ti. Njeriu është një flakë e lidhur nga një mal, por Ne, në ciklin tone, do të jemi gjithmonë të lirë. Dije, o njeri, se kur ti të kesh avancuar në ciklin që i paraprin të sipërmes, vetë jeta do të kalojë në errësirë dhe do të mbetet vetëm esenca e Shpirtit."

Pastaj më foli Zoti i Tetë-s e tha:

"Gjithë sa di ti, nuk është veçse një copëz e vogël. Ti as që e ke prekur shkarazi Të Madhin. Larg, në hapësirë, aty ku Drita mbretëron mbizotëruese, unë erdha në Dritë. Edhe mua më formuan, por jo siç u formove ti. Forma ime ishte prej një

trupi Drite pa formë. Unë nuk e njoh Jetën, nuk e njoh as Vdekjen, gjithsesi unë jam zot i gjithçkaje që ekziston. Përpiqu të gjesh kalimin përmes barrierave! Udhëto në rrugën që çon tek Drita!"

Sërish më foli Nënta:

"Përpiqu të gjesh rrugën për përtej! Nuk është e pamundur të rritesh drejt një vetëdije më të lartë. Sepse kur Dy të bëhen Një, dhe Një të bëhet Gjithçka, dije se barriera ka rënë, dhe ti do të mund ta përshkosh lirisht rrugën. Rritu nga forma për tek e paforma! Ti mund të jesh i lirë në udhëtimin tënd."

Kështu unë dëgjova përmes kohërave, duke mësuar rrugën për tek e Gjitha. Tani unë i ngre mendimet e mia lart tek Gjithësia. Duke mbajtur vesh dhe duke dëgjuar kur thërret.

"O Dritë që zapton çdo gjë. Një me Gjithçka dhe Gjithçka që është Një, rridh tek unë përmes kanalit! Hyr në mënyrë që të jem i lirë! Bëj që unë të jem Një me Frymën Universale duke ndriçuar në errësirën e natës! Lermë të jem i lirë në gjithë hapësirë- kohën, i lirë nga veli i natës! Unë, një fëmijë i Dritës, urdhëroj: qofsh i lirë nga errësira!"

Për Dritë-Frymën, unë jam pa formë, i paformë e megjithatë shkëlqej Dritë. Unë di se zinxhirët e errësirës duhet të copëtohen dhe të bien para Dritës. Tani unë po ta jap këtë mençuri. Mund të jesh i lirë, o njeri, duke jetuar në dritë e në përndritje. Mos e kthe fytyrën tënde larg nga Drita! Fryma yte banon në mbretëritë e përndritjes. Ti je një bir i Dritës. Ktheji përbrenda mendimet e tua, dhe jo për jashtë! Gjeje brenda vetes Frymën tënde të Dritës! Dije se ti je Zoti! Gjithçka vjen nga brenda. Rritu në mbretëritë e përndritjes! Silli mendimet e tua drejt Dritës! Dije se ti je një me Kozmosin, je një flakë dhe

një Fëmijë e Dritës. Tani po të jap një paralajmërim: mos lejo që mendimi yt të të shpërqëndrojë e të bësh hapa mbrapa! Dije se përndritja rrjedh përjetësisht përmes trupit tënd. Mos u kthe tek Ndriçimi i Errët që vjen nga Vëllezërit e Zinj! Por sytë mbaji gjithmonë me vështrimin drejt së lartës, e shpirtin mbaje të sintonizuar me Dritën! Merre këtë mençuri dhe vere vath në vesh! Dëgjoje Zërin tim dhe bindju! Ndiq shtegun e përndritjes dhe ti do të jesh Një me shtegun!

Shpirti yt është marrë vesh me Dritën.

Merri këto pleqësi (dituri) dhe futi në llogari!

Dëgjoje Zërin tim dhe zbatoje!

Ndiq shtegun e ndriçimit dhe ti do jesh Një me Shtegun e Dritës!

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën VII -

Kjo pllakë fillon me rregullat për të hapë mendje e për të thithë nga dituritë e **Thotit**. Ai thotë se jeta është plot me pengesa, që duhen mbikaluar. Duhet të lejohet **Drita e Kozmosit** që të thithet e të shfaqet. Pikësynimi i të gjithë kërkimeve duhet të jetë bashkëpunim me Ndërgjegjen Kozmike, përndryshe ka kufizime.

Drita është e fundme dhe e pafundme, sepse **Zoti, Ndërgjegjja Kozmike, Drita** dhe çdo gjë e dukshme dhe e padukshme janë pjesë e **Zotit**, kështuqë nuk mund të ketë ndarje. E deri nën mbulesën e Errësirës, që ne e quajmë negative, është fsheh esenca e **Dritës**, gati të niset kur t'i hiqet veli. **Truri i Pafund** është i humbur pa mirëkuptimin e njerëzve, nëse nuk marrin parasysh që çdo gjë nuk është tjetër, veçse një shfaqje e ndarë e të vetmit **Tru Kozmik.**

Të gjitha karakteristikat e diturive, si te Zoti, ashtu edhe te

njerëzit, janë pjesë e të njëjtës dituri, por të manifestuara në kanale të ndryshëm. **Ligjet dhe Rregullat** janë rregulla themelore të të gjitha krijimeve, si te Zoti ashtu edhe te Njeriu, sepse në Rregull gjendet drejtpeshimi.

Thoti na flet ende për të kaluarën tonë të largët, para se **Atlantida** të fundosej. Fillimet e tij nisin nëpërmjet Banorit, pastaj njihet me çelësin dhe ishte në gjendje të hynte i vetëm. Çfarë ndryshimi nga kërkuesit e sotëm, të cilët po ta kenë çelësin, e përdorin pa përgjegjësi.

Zotërinjtë e Ciklit i flasin **Thotit** për ciklet (epokat) e të ardhmes, në mënyrë që të kishte njohuritë e tyre, edhe nëse nuk mundej të hynte nëpërmjet **Suntal** në ciklet më të larta.

Thoti premton që do t'i vinte në shërbim të njerëzimit dituritë që i janë dhënë.

Thuhet se **Zotërinjtë** janë **Drejtues** për njeriun dhe janë të mësojnë ato gjëra që janë matanë **Ndërgjegjes Kozmike**, pra te **Ai**, që përvetëson njohuritë e shtrirjes së **I.Yob.**

Sipas simbolizmit të lashtë, dituritë gjendeshin te flaka. Flaka e ardhur nga shenjat e paqarta ekziston për një periudhë e shfaqur dhe më vonë kthehet te e fshehta. Kështu bëhet symbol i ndërgjegjes që rrjedh nga e fshehta. Ekziston për një periudhë te trupat fizikë dhe më vonë kthehet e rinuar te e fshehta. Në thelb i thuhet njeriut që të kërkojë dituritë te ndërgjegjja e tij.

Të Shtatët kishin ardhë nga matanë **Ndërgjegjes Kozmike** para se ne të krijoheshim nga **I.Yob** dhe filluan të formohen ndërkohë që ne bënim ende pjesë te rrëmuja (kaosi). Filllojnë e zhvillohen para epokës së njerëzimit, edhe, kur zunë këtë Cikël Kozmik, dukeshin si njerëz. Ndërgjegja është e paformë dhe e përkulshme dhe mund të thithë çdo formë e çdo mendim të mendjes.

I thuhet Thotit se ishte i lirë të niste udhëtimin derisa të ishte i kompletuar cikli përfundimtar, në të cilin, ajo që në një kohë ishte te **Njishi**, të kthehej po te **Njishi**.

Ndërgjegjja kozmike që pushtoi ciklet Kozmike të sipërme, filluan të formohen në pjesë të rregullta, jo të gjitha përnjëherë.

Ekzistojnë **TË SHTATËT** në botët e tjera, përveç tonës, me fjalë të tjera, më larg se hapësira e **I. Yob**. Këta Zotrinj, edhe pse shfaqen këtu, janë ende të lidhur pikërisht me **Ndërgjegjen Kozmike** të tyre. E pakufijshmja, e pambarimta është hapësira më e madhja, te ne e quajtur e më përtejshmja.

Kur **I.Yob** të ketë kompletuar shtrirjen e tyre në hapësirën e pafundme, do të bashkohen **Pruesit e Flakës** në hapësirën e përtejshme. Duhet të njihen spiralet e Hapësirë-Kohës para se të mund të hyni. Zhvillohet fuqia për të lëvizë nëpërmjet hapësirës dhe kohës vetëm pasi ta kesh njohtë. **Jeta** dhe **Vdekja** ekzistojnë vetëm si shprehje e krahasueshme. Çdo gjë ka të kundërtën e saj: Hiq një pol dhe tjetri pol e heq ekzistencën. Në planin e ndërgjegjes, në të cilin shfaqet më e larta **Ndërgjegjja Kozmike e Nëntës**, vdekja nuk njihet, kështuqë edhe jeta nuk njihet. Ka vetëm ekzistencë të pavdekshme dhe të përjetshme, pa ndryshime në pikën më të randësishme të shfaqjeve apo zhdukjes së ndërgjegjes së ditur. Kur njeriu të fitojë mbi vdekjen, ka dominuar edhe jetën dhe për atë vetëpushojnë të dyja së ekzistuari. **Zotëria e Nëntës** është i pakohë në planin e tij, sepse koha është rezultat i ekzistencës së materiales dhe e **Nënta Ndërgjegje Kozmike** nuk paraqitet si materiale.

Shpirti i njeriut është një flakë, që është e lidhur me një mal, me mishin. Kur të bëhen **një** me **I.Yob** në kompletimin përfundimtar të rrethit të pafund, materia dhe jeta, që janë një me vdekjen, pushojnë së ekzistuari.

Edhe në të **Tetin Cikël**, jeta dhe vdekja janë një dhe aty shfaqet vetëm ekzistenca e përjetshme. **Cikli i Tetë** kozmik është Cikli i Dritës, sepse këtu Drita është e pafundme dhe përqëndrohet në rrëmujën, të dërguara nga i **Nënti Cikël**, i coptuar në pjesë, që janë transmetuar në ciklet kozmike më të vegjël. Rrëmuja që kthehet në rregull është baza e çdo gjëje. Drita është mësuese e të gjitha këtyre që ekzistojnë. Është e mundur të veprohet në ciklin kozmik më të lartë kur të dyja

pjesët e një njësie të ndërgjegjes bëhen një dhe të gjitha pjesët e tjera bëhen një me Njishin e së bashku bëhen: **E GJITHA.**

Thoti vërteton qartë se të gjitha pjesët e njësisë së tij, janë **Nji**, kur thotë se qëllimi i tij është pjesë e Gjithësisë. Thoti përdor një lutje të Dritës, që si përhera, përfundon me një komandë. Te drita, ajo që ne e quajmë formë, është e paformë, sepse vetëm në Dritë ekziston realiteti i vërtetë. Thoti na i paraqet lirisht dituritë e tij, përderisa edhe të tjerët mundet të përshkojnë të njëjtin hap me atë. Urdhëron ndjekësit e tij që të kthejnë shikimin përherë në drejtim të Dritës dhe të drejtojnë mendimet e tyre në drejtim të mësuesit të brendshëm. Duhet të evitohen premtimet e shkëlqyeshme të fuqisë materiale të Vllezërve të Zinj.

PLLAKA – VIII

ÇELËSI I MISTERIT

Brenda teje, o njeri, kam vënë njohuritë e mia. Brenda teje kam vënë Dritën. Më dëgjo tani e merr pleqësitë e mia, që i kam sjellë nga nivelet e hapsirës që janë mbi çdo gjë!

Unë nuk jam si një Njeri, sepse lirisht vij nga nivele e dimensione të ndryshme. Në çdonjërin prej tyre unë marr një trup të ndryshëm. Në çdonjërin prej tyre unë ndryshoj formën. Tash e di se mungesa e formës është gjithandej ku ka një formë.

E madhe është Pleqësia e të Shtatëve. Të mbifuqishëm janë ata në atë botë. Ata bëhen të dukshëm me anë të Forcës së tyre, të mbushur deri në majë nga forca që u vjen nga bota tjetër.

Dëgjoi këto fjalë pleqërishte! Dëgjoi dhe bëri tuajat! Kërko te ato mungesën e formës! Misteri nuk është gjë tjetër veçse njohuria e fshehur. Njihi e do të jenë të zbuluara. Kërkoje pleqësinë shumë thellë të varrosur e do të jesh Mësuesi i errësirës dhe i dritës. Të panjohura e të thella janë të panjohurat që të rrethojnë e që fshehin sekrete shumë të vjetra. Kërko nëpërmjet çelësave të pleqësive të mia! Me siguri do ta gjesh rrugën. Porta për te fuqia është sekrete, por, kush e arrin, duhet të mundohet shumë. Shihe Dritën, o Vllau im! Hapu ti dhe do t'i marrësh! Shtyhu ti nëpër krahinën e errësirës duke mbikaluar banorin e natës. Mbaje gjithmonë shikimin tënd në drejtim të dritës e do të jesh i njëllojtë me atë. Njeriu po ndryshon në forma që nuk janë të kësaj bote. Rritet me kohën në drejtim të paformës që është një nivel i ciklit

superior. Dije se ti do të arrish të bëhesh i paformë, përpara se të njësohesh me Dritën.

Dëgjoje, o njeri, zërin tim, që po të tregon shtigjet e dritës, që të tregon para syve rrugën për te realizimet, kur ti të jesh NjË me Dritën! Kërkoji të fshehtat nga zemra e tokës! Mëso ligjet që atje ekzistojnë, që i mbajnë yjet në ekuilibrin e tyre, me forcën e mjegullës së zanafillës! Kërkoje flakën e jetës së Tokës, të lagur nga vezullimi i flakës së saj! Ndiq shtegun e shumfishuar, derisa edhe ti të jesh NJË me flakën! Foli me fjalë të buta atij që banon në atë Botë! Hyr në Tempullin e Dritës blu dhe zhytu në flakën e jetës së pandarë!

Dije, o Njeri, se ti je i krijuar. Je një gjë e bërë nga toka e flaka. Lëre flakën tënde që të shkëlqejë ndritshëm. Bëhu vetë flakë! Pleqësitë janë të fshehura në errësirë. Kur të shkëlqesh me dritën e Shpirtit, do të gjesh Pleqësitë e te për të lindur në Dritë, një Diell Drite i paformë. Kërko përherë më shumë pleqësi. Do t'i gjesh në zemër të flakës. Dije, nëse ti e lodh Dritën, ajo mund të derdhet në mendët e tua.

Tash unë po të flas me anë të pleqësive. Shpejt dëgjo zërin tim dhe bindu! Shqyeje të gjithë velin e errësirës! Një Dritë do të ndriçojë në shtegun e dijes.

Unë po flas nga e vjetra Atlantidë, flas për ditët e Mbretërisë së Hijeve. Flas për ardhjen e bijve të Hijeve. Ata mundeshin të dalin jashtë nga thellësitë e mëdha nëpërmjet njohurive të njerëzve të tokës, me qëllim që të mbanin për vete një forcë të madhe. Larg, në të kaluarën, para se Atlantida të ekzistonte, ishin disa njerëz që kërkonin nëpër errësirë, duke përdorë mënyra magjike, thërritnin qeniet e thellësive të mëdhaja, poshtë në atë botë. Ata e arritën atë nivel. Ata ishin të përbërë nga një tjetër vibracion i paformë, duke jetuar të

padukshëm nga bijtë e njerëzve të tokës. Vetëm nëpërmjet gjakut ata mund të merrnin formë. Vetëm nëpërmjet njeriut ato mund të jetonin në këtë botë.

Në të largtat kohë të kaluara kanë qenë marrë nën kontroll të Mësuesve, të dërguar poshtë në vendin nga ku kishin ardhë. Por disa nga ata mundën të ngelin të fshehur nëpër vende dhe nivele të panjohura nga njeriu. Ata jetonin në Atlantidë si hije, dhe nganjëherë shfaqeshin midis njerëzve. Po, kur gjaku u vihej përpara, ato vinin e banonin me njerëzit. Hijet ishin midis nesh me pamjen e njeriut. Me kokë gjarpëri, kur magjia u hiqej, por me pamjen e njeriut midis njerëzve. Ato hynin hajdutçe nëpër kuvende, duke marrë formën e njerëzve. Vrisnin sipas mënyrës së tyre të parët e Mretërisë, duke e bërë fytyrën si të atyre që vrisnin dhe mbretëronin midis njerëzve. Vetëm nëpërmjet magjive ishte e mundur të zbuloheshin. Vetëm nëpërmjet tingujve mund të zbulohej fytyra e tyne. Ata vinin nga mbretëritë e Hijeve për të shkatërruar njerëzit dhe për të mbretëruar në vend të tyre. Dhe, duhet ta dini se Mësuesit ishin magjistarë të fuqishëm, të zotë që t'ua hiqnin velin nga fytyra prej gjarpëri, të zotë që t'i kthenin mbrapsht nga kishin ardhë. Ata vinin te njerëzit dhe u mësonin sekretin, Fjalën, që vetëm njeriu mund të flasë. Shpejt Mësuesit ngrinin velin nga gjarërinjtë dhe e hidhnin larg nga toka e njerëzve. Gjithashtu, keni kujdes, gjarpëri jeton në një vend të botës që mundet, nganjëherë, të jetë i hapur! Të padukshëm ato rrëshqasin midis njerëzve, në vende ku bëhen ceremonitë. Përsëri, me kalimin e kohës, ata marrin pamje njerëzore. Ato mund të sillen nga Zotërinjtë që njohin të bardhën e të zezën, por vetëm Mësuesi i bardhë mund t'i kontrollojë e t'i mbërthejë të gjallë. Mos kërkoni mbretërinë e

hijeve, sepse me siguri do të gjeni keq, sepse vetëm Mësuesit e Dritës mundet të zotërojnë frikën nga errësira.

Dije, o vllau im, se frika është një pengesë e madhe. Të jesh përherë Mësues i Dritës dhe frika nga errësira do të të zhduket shpejt! Dëgjo dhe mbaji parasysh këto pleqësitë e mia, zëri i dritës është i qartë. Mos kërko në lëndinën e hijeve, sepse Drita do të shfaqet. Shpejt dëgjo, o njeri, thellësitë e pleqësive të mia, unë po flas për njohuri të fshehura për njerëzit. Unë kam shkuar larg në udhëtimin tim nëpërmjet Hapsirë-Kohës, deri në fund të hapsirës, të këtij zhvillimi të hapsirës.

Po, kam parë përbindësha, ndjekës të kufirit, që rrinin në pritje të çdonjërit që donte të kalonte n'atë botë. Në atë hapsirë ku koha nuk ekziston. Me të vërtetë e kam ndier dobët ekzistencën e Rojeve të Ciklit, që lëvizin vetëm nëpër kufinj, të paliruar nga harkimet dimensionale. Të panjohur e të rrezikshëm janë përbindëshat, rojet e kufirit të hapsirës. Ata ndjekin vetëdijen në fundet e hapsirës. Mos mendo t'i largohesh mishërimit, sepse ata ndjekin me kujdes shpirtin përgjatë kufirit të saj. Vetëm rrethi mundet që të mbrojë, duke të shpëtuar nga thonjtë e përbindshave të kufirit.

Një herë, në një kohë të kaluar, unë iu afrova Pengesës së Madhe dhe shoh anën tjetër ku nuk ekziston koha, formën pa formë të përbindëshave të pengesave. Po, i gjeta të fshehur në harkëzimet e kohës së tyre, që më nuhatnin nga larg, u ngritën e u ranë këmbanave gjigande, që mund të jenë dëgjuar nga njëra shtresë e hapsirës në tjetrën dhe unë lëviza nëpërmjet hapsirës në drejtim të shpirtit tim.

Unë largohem me të shpejtë nga ato, duke u kthyer prapa nga një kohë e pamendueshme, por ata më ndiqnin,

duke lëvizë me mënyra të çuditshme, të panjohura nga njerëzit. Por, në rrjetën e anës së fundit të Hapsirë-Kohës, unë gjej përbindëshat e kufirit të hapsirë-kohës, të uritur për të hëngër shpirtërat që donin të kalonin këtë kufi.

Unë largohem nëpërmjet rrathëve, prapa në trupin tim. Ik me të shpejtë e ato më ndjekin. Po, pas meje më ndjekin të pangopurit, duke kërkuar mënyrën për t'u ngopur me shpirtin tim. Po, o njeri, dije se shpirti që i kundërvihet kufirit të Hapsirë-Kohës mund të mbërthehet nga rojet, ndjekësit e shpirtërave të kohës tjetër (të botës tjetër) dhe e mbajnë të mbërthyer, derisa zhvillimi nuk është përmbushë dhe e lënë prapa, derisa vetëdija ta braktisë.

Unë hyj në trupin tim, krijoj rrathë që nuk kanë kufinj, krijoj forma, nga të cilat, forma ime është krijuar. Vendos trupin tim në qendër, tee rrathët, dhe i lë ndjekësit e mi të pangopur në rrathët e kohës. Por kur shpirti të jetë i lirë nga trupi im, unë duhet të jemë i kujdesshëm që mos u afrohem kufinjve të hapsirë-kohës, përndryshe shpirti im nuk do jetë kurrë i lirë.

Dije se ndjekësit (përbindëshat) e kufirit lëvizin vetëm përgjatë kufirit dhe asnjëherë nëpërmjet harkëzimeve të hapsirës. Vetëm duke lëvizë në drejtim të harkëzimeve (me formë si të valëve të buta të detit), ti mundet të largohesh prej tyre, sepse vetëm në fund të kufirit ata të ndjekin. O njeri, mbaji parasysh paralajmërimet e mia! Kërko që mos e shkelësh hyrjen për n'atë botë! Të pakët janë ata që kanë pasë sukses në kalimin e këtij kufiri, deri në Dritën e Madhe që shndrit nga Bota tjetër, sepse, dije që banorët e asaj bote kërkojnë përherë ndonji shpirt për ta kthyer në skllav.

Dëgjo, o njeri, e futi në llogari paralajmërimet e mia: kërko të lëvizësh përgjatë harkëzimeve (valëve) dhe jo në fundet e tyre, e ndërkohë që ti je i lirë nga trupi yt, beson se po dëgjon një tingull të njëllojtë me një kumbim këmbane nëpërmjet trupit tënd. Tërhiqe prapa trupin tënd dhe ndiq rrathët e mos kërko të hysh nëpër mjegull!

Kur ti të hysh në formën ku banon (shpirti hyn në trup), përdor kombinimet e rrathëve dhe kryqet e qendrave të rrathëve. Hape gojën tande dhe përdor fjalët tueja! Përmbushe Fjalën dhe ti do jesh i lirë. Vetëm kush është i mbushur me Dritë, mund të shpresojë të bëhet Roje i Shtegut të Pleqësive e atëherë mund të lëvizë nëpërmjet harqesh (valësh) të çuditshme dhe kufizimesh, që janë krijuar në drejtime të pa njoftura nga njeriu.

Dëgjo, o njeri, e mbaji parasysh paralajmërimet e mia: mos u mundo t'i kalosh rojet e shtegut! Më mirë ta mbash Dritën e të jesh gati për të kaluar te shtegu. Drita është gjysma e fundit tënd, o vlla! Kërko e do ta gjesh përherë Dritën në shteg!

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën VIII -

Thoti ka përvetësuar fuqinë e mësuesisë dhe kështu aftësinë për të hyrë në çdo botë të ndërlidhur dhe të marrë një formë dhe mundësinë për të hyrë në hapësira të brendshme të Dimensionit të Katër. Çelësi i diturive gjendet te simbolet. Vetëm kush kërkon domethëniet e fshehura e gjen jetën. Te njeriu ekziston një zhvillim e kapërcim konstant, si nga ana materiale ashtu edhe në ana shpirtërore. Në të njëjtën mënyrë zhvillohet edhe ndërgjegjja, që është e paformë dhe pa kufinj të përcaktuar. Në fund arrihet n'atë cikël kozmik, në të cilin asgjë materiale nuk paraqitet si formë.

Thoti thotë që të studjojmë misteret e brendshme të Tokës dhe të mësojmë për barazpeshat. Piramida e forcave është e përbërë nga esenca e këtyre forcave, e cila bën që atomet të shtyjnë pjesët nga vetja e vet. Njeriu duhet të gjejë piramidën dhe të qëndrojë brenda në të, ose përpara saj, për të marrë nga forca e saj universale. Aty thuhet se duhet të futesh në **Tempullin** e ndritshëm me blu, që është **Salla e Amentit**, ku janë të **Shtatët**. Njeriu është trup dhe ndërgjegje, por ndërgjegjja, flaka e saj, duhet të thithë trupin, tokën. Vetëm nëpërmjet këmbënguljes mund të gjendet dituria e fshehur në Errësirë, ose thënë më mirë, se në këtë dituri ekziston esenca e flakëve dhe në atë gjendet dituria e vërtetë.

Mbretëria e Hijeve ishte ajo e të **Tetit Vibracion**, ku gjendet përjetësia e sjellë aty nga ciklet kozmike më të vegjël, kur njeriu kishte hapë hyrjen. Kjo gjë ka ndodhë në të **Tretin Cikël**, ose në **Ciklin Polar** dhe kërkuesit në Errësirë ishin njerëzit që donin fuqinë e materiales, në vend që ta përcaktonin jetën e tyre në gjëra shpirtërore. Këta njerëz të

ringjallur ishin të paformë, meqenëse u ishte zgjuar vetëm ndërgjegjja, gjë e vendosur që trupat të krijoheshin këtu, në Tokë. Ato, si gjëja më **elementare,** ishin qenie të ndara nga ndërgjegjja kozmike dhe nga forma e tyre e krijuar, por nuk ishin në gjendje të bashkoheshin me këtë cikël, sepse nuk kishin zhvilluar kthesat kryesore. Vetëm me dëshirën e njeriut dhe ndarjen e shpirtit nga gjaku, mundet të merrnin formë. Mësuesit kishin rikthy shumë nga ato nëpërmjet hyrjes së mëposhtme, por ishin edhe disa që kishin mbetë në vendet e ndërtuara për ato dhe shihnin vetëm thirrjet e emrave të tyre në sakrificat me gjak. Merrnin ngjashmëri njerëzore, por pamja e tyre e vërtetë ishte trupi i një burri ose i një gruaje me kokë gjarpri. Ishin në gjendje të shprehnin magjitë, hipnotizues rreth e përqark tyre, që të dukeshin se kishin formë njerëzore. Është ky bazamenti i besimit në fuqinë hipnotike të gjarpërinjve. Merrnin karakteristikat e drejtuesve, që tinës i kishin vrarë dhe gradualisht ata dhe njerëzit që i kishin thirrë, merrnin kontrollin e vendit. Kishin ngjashmëri njerëzore, por ishte një fjalë që nuk mundeshin ta thoshin dhe u ishte mësue mësuesve të njeriut dhe bëhet ligj, që çdo njeri që kishte këtë ngarkesë duhej të thoshte atë fjalë përpara popullit çdo muaj hënor. Nëse gabonte, vritej. Kjo bëri që të largoheshin nga pozicioni që kishin midis njerëzve dhe kështu gradualisht filluan të harrohen, por ndonjëri mbeti në postin që kishte pushtuar, të paaftë për të hyrë te njeriu, sepse njeriu i keq harroi ritet për t'i thirrë. Fjala që nuk mundeshin të thoshin ishte: **KININIGEN.** Mësuesit e magjive të **Bardha dhe të Zeza** mundeshin t'i thirrnin, por vetëm një **Mësues i Bardhë** ka forcën t'i kontrollojë. Qeverisin duke frikësuar. Fitoni mbi frikën dhe keni arritë te **Drita**.

Thoti vërteton që ka qenë ke **Suntal** dhe ka arritë të shohë **Dimension e Gjashtë**. Thotë se aty janë **Rojet,** të aftë që të lëvizin nëpër kufinjtë, dhe asnjëherë nëpër dallgëzimet. Ndërgjegjja e nxjerrë që mundohet të hyjë te i Gjashti Dimension, do të jetë në mënyrë të pagabueshme e sulmuar nga **Tufa e Egërsirave të Kufirit**. Vetëm duke lëvizë në hapësirë nëpërmjet rrathësh, mundesh t'i largohesh Tufës. Ka mbrojtje vetëm nëpër rrathë. Rikthimi në trup nuk ndihmon. Gjithsesi, nuk mund tu afrohesh atyre pa shkak. **Thoti** ka pasë këtë eksperiencë në të kaluarën dhe kishte mësuar të ishte i kujdesshëm nga ajo që kishte ndodhë. Mundohet të kalojë hyrjen, për te **Suntal** dhe rojet shkuen menjëherë te ai. Njihte ligjin e rrathëve dhe kufirit dhe nëpërmjet kësaj u bëri dredha, duke u kthyer në trupin e tij dhe duke kompletuar mbrojtjen. **Tufat** e **Egërsirave të Kufirit** nuk përlajnë ose shkatërrojnë shpirtin lehtësisht, por bllokojnë të tjera shfaqje derisa ky cikël kozmik të jetë i përfunduar, pastaj mundet të njësohesh me ndërgjegjen kozmike, që vjen më pas. E pasi kishte plotësuar mbrojtjen e tij, Thoti kishte kujdes që të mos afrohej shumë në të Gjashtin Dimension me lëvizje nga fundi i kufinjve.

Thoti përsërit ende paralajmërimin e tij për lëvizjen nëpërmjet harqeve, rrathve. Thotë edhe që të mos provoni të kaloni **Suntalin** para kohe, sepse vetëm pak njerëz kanë pasë sukses. Të mëson edhe si të njiheni me **Rojet e Kufirit.**

PLLAKA – IX

ÇELËSI PËR TË QENË I LIRË NËPËR HAPËSIRË

Kujdes, o njeri, dëgjoje zërin tim, që të mëson pleqësitë dhe Dritën për këtë periudhë, që të mëson si të përballosh errësirën, që të mëson si ta çosh përpara dritën në jetën tënde! Kërko, o njeri, të gjesh shtegun që të drejton për te Përjetësia si një Dritë! Përplase tutje nga vetja velin e errësirës! Kërko të jesh një Dritë nëpër botë! Bëre veten tënde nji flamur për Dritë, nji flakë për Diellin e kësaj hapësire! Ktheje fytyrën tënde në Kozmos! Fol me zërin e Banorit, që është një këngë që rithërret dritën. Këndo një këngë të lirisë. Këndo këngën e shpirtit. Krijo vibracione që do të bëjnë ty Një me Gjithësinë, të përzier me Kozmosin. Rritu i bërë një me dritën! Të jesh një kanal për ekuilibrin, një shteg për te Ligjet e kësaj bote! Drita, o njeri, është Drita e Madhe, që ndriçon nëpërmjet hijeve të trupit. Ti je i lirë të burosh/rilindësh nga e stërvjetra errësirë, ti je një me Dritën. Hijet e errësirës të rrethojnë, por jeta të mbush me rrjedhën e saj. Dhe, tash, o njeri, duhet të burosh e ta çosh trupin tënd larg nga shtresat (nivelet) që të rrethojnë dhe që janë një me ty.

Rrotulloje shikimin, o njeri! Shihi përthyerjet (valëzimet) e dritës tënde. Po, shih deri dhe errësirën që të rrethon, e derdhur jashtë nga veli saj. Kërko përherë pleqësitë! Mos len që trupi yt të të tradhtojë! Vazhdo në shtegun e valëve të Dritës. Evitoi rrugët e errëta! Dije se pleqësitë janë të përhershme. Kanë ekzistuar qyshkur Shpirti i Madh i Gjithësisë ka filluar të ekzistojë, duke krijuar rregullsi me ligjet që ekzistonin nëpër shtigjet e tyre. Futi në llogari, o njeri,

mësimet nga pleqësitë. Fute në llogari zërin që të flet për kohën e kaluar. Po, unë do të tregoj për njohuri të harruara, të tregoj për pleqësitë e fshehura në kohët e kaluara, të humbura në errësirën që më rrethon. Dije, o njeri, ti je fundi i të gjitha gjërave. Vetëm se këto njohuri janë harruar, janë humbur kur njeriu është hedhë në robëri, i lidhur e i mbërthyer nga zinxhirët e errësirës/paditurisë. Shumë, shumë kohë më parë, unë e braktisa trupin tim. I mrrekulluar unë shkoja i lirë nëpër hapsirën e Kozmosit, duke shqyrtuar shkaqet që e çojnë njeriun në skllavëri.

Dije, o njeri, që ti je vetëm nji shpirt. Trupi nuk është asgjë. Shpirti është gjithçka. Mos lejo që trupi yt të jetë një burg për shpirtin! Ik nga errësira e udhëto nëpër Dritë. Largohu nga trupi yt, o njeri, e do të jesh i lirë, me të vërtetë një Dritë që është Një me Dritën! Kur ti të jesh i lirë nga zinxhirët e errësirës e udhëton nëpër hapsirë si një Diell i Dritës, atëherë do ta kuptosh se hapësira nuk është pa pengesa, por me të vërtetë është e mbyllur me harqe e kënde.

Dije, o njeri, se çdo gjë që ekziston, është vetëm një pjesë e vogël e një pamjeje e më të Madhes Gjendje që i bashkohet asaj. Lënda materiale është si një lëng që rrjedh si korrent, që ndryshon në mënyrë të njëllojtë nga një pamje në një tjetër. Njohuritë kanë ekzistuar gjithmonë nëpër të gjitha kohërat, asgjë nuk është ndryshuar, edhe pse të groposura në errësirë, asgjë nuk humb, edhe pse të harruara nga njeriu. Dije se nëpërmjet hapësirës ku ti banon, ka dhe të tjerë që janë të mëdhej njësoj si ti, të krijuar nga zemra e lëndës, ose të ndarë nga hapësira e tyre.

Dikur, në një kohë të harruar gjatë, unë Thoti, hapa një kalim e u zhyta në të tjera hapësira dhe mësova sekretet e

fshehta. Shumë thellë në esencën e lëndës materiale janë fsheh shumë sekrete. Nëntë janë dimensionet e pakapërcyeshme dhe nëntë janë ciklet e hapësirës. Nëntë janë zhvillimet e njohurive e nëntë janë botët brenda botëve. Po, nëntë janë Zotërat e cikleve (zhvillimeve) të hapësirës që vijnë nga sipër e nga poshtë. Hapësira është e mbushur me gjëra të fshehta, sepse hapësira është e ndarë nga koha.

Kërko çelësin për hapësirë-kohën dhe ti do të hapësh portën e madhe. Dije se në hapsirë-kohën është e sigurtë se ekziston vetëdija, edhe pse e fshehur nga ndërgjegjia jonë, ajo do të ekzistojë tash e për jetë të jetëve. Çelësin për botët brenda teje mund ta gjesh vetëm brenda teje, sepse është njeriu hyrja e misterit, është hyrja për të qenë Një me NJËSHIN. Kërkoi brenda në rreth! Përdor FJALËN dhe UNË do ta jap. Hape kalimin brenda teje dhe me siguri do të jetosh. Njeri, ti beson se po e jeton jetën, por dije se jeta është brenda vdekjes.

Nga çasti që ti je lidhur me trupin tënd, për ty nuk ekziston më jeta. Vetëm shpirti është i lirë në hapësirë, ka një jetë që është me të vërtetë jetë, Gjithë pjesa tjetër është skllavëri, një zinxhir nga i cili duhet të lirohesh. Mos beso se njeriu është i lindur nga toka, edhe pse ka origjinën nga toka. Njeriu është një shpirt i lindur në dritë, por pa njohuri, nuk mund të jetë kurrë i lirë.

Errësira e rrethon të lindurin nga Drita. Errësira kap Shpirtin. Vetëm ai që kërkon, mund të shpresojë të jetë ndonjëherë i lirë. Hijet përreth teje po bien, errësira po mbush gjithë hapsirën, edhe Dritën, o Dritë e shpirtit njerëzor!

Mbushe errësirën e hapësirës! Ju jeni bijtë e të Madhes Dritë. KUJTOJENI E DO TË JENI TË LIRË! Mos rrini në hije!

Drita vërshon nga errësira e natës. Lëre shpirtin tënd, që është i lindur nga DIELLI të mbushet nga Lavdia e Dritës, i lirë nga zinxhirët e errësirës, një shpirt që është Një me Dritën.

Ti je çelësi i pleqësive tuaja. Brenda teje është e gjithë koha dhe hapësira. Mos jeto në skllavërinë e errësirës! Liroje trupin tënd nga drita e natës! O Dritë e Madhe që mbush të gjithë Kozmosin, rridh e gjitha te njeriu! Bë nga trupi i tij një pishtar që të ndriçojë përsëri midis njerëzve!

Larg, në të kaluarën, kërkoja pleqësitë, dituritë, njohuritë e panjohura nga njerëzit! Larg në të kaluarënn, unë udhëtova në hapsirën ku fillon koha. Kërkoja përherë të arri njohuritë dhe pleqësitë. Atëherë unë mendova: vetëm e ardhmja mund të më sjellë çelësin e pleqësive.

Unë udhëtova poshtë, në thellësitë e Amentit, për të kërkuar Njohuritë e Mëdhaja. Ju pyes ju, Zotërinj të Ciklit, për rrugën e njohurive që po kërkoj. U vë përpara Zotërinjve këtë pyetje:

- Ku është burimi i GJITHËSISË?

Me një zë të fuqishëm, më përgjigjet Zotëria i Nëntës:

- Liroje shpirtin tënd nga trupi yt dhe ec me mua përballë Dritës!

Unë dal nga trupi im si një flakë e ndritshme nëpër natë. Qëndroj në këmbë përballë Zotërisë, i lagur nga Flaka e Jetës. Më vjen e më mbërthen një forcë e madhe jashtë çdo njohurie të njeriut. Gjendem i hedhur në një greminë midis hapësirash të panjohura nga njeriu. Unë shoh Farkëtuesin dhe Krijuesin e RREGULLIT (Harmonisë) e të RRËMUJËS (Kaosit) dhe kufirin e natës. Unë shoh Dritën, që rrjedh nga Rregulli (Harmonia) dhe dëgjoj tingujt e Dritës. Unë shoh flakën nga Humnera, që

vë në Rregull Dritën. Shoh Rregullin që buron nga Rrëmuja. Shoh Dritën që jep Jetën. Ndërkohë dëgjoj zërin:

- Dëgjo dhe kupto! Flaka është burimi i të gjitha gjërave, që përmban fuqinë e të gjitha gjërave.

Është Rregulli që formon çdo gjë, është FJALA dhe nga FJALA vjen Jeta dhe ekzistenca e të gjithave.

Dhe një herë më thotë Zëri:

- Jeta që është te ti, është FJALA. Kërkoje Jetën brenda teje dhe do të kesh fuqinë për të përdorë FJALËN!

Për një kohë të gjatë shoh flakën e ndritshme, që del nga përqëndrimi (esenca) i flakës, realizuese si e Jetës, ashtu dhe e Rregullit ku njeriu është Një me Flakën.

Unë kthehem prapa në trupin tim, dhe rri në këmbë përballë të Nëntëve, duke dëgjuar Zërin e Cikleve, me një vibracion të fuqishëm që më thonë:

- Dije, o THOT, se Jeta nuk është gjë tjetër, veçse Fjala e Flakës. Jeta tjetër që ti kërkoje më parë nuk është veçse si një flakë, Fjala në Botë, si një flakë. Kërkoje rrugën për Fjalën dhe sigurisht Fuqia do të jetë jotja me siguri!

Atëherë unë pyes Nëntën:

- O Zotëri, më trego rrugën! Më jep drejtimin për te pleqësitë! Më shpjego drejtimin për te FJALA!

Më përgjigjet atëherë Zoti i Nëntës - ARDALI:

- Në mes të drejtqëndrimit (ekuilibrit), ti do të gjesh rrugën. Ke pa se FJALA vjen nga KAOSI? Nuk e ke pa se DRITA vjen nga FLAKA? Kërkoje te jeta jote këtë drejtpeshim! Drejtpeshoje dhe sistemoje jetën tënde! Përmbaje të gjithë Rrëmujën e emocioneve dhe ti do të arrish drejtqëndrimin në jetën tënde. Rregulli i ardhur nga Rrëmuja të dërgon FJALËN nga BURIMI, vullnetin e fuqisë së Ciklit dhe i jep shpirtit tënd

një forcë që shpërndahet lirisht nëpërmjet të gjitha kohërave, një Diell i përkryer që del nga BURIMI. Unë dëgjova Zërin dhe e falenderova me sinqeritet nga fundi i zemrës time për këto fjalë.
Gjithmonë kisha kërkuar Rregullin që të kisha mundur të krijoja me FJALËN. Dije se kushdo që arrin te kjo gjë duhet përherë të jetë në drejtpeshim, edhe pse ky drejtpeshim nuk ka qenë kurrë e asnjëherë nuk mund të jetë. Merri këto fjalë, o njeri, lëri që ato të jenë si një pjesë e jetës tënde! Kërko ta arrish e ta përvetësosh këtë drejtpeshim e do të jesh Një me Diellin. Kërko të jesh vetëm Dritë. Çoje pikërisht mendimin tënd drejt bashkimit të Dritës me trupin njerëzor! Kujtohu që e gjitha është Rregulli që vjen nga Rrëmuja e që shpërthen nëpër Dritë.

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën IX -

Pjesa e parë e pllakave përbëhet nga rregulli për të ndjekë **Dritën**, në vend të **Errsirës,** në mënyrë që të mund të realizohet **Bashkimi** i të gjitha gjërave. Komanda drejtuese thotë që të kërkosh dituritë dhe të mos lejosh që materja të të tërheqë, sepse vetëm dituritë krijojnë mirëkuptimin. Deri në kohën kur shkruante **Thoti**, dituritë e brezave të lashtë kishin filluar të harroheshin nga popujt që rridhnin nga tributë e pazhvilluara që **AI** i takoi pasi braktisi **Atlantidën** e përmbytur. Njeriu bën pjesë në esencë të ndërgjegjes, por kjo njohuri ka qenë harruar nga njerëzimi. **Thoti,** gjatë projektimit të ndërgjegjes, e kupton se pikërisht ndërgjegjja është realiteti i fundit dhe që trupi është zinxhiri që e lidh njeriun me botën fizike. Me eksperiencën e arritur në projektimin e ndërgjegjes, përfshihen harqet dhe skajet e kufirit të hapësirës. **Thoti** fillon të tregojë disa Ligje që u ishin mbajtë sekret njerëzve të kohës së tij, ashtu siç janë edhe sot. Ajo që duket se është plotësim i të gjitha gjërave është vetëm sipërfaqja e zbukuruar, një pjesë e të çmueshmes, që është e vërteta. Materja është shumë e rrjedhshme për tu shkatërruar rregullisht dhe pastaj për tu rikrijuar në bashkime të reja. Në hapësirat e tjera të përshkruara këtu, janë botët më vete, hapësirat e bredshme të Dimensionit të Katërt dhe të dimensioneve të tjera.

Frekuenca e numrit **naëntë** konsiderohet numër që përmban **Nëntë Zotërinjve të Cikleve,** edhe pse po flitet vetëm për të **Shtatët**. **Nëntë** janë **zotërinjtë e këtij cikli kozmik dhe të ciklit më të poshtëm.** Hapësirë-koha përmban edhe këto të fshehta që fshihen prapa hapësirës spirale. Ngaqë në çdo pjesë të çdo gjëje ndodhet dituria, kjo don të thotë se

ndodhet edhe në dimensionet e tjera të shkuara të materie-kohës. Kalimi nëpër kate të tjera mund të hapet vetëm nëpërmjet njeriut. Rrethi tregon mbarimin e hapësirës së kanalit të forcës, që kalon nëpërmjet qendrës së trupit. **Verbo (Folja)** është vibracioni që liron fuqinë. Vetëm kështu mund të realizohet me të vërtetë jeta. Njeriu nuk është material, edhe pse ngjan. Është **Dritë** që del nga **Burimi i Pafund**, që paraqitet si gjë materiale. Edhe materialiteti është vetëm gjë që ngjan, sepse edhe kjo transformohet në **dritë.**

Thoti kërkon sa më shumë dituri, që t'ia shtojë diturisë që ka. **Thoti** shkon te **Salla e Amentit** dhe i pyet **Zotërinjtë:** - Ku është "**E dhëna"? Zotëriu i Nëntës** e komandon të lirojë veten nga trupi, se vetëm me shpirtin mund t'i përgjigjej pyetjes. **Thoti** lirohet nga trupi dhe është i projektuar te thellësia, në të vertetë në thellësinë më të madhe, dhe aty shikon realizimin e **rregullit** nga **kaosi**. **Zotëriu i Nëntës** e ka harmonizuar për disa kohë me fluksin **Yarkima** dhe mund të shikojë në **I.Yob** në **Arech**, dhe të shikojë me vëmendje krijimin dhe konfiguracionin e një **Diturie Kozmike.** Na thotë që **Verbo** është **Rregulli**, që ndryshon çdo çrregullim në pamjen e vet. **Jeta** në njeriun është një paraqitje e **Rregullit,** kështuqë dhe çelës për **Verbo.** Nëqoftëse kuptoni plotësisht kalimin, keni në dorë çelësin e **Botës së Humbur.**

Jeta është shprehje e **Rregullit,** që fillon nga flaka universale e **Prurësit të Flakës**. Pastaj na thotë që **Verbo** është **Rregull** dhe **Harmoni**. Rruga për në **Verbo** gjendet duke gjetë rregull në jetë dhe duke eliminuar **Kaosin.** Njeriu e ka humbë **Verbo-n,** sepse ka lënë çrregullin dhe **rrëmujën** që t'ia komandojë jetën. Çdo sforcim, çdo fitim në rrëmujë, ju çon më afër **Verbo-s.**

PLLAKA – X

ÇELËSI I KOHËS

Dëgjo, o njeri, merri pleqësitë e mia! Mësoji sekretet e thella të fshehura të hapsirës! Mësoji nga mendimet që rriten në humnerë, duke çuar Rregullin dhe Mirëkuptimin (Harmoninë) në hapësirë. Dije, o njeri, gjithçka që ekziston, ka ekzistencën e saj vetëm për shkak të LIGJIT. Njihi Ligjet dhe do jesh i lirë e nuk do jesh kurrë i lidhur nga zinxhirët e natës.

Larg, nëpërmjet hapësirash të çuditshme, unë kam udhëtuar nëpërmjet thellësive të humnerave të kohës, derisa më në fund e gjitha u zbulua. Dije se misteri është mister vetëm kur është një njohuri e panjohur akoma nga njeriu. Kur ti ta kesh mbërthyer zemrën e të gjithë mistereve, njohuritë dhe pleqësitë do të jenë me siguri tuajat! Kërko dhe mëso se te Koha është sekreti që mund t'ju lirojë nga kjo hapsirë.

Shumë gjatë unë, me anë të pleqësive kam kërkuar pleqësi, po, dhe e gjej në fund të pafundësisë, sepse e di që përgjithmonë, para meje është gjysma që unë kërkoj të arrij, që më largohet prapa.

Deri dhe Zotërat e Cikleve e dijnë se nuk kanë arritë akoma gjysmën, sepse me të gjitha pleqësitë (dituritë, aftësitë, njohuritë) e tyre, e dinë që e vërteta duhet gjithmonë të përpunohet.

Njëherë, në një kohë të kaluar, unë i fola Banorit. E pyeta për misteret e kohës dhe të hapësirës. I drejtova pyetjen që buroi nga vetja ime:

- O Mësues! Çfarë është koha?

Atëherë kështu më tha Mësuesi:

- Dije, o Thot, që në fillim ishte BOSHLLËKU (Zbraztësia) e atje ishte mosekzistenca, mungesa e kohës, mungesa e hapësirës dhe jo ekzistenca. Atje, brenda, mosekzistenca arrin një mendim vendimtar, përmbushës dhe e mbush BOSHLLËKUN. Nuk ekzistonte lënda, vetëm forca, një lëvizje, një vibracion (dridhje), një mendim i përcaktuar që mbush Boshllëkun. (Sot quhet teoria e Big-Bengut).

Unë pyes Mësuesin: Çfarë është ky Mendim i Përjetshëm?

Më përgjigjet Banori, duke më thënë:

- Në fillim ishte Mendimi i Përjetshëm, sepse që mendimi të jetë i përjetshëm, duhet të ekzistojë koha. Kështu nga brenda mendimeve të përmbushura, rritet Ligji i Kohës. Po, koha që ekziston nëpërmjet gjithë hapsirës fluturon me një lëvizje ritmike që është e përjetshme në një gjendje qëndrueshmërie. Koha nuk ndryshon, por të gjitha gjërat ndryshojnë në kohë.

Sepse koha është forca që çon në ndarje ndodhitë, çdonjëra në vendin e vet. Koha nuk është lëvizja, por ti lëviz nëpërmjet kohës, sepse ndërgjegjia jote lëviz nga një ngjarje në tjetrën. Po, brenda në kohë megjithatë, e gjitha mbi të gjitha është Ekzistenca. Dije që me të vërtetë edhe pse në kohë je i ndarë, ti je Njëshi, ekziston në çdo kohë. Kështu ndaloi zëri i Banorit dhe unë u largova për t'i peshuar gjërat. Unë e dija që në këto fjalë ishte vendosë pleqësia dhe mënyra për të zbuluar të fshehtat e kohës. Shpesh rri e mendoj fjalët e Banorit dhe kërkoj të zgjidh misteret e Kohës.

Unë zbuloj se si Koha lëviz përgjatë drejtimesh të çuditshme, edhe pse vetëm nëpërmjet ndryshimesh të

menjëhershme, mund të shpresoja të arrija të kisha çelësin që do të mund të më jepte hyrjen për te hapësirë-koha.

Zbulova se vetëm lëvizja për së larti e në mënyrë të drejtë mund të më lironte nga Koha e nga lëvizja. U ktheva prapa nga jashtë trupit tim, duke lëvizë në mënyrë që koha të më ndryshonte.

Pamje të çuditshme pashë në udhëtimin tim, shumë të fshehta që më hapën sytë. Po, unë pashë lindjen e njeriut, mësova për të kaluarën që nuk ka ndonjë të re.

Kërko, o njeri, të mësosh shtegun që të drejton nëpërmjet hapsirash që janë formuar në kohët e kaluara!

Mos harro, o njeri, se, me të gjitha zbulimet tuaja, Drita është Qëllimi që duhet të kërkosh të arrish!

Kërko dritën në shtegun tënd dhe përherë për ty gjysma do të jetë e qëndrueshme. Mos lejo kurrë që zemra jote të kthehet në drejtim të errësirës!

Lëre që shpirti yt të ndriçohet nga Drita, një Diell në shtegun tand!

Dije se trupi yt do të gjejë gjithmonë përjetësinë e ndritshme, të fshehur në dritë, asnjëherë e mbajtur nga lidhja me errësirën, përherë do të të ndriçojë si një Diell i Dritës. Po, dije, edhe pse i fshehur në errësirë, Shpirti yt është një shkëndijë e flakës së vërtetë, ekzistuese.

Të jeshë Një me Dritën më të madhe nga të gjitha! Kërko burimin, fundin e gjysmës tënde! Drita është jeta, sepse pa Dritën e Madhe asgjë nuk mund të ekzistojë. Dije se në të gjithë lëndën e krijuar, ekziston përherë zemra e Dritës. Po, deri te burgu i errësirës, ekziston Drita e brendshme.

Një herë unë po rrija drejt te Odat e Amentit dhe dëgjoja Zotin e Amentit, që thoshte me një zë që kumbonte në qetësi

fjalë të fuqishme, energjike e të kumbueshme. Ata ja morën këngës së Ciklit, me fjalë që hapën hyrjen për te Bota tjetër. Po, unë pashë portën e madhe të hapur dhe hodha vështrimin matanë vetëm një çast. Pashë lëvizjen e Ciklit, e gjërë si mendimi i Burimit ku shkova. Atëherë mësova se dhe pafundësia lëviz në drejtim të të pamendueshmit fund. Pashë që Kozmosi dhe rregulli bënin pjesë në një lëvizje që shtrihet në të gjithë hapsirën, një bashkim i Rregullit të Rregullit, që në mënyrë të njëjtë lëviz në Harmoninë e Hapsirës.

Pashë rrotullimin e Ciklit si rrathë të gjërë nëpër qiell. Dije se e gjithë kjo që ekziston, rritet për të takuar një tjetër ekzistencë me një tjetër të largët bashkë me hapsirë-kohën. Atëherë dije se ke fjalët është forca për të hapë nivele të panjoftura nga njeriu. Po, dhe deri te fjalët shtrihet i fshehur çelësi për të hapë hyrjen për te bota e sipërme dhe e poshtme.

Dëgjo tash, o njeri, fjalën që po të lë. Përdore e ti do të gjesh fuqinë në kumbimin e saj! Thuaj fjalën:

"ZIN-URU" dhe do të gjesh forcë. (Duket si fjalët shqipe në dialektin gegë: me "zie" dhe me "urue" dmth. Zin Urimi. Edhe sot përdoret kjo fjalë ke ne si dhe: Zien, valon hareja, zien nga inati, etj.). Edhe një herë duhet të kuptosh se njeriu është i dritës dhe drita është e njeriut.

Shpejt, dëgjo, o njeri, dëgjo për sekretet që shtrihen poshtë Diellit! Dije që e gjithë hapësira është e mbushur me botë brenda botëve, po, njëra te tjetra, ose të ndara nga Ligji. Një herë në kërkimet për te pleqësitë në thellësi të mëdhaja të fshehura, hap portën që ndan Ato me njeriun. Unë i thërras nga nivele të tjera të ekzistencës, njërën që ishte më e bukura gocë e njerëzve. Po, e thërras nga pjesa tjetër e hapësirës, që të rishkëlqejë si një dritë në botën e njerëzve. Unë përdor daullen

me lëkurë gjarpëri. Vishem me veshje ngjyrë ari dhe të kuqe të ndezur (purpur). Vë mbi kokë kurorën prej argjendi. Përqark meje bëj një rreth të kuq, të ndezur. Ngrej lart krahët e shqiptoj thirrjen time, që hap shtegun për te niveli i botës tjetër, thërras Zotërat e Shenjave (astrologjike) në banesën e tyre:

- Zotër të dy horizonteve, roje të portave që dridhen, drejtohuni, njëri djathtas e tjetri majtas, si yjet që agojnë nga froni i tyre dhe rregullojnë shenjat e tyre. Po, Ti, princi ezmer i ARULU-t, hapi dyert e të padukshmes, fshehe tokën dhe lëri të lirë ata që mbani të burgosur!

Dëgjoni, dëgjoni, dëgjoni Zotëra ezmerë e Zotëra të ndritshëm: nëpërmjet emrave tuaj sekretë, emra që unë i njoh e mundet t'i them, më dëgjoni e binduni dëshirës time! Ndërkohë, ndez një flakë dridhëse në rrethin tim e i bëj thirrje nga ana tjetër e hapsirës:

- Goca e Dritës, kthehu nga ARULU! Shtatë herë e shtatë herë unë kam kaluar nëpërmjet flakëve. Nuk kam ngrënë ushqim. Nuk kam pi ujë. Të kam thirrë nga ARULU për te mbretëria EKERSHEGAL.

Të thërras që të shfaqesh, Zonja e Dritës! Atëherë përballë meje u lartësuan figurat e errëta. Po, figurat e Zotërave të ARULU-t hapen përballë meje e doli përpara Zonja e Dritës. Tash Ajo ishte e lirë nga Zotërat e natës, e lirë të jetonte në Diellin e tokës, e lirë të jetonte si një gocë e vogël e Dritës. (Mund të jetë Perëndeshën e Drejtësisë dhe e Rregullit, MAT – Gruaja e Thotit).

Më dëgjoni e më besoni, o fëmijët e mi! Njohuria është e magjishme dhe është vetëm ligje. Mos kini frikë nga forca brenda jush, pasi ajo (njohuria) ndjek Ligjet si yjet në qiell. Dijeni e bëni kujdes të mos jeni pa njohuri, sepse e magjishmja

është te pleqësitë/dituritë e jo te Ligjet. Por dije se përmes njohurive tuaja do mundesh përherë t'i afrohesh më afër një vendi, afër Dritës. Dëgjo, biri im, ndiq mësimet e mia! Të jesh përherë kërkues i Dritës! Ndriço nëpër botën e njerëzve rrotull teje, një dritë në shtegun që ndriçon midis njerëzve. Ndiq dhe mëso nga magjitë e mia (mësimet e shkencës). Dije që e gjithë forca do jetë jotja, nëse ti e don. Mos kesh frikë nga shtegu, që të çon te njohuritë, më mirë shmangiu rrugës së errët! Drita është jotja, o njeri, mundet ta marrësh! Hidhi tutje lidhjet me errësirën dhe ti do jesh i lirë. Dijeni se shpirti juaj jeton me zinxhirë për shkak të frikës që ju mban si skllevër. Hapni sytë tuaj e shihni Dritën e Madhe të Diellit! Të mos kini frikë, sepse çdo gjë është e juaja. Frika është te Zotëria i errësirës - ARULU, nga ku asnjëherë nuk e keni kundërshtuar frikën për errësirën. Po, dije se frika ekziston, sepse është krijuar nga ata që janë të lidhur nga frika. Tunduni nga skllavëria juaj, o fëmijë, e shkoni te drita e lavdishme e ditës! Mos e ktheni kurrë mendimin tuaj në drejtim të errësirës dhe sigurisht do të jeni Një me Dritën! Njeriu është ai që beson se është, një vëlla i errësirës ose një fëmijë i Dritës. Ecni tash në Dritë, fëmijtë e mij! Ecni në shtegun që të drejton te Dielli!

Dëgjo tash e futi në llogari pleqësitë e mia! Përdor fjalët që të kam dhënë! Përdori dhe me siguri do gjesh forcë, pleqësi e dritë për të ecur nëpër rrugë! Kërko e do të gjesh çelësin që të kam dhënë dhe do jesh përherë biri i Dritës!

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën X -

Mendimi që u prezantua në thellësinë më të madhe ishte përshtypja e parë e lëvizjes dhe e aksionit. Pa **Ligjin** që është **Rregulli**, asgjë nuk do të ezistonte në formë. **Koha**, sekreti i madh, është çelësi për lirinë, sepse, kur njeriu fiton te koha, ka fituar edhe mbi vdekjen. E vërteta me vlerë të pafundme nuk mund të shpjegohet kurrë si e përgjithshme, sepse e drejta ka hapësirë-shtrirje të vetes dhe, kur shpjegohet në thellësi, njëra prezanton të tjera.

Thoti pyet **Banorin** mbi kohën dhe hapësirën dhe ky i flet për principin e të gjitha gjërave në zbrazëtinë e madhe. I thotë për mendimin që lind në njeriun dhe që i përgjigjet pyetjes mbi përjetësinë. **Thoti** zbulon që koha është anësore në lëvizje dhe mund të ketë faqe anësore të përkulura. Për të kaluar në kohën e kaluar, dituria duhet të lëvizë në kthesa që nisen nga "pineale": domethënë është i njëjti ushtrim i dhënë më përpara.

Thoti shkoi në thellësi të kohës dhe arriti të lëvizte përpara dhe prapa në kohë, duke vizituar gjëra të çuditshme e duke paraparë principin e njeriut. **Thoti** e shtyn akoma njeriun të kërkojë **Dritën,** sepse kjo është e vetmja mënyrë për të njohur shpirtin e vet. Është i bindur që gjithë materia është **Dritë** ose dituri dhe ekziston, edhe pse nuk është gjithmon dituri më vete.

Thoti tregon për eksperiencën e jashtëzakonshme te **Amenti,** kur **Zotërinjt** i hapën rrugën e ciklit të tyre dhe e lejuan të shihte me sytë e vet çfarë ndodhte në jetën që vjen pas vdekjes. Nga kjo, **Thoti** kupton që zhvillimi dhe **Rregulli** janë të njejtat në të gjitha ciklet kozmike dhe që çdo gjë

vazhdon në harmoni drejt të njëjtit drejtim. **Thoti** arriti të kuptojë pse ciklet kozmike shpërndahen në haësirë dhe kupton, bashkë me **Zotëriun e Nëntës**, vizatimin e kompletuar të shtrirjeve të **I.Yob** të ndryshme. Mësoi që fjalët ishin shembull i vibracioneve, që përmbanin çelësin për të hapë hapësirat dhe deri edhe ciklet.

Thoti na jep një **Fjalë** vibacioni, që është **Çelësi i Jetës.** Flet për botë të lidhura dhe për hapësira të ndara nga ajo ku jetojmë, të gjitha plot me manifestime të diturisë. Pastaj na tregon për eksperiencën e jashtëzakonshme në lirimin e një ndërgjegjësimi të Dimensionit të Gjashtë, që ishte i burgosur nga **Zotërinjtë e Arulu-t.**

Kur ishim në ciklin e kaluar, Ai kishte provuar të kalonte te ai cikël kozmik, por nuk kishte arritë dhe kishte qenë burgosë nga **Zotat e Arulu-t. Thoti**, me njohuritë e tij, hap kalimin dhe thërret këtë ndërgjegje të burgosur. U jep urdhër **Zotërinjve** që ta lironin dhe i detyron me emrat e tyre sekretë. Ai bëhet pjesë e kësaj diturie ku merrte pjesë

Thoti vërteton që njohuria është quajt magjia e injorantit, por na mëson që të mos kemi frikë nga manifestimet e ndryshme të **Ligjit.** Gjithkush mund të ketë fuqinë, po të dinte si ta përdorte, por pak kush ka njohuri për ta gjetë. Ata që kanë frikë nga e panjohura, ngjallin frykën. Të gjitha frikësimet e njerëzimit lindin nga **Zotërinjtë e Errët.** Mposhte frikën dhe do të jesh i lirë. Njeriu bashkëjeton ose me **Dritën** ose me **Errësirën,** sipas mendimit të tij.

PLLAKA XI

ÇELËSI PËR TE BOTA E SIPËRME DHE PËR TE E POSHTMJA

Dëgjoni e futini në llogari, o Bijtë e Khem-it, fjalët që po ju jap e ju çojnë te Drita! Dijeni, o njerëz, se unë i kam njohtë baballarët tuaj, po, baballarët tuaj, në një kohë shumë të kaluar. Unë kam qenë i pavdekshëm në të gjitha kohërat. Jetova midis jush qysh në fillim të fillimit të Njohurive. Jam sforcuar gjithmonë për t'u drejtuar drejt, për lart, drejt Dritës së të Madhit Shpirt. Ju drejtoja jashtë nga errësira e natës.

Dijeni, o njerëz, që ju kam përqark, se unë, THOTI, kam të gjitha njohuritë e pleqësitë e njohura nga njeriu, qysh nga kohërat më të vjetra. Kam qenë grumbulluesi i sekreteve të Rracës së Madhe, mbajtësi i çelësit që të drejton për te jeta. Të kam nxjerrë nga errësira, o njeri, edhe nga errësira e kohërave shumë të vjetra.

Tashti, dëgjoni me vëmendje fjalët e pleqësive të mia! Shpejtoni e dëgjoni fjalët që po ju jap e ju do të buroni/rilindni/delni nga errësira në dritë!

Larg/heret, në të kaluarën, kur për herë të parë u njoha me ju, unë ju gjeta te shpellat nëpër shkëmbinj. Ju lartësova me fuqinë time e me pleqësitë e mia, derisa ju shkëlqyet si njerëzit midis njerëzve.

Po, ju gjeta pa asnjë njohuri. Vetëm pak nga ju ishin disi më lart se kafshët. Ju ushqeva me shkëndijat e përgjegjshmërisë tuaj, derisa më në fund, ju shkëlqyet si njerëzit. Tash po ju flas për një njohuri shumë të vjetër mbi përmbajtjen e rracës tuaj. Dijeni, se ne të Rracës së Madhe

kishim dhe kemi njohuri superiore nga ato të njeriut. Ne transmetojmë pleqësitë e rracave të lindura nga yjet, (Atlashtët, Pellazgët,Yllirët, Shqiptarët) pleqësitë e njohuritë nga larg, matanë njerëzve. Mësuesit e pleqësive zbrisnin midish nesh, aq larg nga ne ishin Ata, sa jemi ne me ju. Dëgjoni me vëmendje tash, ndërkohë unë po ju jap pleqësitë. Përdorini e do jeni të lirë!

Dijeni se në piramidat që unë kam ndërtuar, janë çelësat që të tregojnë rrugën për tek jeta. Po, shënoni vijat e pamjes së madhe që po ndërtoj, deri në majë të piramidës, e ndërtuar si një portë. Shënoni një tjetër në anën tjetër me të njëjtin kënd e drejtim. Gërmoni aty e do të gjeni atë çfarë unë kam groposë. Aty do të gjeni hyrjen nëntokësore të sekreteve që janë fsheh para se ju nuk ishit bërë njerëz.

Tash po ju kallëzoj për ciklet që lëvizin në mënyrë të çuditshme në pafundësi, sepse pafundësia shkon matanë njohurive të njeriut. Dijeni se aty janë nëntë cikle, që lëvizin me harmoni në drejtim të pikës së bashkimit që do të ekzistojë në të ardhmen.

Dijeni se Zotërat e Ciklit janë bashkuar për përgjegjësinë e dërguar nga TË TJERËT për bashkimin e kësaj me Gjithësinë. TË TJERËT janë më lart nga përgjegjësia nga të gjithë Zotërat e Ciklit, punojnë në harmoni me Ligjet. Ata e dijnë se me kalimin e kohës Gjithësia do të jetë e përsosur, nuk do të ketë asgjë sipër e asgjë poshtë, por NJË GJITHËSI me një pafundësi të përsosur, në harmoni me GJITHËSINË, me bashkimin e GJITHËSISË.

Në thellësi, poshtë sipërfaqes së tokës, në Odat e Amentit, qëndrojnë të SHTATËT, Zotërat e Ciklit, po, dhe nji tjetër, Zotëria i Botës së Poshtme. Shpesh kam pi nga burimi i

Pleësive të Tyre dhe kam mbushë trupin dhe shpirtin tim me Dritën e Tyre. Ata më flasin, duke më treguar për Ciklet dhe Ligjet që u jep atyre arsye për të jetuar.

Më flet Zotëria i Nëntës, duke më thënë:

- O Thot, ti je i madh midis bijve të njerëzve, por ka të fshehta që ti nuk i njeh. Dije se ti ke ardhë nga një Hapësirë-Kohë përposhtë kësaj ku je dhe do të udhëtosh në drejtim të një hapësire-kohë më superiore. Dhe ti di pak për të fshehtat e tyre, di pak për pleqësitë që ekzistojnë n'atë botë. Ti e di se e gjithë dituria është vetëm një qelizë në proçesin e rritjes. Njohuria poshtë teje përhapet në mënyrë të ndryshme nga ajo që njeh ti. Po ato, edhe pse në një hapësirë-kohë të botës tjetër, rriten përherë në mënyra të ndryshme nga ato që bëjnë pjesë në shtegun e dijeve tuaja. Dije që ajo rritet për shkak të rritjes tënde, por jo në të njëjtën mënyrë që rritesh ti. Rritja që ti ke bërë dhe ke arritë deri tash, ka bërë që të jenë shkak i pasojës. Jovetëdija ndjek po atë rrugë, çdo gjë mund të jetë e përsëritshme dhe pa kuptim. Çdo vetëdije në çdo cikël ekziston për të ndjekë shtegun e tij deri në mesin e fundit. Çdonjëri reciton pjesën e vet në Planin Kozmik. Çdonjëri reciton pjesën e vet deri në fundin e përhershëm. Matanë cikleve, më e madhe është njohuria e përshtatja që të shkrihesh me Ligjin e Gjithësisë. Dije që ti, në ciklet para nesh, po punoje në një pjesë të vogël të ligjit, kurse ne, të ciklit që shtrihet deri në pafundësi, përmbajmë sforcimet për t'i bërë më të mëdha ligjet. Çdonjëri ka pjesën e vet për të recituar në cikle. Çdonjëri ka punën e vet për ta kompletuar në mënyrën e vet. Cikli para teje nuk është shumë para teje, dhe është formuar vetëm nga nevoja për të ekzistuar. Sepse dije që burimi i pleësive, që buron prapa në cikle, është përjetësisht në

kërkim të forcave të tjera për t'i thithë. Ti e di se njohuritë fitohen vetëm me praktikë, e pleqritë fitohen vetëm me njohuri e këto janë ciklet të krijuara nga Ligji. Ato janë mjete për të arritë njohuritë që duhen për të fiksuar Ligjet, që janë Burim i Gjithësisë. Cikli më i vogël, në të vërtetë nuk është më i vogël, por vetëm i ndryshëm në hapësirë e në kohë. Vetëdija atje po punon e po provon më pak gjëra në krahasim me atë ku ti ekziston.

Dije, ashtu si po punon ti ke cikli i madh, kështu dhe n'atë botë sipër janë disa që po punojnë si ti me të tjera ligje. Ndryshimi që ekziston midis cikleve është vetëm aftësia për të punuar sipas Ligjit.

(Këto vitet e fundit po zhvillohet teoria e botëve paralele. Të gjithë po kopjojnë nga Thoti).

Ne që kemi ekzistuar në ciklet e maparshëm, jemi ata më të parët që kemi dalë nga Burimi dhe në kalimin nëpërmjet hapsirë-kohës kemi fituar aftësinë për të përdorë Ligjet më të Mëdha që janë larg, matanë njohurive të njeriut. Nuk është asgjë reale n'atë botë poshtë teje, por janë vetëm shfaqje të ndryshme të Ligjit.

Nëse sheh ato botë sipër e poshtë, do të gjesh përherë të njëjtën gjë, sepse Gjithësia nuk është gjë tjetër veçse një pjesë e Njësisë/Tërësisë, që është Burimi i Ligjit. Vetëdija që është përposhtë teje bën pjesë edhe te vetja jote, ashtu si dhe ne jemi pjesë te e jotja. Po, si një fëmijë pa njohuri që vjen te ti kur je bërë burrë. Krahaso ciklin e njeriut në udhëtimin e tij nga lindja deri në vdekje e shih në ciklin e përposhtëm fëmijën me njohurinë e tij me kohën që i kalon. Na shih edhe Ne, fëmijë të rritur në njohuri e me pleqësi që i kemi arritë me kalimin e viteve.

Kështu, o THOT, janë dhe ciklet e vetëdijes, fëmijë në periudha të ndryshme të rritjes, kështuqë e gjitha vjen nga i Vetmi Burim, që është pleqësia dhe të gjitha te pleqësitë kthehen.

Ai pushon së foluri e qëndron në një heshtje që vjen nga Zotat. Atëherë më flet akoma, duke më thënë:

- O Thot, për shumë kohë kemi qëndruar te Amenti, duke parë Flakën e Jetës nëpër Odat dhe dije që Ne jemi akoma pjesë e ciklit tonë, me Pamjen tonë që shpërndahet te Zotërat e n'atë botë. Po dije, se mbi të gjitha, asgjë tjetër Atyre nuk u intereson, përveç se rritja që mund të fitojmë për shpirtin tonë.

E dijmë që trupi është nji udhëtar. Gjërat që njerëzit i vlerësojnë si të mëdhaja, për ne janë asgjë. Gjërat që ne kërkojmë nuk bëjnë pjesë te trupi, por janë vetëm qenie e përkryer e shpirtit tonë. Kur ti si njeri të mundesh të mësosh që në fund asgjë nuk merret parasysh, veçse zhvillimi i shpirtit, atëherë ti me të vërtetë do të jesh i lirë nga do lidhje, i lirë të punosh në harmoni me ligjet, që ti të mundesh të thithësh përsosmërinë, sepse vetëm ajo të bën që të arrish te gjysma. Duhet të dish se asgjë nuk është e përkryer, gjithashtu ti mund të jesh thithja jote dhe gjysma jote.

Ndalon zëri i Nëntës dhe fjalët e tij u fundosën te ndërgjegjia ime. Tash unë po kërkoj akoma më shumë pleqësi/dituri, derisa të mund të jemë i përkryer në Ligjet e Gjithësisë. Me të shpejtë, zbres në Odat e Amentit për të jetuar në të ftoftën Lule të Jetës. Ju, që unë ju kam mësuar, nuk do më shihni më, sepse unë do të rroj përherë te pleqësitë që kam mësuar. Njeriu është njeri për shkak të pleqësive. Çdo gjë që do të jetë, do të jetë për shkak të kësaj gjëje.

Dëgjoni tash zërin tim dhe do të bëheni më të mëdhenj se njerëzit e zakonshëm. Drejtoni sytë tuaj në drejtim për së larti, leni Dritën që të mbushë veten tuaj! Të jeni gjithnjë fëmijët e Dritës. Vetëm me mundime mund të rriteni për te e sipërmja, në nivelin ku Drita është Një me Gjithësinë. Të jeni mësuesit e gjithçkaje që ju rrethon! Të mos jeni asnjëherë të kontrolluar nga pasojat e jetës tuaj, prandaj krijoni qëllime gjithnjë më të përsosura e me kalimin e kohës do të jeni Diell i Dritës!

Lirohuni, lëreni që shpirti juaj të lartësohet gjithnjë për së larti, i lirë nga zinxhirët e nga lidhjet me natën! Ktheni sytë te Dielli në hapësirë. Quajeni atë një simbol të jetës!
Dije, që ti je Drita më e Madhe, e përkryer te sfera jote, kur ti të jesh i lirë!

Mos shih brenda në errësirë! Ktheji sytë tuaj në hapsirën sipër!

Lëre që flaka jote të ngjiet e lirë e ti do të jeshë një fëmijë i Dritës!

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën XI -

Thoti u përshkruan njerëzve të kohës së tij për kohën kur paraardhësit e tyre e njohën dhe vetëm kjo duhet tu mjafojë atyre për të kuptuar fuqinë e tij. U tregon atyre që ka qenë mbrojtësi i mistereve në kohët e kaluara dhe që i ka drejtuar, kur ishin të egër, kah **Drita.** Ai thotë që do na tregojë disa nga gjërat e paditura më të vjetra, që i janë thënë, bashkë me paraardhësit, nga **Fëmijët e Dritës** dhe **Zotërinjtë e Ciklit.**

Thoti shpjegon si mundet të gjendet një rrugë për te **Odat e Amentit**. Duke vizatuar një vizë me kënd gjeometrik nga **Sfinga,** mund të gjendet çelësi për të hap Dhomën e shenjtë poshtë Piramidës. **Ciklet** që tregon **Thoti** janë cikle kozmike nga ana pozitive të këtij **Arech,** deri në anën negative, në drejtimin që jemi duke u zhvendosur. Ana negative e kësaj dhe ana pozitive e tjetrës kanë katërmëdhjetë cikle kozmike për çdo anë. **Zotërinjtë e Cikleve** u takojnë **Gjithësisë Qendrore** të çdo **Diturie Kozmike.** Njohin përsosmërinë përfundimtare të çdo gjëje. Për herë të parë **Thoti** flet për **Zotëriun e Poshtëm,** me fjalë të tjera, që bën pjesë te cikli kozmik i mëposhtëm. Kjo do të thotë se **Diturinë Kozmike** ka kush e prezanton në të gjitha ciklet kozmike. **Zotëriu i Nëntës** i thotë **Thotit** që është i madh dhe i përparuar në dituritë kozmike, por që akoma ka gjëra të paditura që ai ende nuk i ka mësuar. **Thoti** është i ditur, por të fshehtat në çdo **Dituri Kozmike** janë gjëra që nuk do t'i mësojë plotësisht, derisa çdo gjë të bëhet **NJË.** Përhapja e çdo diturie është e ndryshme, sepse çdo dituri përmban një pjesë të ndryshme të planit të pafund. Çdo pjesë kompleton tjetrën, kështuqë rritja e njërës ndërhyn te tjetra në mënyrë reciproke. Çdo dituri është e

rëndësishme si të tjerat, edhe pse ka disa që bëjnë punë më të rëndësishme. Në të vërtetë, nuk ka realisht lart dhe poshtë, sepse këto janë fjalë krahasuese.

Dituritë Kozmike janë instrumentet që **Prurësit e Flakës,** përdorin për të shndërruar **Rrëmujën** dhe **Kaosin** në **Rregull** dhe në **Ligj.** Të gjitha këto punojnë në hapësirën e tyre duke bërë punët që duhen. Edhe cikli kozmik i mëposhtëm është i rëndësishëm për planin e lartë, dhe për atë më të lartin. Ciklet kozmike superiore janë vetëm për fuqi të madhe. Të gjitha **Dituritë Kozmike,** në fund të fundit, janë **Një,** ashtu si të gjitha Shpirtërat janë **Një** në **Diturinë Kozmike**. Diferencat e kapacitetit të diturive kozmike, më lart dhe më poshtë, krahasohen me djalin e ri dhe burrin e pjekur. **Thotit** i prezantohet shembulli i një mikrokozmosi dhe i një makrokozmosi: **si lart, si poshtë. Zotërinjtë,** edhe pse manifestohen te **Amenti**, janë të lidhur dhe janë pjesë e të njëjtit cikël kozmik. Prezenca e tyre në ciklet kozmike duhet për të ndihmuar rritjen e shpirtit të njerëzve dhe duke u dhënë **Dituritë Kozmike,** këshuqë mund të venë bazën e cilësisë së rrëmujës së lejuar, që mund të rrjedhë nga çdo cikël kozmik. Pika e arritjes nuk do të jetë kurrë e përsosur, edhe pse ne duhet të kuptojmë që vlerësimi i përsosmërisë ulet në proporcionin direkt me rritjen tonë. Ajo që sot ngjan e përsosur, nesër nuk do të jetë më e tillë, sepse ne dijmë që përsosmëria nuk do jetë kurrë e realizuar as nga **Prurësit e Flakës. Thoti** përsërit që do të shkojë te **Amenti,** do të jetojë me **Ata** në të vërtetat që ka mësuar. **Thoti** jep urdhër për të provuar me të gjitha mënyrat për tu bërë një me **Dritën. Thoti** e mbaron pllakën me urdhërin për të ngritur sytë te **Dielli** dhe për tu liruar nga **Errësira.**

PLLAKA – XII

ÇELËSAT E PROFECISË

Dëgjo me vëmendje, o njeri, fjalët e pleqësive/diturive të mia, dëgjo me vëmendje zërin e Thot Atlantideut!

Unë kam zotëruar ligjet e Hapsirë-Kohës, kam fituar njohuritë për të ardhmen e kohës. E di që njeriu në kalimin nëpërmjet hapsirë-kohës mund të jetë Një me Gjithësinë. Dije, o njeri, se e gjithë e ardhmja është një libër i hapur për ata që dinë ta lexojnë.

Të gjitha pasojat arrijnë nga shkaqet e tyre, ashtu si të gjitha pasojat arrijnë nga Shkaku i Parë. Dije se e ardhmja nuk është e shtangun apo e qëndrueshme, por ndryshon, ashtu si dhe shkaqet krijojnë pasojat. Shihe pasojën që të drejton për të qenë (ekzistuar) dhe me siguri sheh që e gjitha është një pasojë. Kështu, o njeri, të jesh i qartë se në pasoja që kanë ndodhë janë përherë shkaqet gjithnjë e më të përsosura. Dije se e ardhmja nuk është e fiksuar, por gjithmonë është rrjedhojë të dëshirës së lirë të njerëzve, nga çasti kur lëviz nëpërmjet lëvizjes së hapsirë-kohës në drejtim të qëllimit të fundit ku fillon koha e re. Njeri, mund ta lexosh të ardhmen vetëm nëpërmjet shkaqeve që krijojnë pasojat. Kërko brenda pasojave dhe me siguri do të gjesh shkaqet! (Teoria e shkak-pasojës përdoret sot në shkencat shoqërore).

Dëgjo me vëmendje, o njeri, ndërsa unë flas për të ardhmen, flas për shkaqet që ndjekin pasojat! Dije se njeriu në udhëtimin e tij të ndritshëm kërkon përherë që t'i largohet natës që e rrethon, si hijet që rrethojnë yjet e qiellit dhe si yjet e hapsirës ato shndrisin nga hijet e natës. Destinacioni i drejton

përherë përpara, derisa të jenë një me Dritën. Po, edhe pse rruga e tij është midis hijeve, brenda te ai shkëlqen përherë Drita e Madhe, edhe pse rruga është e errët, megjithatë ai do t'i zotërojë hijet që do fluturojnë përqark tij porsi nata.

Larg, në të ardhmen, unë shoh njerëzit si të lindur nga Drita, të lirë nga errësira që i lidh Shpirtin, që jetojnë në Dritë pa lojën e errësirës që don të fshehë Dritën, që është drita e Shpirtit të tyre.

Dije, o njeri, se para se ti të arrish këtë gjë, shumë hije të zeza do bien sipër dritës tënde, duke u munduar ta shuajnë me hijet e natës, dritën e Shpirtit që stërmundohet për t'u liruar. E madhe është lufta midis Dritës dhe Errësirës, shumë e vjetër dhe përherë e re. Gjithashtu e dij që në një kohë, në një të ardhme të largët, e gjitha do të jetë Dritë dhe errësira do të bjerë.

Dëgjo me vëmendje, o njeri, fjalët e mia të pleqësvie! Përgatitu dhe nuk do të jesh i pranguar nga errësira! Njeriu ka lindur e është rritë dhe si përherë ka mbaruar, kur valë të reja përgjegjësie burojnë nga humnera e madhe poshtë nesh, në drejtim të Diellit, të mesit të vet. Po, bijtë e mij, jeni rritë nga një gjendje që ishte pak më e lartë se ajo e kafshëve, derisa tash ju jeni nga më të mëdhenjtë midis njerëzve, por më parë ishin të tjerë më të mëdhenj se ju dhe, siç ju kam treguar, si të tjerët më parë edhe ata kanë mbaruar. Kështu edhe ju do të mbaroni, sipër, te toka ku unë tash po ju mësoj, do banojnë barbarët dhe do bëjnë të perëndojë Drita. Pleqësitë e vjetra do të harrohen, edhe pse ajo do të jetojë, gjithmonë e fshehur nga njerëzit.

Po, në tokën që quhej Khem, raca do të lindin e rraca do të mbarojnë. Ju do të jeni harruar nga bijtë e njerëzve,

megjithatë ju do të keni lëvizë në drejtim të një hapësire yjore të një bote tjetër, të ndryshme nga ajo që po lini pas shpine dhe vendin ku keni banuar. Shpirti i njeriut lëviz përherë para, i pa lidhur me asnjë yll, duke lëvizë përherë në drejtim të Qendrës së Madhe që ka përpara, ku ai është shpërdarë në Dritën e Gjithësisë. Dije, që do shkoni para gjithmonë, të lëvizur nga Ligjet e shkak-pasojës, derisa më në fund, si njëra ashtu dhe tjetra do bëhen Një.

Po, njeri, mbasi të kesh mbaruar, të tjerë do lëvizin në hapësirat ku jetoje ti. Njohuritë e pleqësitë do të jenë harruar të gjitha. Ashtu siç jam unë si një Zot për ju, ashtu dhe ju do jeni Zotat e të ardhshmes për shkak të njohurive tuaja, për brezat e tjerë që do vijnë. Brezat që do vijnë do të shohin të burojnë pleqësitë nga ata që ju i keni lënë trashëgim në këtë vend të këtij planeti. Ata do të kthehen te pleqësitë tuaja dhe të mësojnë t'i zhysin hijet në një banjë Drite. Duhet të mundohen shumë ata që do vijnë për të fituar nëpër të gjithë brezat e tyre, për të fituar lirinë e Dritës. Do të fillojë midis njerëzve luftë e madhe që do bëjë të dridhet toka e do t'i ndryshojë drejtimin. Po. Atëherë bijtë e hijeve do hapin armiqësinë midis Ditës dhe Natës. Kur njerëzit do t'i rizotërojnë tokën e oqeanet dhe të fluturojnë në ajër me krahë si zogjtë, kur njeriu të ketë mësuar ta ndriçojë dritën, atëherë do fillojë koha e luftës. E madhe do të jetë lufta mes forcave, e madhe do jetë lufta midis Errësirës dhe Dritës. Popuj do të ngrejnë krye kundër popujve të tjerë, duke përdorë forca të errta për të pushtuar Tokën. Armë të fuqishme do i thajnë (avullojnë) njerëzit nga toka, derisa gjysma e racës njerëzore të jetë zhdukë.

Ndërkohë mbrrijnë Bijtë e Mëngjesit dhe ua shpallin deklaratën e tyre njerëzve duke u thënë:

- O njerëz, ndaloni luftën kundër vllezërve tuaj! Vetëm kështu ju mund të shkoni te Drita! Ndaleni mosbesimin, vllezërit e mi, ndiqni shtegun e dritës dhe mësoni të gjeni se ku është e drejta! Atëherë njerëzit do ndërpresin luftën e vllaut kundër vllaut dhe babës kundër fëmijve. Atëherë do të burojë/rilindë shumë e vjetra shtëpia e popullit tim, në vendin e vet, poshtë dallgëve të detërave.

N'atë kohë do të krijohet Era e Dritës dhe të gjithë njerëzit do kërkojnë mesin e Dritës. Atëherë Vllazëria e Dritës do të mbretërojë ndër popuj. Do të jetë shpërnda errësira e natës. Po, bijt e njerëzve zhvillohen e shkojnë para e në drejtim për së larti, në drejtim të Qendrës së Madhe. Ata do të bahen Fëmijët e Dritës. Shpirtërat e tyre do të jenë përherë, sepse po afron flaka e përjetshme, burim i të gjitha pleqësive, vendi i fillimit, që megjithatë është **NJISHI** (Zoti, Perëndia, Allahu…) me fillimin e çdo gjëje. Po, në një kohë që akoma nuk ka lindur e do të lindë, **Njëshi do jetë Gjithësia dhe Gjithësia do jetë bërë Një**. Njeriu, një flakë e përsosur e këtij Kozmosi, do lëvizë përpara, në drejtim të një vendi te yjet. Po, po, do të lëvizë drejt e jashtë nga kjo hapsirë-kohë, në një tjetër botë, matanë yjeve.

Për një kohë të gjatë më keni dëgjuar, o fëmijtë e mi, për një kohë të gjatë keni dëgjuar pleqësitë e Thotit. Tash po largohem nga ju në errësirë. Tash po shkoj te Odat e Amentit, për të banuar aty edhe në të ardhmen, kur drita të kthehet midis njerëzve. Dijeni, se shpirti im do të jetë përherë me ju, për të drejtuar hapat tuaj në shtegun e dritës. Ruani sekretet që po ju lë dhe me siguri shpirti im do të ju ruajë gjatë jetës! I

mbani përherë sytë tuaj te shtegu i pleqësive, mbajeni përherë dritën si gjysmën tuaj! Mos lini që shpirti juaj të mbërthehet nga skllavëria e errësirës/paditurisë, lëreni që ajo të fluturojë lart në drejtim të yjeve!

Tash po nisem për të banuar te Amenti. Ju do të jeni fëmijët e mi në këtë jetë e në tjetrën. Në kohën që do vij këtu, edhe ju do të jeni të pavdekshëm, duke jetur nga një erë në tjetrën erë, si një Dritë midis njerëzve. Ruani hyrjen e Odave të Amentit! Ruani sekretet që kam fshehur midis jush! Mos lini që pelqësitë të hidhen tutje nga barbarët! Po i mbaj fshehur e po i ruaj për ata që kërkojnë Dritën. Do të merrni bekimin tim. Merrni rrugën time dhe ndiqni rrugën! Përziheni shpirtin tuaj me Esencën e Madhe! Lëreni që përgjegjësia të jetë Një me Dritën e Madhe! Më thirrni kur të kini nevojë! Përdorni emrin tim tri herë me vargun: THOT, CHEQUETET (kequetet, ose keqetet), ARELICH (arelik) VOLMATLITES. (Po mundohem t'i jap shpjegimin, sipas meje: TË KEQET, AR E IK ose AR E LIK, ku E LIK në shqip ka kuptimin: e dobëson ose e keqëson, VEZ (VO) E MALIT ESHT.)

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën XII -

Thoti ka fituar mbi kohën, kështu që e ka kompletuar ndjesinë e **Ligjit** të *shkakut* dhe *pasojës*. Arriti të futet te e shkuara dhe te pasoja e shkakut dhe të kuptojë që asgjë nuk ndodh pa kuptim dhe se e ardhmja nuk është e vendosur nga fati, por arrihet nëpërmjet **Ligjit** të pasojës (efektit), që rezulton nga shkaqet që përmban. Nga shkaku i parë deri në hapësirë-shtrirjen më të largët, të gjitha gjërat duhet të lëvizin vetëm sipas këtij **Ligji.** Duke e ditë këtë, njeriu duhet të bëjë kujdes te shkaku që krijon.

Thoti fillon të flasë për të ardhmen sipas shkakut që ka. Fati i njeriut është kombinimi final me **Dritën**, edhe pse lëviz nëpër **Errësirë** gjatë mishërimit material. Kur flet për të ardhmen e të **Lindurve të Dritës**, flet për **Qiellin e Shtatë.** Dhe flet edhe për **Kaosin** që do të vijë më përpara, edhe pse më në fund **Drita** do të fitojë mbi errësirën. Në kohët e kaluara njeriu ishte zhvilluar dhe kishte arritë më afër me gjendjen **Diellore.** Ajo që ka ndodhë më parë do të ndodhë përsëri. Ata me të cilët ka folë **Thoti** do të mbijetojnë dhe do të vdesin. Vendi i tyre do të merret nga një tjetër rreth diturie, që do vijë nga një planet i mëposhtëm. Rracat antike do të harrohen me kalimin e kohës dhe ata që komandojnë do të bahen **Zotërinjtë** për ata që do të vijnë më pas. Kështu ndodhi me **Osirisin, Horusin dhe Isidën.** Shpirti i njeriut do të rrijë në këtë planet deri sa të marrë gradën e parë të ndriçimit, pastaj do të kalojë te **Afërdita** dhe më pas te **Mërkuri,** e ma në fund ke **Dielli,** ku do bëhet një me **Diturinë Kozmike.**

Pasi rraca antike iku, njohuria që patën u harrua nga njeriu, përveç atyre që e mbronin. Lufta antike do të vazhdojë:

Njeriu lufton përherë për të marrë përsëri atë që ka humbur. Ka disa që gjenden në rrëmujë të madhe, që do të luftojnë për të kthyer prapa të tjerët, por **Drita** duhet të pushtojë errësirën, **Rregulli** duhet të fitojë mbi **Rrëmujën**, edhe pse **Toka** do të dridhet prej luftës. Sipas profecisë, koha në të cilën do të ndodhin të gjitha këto, është kjo e sotmja. Profecia në këtë faqe është kaq e qartë, sa që s'ka nevojë për koment, sepse po futemi tani në periudhën që po flasim. Ma në fund **Drita** do të mbretërojë dhe njeriu do të bahet **Një** me **Diturinë**, e gjitha mbisunduese, dhe do të kalojë si **Njëshi** në një cikël kozmik më të lartë.

Thoti bëhet gati për të lënë **Tokën e jashtme,** për tu kthyer te **Amenti,** duke vënë trupin e tij poshtë **Lules së Jetës,** ndërsa shpirti i tij do shkojë në një vend tjetër. Premton që do të kthehet kur njeriu të niset në drejtim për te **Drita.** U rekomandon atyre që të mbrojnë sekretet që i ka thënë, e në veçanti, hyrjen për te **"Oda e Amentit".** Se sa mirë janë mbrojtë këto sekrete, është e dëshmuar nga fakti që janë edhe sot të mbrojtura.

PLLAKA – XIII

ÇELSËSI I JETËS DHE I VDEKJES

Dëgjo me vëmendje, o njeri, dëgjo pleqësitë e mia! Dëgjo fjalët që të mbushin me jetë! Dëgjo fjalët që shpërndajnë errësirën. Dëgjo Zërin që shpërndan natën. U kam sjellë mistere e pelqësi fëmijëve të mi: njohuri e fuqi të sjellura nga kohët shumë të vjetra. Nuk e dinë që e gjitha do dalë në dritë kur ti të jesh i bashkuar me Gjithësinë? Ti do jeshë Një me Mësuesit e Misterit, Zotëruesit (fitimtarët) e Vdekjes dhe Mësuesit e Jetës.

Po, ti njeh lulen e jetës, o njeri, zhvillimin e jetës që shkëlqen ke Odat. Nëpërmjet shpirtit zbulon këto Odat e Amentit e don t'i çosh prapat pleqësitë që jetonin në dritë. Dije se hyrja për te fuqitë është sekrete. **Dije se e hyrja për te jeta kalon nëpërmjet vdekjes, por nji vdekje që është jetë - flakë e dritës.** Ke dëshirë t'i njohësh të fshehtat e fshehura shumë thellë? Shih te zemra jote ku njohuritë janë fshehur! Dije se sekretet janë fshehur brenda te ti. Burimi i gjithë jetës është dhe burimi i gjithë vdekjes.

Dëgjo me vëmendje, o njeri, ndërkohë që unë të tregoj sekretin, të zbuloj sekretin e vjetër. Shumë poshtë, thellë në zemër të tokës, është vendosë nji lule, burim i jetës, që i ka ndrye të gjitha në formën e tyre. Dije se Toka jeton në një trup, ashtu si ti jeton me formën e trupit që ke. Lulja e Jetës ka, ashtu si ti, një vend për shpirtin dhe rrjedh nëpërmjet Tokës, pikërisht ashtu si shpirti yt rrjedh nëpërmjet formës së trupit tënd. Ajo i jep jetë Tokës dhe bijve të saj, duke rinovuar shpirtin nga nji formë në tjetrën.

Ky është shpirti që i ka dhënë trupit tënd formën, të përfunduar e të formuar brenda formës tënde. Dije o njeri, se forma jote është e dyfishtë, e barazpeshuar në këtë dyfishim gjatë formimit të saj. Dije dhe këtë: kur ti i afrohesh me të shpejtë vdekjes, ndodh vetëm sepse ky drejtpeshim është prishë, ndodh sepse një pol ka humbë.

Dije se sekreti në jetën te Odat e Amentit është aftësia për t'i rregulluar këta polaritete. Çdo gjë që është krijuar dhe ekziston, ka formën e jetës për shkak të Shpirtit të jetës në dy polet e tyre. Nuk sheh se në zemër të tokës është ekuilibri i të gjitha gjërave që ekzistojnë dhe do të ekzistojnë në sipërfaqe? Burimi/lindja/formimi i shpirtit tënd është përpunuar nga zemra e Tokës, sepse në formën tënde ti je një me Tokën. Kur ti të kesh mësuar të kontrollosh drejtpeshimin tënd, atëherë mund të përshtatesh me drejtpeshimin e Tokës. Ti do të jetosh në këtë formë derisa Toka do të jetojë. Një ndryshim në formë do të ndodhë vetëm nëse Toka do të ndryshojë formë. Mos e shijo vdekjen, po njësohu me këtë planetë, duke mbajtë formën tënde, ndërsa koha po kalon.

Dëgjo me vëmendje, o njeri, ndërkohë unë të jap sekretet kështu edhe ti nuk do të kujtohesh për ndryshimin:

Shtrihu për një orë në ditë me kokën e kthyer në drejtim të Polit Pozitiv (Veriut). Një orë tjetër në ditë ktheje kokën në drejtim të Polit Negativ (Jug). Kur koka jote është kthyer në drejtim të Veriut, çoji mendimet tuaja nga krahrori në drejtim të kokës! Ndërsa kur koka jote të jetë kthyer nga Jugu, çoji mendimet tuaja nga krahrori te këmbët! Të çuara në drejtpeshim një herë në çdo shtatë ditë, dhe drejtpeshimi yt do të mbajë të gjithë forcën. Po, nëse ti je i vjetër, trupi yt do të freskohet e do të bëhet si i ri. Kjo është e fshehta e Mësuesve,

nga ku ata mbajnë dorën e vdekjes. Mos e len pas dore ndjekjen e kësaj që të tregova, sepse kur ti të kesh kaluar mbi njëqind vjet, ndjekja e kësaj do të thotë se vdekja po të afrohet. Dëgjo fjalët e mia dhe ndiq shtegun tim! Përvetësoje ekuilibrin tënd dhe jetoje jetën.

Më dëgjo, o njeri, dhe futi në llogari fjalët e mia!

Dëgjo me vëmendje pleqësitë që po të jap për vdekjen!

Kur të jesh në fund të punës (jetës), që t'u ka shënuar, ti mund të dëshirosh të ikësh nga kjo jetë, për të kaluar në nivelin ku jetojnë Bijtë e Mëngjesit që ekzistojnë si Fëmijët e Dritës. Kalo pa dhimbje dhe kalo pa mërzitje në nivelet ku është Drita e Përjetshme. Në fillim, shtrihu në qetësi me kokën të drejtuar nga lind Dielli! Përthyej (gërshetoi) duart mbi Burimin e jetës tënde (mbi krahror)! Vëre ndërgjegjen tënde te vendi i jetës! Rrotulloje e ndaje ndërgjegjen në dy pjesë: për në veri e për në jug. Njërën pjesë mendoje në drejtim të veriut, tjetrën në drejtim të jugut. Qetësohu dhe kaloje (braktise) sipër ekzistencën tënde! Përpara dy pjesëve të drejtuara në veri e në jug, shkëndija jote e argjendtë fluturon para në botën sipër Diellit të mëngjesit, e zhytur në dritë, e bërë Një me Burimin e do të ndriçojë derisa t'i plotësohet dëshira. Do të ndizet përsëri dëshira për të qenë i krijuar, atëherë do të kthehesh në një vend e me një formë. (Rilindja, reinkarnimi, rimishërimi… Kjo gjë pranohet e predikohet nga budistët).

Dije, o njeri, se në këtë mënyrë do të mbikalosh Shpirtin e Madh, duke ndryshuar me dëshirë nga jeta në jetë. Në këtë mënyrë mbikalohet përherë mbi AVATAR, i gatshëm për të vdekë, ashtu siç mund të keshë dëshirë për jetën tënde!

Dëgjo me vëmendje, o njeri, e pi (mëso) nga pleqësitë (dituritë) e mia:

- Mëso të fshehtën që është e Mësuesit të Kohës! Mëso se si ata që ti i quan Mësues, janë të aftë të kujtojnë jetët e kaluara. I madh është sekreti, por edhe i lehtë për t'u përvetësuar, po të të jepet kontrolli i kohës. Kur vdekja të të afrohet me të shpejtë, nuk duhet të kesh frikë, dije që ti je pronar i vdekjes.

Qetësoje trupin tënd, mos u sill i tensionuar!

Vëre në zemrën tënde flakën e Shpirtit tënd!

Atëherë largohu me të shpejtë nga vetja jote e vendosur te trekëndëshi!

Ndalo për një çast, pastaj lëviz në drejtim të gjysmës! Kjo, gjysma jote, është vendi midis vetullave, vendi ku duhet të fluturojë kujtesa e jetës.

Mbaje flakën tënde këtu, brenda trurit tënd, para se dora e vdekjes ta mbërthejë shpirtin tënd!

Atëherë, kur ti sapo ke kaluar gjendjen e ndërmjetme (transit – midis jetës dhe vdekjes), me siguri do të të vijë dhe kujtesa e jetës.

Atëherë e kaluara do të jetë Një me atë që po rijeton.

Atëherë do të kesh fituar kujtesën për gjithçka.

Ti do të jesh i lirë nga të gjithë ndërlikimet.

Gjërat e së kaluarës do t'i jetosh në të tashmen!

- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën XIII -

Thoti ka premtuar që do të na mësojë sekretin e **Lules së Jetës.** Kur të arrihet bashkimi, duhet të shkohet te **Amenti. Lulja e Jetës** është **Gërshetimi Diellor** i **Tokës.** Nga kjo pikë Shpirti rrjedh, duke mbajtë **Tokën** në formë. Ashtu si te **Toka,** i njëjti Shpirt është te njeriu, vetëm se ndryshon në masë. Njeriu është i dyfishtë në polaritetin e tij: kur një pol humb drejtpeshimin, ekuilibri i trupit prishet dhe vijnë sëmundjet dhe vdekja. Ekuilibri i përsosur në polaritet eliminon sëmundjen dhe vdekjen. **Lulja e Jetës** ka një efekt ekuilibrues mbi polaritetin e trupit, duke e mbajtë atë në ekuilibër.

Pjesa tjetër e kësaj pllake është aq e qartë, sa që nuk ka nevojë për interpretim, sepse flet vetëm për formula përcaktuese.

PLLAKA – XIV

SHTESË

Dëgjo me vëmendje, o njeri, pleqësitë e fshehura në fund të thellësive të fshehura, që kanë humbë nga kjo botë qysh nga koha e Banorit, të humbura e të harruara nga njerëzit e kësaj ere/epoke. Dije se kjo Tokë nuk është gjë tjetër veçse një hamalle (bartëse) e kontrolluar nga fuqi të panjohura nga njeriu.

Po, Zotërat Ezmerë fshehin hyrjen që të çon te ata që kanë lindë nga qielli. Dije se rruga që të çon te sfera e ARULU-së është e ruajtur nga pengesa që mund të hapen vetëm nga njerëz të lindur nga Drita. Sipër tokës unë jam më i vjetri mbajtës i çelësave të portës për te Toka e Shenjtë. Unë komandoj nëpërmjet fuqisë që është brenda meje, për t'i lënë çelësat në botën e njerëzve.

Para se të nisem, unë po ju lë sekretin që ju mëson se si të shkëputeni nga skllavëria e errësirës, se si të hidhni tutje zinxhirët që ju kanë lidhë e të buroni (delni) nga errësira në dritë. Dije se shpirti duhet të jetë i pastruar nga errësira e tij, para se të mundet të kapërcejë portën e madhe të Dritës. Po, edhe pse njerëzit mund të bien në errësirë, Drita do të ndriçojë gjithnjë si një udhërrëfyes. Shumë thellë, në fund të errësirës, e mbuluar me vel simbolesh, rruga për te Porta mundet përherë të jetë e gjetur.

Njeriu në të ardhmen do t'i mohojë Misteret, por kërkuesi do të gjejë përherë rrugën. Tash ju urdhëroj që t'i mbani fort të fshehtat e mia e t'ia jepni vetëm atij që ju keni

verifikuar, kështu që pastërtia të mos jetë e njollosur, kështu që fuqia e së Vërtetës të mbizotërojë.

Dëgjo me vëmendje, tash po të zbuloj të fshehtën! Dëgjo me kujdes shenjat e të fshehtave të Mistereve që po të jap! Bëri, në bazën e këtyre një drejtim fetar, sepse vetëm kështu mund të qëndrojë esenca.

Ekzistojnë zona midis kësaj jete dhe TË MADHIT NJË, të përshkuara nga shpirti që largohet nga kjo Tokë kur ndahet nga jeta. Këto janë:

Duat, - shtëpia e fuqisë dhe e zhgënjimeve. (Dialekt geg: ***du-at*** që do të thotë ***dua atë***).

Sekhet Hetspet – shtëpia e zotërave.

Osiride – simboli i rojes së portës, që kthen prapa shpirtërat e njerëzve të padenjë. Nga prapa qëndron sfera e fuqisë e të lindurve nga qielli.

Arulu, - toka ku Të Mëdhenjtë kanë kaluar. Atje ku unë përfundova punën time midis njerëzve, ku unë ju bashkova Të Mëdhenjve të së vjetrës Shtëpisë Time.

Shtatë janë detyrat e Shtëpisë së të Fuqishmëve. ***Tre*** janë rojet e errësirës për çdo portë të madhe.

Pesëmëdhjetë janë rrugët që të drejtojnë ke Duat (shtëpia e fuqisë dhe e zhgënjimeve).

Dymbëdhjetë janë shtëpitë e Zotërinjve të Iluzioneve, që përballojnë katër rrugë, çdonjëra e ndryshme nga tjetra.

Dyzetë e dy janë Fuqitë e Mëdhaja, që vendosin për vdekjen e atyre që kanë vendosë të kalojnë nëpërmjet Portës së Madhe.

Katër janë bijtë e Horus-it.

Dy janë rojet e Lindjes dhe Perëndimit: Iside, nëna që lutet për fëmijët dhe Mbretëresha e Hënës, refleks i Diellit.

Ba- është esenca që jeton përherë.

Ka – është hija që njeriu e njeh si jetë. Ba – nuk vjen derisa Ka – nuk është mishëruar.

(Ba e Ka duken si fjalët shqipe: BA=Me ba, Ai ban/bën. KA=me pasë, Ai ka).

Këto janë të fshehtat për t'i ruajtë gjatë të gjitha erërave/epokave. Ato janë çelësi i jetës dhe i vdekjes.

Dëgjo tash për Të Fshehtat e Të Fshehtave, mëso për rrathët pa fillim e pa fund, për formën e Atij që është NJËSHI i të gjithave. Dëgjo e veni veshin, kthehu prapa dhe vëri në praktikë, në këtë mënyrë do të udhëtosh nëpër rrugën që unë kam bërë, Mistere në Mistere, megjithatë janë shumë të qarta për ata që kanë lindur nga Drita. Unë tash të tregoj sekretin për të gjitha. I tregoj të fshehtat fillestare, por e lë plotësisht të mbyllur portën kundër atyre që nuk më besojnë.

Te të TRE është misteri që vjen nga i Madhi NJËSH. Dëgjo dhe Drita do të Ndriçojë mbi ty! Në fillim ishin tre banorë. Para këtyre asgjë nuk ekzistonte. Këta ishin ekuilibri: Një Zot, Një e Vërtetë, Një bazë e Lirive. Nga këta të TRE vijnë tre drejtpeshimet: E gjithë jeta, Të gjitha të mirat dhe Të gjitha fuqitë.

Tri janë cilësitë e Zotit te shtëpia e tij e Dritës:

- Pafundësia e Fuqive
- Pafundësia e Diturive
- Pafundësia e Dashurisë

Tri janë fuqitë e Mësuesve:

- Të ndryshojnë të keqen
- Të marrin pjesë te e mira
- Të përdorin dallimet

Tri janë gjërat që nuk mund t'u shmanget Zoti për t'i plotësuar:

- Të tregojë Fuqinë
- Diturinë
- Dashurinë

Tri janë fuqitë që kanë krijuar çdo gjë:

1.Dashuria e Përjetshme që i zotëron të gjitha njohuritë.
2.Njohuritë e Pleqësitë e Përjetshme, që njohin çdo mendim të mundshëm.
3.Fuqia e Përjetshme, e arritur nëpërmjet dëshirës së bashkuar midis Dashurisë së Përjetshme dhe Pleqësive.

Tri janë rrathët (gjendje) e ekzistencës:

1.Gjendja e Dritës, ku nuk banon tjetër përveç se Zoti dhe vetëm Zoti mund ta mbikalojë.
2.Gjendja e Rrëmujës (kaosit), nga ku të gjitha gjërat në natyrë rilindin nga vdekja.
3.Gjendja e Përgjegjësisë, ku të gjitha gjërat çelin nga jeta.

Të gjitha gjërat me shpirt, kanë tri gjendje të ekzistencës:

1. Rrëmujë ose vdekje
2. Liri midis njerëzve
3. Lumturi e qiellit

Tri kërkesa kontrollojnë të gjitha gjërat:

1. Fillimi në Thellësitë e Mëdha
2. Gjendja e Kaosit (rrëmujës)
3. Plotësia e Qiellit

Tri janë shtigjet e Shpirtit:

1. Njeriu
2. Liria
3. Drita

Tri janë pengesat:

1. Mungesa e Mundimeve për të marrë ditunitë

2. Mosnjohja e Zotit
3. Njohja e së keqes

Te njeriu:

- tri janë shfaqjet,
- tri janë mbretëritë e fuqive të brendshme,
- tri janë Odat e Mistereve të krijuara, e gjithashtu të pagjetura te trupi i njeriut.

Tash të më dëgjojë kush është i lirë, i zgjidhur nga zinxhirët e jetës për dritën. Me njohuritë hapen burimet e të gjitha botëve, po, e deri edhe porta e madhe e Arulu-së nuk mund të jetë e mbyllur. Edhe një herë dëgjo me vëmendje, o njeri, t'ju them se kush mund të hyjë në qiell. Nëse ti nuk do të jesh i denjë, është mirë që të të hedhin në flakë. E njeh hyrjen blu nëpërmjet flakës së pastër? Në çdo revolucion të qiellit ata bëjnë banjë në shatërvanin e dritës.

Dëgjo me vëmendje, o njeri, për këtë të fshehtë: në një të kaluar të largët, para se ti të lindje si njeri, unë banoja në të vjetrën Atlantidë. Atje, në Tempull, unë pija nga pleqësitë e hedhura nga Banori si një shatërvan i Dritës. Më dha çelësin për të zbritë te Vendndodhja e Dritës, në Botën e Madhe. Ngriva në këmbë përballë të Shenjtit e të Madhit **NJË**, i lartësuar në fronin e tij, në Lule të Flakës. Ai ishte mbuluar me velin e vezulluar të errësirës, megjithatë shpirti im u coptua nga Lavdia e Tij. Përpara këmbëve të Fronit të Tij, i ngjashëm me diamantin, vërshonin katër lumenj flake. Vërshonin nëpërmjet një kanali mjegulle në drejtim të tokës së njerëzve. Oda u mbush me Shpirtëra Blu. Pallati me yje ishte mrekullia e mrekullive. Sipër në qiell, Shpirtërat formonin një ylber me flakë e dritë. Këndonin për lavdinë e të Shënjtit NJË.

Atëherë nga mesi i flakës arrin një zë:

- Shihni lavdinë e Çështjes së Parë!

Unë pashë këtë Dritë, e lartë sipër të gjitha errësirave, që reflektonte te vetja ime. Unë kuptova që Ai ishte Zot i të gjithë zotave, Shpirti i Diellit, i Plotfuqishmi i Sferave Diellore.

Ekziston NJËSHI, që është i Pari, që nuk ka fillim e nuk ka mbarim; që ka krijuar të gjitha gjërat, që drejton Gjithësinë, është i mirë, i drejtë, që të ndriçon e të mbron.

Atëherë, nga Froni që grumbullonte nji rrezatim të madh, më rrethonte e lartësonte Shpirtin tim me Forcën e Tij. Me shumë shpejtësi më lëvizi nëpërmjet hapsirave blu e më paraqiti Misteret e Mistereve, zemrën e sekreteve të Kozmosit, paskësaj u transportova te toka e Arulu-së dhe u ngrita në këmbë, në Shtëpinë e tyre. Ata më hapën hyrjen, kështu munda të hedh sytë te Rrëmuja (kaosi) e Fillimit. Shpirti im u drodh nga pamjet e tmerrshme, të tërhequra nga oqeani i errësirës. Atëherë unë pashë nevojën për pengesat, pashë nevojën për Zotërat e Arulu-së. Vetëm Ata, me të pafundmin drejtpeshim, mund të qëndrojnë në shtegun rrjedhës të Rrëmujës. Vetëm Ata mund të shohin krijimtarinë e Zotit.

Ndërkohë unë kalova përqark përkatësive të Tetës. Pashë të gjithë shpirtërat që kishin pushtuar errësirën. Pashë të ndritmen dritë ku banonin. Unë ndejta gjatë midis tyre, më mbajtën dhe për shkak të jetës që kisha zgjedhë, kur unë ndejta në këmbë te Odat e Amentit dhe bëra zgjedhjen time për punën që do të më duhej të kryeja. Unë kalova përmes Odave të Arulu-së, poshtë, drejt Tokës ku shtrihej trupi im. Riburova/rilinda nga toka ku isha shtri, ndenja në këmbë përballë Banorit, i dhashë pengun tim të miqësisë duke thënë të Drejtat e mia, derisa të jetë kompletuar puna ime në Tokë, derisa të kalojë epoka e errësirës.

Dëgjo me vëmendje, o njeri, fjalët që po të dërgoj. Te vetja jote do gjesh Esencën e jetës. Para se të kthehem te Odat e Amentit, si unë, ashtu dhe ti do të burosh nga Drita. Fshehe dhe ruaje, mbylle te simboli, kështu që i padituri nuk e qesh e nuk e përfol. Në çdo tokë jepi formë të panjohurës! Bëhuani të vështirë rrugën kërkuesve që e dëmtojnë. Në këtë mënyrë, të dobëtit e të pasigurtët do kenë një shtytje, do gjejnë pengesa. Në këtë mënyrë sekretet do të jenë fshehur e ruajtur, të mbajtura deri në kohën kur këtu të kthehet periudha e drejtë.

Nëpërmjet epokave të errëta, shpirti im do të ngelë nën tokë i fshehur, duke pritë e duke vështruar. Kur të kalojnë të gjitha provat e jashtme, më thirrni e do të shfaqem nëpërmjet çelësave që ju kam lënë. Kështuqë unë, Filluesi, do të përgjigjem nga Odat e Amentit, kështuqë pranoj Fillimin, duke dhënë fjalën e fuqisë.

Dëgjo dhe kujto, këta fjalë paralajmëruese:

- Mos ec te unë i pakompletuar me pleqësitë, i papastër në zemër ose me propozime të dobëta, përndryshe unë ta heq fuqinë duke të gërthitë dhe do të dal nga vendi ku po flej.

Tashti po kthehem prapa dhe po mbledh vllezërit tuaj, kështu që unë mund të rinis pleqësitë e Dritës, kur të kem ikë. Ec te Oda përballë tempullit tim! Mos ha ushqim para se të kalojnë tri ditë! Atje unë do të të jap esencën e pleqësive, kështuqë do të mund të shndritësh me fuqi midis njerëzve. Atje do të jap Sekretet e botës, që edhe ti të mundesh të ngjitesh te e Vërteta në Qiellin e Njerëzve Zotërinj, te esenca e asaj që ti je.

Tash nisu e më lë, ndërkohë unë po mbledh ata që dijnë, por nuk dijnë se si.

PLLAKA – XV

SEKRETI I SEKRETEVE

Tash bashkohuni, bijt e mij, e pritni të dëgjoni për Sekretin e Sekreteve, që do t'u japë fuqi për të zbuluar Njeriun Zot, që ju jep drejtimin për ke rruga e jetës së përjetshme! Do ju flas me qartësi për të Fshehtat e Zbuluara: Nuk do ju jap fjalë të errta. Hapni veshët tash, fëmijët e mij! Më dëgjoni dhe binjuni fjalëve që do ju them!

Në fillim do flas për zinxhirët e errësirës që ju mbajnë të lidhur te sfera e Tokës. Errësira dhe Drita janë në të njëjtën kohë pjesë e të njëjtës natyrë, ndryshimi qëndron te paraqitja, sepse çdonjëra buron nga Burimi i të gjithave.

Errësira është çrregullsia. Drita është rregulli. Errësira e ndryshuar është drita e Dritës. Kjo duhet të jetë, bijtë e mi, qëllimi juaj: ndryshimi i errësirës në dritë.

Dëgjoni tani për të fshehtat e natyrës, bashkëveprimin e jetës me Tokën ku banoni! Dijeni, se ju në natyrë jeni të ndërtuar nga tri mënyra: fizike, mendore dhe hapsirore, të gjitha të mbledhura ke ti. Tri janë cilësitë e çdonjërës nga këto cilësi, që bëhen nëntë gjithsej, si për lart ashtu dhe për poshtë.

Në fizikun e njeriut janë këta kanale:

Gjaku që lëviz me rrethqarkullim të vrullshëm, bashkëpunon me zemrën, duke e ushqyer atë për t'i dhënë rrahjet.

Magnetizmi që lëviz nëpërmjet fijeve nervore, që e çojnë energjinë ke të gjitha qelizat dhe te lëkura.

Akasha (Nuk e shpjegojnë se çfarë është, por duhet të jetë palca e kockave dhe sistemi nervor), që rrjedh nëpërmjet kanalesh, të hollë dhe fizikë, që plotësojnë kanalet. Këta formojnë skeletin, nga ku rrjedh hapësira (kozmosi) e hollë. Në kontrollin e këtyre shtrihet e fshehta e jetës për trupin. Braktiset nga dëshira e bashkëmendimtarit, kur të ketë arritë fundi i qëllimit të jetës(Vdekja).

Tri janë format e Astrales, që është ndërmjetës për n'atë botë, lart e poshtë. Nuk është fizike, nuk është shpirtërore, por është e aftë të lëvizë n'atë botë, lart ose poshtë.

Tri janë cilësitë e mendve, trasnmetuese e dëshirave të të Madhit NJISH, Drejtues i çështjes dhe efekteve në jetën tuaj. Kjo është e përbërë nga tri esenca, të drejtuara për lart nga forca e Katrës.

Në botën tjetër sipër, natyra treshe e njeriut rrin te mbretëria e vetes së vet Shpirtërore. Në brendi të vetes janë katër cilësi, ndriçuese në çdo nivel të ekzistencës, edhe tremëdhjetë në një, që është numër mistik. VLLEZËRIT i kanë hedhë themelet te cilësia e njeriut, çdonjëri drejton zhvillimin e qenieve, çdonjëri kanalizues i të Madhit Një.

Në tokë njeriu është në zinxhirë, i burgosur nga hapsirë-koha në nivelin e Tokës. Ai rrethon çdo planetë me një valë vibracionesh, duke lidhë aftësitë e tij të zhvillimit. Gjithashtu brenda te njeriu është dhe çelësi i qetësimit, brenda ke njeriu mund të gjendet liria. Kur ju të keni liruar Veten nga trupi, do të buroni nga një sasi e madhe zinxhirësh të nivelit tuaj tokësor. Thoni fjalën: **Dor-E-Lil-La**, (Duket si fjala shqip: ***dorën e lidha***) atëherë për ca kohë Drita juaj do të lartësohet e do të mund të kaloni lirisht pengesat e niveleve tokësore. Shihni dhe dijeni se kush jeni matanë vetes tuaj! Po, do të mundeni të

kaloni për ke botët më të larta! Do të shihni mundësi ngritjeje të zhvillimit tuaj, do të njihni të ardhmen e tokësorëve dhe të shpirtërave të tyre. Ju jeni lidhë me trupin tuaj, ama nëpërmjet fuqisë mund të jeni të lirë.

Ky është sekreti, nëpërmjet të cilit ju mund të ndërroni magjinë me lirinë tuaj. Që të qetësohen mendimet tuaja, që i qetë të jetë trupi jaej, përgjegjës vetëm për lirinë nga trupi, përqendroje veten tënde ke dëshira e mesit tënd!

Mendo njëherë, edhe një herë që mund të jesh i lirë. Mendo këto fjalë: **La-U-M-IL** (Duket si: ***Lahu mirë***) dhe lëre të rikumbojë ke mendët tuaja! Lëviz me këtë kumbim në drejtim të vendit ku ti dëshiron. Lirohu nga lidhjet e trupit nëpërmjet dëshirës tënde!

Dëgjo, ndërkohë unë po të jap Sekretin më të madh: se si mund të hysh ke Odat e Amentit, të hysh si bëj unë, ke pallati i të pavdekshmëve. Rri te qetësia e trupit tënd! Qetësoje mendjen tënde në mënyrë që asnjë mendim të mos të të shqetësojë. Duhet të jesh i pastër në mendimet dhe në qëllimet tuaja, përndryshe mund të vijë dështimi i veprimit. Pamja e Amentit është kjo që po ju tregoj te pllakat (shkrimet) e mia. Me dëshirën e zjarrtë për të qenë aty me zemrën plot, mbetem përballë Zotërave me sytë ke mendimet tuaja. Thoni me mend fjalën që të jep fuqi, që unë po të jap: **Mekut-El-Shab-El-Hale-Sur-Ben-El-Zabrut-Zin-Efrim-Quar-El.** Qetësoje mendjen dhe trupin tënd, kështu të jesh i qartë se shpirti yt do të thërritet!

Tani po të jap Çelësin për te Shamballa, vendi ku vllezërit e mi jetojnë në errësirë, por e mbushur me dritë të Diellit në Errsirën e Tokës, Dritë e Shpirtit, udhëtregues për ju kur ditët e mia të kenë kaluar.

Braktise trupin tënd ashtu si të kam mësuar. Kaloi pengesat e thellësive, vendin më të fshehtë, qëndro përballë portës së madhe dhe rojeve të tyre.

Urdhëroje hyrjen tënde atje me këto fjalë:

- Unë jam Drita. Brenda meje nuk është errësira. Unë jam i lirë nga zinxhirët e natës. Ma hapni rrugën e të Dymëdhjetëve e të Njëshit, kështu që unë të mundem të kaloj te mbretëria e Pleqsive.

Kur ata nuk do të të pranojnë, e me siguri kështu duan, urdhëroi ata që ta hapin portën me këto fjalë që do të të japin fuqi: **Edom-El-Ahim-Sabbert-Zur-Adom.**

Kështuqë, nëse fjalët tuaja kanë qenë të vërtetat më të larta, për ty pengesat do largohen e porta do të të hapet.
Tani po ju lë, fëmijët e mi. Po shkoj poshtë ose edhe lart, ke Odat.

Fitojeni udhëtimin për ke unë, fëmijët e mi. Me siguri do të bëheni vllezërit e mi.

Me këtë po mbaroj shkrimin tim. Po i lë që të jenë udhëzime për ata që do të vijnë prapa, por vetëm për ata që do të kërkojnë pleqësitë/dituritë e mia, sepse vetëm për ata unë jam Çelësi i Jetës.

IV.HERMESI

1. Hermes Trismegistus
(Hermesi Tre herë i Madh – Tre herë i Rilindur)

HERMESI (greq. Hermes, lat. Mercurius) - i biri i Zeusit, zotit suprem dhe Pledes Maia, lajmëtar i zotërave dhe udhërrëfyes i të vdekurve në botën nëntokësore, zot i tregtarëve, shpikësve dhe udhëtarëve, atletëve, mashtruesve dhe i vjedhësve.

Ishte zëdhënës dhe lajmëtar i zotave tjerë nga Olimpi. Po ashtu, Hermesi konsiderohej si Zoti i tregtisë, oratorisë dhe i hajnave. Nga mitologjia Romake atij i përshtatej Merkuri. Ka qenë biri i Zeusit, i lindur nga marrëdhënia e tij jashtëmartesore me Majën.

Hermesi kishte sandalet e mbathura në këmbë dhe përkrenaren që e bartëte në kokë, kishte krahë me të cilët fluturonte furishëm nga një vend në vendin tjetër.

Shpesh ju ka ndihmuar shumë heronjve legjendarë, sikur janë: Herakliu (Herkules), Perseu, Odiseu.

Prej të gjithë zotërave ka qenë me i shkathëti dhe më dinaku, ndërsa aftësitë e veta i ka dëshmuar që në ditën e parë të jetës së vet. Ka lindur në mëngjes (në shpellë nën malin Kilen në Arkadi), para dite ka ikur nga djepi, në mesditë e ka gjetur lirën dhe mësoi të luajë në të, pasdite zotit Apollon ia vodhi tufën prej pesëdhjetë lopësh (dhe i ngrehu për bishti deri në shpellë, në mënyrë që pas vetes të lënë gjurmë të kundërta), në mbrëmje u kthye sikurse mos të kishte ndodhur gjë, u mbështjellë në mënela dhe e zuri gjumi me një gaz fëmije të pafajshëm në buzë. Kur zoti Apollon erdhi për ta

dënuar, u arsyetua në mënyrë aq të shkathët dhe pa pikë turpi gënjente (të folurit dhe të gënjyerit i mësoi në të njëjtën ditë), sa që Apolloni vendosi ta çojë para vetë Zeusit. Ndërmarrjet e djalit të tij më të ri, Zeusin në të vërtet e mahnitën, por për shkak të rendit e urdhëroi që t'ia kthejë Apollonit bagëtitë e tij. Kuptohet se kjo Hermesit nuk i shkonte për shtati dhe në vend të përgjegjes filloi t'i bie lirës aq bukur sa që Apolloni dëshiroi që ta ketë për vete dhe i propozoi Hermesit që t'i mbajë lopët e vjedhura. Hermesi u pajtua me këtë, ndërsa Apolloni me këtë kombinim ishte aq i kënaqur, sa që ia dha edhe shkopin e artë me këshillë të mirë: le të shkojë në malin Parnas dhe te priftëreshat e atjeshme le ta mësojë artin e magjisë. Hermesi e dëgjoi edhe aty në mënyrë të përsosur u përgatit për rolin e vet të ardhshëm në Olimp.

Mirëpo, në Olimp nuk erdhi menjëherë dhe aq lehtë. Këte ia ndalonte e ëma, e cila ishte vetëm hyjneshë e rangut të ulët dhe shoqërinë e zotërave e konsideronte si tejet të lartë. Për këtë arsye Hermesi mbet në tokë, e ruante bagëtinë e blegtorëve të Arkadisë dhe kështu ia shkurtonte vetes kohën me shpikje të ndryshme. Si kompensim për lirën, të cilën ia ka dhënë Apollonit e shpiku fyellin baritor dhe, që mos të lodhet me mënyrën e deriatëhershme të ndezjes së zjarrit, e zbuloi shkrepsën. Pastaj i shpiku numrat, masat dhe shkrimin. Më në fund iu mërzit jeta në tokë dhe e luti nënën që ta lejojë të shkojë në Olimp. Më mirë është të jetohet në mesin e zotërave në pallate, se sa në errësirën e shpellës në Arkadinë e varfër. Kur Maia i tha se zotërat ndoshta nuk do ta pranonin në radhët e veta, Hermesi tha se në këtë rast do ta mbledh një grup cubash dhe se do të bëhet udhëheqës i tyre. Ky argument

për Majën tingëllonte bindshëm dhe nuk i mbeti tjetër pos ta lejojë të shkojë në Olimp.

Zotërat e pranuan aq përzemërsisht sa edhe nuk e kishte pritur. Për veprimtarinë e tij kishin dëgjuar tanimë mjaft dhe përveç kësa,j ishte i biri i vetë Zeusit. Në Olimp menjëherë e fitoi funksionin e lartë. Zeusi e emëroi lajmëtar të vetin, funksionin e ngjashëm, në të vërtetë, e ka pasur hyjnesha Irida, mirëpo Hermesi së shpejti e tejkaloi. Derisa Irida vetëm i shpallte urdhërat e Zeusit, ai edhe i zbatonte. Së shpejti e zgjëroi ndikimin e vet edhe te zotërat e tjerë dhe u bë jo vetëm lajmëtar i tyre, por edhe këshilltar. Kuptohet se më me ëndje punonte për Zeusin, i cili ia besonte rastet delikate dhe të ndërlikuara, për shembëll e shpëtoi Dionisin, djalin e Zeusit, të cilin Admanti i Orhomenës, në çastin e tërbimit, deshti ta vrasë, e mbyti bariun me njëqind sy të Argut, i cili sipas urdhërit të Herës xheloze e ka ruajtur Ijen, dashnoren e Zeusit. E çliroi Aresin, zotin e luftës, nga fuqia metalike, në te cilën e mbyllën Gjigantët Aloidet dhe e solli në Olimp zotin Hefest. U ndihmoi edhe shumë trimave: Perseut në luftë me Gorgonën Meduzë. Herakliut gjatë shërbimit te Euristeu, mbreti i Mikenës. Orfeut me rastin e ndërmarrjes së tij të guximshme - në zbritjen në botën nëntokësore dhe në kthimin e tij në tokë. Odiseut gjatë bredhjeve të tij të gjata duke u kthyer nga Troja e rrënuar për në Itakë. Sipas urdhërit të Zeusit e ktheu në jetë edhe Pelopsin e ri kur e vrau i ati i tij, Tantali.

Njësoj sikurse trimave ashtu edhe njerëzve të vdekshëm të thjeshtë u ka ndihmuar kur e lutnin për këtë. Barinjëve ua ruante bagëtinë, udhëtarët i udhëheqte dhe i mbronte, luftëtarëve u jepte fuqi, ndërsa vrapuesve u jepte shpejtësinë, tregtarëve u ndihmonte të fitonin pasurinë dhe në përgjithësi

njerëzve ambiciozë u ndihmonte në rrugë deri te suksesi. Ishte i vetmi prej zotërave që nuk ngurronte për t'u ndihmuar mashtruesve dhe kriminelëve, kuptohet me kusht nëse punën e tyre e kanë kryer me dinakëri dhe mençuri. Njerëzit budallenj dhe përtacë nuk kanë pasur se çka të presin prej Hermesit. Të vetmit janë këta që ankoheshin në të.

Për shkak të detyrave të shumta të cilat qe i detyruar t'i kryejë dhe angazhimit të pandërprerë, Hermesi sikur nuk kishte pasur kohë të martohej. Kuptohet se kjo nuk do të thotë se nuk ka lënë pas vetes trashëgimtarë. Me Polimelën e bukur nga përcjellësit e hyjneshës Artemida e ka pasur djalin Eudori, i cili në luftën e Trojës qe njëri prej udhëheqësve të mirmidonëve të Akilit. Me nimfën Karmenta e ka pasur djalin, Euandrin, i cili e braktis vnedlindjen, Arkadinë, u shpërngul në Itali dhe u vendos në Pallatin, kodrinën romake. Me Herën, bijën e mbretit të parë të Athinës, Kekropsit, e ka pasur djalin Kefal, ndërsa me hyjneshën e bukurisë dhe të dashurisë, Afroditën, djalin Hemafrodit. Sipas disa autorëve djalë i tij ka qenë edhe Sizifi, mbreti i Korintit, ndërsa sipas të tjerëve kanë qenë Sileni, Satiri dhe Pani. Prej djemëve të tij të tjerë veçmas janë të njohur Antaliku, mashtruesi i famshëm e kriminel, dhe Dafnisi, themelues i llojit të ri poetik dhe këngëtar i këngëve pastorale.

Pellazgët dhe më vonë Grekët që nga kohërat më të lashta e adhuronin Hermesin. Kultin e tij, si duket, përafërisht në shek. V p.e.s. e kanë marrë edhe Romakët dhe e kanë identifikuar me Merkurin, zotin e tyre të tregtisë dhe të fitimit (Mercurius). Në fillim ka qenë zot i bagëtisë dhe me këtë edhe dhurues i pasurisë së fituar me kultivimin e kafshëve. Me zhvillimin e ekonomisë së tregut u bë zot i tregtisë e pasi që

tregtia varet nga udhëtimi dhe shpeshherë edhe nga mashtrimi, u bë zot i udhëtarëve, shtegtarëve dhe mashtruesve. Vjedhësit e kanë nderuar për shkak të aftësisë së tyre, të cilën e ka dëshmuar që nga dita e parë e jetës së tij (dhe këte më shakatë siç është vjedhja e purtekut të Zeusit, tredhëmbëshin e Poseidonit dhe shpatën e Aresit). Pajtuesin dhe mbrojtësin e vet në të e kanë parë edhe lajmëtarët, predikuesit dhe për befasi edhe mjekët, për arsye se ka ditur të shërojë: e ka njohur fshehtësinë e bimëve shëruese. E kanë adhuruar edhe sportistët për të cilët si „zoti këmbëshpejtë, ishte shembull i shkathtësisë dhe i zhdërvjelltësisë. Me shtatoret e tij i kanë zbukuruar veçmas udhëkryqet në rrugë (ishin këto të ashtuquajturat *herme*, shtyllat katërkëndëshe me kokën e Hermesit dhe me mbishkrime të cilët tregonin drejtimin e rrugës), shpesh edhe vendshërimet dhe institucionet mjekësore dhe pothuajse rëndom fushat e lojës dhe rrugët e pjesëmarrësve në gara. E paraqitnin si djalosh, kryesisht me shkop dhe kapelë të gjërë të rrugës, sikurse edhe me atributet e tij: krahët, sandalet dhe kapelën.

Prej krijimeve artistike të antikës, s'do mend, se sot vend të parë zë Hermesi me Dionisin e vogël i Praksitelit, origjinali është rreth vitit 340 p.e.s. E kanë gërmuar në vitin 1877 arkeologët gjermanë në Olimpi (sot në Muzeun e Olimpisë). Prej të tjerëve le t'i përmendim vetëm të ashtuquaiturin Hermesin e Belvederes, kopjen romake të skulpturës greke nga shkolla e Praksitelit (sot gjendet në Muzeun e Vatikanit). Hermesin, udhërrëfyesin e shpirtrave, poashtu kopje e origjinalit helenistik nga shkolla e Praksitelit (gjendet në Muzeun Arkeologjik Kombëtar në Athinë). Hermesin në pushim, kopje romake me siguri origjinali i Lisipit nga fundi i

shek. IV p.e.s. (sot giendet në Muzeun Kombëtar të Napolit). Hermesi i cili është duke e lidhur sandalen, kopja antike e origjinalit të Lisipit (në Luvër të Parisit). Hermesi prej mermerit, kopje romake e skulpturës greke nga mbarimi i shek. V p.e.s. (sot giendet në Muzeun Metropolitan në Nju Jork). Vaza dhe relieve me figurën e Hermesit ka poashtu shumë. Prej veprave skulpturale të kohës më të re le t'i përmendim vetëm ato më të shquarat: Hermesin e Gjovani da Bolonies të kohës rreth vitit 1564 (në pallatin firentinas Ufici dhe në Muzeun artistiko-historik në Vienë). Hermesin që e lidh sandalen të Jean Baptist Pigallit (Zhan Baptist Pigallit) të vitit 1774 (sot gjendet në Luvër të Parisit), dhe Merkurin me Amorin e Matijash Braunit nga giysma e parë e shek. XVIII, sot gjendet në Belevedere të Pragës). Prej veprave pikturale po i cekim Venerën, Merkurin dhe Amorin të Koregjiut (nga fillimi i shek. XVI dhe sot gjendet në Galerinë Kombëtare të Londrës) dhe Hermesin, Argun dhe Ijen e magjepsur të Pietër Paul Rubesit (si duket e viteve 1635 - 1638 dhe sot gjendet në Galerinë e Drezdenit). Me emrin e Hermesit që nga koha antike quhet planeti më i afërt i Diellit (sot sipas emrit latin - Merkur).

2.Hermesi dhe Hermetizmi

Hermesi në mitologji greke ishte lajmëtari i perëndive. Ishte biri i Zeusit dhe Majës, vajzës së Atlasit. Në mitologjinë romake, ai përfaqësohet nga Merkuri. Hermes Trismegistus është një emër i Pellazgjisë dhe Greqisë së vonëshme për zotin egjyptian nga Atlantida - **Thotin**, të cilin grekët e identifikuan me perëndinë e tyre Hermes.

Hermes Trismegistus ishte konsideruar si autor i shkrimeve hermetike, i letërsisë, astrologjisë, mjekësisë, alkimisë, magjisë, gnosticizmit dhe sidomos doktrinës fetare-filozofike. Këto shkrime, të cilat luajtën një rol vendimtar në misticizmin mesjetar, janë të shumta dhe janë ruajtur në gjuhën e vjetër greke, latine apo arabisht.

Hermetizmi është një doktrinë fetare-filozofike, që daton nga koha e fundit të antikitetit të Egjyptit të helenizuar. Periudha helenistike e historisë greke filloi nga viti 323 para Krishtit, me vdekjen e Aleksandrit të Madh, dhe deri me pushtimit e Greqisë nga Roma, viti 146 pas Krishtit.

Tekstet më të rëndësishme të hermetizmit janë mbledhur në ***Corpus Hermeticum*** dhe janë kryesisht për çështje thjesht filozofike. *Corpus Hermeticum* është grumbullimi i teksteve më të famshme të padeshifrueshme, dhe përbëhet nga një koleksion prej 17 traktateve filozofike të shkruara në formë të dialogut me Hermes Trismegistus, Tat dhe Asclepius si personazhet e dramës. Është e sigurt se ata janë shkruar në Egjypt, në greqisht, në shekujt e parë të epokës sonë, dhe se ata janë të ndikuar nga idetë neoplatonike dhe gnostike. Deri

në çfarë mase ato janë të ndikuara nga mendimi i vjetër egjyptian, është jashtëzakonisht e pasigurt.

Corpus Hermeticum, si shumë tekste të tjera të lashta, ishte përpiluar në formën e tij aktuale, gjatë Mesjetës në Perandorinë Bizantine, nga Michael Psellos. Në Europën Perëndimore hermetizmi arriti në vitin 1400, me mbledhjen e teksteve dhe përkthimin e tyre në latinisht nga neoplatinisti italian, italian Marsilio Ficino. Gjatë dy shekujve të ardhshëm *Corpus Hermeticum* do të ushtrojë një ndikim të madh në Rilindjen Europiane. Kryesisht për shkak se *Corpus Hermeticum* përmbante, pas Biblës, urtësitë më të vjetra të njerëzimit, i ashtuquajturi Prishilës Sapientia, dhe se tekstet janë datuar në kohën e Moisiut. Me kohën interesi për të mësuar *Corpus Hermeticum* ra gradualisht, shumëçka e mbuloi errësira dhe harresa. Të vetmit lexues dhe interpretues të tij mbetën alkimistët dhe okultistët, që veprinin në hije dhe në heshtje.

3.Ligji i Hermesit

Hermesi është emër i greqizuar i perëndisë egjyptiane nga Atlantida, THOTI, i cili konsiderohet pionier i shumë shkencave, posaçërisht i alkimisë dhe i shumë shkathtësive të tjera.

Nocioni "Hermetizëm" rrjedh nga greqishtja dhe ka kuptimin e diçkaje të mbyllët dhe të pakuptueshëm, për shkak të gjuhës së vështirë ose të ideve dhe të figurave të paqarta.

Një ndër ligjet e hermetizmit është edhe ligji i analogjisë, i ngjasimit ose Ligji i Hermesit.

Ligji i Hermesit thotë: "Si është lartë, ashtu është edhe poshtë, e si është poshtë, ashtu është edhe lart". Pra, një formë shumë e thjeshtë, prapa së cilës fshihet një fushë shumë e gjërë e përdorimit praktik.

Shprehja "si është poshtë, ashtu është lart", në kuptim të parë do të thotë: "si është fotografia juaj psikike, ashtu është edhe në botën tuaj reale". Fotografia që krijohet nëpërmjet imagjinatës kreative u takon planeve të ekzistencës, planeve të mendimeve (lart), ndërsa plani fizik, që është më i ulët, i takon planit material (poshtë).

Në qoftë se dëshirojmë të krijojmë diçka në botën materiale, duhet që së pari ta krijojmë atë në planin psikik/shpirtëror. Duhet të formojmë përfytyrim të kthjellët dhe të qartë. Në atë moment që një gjë e krijojmë në imagjinatë, ajo tani më veç ekziston, por në botën e mendimeve. Në çoftë se bëhet mbushja e mjaftueshme e fotografisë së imagjinuar me energji (kjo do të thotë se sa më shumë energji emocionale dhe mendore të derdhim në të), për

një kohë të caktuar, ajo do të kalojë nga plani mendor në atë material.

Elementet kryesore kozmike, pa njohjen e të cilave nuk mund të lidhemi me hermetizmin, janë:

Shpata - simbol i elementit të **ajrit**

Shkopi - simbol i elementit të **zjarrit**

Kupa - simboli i elementit të **ujit**

Monedha - simbol i elemenetit të **tokës**

Nuk duhet t'i krahasojmë këto elemente kozmike me elementet reale në tokë, që mbajnë të njëjtin emër. Elementet kozmike: ajri, zjarri, uji dhe toka nuk janë fizike. Toka fizike, nëpër të cilën ecim, përbëhet nga humusi, gurët, rëra etj., pra, kjo është përzierje e elementeve kimike. Ose ajri, në planin fizik, përbëhet nga gazrat, tymi, avulli, grimcat e pluhuri etj.

Kur flasim për këto elemente, nuk mendojmë në elemente fizike, por mendojmë në shfaqjet e energjisë universale kozmike. Pra, me energji kozmike nënkuptojmë mënyrën, në të cilën shfaqet energjia e përgjithshme kozmike në universin dhe njeriun.

Këto katër elemente kozmike nuk janë forca kozmike, por mënyra të shfaqjes në universin e pafund nga mijëra anë dhe përthyerja e tyre në dijen e njeriut, nga ana tjetër. Ato janë dukuri me të cilat forcat kozmike paraqiten dhe ndryshojnë, duke kaluar nga një gjendje në tjetrën.

Ekziston edhe elementi i pestë kozmik, nga i cili burojnë të gjithë elementet e tjerë dhe quhet AKASHA. Për këtë element ka pak të dhëna. Ky element konsiderohet si element fillestar krijues. Akasha, thonë kaballistët, është diçka joekzistuese. Por si mund të jetë joegzistuese kur thuhet se ajo ekziston?! Përgjigja është në atë se ajo "diçka" ka plotësisht

dimensione tjera në krahasim me botën tonë të mendimeve, të ndjeshmërisë dhe të realitetit material. Disa religjione Akashën e krahasojnë me Zotin.

Gjithçka që ekziston, si në univers, ashtu edhe në shpirtin e njeriut, ekziston në njërën nga gjendjet që i quajmë elemente kozmike. Gjithçka që është krijuar, që krijohet, kalon nëpër këto katër elemente kozmike. Këto katër elemente kozmike shfaqen te njeriu si katër procese psikologjike:

Ajri - lindja e ideve ose bota e mendimeve në vetëdije.

Zjarri - paraqitja e emocioneve. Ky është investimi i energjisë emocionale, zgjerimi i ideve origjinale në të gjitha drejtimet.

Uji - përmbledhja e dëshirave të flakta në një drejtim konkret.

Toka - shndërrimi i ideve në realitet, pra, materializimi i tyre.

Këtu qëndron edhe sekreti i sukseseve për realizimin e planeve dhe dëshirave të caktuara në secilën fushë.



Simboli i ajrit-Simboli i zjarrit-Simboli i tokës-Simboli i ujit

4.Shtatë parimet Hermetike

"Shtatë janë Parimet e së Vërtetës. Ai i cili i njeh dhe i kupton - zotëron Çelsin Magjik, që hap në çast të gjitha Dyert e Tempullit ende pa i prekur." **– Hermesi** (Thoti, Enoku, Kybalioni)

Shtatë parimet Hermetike mbi të cilat bazohet e gjithë Filozofia Hermetike janë:

1. Parimi i Mentalizmit
2. Parimi i Përkimit
3. Parimi i Lëkundjes
4. Parimi i Polaritetit
5. Parimi i Ritmit
6. Parimi i Shkakut dhe Pasojës
7. Parimi i Gjinisë

1. Parimi i Mentalizmit

"GJITHËSIA është Mendje, UNIVERSI është Mendor." **– Hermesi** (Thoti, Enoku, Kybalioni)

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se "Gjithçka është Mendje". Ai sqaron se GJITHËSIA është SHPIRT, i cili në vetvete është I PANJOHSHËM dhe I PAPËRCAKTUESHËM, por që mund të konsiderohet dhe mendohet si një MENDJE E GJALLË, E PAFUNDME DHE UNIVERSALE. Ai gjithashtu shpjegon se e gjithë bota apo universi me dukuritë e tij, është thjeshtë Krijim Mendor i GJITHËSISË, i cili u nënshtrohet Ligjeve të Gjërave të Krijuara,

dhe se ky Univers në tërësi apo në pjesët apo njësitë e tij, ekziston në Mendjen e GJITHËSISË, brenda së cilës ne "jetojmë, lëvizim, dhe ekzistojmë".

Ky parim, duke treguar Natyrën Mendore të Universsit, shpjegon lehtësisht të gjitha fenomenet e ndryshme mendore dhe psikike që zënë një pjesë kaq të madhe të vëmendjes publike, dhe të cilat, pa shpjegim të tillë, mbeten të pakuptueshme dhe sfidojnë çdo trajtimin shkencor. Kuptimi i drejtë i Parimit të madh hermetik të Mentalizmit, i mundëson individit të kuptojë menjëherë ligjet e Universit Mendor, dhe t'i zbatojë ato në funksion të mirëqenies dhe përparimit vetjak.

Nxënësi Hermetik është i aftë t'i zbatojë Ligjet e mëdha mendore në mënyrë inteligjente, në vend që t'i përdorë symbylltazi. Me Çelsin Universal në duart e tij, nxënësi është i aftë të hapë dyert e shumta të tempullit mendor e psikik të diturisë, dhe të hyjë aty lirisht e me zgjuarsi. Ky parim shpjegon natyrën e vërtetë të "Energjisë", "Forcës" dhe të "Materies", përse dhe në ç'mënyrë janë të varura këto të fundit nga Mjeshtëria e Mendjes. Një nga Mjeshtrit e vjetër të hermetizmit, shumë kohë më parë, shkroi: ***"Ai i cili shtie në dorë të vërtetën e Natyrës Mendore të Universit, ka përparuar larg në Udhën drejt mjeshtërisë."***

Dhe këto fjalë janë po aq të vërteta sot, sa në kohën kur u shkruan për herë të parë. Pa këtë Çelës Universal, Mjeshtëria është e pamundur dhe nxënësi troket më kot në dyert e shumta të Tempullit.

2. Parimi i Përkimit

"Si lart, ashtu edhe posht - si poshtë, ashtu edhe lart." – **Hermesi** (Thoti, Enoku, Kybalioni)

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se ka gjithmonë një Përkim midis ligjeve dhe fenomeneve të rrafsheve të ndryshme të Ekzistencës dhe Jetës. Aksioma e vjetër Hermetike shfaqet më këto fjalë: "Si lart, ashtu edhe posht - si poshtë, ashtu edhe lart." Rrokja e këtij parimi, jep mjetet për zgjidhjen e shumë paradokseve të errëta dhe mistereve të fshehta të Natyrës. Ekzistojnë rrafshe përtej perceptimit tonë për të cilin jemi të aftë të mësojmë shumë, vetëm pasi epërdorim ***Parimin e Përkimit***. Në të kundërt ato do të mbeteshin të panjohura për ne.

Ky Parim gjen zbatim dhe manifestim universal në rrafshet e ndryshme të universit material, mendor dhe shpirtëror. Ky Parim është një Ligj Universal. Hermetistët e lashtë e konsideronin këtë Parim si një nga instrumentet mendore më të rëndësishme, neëpërmjet të të cilit njeriu ishte i aftë të mënjanonte pengesat që fshihnin e mbulonin të Panjohurën.

Falë këtij Parimi u bë e mundur të ngrihej Velloja e Isisit aq sa për të hedhur një shikim të rrufeshëm mbi fytyrën e perëndeshës. Ashtu siç i ndihmon njeriut Principi i Gjeometrisë për të matur yje të largët dhe lëvizjet e tyre derisa rri ulur në observatorin e tij, ashtu edhe Parimi i Përkimit i mundëson njeriut të arsyetojë me mençuri nga e Njohura tek e Panjohura. Duke studiuar mondën, ai kupton Krye Engjëllin.

3. Parimi i Lëkundjes

"Asgjë nuk ndalet, çdo gjë lëviz - gjithçka lëkundet." – **Hermesi** (Thoti, Enoku, Kybalioni)

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se "gjithçka është në lëvizje", "gjithçka lëkundet", "asgjë nuk ndalet". Këto janë fakte të vërtetuara nga shkenca bashkohore, të cilat konfirmohen pas çdo zbulimi të ri shkencor. E megjithatë, ky Parim Hermetik është shpallur mijëra vite më parë, nga Mjeshtrit e Egjyptit të Lashtë.

Ky parim shpjegon se dallimet midis manifestimeve të ndryshme të Materjes, Energjisë, Mendjes e madje edhe Shpirtit, janë tërësisht pasojë e shpeshtësisë së ndryshme të Lëkundjes (Vibrimit). Duke nisur që nga GJITHËSIA që është Shpirt i Pastër, e duke përfunuar te forma më bruto e Materjes, gjithëçka lëkundet. Sa më e lartë lëkundja, aq më i lartë pozicioni në shkallë.

Lëkundja e Shpirtit është aq pafundësisht e shpeshtë dhe e shpejtë, sa që është praktikisht në prehje (qetësi), ashtu siç duket e palëvizshme një rrotë e cila rrotullohet me shpejtësi shumë të madhe. Ndërkohë në skajin tjetër të shkallës, ekzistojnë forma materje bruto, me lëkundje aq të ulëta, sa që duken edhe ato në prehje.

E midis këtyre dy poleve shtrihen miliona e miliona grada të ndryshme lëkundjeje. Që nga grimca e elektronit, atomit e molekulave, deri te botët e universet, gjithëçka lëviz duke u lëkundur. Kjo është njësoj e vërtetë edhe për rrafshet e energjisë dhe forcës (që nuk janë gjë tjetër veçse grada të ndryshme lëkundjeje), për rrafshet mendore (gjendjet e të

cilëve varen nga lëkundjet), e madje edhe për rrafshet shpirtërore.

Përqafimi në mënyrë të drejtë i këtij Parimi, së bashku me formulat e duhura, i mundëson nxënësit Hermetik të kontrollojë lëkundjet mendore, si vetjake, ashtu edhe ato të të tjerëve. Mjeshtrit gjithashtu e aplikojnë këtë Parim për të mposhtur fenomene të Natyrës në mënyra të ndryshme.

"Ai i cili kupton drejtë Parimin e Lëkundjes, ka shtënë në dorë skeptrin e Pushtetit, thotë një nga shkruesit e vjetër.

4. Parimi i Polaritetit

"Gjithçka është e dyzuar, gjithçka ka pole, gjithçka ka çiftin e saj të të kundërtave. Ngjashmëria dhe dallim janë e njëjta gjë. Të kundërtat janë identike në natyrën e tyre, por të ndryshme në gradë. Skajet takohen. Të gjitha të vërtetat nuk janë veçse gjysmë të vërteta. Të gjitha paradokset mund të pajtohen." **– Hermesi** (Thoti, Enoku, Kybalioni)

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se "gjithçka është e dyzuar", "gjithçka ka dy pole", "gjithçka ka çiftin e saj të kundërt",…, të gjitha këto janë aksioma të vjetra Hermetike. Ai shpjegon paradokset e vjetra që kanë munduar njerëz të shumtë e që janë formuluar si vijon: "Teza e antiteza kanë natyrë identike, por ndryshojnë në gradë"; " të kundërtat janë e njëjta gjë, të ndryshme vetëm në gradë", "një çift kundërshtish mund të pajtohet"; "skajet takohen"; "gjithçka është dhe s'është në të njëjtën kohë"; "të gjitha të vërtetat nuk janë veçse gjysmë të vërteta"; "çdo e vërtetë është gjysmë e rreme"; "ka dy anë të gjithçkaje,"etj.

Parimi sqaron se gjejmë dy pole apo aspekte të kundërta në gjithçka, dhe se këto "të kundërta", në të vërtetë, nuk janë veçse dy skaje të së njëjtës gjë, me shumë gradë të ndryshme që qëndrojnë ndërmjet.

Për ilustrim: Nxehtësia dhe Ftohtësia ,megjithëse "të kundërta", në të vërtetë janë e njëjta gjë; dallimi ndërmjet tyre qëndron thjesht në diferencën e gradëve të së njëjtës gjë. Shikoni termometrin tuaj dhe kërkoni nëse mund të gjeni ku mbaron "nxehtësia" e ku fillon "ftohtësia".

Nuk ekziston diçka e tipit "nxehtësi absolute" apo "ftohtësi absolute". Dy termat "nxehtësi" e "ftohtësi" thjeshtë tregojnë diferencë gradash të së njëjtës gjë, dhe kjo " gjë e njëjtë" e cila shfaqet si "nxehtësi" e "ftohtësi", nuk është tjetër veçse një formë, lloj dhe frekuencë Lëkundjeje.

Kështu "nxehtësia" e "ftohtësia" janë thjeshtë "dy pole" të asaj që ne quajmë "ngrohtësi", dhe fenomenet që e shoqërojnë janë shfaqje të Parimit të Polaritetit. I njëjti Parim manifestohet në rastin e "Dritës dhe Errësirës", që janë e njëjta gjë, por me diferencën në gradë që qëndron midis dy poleve të fenomenit.

Ku përfundon "errësira" e ku nis "drita"? Ku qëndron dallimi midis "Madhësisë e Vogëlsisë"? Midis "Fortësisë e Butësisë"? Midis "së Bardhës e së Zezës"? Midis "Mprehtësisë e Topitjes"? Midis "Zhurmës e Qetësisë"? Midis "Lartësisë e Ultësisë"? Midis "Pozitives e Negatives"?

Parimi i Polaritet i sqaron më së miri këto paradokse,e asnjë Parim tjetër nuk mund ta zëvendësojë. I njëjti Parim vepron ne Rrafshin Mendor. Le të marrim një shembull radikal dhe të skajshëm si "Dashuria dhe Urrejtja", dy gjendje

mendore në dukje krejtësisht të ndryshme, e megjithatë, ekzistojnë gradë të Dashurisë e grad të Urretjes dhe diku në mes, një pikë në të cilën përdorim shprehje si "pëlqim" apo "mospëlqim", hijet e të cilave shkrihen aq gradualisht sa ndonjëherë nuk e kuptojmë nëse ndjejmë "pëlqim", "mospëlqim" apo "asnjërën".

E nëse mendoheni një çast do të vini re se të gjitha nuk janë veçse shkallë apo gradë të së njëjtës gjë. Për më tepër (e konsideruar nga Hermetistët me rëndësi të madhe), është e mundur të ndryshohen lëkundjet e Urrejtjes në lëkunjde Dashurie, si në mendjet tona, ashtu edhe në mendjet e të tjerëve.

Shumë prej jush që po i lexoni këto fjalë, keni pasur përvoja vetjake me kalimin e shpejtë e të pavullnetshëm nga Dashuria në Urrejtje dhe anasjelltas, qoftë personale apo të mësuara prej të tjerëve. Ju do të bëheni kështu të aftë të kuptoni se si mund të realizohet kjo duke përdorur Vullnetin nëpërmjet shfrytëzimit të formulave Hermetike.

"E Mira dhe e Keqja" nuk janë veçse pole të së njëjtës gjë, dhe Hermetistët e kuptojnë artin e shndërrimit të së Keqes në të Mirë, duke shfrytëzuar zbatimin e Parimit të Polaritetit. E thënë shkurt, "Arti i Polarizimit" bëhet një nga fazat e "Alkimisë Mendore", e njohur dhe e praktikuar si nga Mjeshtrit e lashtë Hermetikë, ashtu dhe nga ata të sotëm. Njohja e këtij Parimi i mundëson dikujt të ndryshojë Polaritetin e tij dhe atë të të tjerëve, nëse i kushtohet koha dhe studimi i domosdoshëm i njohjes me themel të këtij arti.

5. Parimi i Ritmit

"Gjithçka rrjedh në mënyrë qarkulluese. Gjithçka ka baticën (ngritjen) dhe zbaticën (Uljen) e saj. Çdo gjë ngrihet e bie. Luhatja e lavjerrësit shfaqet në gjithçka; luhatja në të majtë është e barabartë me lëkundjen në të djathtë; ritmi balancon." **– Hermesi** (Thoti, Enoku, Kybalioni)

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se në gjithçka shfaqet një lëvizje prej saj dhe drejt saj; një fluks në dalje e në hyrje; një lëkundje para e pas, një luhatje si ajo e lavjerrësit; një baticë ndërmjet dy poleve në përputhje me Parimin e Polaritetit të përshkruar pak më parë.

Ekziston gjithmonë një veprimi e një kundrveprim, një përparim e një tërheqje, një lartësim e një fundosje. Kjo vlen për të gjithë elementët e Universit, yjet, planetët, botërat, qeniet njerëzore, kafshët, mendjen, energjinë dhe materjen. Ky ligj manifestohet në krijimin dhe shkatërrimin e botëve, në lulëzimin dhe rënien e kombeve, në ciklin jetësor të të gjitha gjërave, e në fund, edhe ne gjendjet mendore të Njeriut (ku sipas Hermetisëve qëndron edhe rëndësia kryesore e të kuptuarit të këtij Parimi).

Hermetistët e kanë kuptuar mirë Parimin dhe zbatimin e tij universal, duke zbuluar gjithashtu disa mënyra për t'iu shmangur efektit të tij mbi ta, nëpërmjet përdorimit të formulave dhe metodave të duhura. Ata zbatojnë Ligjin Mendor të Asnjanësimit. Ata nuk mund të shfuqizojnë Parimin apo ta ndalin veprimin e tij, por kanë mësuar si t'i shmangen ndikimeve të tij në njëfarë mase, në vartësi të nivelit të njohjes së Parimit.

Ata kanë mësuar si ta PËRDORIN atë, në vend që të jenë të PËRDORUR prej tij. Pikërisht në këtë e në metoda të ngjashme konsiston Arti i Hermetistëve. Mjeshtri i Hermetikës polarizon vetveten në pikën ku dëshiron të prehet, e më pas asnjanëson luhatjen Ritmike të lavjerrësit i cili do të prirej ta zhvendoste drejt polit tjetër.

Të gjithë individët që kanë arritur të fitojnë njëfarë vetëkontrolli, e bëjnë këtë pak a shumë në mënyrë të pavetëdijshme, por Mjeshtri e bën në mënyrë të vetëdijshme duke përdorur Vullnetin e tij, e duke arritur një gradë të tillë Drejtpeshimi e Qëndrueshmërie Mendore, e cila është pothuajse e pabesueshme nga masat, të cilat luhaten para e pas si një lavjerrës.

Ky Parim, së bashku me atë të Polaritetit, janë studiuar nga afër nga Hermetistët dhe metodat e kundërveprimit, asnjanësimit dhepërdorimit të tyre, përbëjnë një pjesë të rëndësishme të Alkimisë Mendore Hermetike.

6. Parimi i Shkakut dhe Pasojës

"Çdo Shkak ka Pasojën e tij; çdo Pasojë ka Shkakun e saj; gjithçka ndodhë në përputhje me ligjin. Rastësi nuk është veçse emri që i japim një Ligjësie të panjohur. Ekzistojnë shumë rrafshe shkakësie, por asgjë nuk i shpëton Ligjit." **– Hermesi** (Thoti, Enoku, Kybalioni)

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se ekziston një Shkak për çdo Pasojë, e një Pasojë për çdo Shkak. Ai sqaron se "gjithçka ndodhë në përputhje me Ligjin"; se asgjë nuk ndodhë "thjeshtë sepse ndodhë"; se nuk ekziston diçka si Rastësia, se megjithëse ka rrafshe të ndryshme Shkaku e

Pasoje, ku rrafshet e epërme dominojnë të poshtmet, përsëri asgjë asnjëherë nuk i shpëton plotësisht Ligjit.

Hermetistët e kuptojnë artin e metodat e lartësimit mbi rrafshin e rëndomtë të Shkakut dhe Pasojës deri në një farë mase, e duke u ngritur mendërisht në një rrafsh më të lartë, ata kthehen në Shkaktarë në vend që të përsojnë Pasoja. Masat e gjera merren përpara nga rryma, të bindura ndaj ambientit rrethues, ku vullnetet dhe dëshirat e atyre më të fortë se ta, trashëgimia, sugjestioni e shkaqe të tjera të jashtme i lëvizin si ushtarë mbi fushën e shahut të Jetës.

Por Mjeshtrit duke u ngritur në rrafshin e sipërm, domonojnë gjendjet e tyre shpirtërore, karakterin, cilësitë e forcat, si edhe ambientin që i rrethon, duke u kthyer në Lojtarë në vend të jenë ushtarë. Ata ndihmojnë TË LUHET LOJA E JETËS, në vend që të jenë thjeshtë pjesë e lojës, të lëvizur nga mjedisi rrethues apo nga vullneti i të tjerëve.

Ata e PËRODRIN Parimin në vend që të jenë mjet i tij. Mjeshtrit i binden Shkakësisë së rrafsheve më të larta, por ndihmojnë të Sundohet rrafshi i tyre. Në këtë pohim përmblidhet një thesar njohurie Hermetike. Le ta kuptojë ai që mundet.

7. Parimi i gjinisë

"Gjinia ekziston në çdo gjë;gjithçka ka Parimet e saj Mashkullore e Femërore,Gjinia manifestohet në të gjitha rrafshet." **– Hermesi** (Thoti, Enoku, Kybalioni)

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se GJINIA shfaqet në gjithçka. Parimet Mashkullore e Femërore veprojnë në mënyrë të vazhdueshme. Kjo vlen jo vetëm për Rrafshin

Fizik, por edhe për rrafshet Mendore e Shpirtërore. Në Rafshin Fizik, Parimi manifestohet në formën e Seksit, ndërkohë që në rrafshe më të larta merr forma më të larta; në çdo rast gjithmonë i vlefshëm. Pa këtë Parim, krijimi qoftë fizik, qoftë mendor apo shpirtëror është i pamundur.

Përqafimi i ligjeve të tij, hedh dritë mbi shumë çështje që kanë trazuar mendjet e njerëzve. Parimi i Gjinisë vepron gjithmonë në drejtim të gjenerimit, rigjenerimit dhe krijimit. Gjithçka e çdokush, mbart brenda tij ose saj dy Elementet e Parimit, ose vetë Parimin.

Gjithçka Mashkullore ka Elementet Femërore dhe anasjelltas, gjithçka Femërore mbart në vevete Parim Mashkullor. Nëse dëshironi të kuptoni filozofinë e Krijimit, Gjenerimit apo Rigjenerimit Mendor e Shpirtëror, duhet të studioni dhe të kuptoni këtë Parim Hermetik. Ai përmban zgjidhjen e shumë mistereve të Jetës.

Ju paralajmërojmë se ky Parim nuk ka asnjë lidhje me mësimet, praktikat dhe teoritë e shumta të rëndomta, të dëmshme dhe degraduese epshore, të cilat përhapen nën tituj të trilluar, që nuk janë gjë tjetër veçse një prostitucion i Parimit të madh natyral të Gjinisë, të formave të lashta famëkeqe të Falicizmit, që priren të shkatërrojnë mendjen, trupin dhe shpirtin.

Filozofia Hermetike i ka rënë gjithmonë këmbanës së alarmit kundër këtyre mësimeve degraduese, të cilat priren drejt epshit, shthurrjes e zvetësimit të parimev të Natyrës. Nëse janë mësime të tilla ato mësime që kërkoni, duhet të drejtoheni tjetërkund. Hermetizmi nuk përmban asgjë për ju në këtë drejtim. Për të pastrin, gjithçka është e dëlirë. Për të ndyrin, gjithçka është e ndyer (fëlliqur).

Pra, "Mendja (ashtu si metalet dhe elementet) mund të shndërrohet nga një gjendje në një tjetër. Nga një gradë në një tjetër, nga një konditë në një tjetër. Nga poli në pol, nga lëkundjet në lëkundje. Shndërrimi i Vërtetë Hermetik, është një Art Mendor", dhe ky Art në Hermetizëm quhet ***Transmutacioni Mendor.***

5.Transmutacioni Mendor

Siç e kemi thënë më lartë, Hermetistët ishin alkimistët, astrologët dhe psikologët e parë dhe Hermesi ishte themeluesi i këtyre shkollave të mendimit. Nga astrologjia u zhvillua astronomia bashkëkohore, nga alkimia hodhi rrënjë kimia e ditëve të sotme dhe nga psikologjia mistike u rrit psikologjia bashkëkohore që studiohet në shkolla.

Por nuk duhet hamendësuar se të parët qenë injorantë në ato fusha, për të cilat sot shkolla pretendon se i ka prona të veta të patjetërsueshme.

Hieroglifet e gdhendura, të plota, gjithëpërfshirëse mbi astronominë, Vetë Piramidat janë dëshmitare të lidhjes së ngushtë midis projektimit të tyre dhe studimit të shkencës së astronomisë. Ata nuk ishin injorantë as në Kimi, sepse fragmentet e shkrimeve të lashta tregojnë se njihnin më së miri vetitë kimike të sendeve. Për më tepër, teoritë e lashta mbi fizikën po vërtetohen ngadalë nga zbulimet e shkencës bashkohore, sidomos ato që kanë të bëjnë me përbërjen e materjes. Nuk duhet hamendësuar as për injorancën e tyre mbi të ashtuquajturat zbulime bashkëkohore në psikologji, përkundrazi, Egjiptianët ishin veçanërisht të talentuar në

shkencën e Psikologjisë, posaçërisht në degë që shkolla bashkëkohore nuk i merr parasysh, të cilat sidoqoftë po dalin në shesh nën emrin e "shkencave psiqike", duke i vënë në ngurrim se "ndoshta mund të ketë diçka të vërtetë në to në fund të fundit".

E vërteta është se nën kiminë, astronomonë dhe psikologjinë materiale (nënkuptohet psikologja në fazën e saj të studimit të mekanikës së trurit), të parët zotëronin një njohuri mbinatyrore të astronomisë të quajtur ***astrologji***, një njohuri mbinatyrore të kimisë të quajtur ***alkimi*** dhe një njohuri mbinatyrore të pikologjisë të quajtur ***psikologji mistike***.

Ata zotëronin si Njohurinë e Brendshëme, ashtu edhe Njohurinë e Jashtme, ndërkohë që shkencëtarët bashëkohorë zotërojnë vetëm të dytën. Midis shumë degëve të fshehta të diturisë së zotëruar nga Hermetistët, është edhe ajo që njihet si *Transmutacioni Mendor*.

"***Trasmutacioni***", është fjala që përdoret zakonisht për të përshkruar artin e lashtë të shëndërrimit të metaleve, sidomos të metaleve bazë, në ar. Fjala "trasmutacioni" do të thotë "***Shndërrim*** i natyrës, formës apo substancës, në diçka tjetër - ***Transformim***".

Në përputhje me këtë "*Trasmutacioni Mendor*" nënkupton artin e ndryshimit dhe shëndrrimit të gjendjeve mendore, formave dhe konditave, në të tjera. Parë në këtë prizëm, Shndërrimi Mendor është "Arti i Kimisë Mendore" nëse kjo shprehje ju duket e pëlqyeshme; një formë praktike e Psikologjisë Mistike.

Kjo nënkupton shumë më tepër nga sa duket në sipërfaqe. Shndërrimi, Alkima apo Kimia në Rrafshin Mendor

ka një rëndësi aq të madhe ndikuese, sa edhe sikur arti të kufizohej me aq, përsëri do të ishte një nga degët më të rëndësishme të studimit që njeriu ka njohur ndonjëherë. Por ky është vetëm fillimi. Le të shikojmë përse!

I Pari nga shtatë Parimet Hermetike, është Parimi i Mentalizmit, aksioma e të cilit thotë: ***"GJITHËSIA është Mendje - Universi është Mendor".*** Kjo do të thotë se Realiteti Themeltarë i Universit është Mendja dhe se vetë Universi është Mendor, çka do të thotë se "ekziston në mendjen e GJITHËSISË". Ti shohim efektet e tij të menjëhershme nëse e pranojmë si të vërtetë këtë Parim.

Nëse natyra e Universit është mendore, atëherë Shndërrimi Mendor duhet të jetë arti i NDRYSHMIT TË KONDITAVE TË UNIVERSIT përgjatë trajtave të Materjes, Forcës dhe Mendjes. Siç e shikoni pra, Shndërrimi Mendor është në të vërtetë "Magjia" të cilën shkruesit e lashtë e përmendin aq shpesh në veprat mistike, duke dhënë për të aq pak udhëzime praktike. Nëse Gjithçka është Mendore, atëherë arti që mundëson shndërrimin e kushteve mendore, duhet ta kthejë Mjeshtrin në kontrolluesin e kushteve apo konditave si materiale, ashtu edhe të atyre të quajtura rëndom "mendore".

Në fakt, askush tjetër përveç Alkimistëve Mendorë të avancuar nuk ka qenë i aftë të zotërojë nivelin e nevojshëm të forcës për të kontrolluar fenomene fizike me peshë, si kontrolli i elementëve të Natyrës; prodhimi apo ndalimi i stuhive, prodhimi apo ndalimi i tërmetëve e fenomeneve të tjera Universale fizike.

Por fakti që njerëz të tillë kanë ekzistuar e vazhdojnë akoma të ekzistojnë sot e kësaj dite, pranohet me seriozitet nga të gjithë okultistët e avancuar të të gjitha shkollave.

Mësuesit më të aftë, i sigurojnë Nxënësit e tyre se Mjeshtrit ekzistojnë dhe i kanë këto fuqi, duke qenë se ata vetë kanë pasur përvoja që justifikojnë besimin dhe deklaratat e tyre. Këta Mjeshtra nuk japin shfaqje publike të fuqive të tyre, por përpiqen të veçohen nga turmat në mënyrë që të shtrojnë sa më mirë Udhën e tyre drejt Lartësimit.

Ne e përmendëm ekzistencën e tyre në këtë pikë, thjeshtë për të tërhequr vëmendjen tuaj në faktin që fuqia e tyre është tërësisht mendore, dhe vepron përgjatë trajtave të Shndërrimit të lartë Mendor, nën Parimin Hermetik të Mentalizimit: ***"Universi është Mendor".***

6.Një studim i Filozofisë Hermetike të Egjyptit të Lashtë dhe Greqisë

"Buzët e Urtësisë janë të kyçura, përveçse për veshët e Arsyes" **– Hermesi** (Thoti, Enoku, Kybalioni)

Mësimet themelore ezoterike dhe okulte, të cilat kanë ndikuar kaq fuqimisht filozofitë e të gjitha racave, kombeve dhe popujve, për mijëra e mijëra vite, e kanë origjinën në Egjyptin e Lashtë. Egjypti, shtëpia e Piramidave dhe e Sfinksit, ishte vendlindja e Diturisë së Fshehtë dhe e Doktrinave Mistike.

Të gjitha kombet huazuan nga Doktrina e tij e Fshehtë. India, Persia, Kaldea, Medea, Kina, Japonia, Siria, Greqia e Roma e lashtë, si edhe qytetërime të tjera të lashta, morën pjesë bujarisht në gostinë e diturisë, të cilën Hierofantët dhe Mjeshtrit e Truallit të Thotit e të Isisit e shtruan lirisht për ata që erdhën të bëhen pjesë e rezervës së madhe të Njohurisë

Mistike e Okulte, që kishin mbledhur mendjendriturit e asaj toke të lashtë.

Në Egjiptin e lashtë rronin Dijetarët dhe Mjeshtrit e mëdhenj të cilët kurrkush nuk i ka tejkaluar, e rrallëkush i ka barazuar gjatë shekujve që i ndajnë nga ditët e Hermesit të Madh. Në Egjypt ndodhej e Madhërishmja Lozhë e Lozhave e Mistikës. Në dyert e tempullit të saj hynë Neofitët, të cilët më pas si Hierofantë, Dijetarë dhe Mjeshtra, udhëtuan në të katër cepat e botës, duke mbartur me vete dijen e vyer, të cilën ishin të gatshëm, të ethshëm e plot dëshirë t'ua përçonin atyre që ishin gati për të. Të gjithë nxënësit e Okultizmit e njohin borxhin që i detyrohen Mjeshtrave të përnderuar të asaj toke të lashtë.

Midis këtyre Mjeshtrave të Mëdhenj të Egjyptit të Lashtë, njëherë e një kohë rronte dikush të cilin ata e nderonin si "Mjeshtri i Mjeshtrave." Ky njeri, nëse "njeri" ishte vërtetë, rronte në Egjypt në ditët e hershme. Ai njihej si **Thoti** (më vonë si Enoku dhe Hermes Trismegistus). Ai është babai i Diturisë Okulte; themeluesi i Astrologjisë; zbuluesi i Alkimisë. Detajet e bëmave të jetës së tij janë të humbura për historinë në rrjedhën e viteve, e megjithatë shumë nga vendet e lashta kanë debatuar me njëra-tjetrën pretendimet se cila prej tyre kishte nderin të ishte vendlindja e tij, kjo mijëra vjet më parë.

Data e qëndrimit të tij në Egjipt, që përbën mishërimin e tij të fundit mbi këtë planet nuk dihet, por është vlerësuar në ditët e hershme të dinastive më të vjetra të Egjyptit; shumë kohë përpara ditëve të Moisiut. Autoritetet më të larta e konsiderojnë si bashkëkohës i Abrahamit, dhe disa gojëdhëna hebraike shkojnë edhe më tej, duke pretenduar se Abrahami e

ka përfituar një pjesë të diturisë së tij mistike nga vetë Hermesi.

Me kalimin e viteve pasi ai ndërroi jetë (gojëdhëna thotë se ai jetoi treqind vjet), Egjyptianët e hyjnizuan Hermesin, duke e bërë atë një nga perënditë e tyre nën emrin e Thotit. Vite më pas, edhe populli i Greqisë së Lashtë e bëri një nga perënditë e tij të shumta, duke e quajtur "Hermes, Zoti i Diturisë." Egjyptianët e nderuan kujtimin e tij për shumë shekuj, për dhjetëra shekuj, duke e quajtur "Shkruesi i Perëndive" e duke i akorduar vetëm atij në veçanti, titullin e tij të vjetër "Trismegistus", që do të thotë "Tri herë i madhi", "i madhi i të mëdhenjve", "më i madhi i të mëdhenjve" etj. Në të gjitha tokat e lashtësisë, emri i Hermes Trismegistusit nderohej duke qenë sinonim me numrin 12, me "Burim Diturie".

Edhe sot e kësaj dite, ne e përdorim termin "hermetik" me kuptimin "sekret", "i mbyllur në mënyrë të tillë që asgjë nuk mund të dalë", "i padepërtueshëm" etj., e kjo si pasojë e faktit që pasuesit e Hermesit, gjithmonë mbajtën parasysh parimin e fshehtësisë në mësimdhëniet e tyre. Ata nuk besonin në "hedhjen e perlave derrave", por i përmbaheshin fjalës së urtë "qumësht për foshnjat; mish për burrat e fortë", të dyja këto shprehje të njohura për lexuesit e shkrimeve të shenjta të Krishtere, por që të dyja të përdorura nga Egjyptianët për shekuj të tërë përpara erës së Krishterë.

Kjo politikë e propagandimit të kujdesshëm të të vërtetës i ka karakterizuar gjithmonë Hermetistët, madje edhe sot e kësaj dite. Doktrinat Hermetike mund të gjenden në çdo truall, ndër të gjitha fetë, por asnjëherë të identifikuara me një shtet të caktuar apo ndonjë sekt fetar të veçantë. Kjo për shkak të

paralajmërimit të mësuesve të lashtë, për të mos e lejuar kristalizimin e Doktrinës së Fshehtë në një fe.

Urtësia e kësaj kështille është e dukshme për të gjithë studentët e historisë. Okultizmi i lashtë i Indisë e Persisë degjeneroi dhe humbi gjerësisht si pasojë e faktit që mësuesit u kthyen në priftërinj, duke përzierë teologjinë me filozofinë, e duke sjellë si pasojë humbjen graduale të okultizmit Indian e Persian në lëmshin e masës së kulteve supersticioze fetare, besëtytnive dhe "perëndive". Kështu ndodhi me Greqinë dhe Romën e Lashtë.

Kështu ndodhi me Mësimet Hermetike të Gnostikëve dhe të Krishterëve të Hershëm, të cilat humbën në kohën e Konstandinit, dora e hekurt e të cilit e mbyti filozofinë me shtrojën e teologjisë, duke i shkulur Kishës së Krishterë atë çka ishte thelbi e shpirti i saj, e duke e bërë të endej kuturu për shekuj të tërë përpara se të gjente sërish udhën për te besimi i saj i vjetër; shenja këto të dallueshme lehtësisht nga të gjithë vëzhguesit e vëmendshëm në këtë Shekull të Njëzet e Një, kur Kisha tashmë po lufton t'u kthehet pas mësimeve të saj të lashta mistike.

Por ka pasur gjithmonë disa shpirtra besnikë të cilët e kanë mbajtur të gjallë Flakën, janë përkujdesur për të e nuk kanë lejuar që drita e saj të venitet. Dhe është falë këtyre zemrave të patrembura e mendjeve të patundura, që e kemi ende të Vërtetën mes nesh. Por e Vërteta nuk gjendet në libra. Ajo është përçuar nga Mjeshtri te Nxënësi, nga Rishtari te Hierofanti, e pështëritur në vesh. E nëse ndonjëherë është shkruar, kuptimi i saj është mbuluar nën vellon e termave të alkimisë e astrologjisë, në mënyrë që vetëm ata të cilët zotërojnë çelësin të mund ta lexojnë drejtë.

Kjo u bë e domosdoshme në mënyrë që të shmangeshin përndjekjet e teologëve të mesjetës, të cilët e luftuan Doktrinën e Fshehtë me zjarr e shpatë, turrë drushë, trekëmbësh dhe kryq. Edhe sot nuk mund të gjenden veçse fare pak libra të besueshëm mbi Filozofinë Hermetike, paçka se ekzistojnë adresime të panumërta ndaj saj në shumë libra të shkruar në faza të ndryshme të Okultizmit. Prapëseprapë, Filozofia Hermetike është Çelësi i vetëm Universal i cili do të hapë të gjitha dyert e Mësimeve Okulte.

Në ditët e hershme, ekzistonte një përmbledhje e disa Doktrinave Themelore Hermetike, të përçuara nga mësuesi te nxënësi, e njohur me emrin "Kybalion", një fjalë së cilës domethënia e kuptimi i kanë humbur prej shumë shekujsh. E megjithatë, ato që kjo përmbledhje mëson, njihen nga disa persona të cilëve u është përçuar gojarisht e brez pas brezi. Normat e saj nuk janë shkruar apo shtypur kurrë me aq sa dimë.

Kanë qenë thjesht një koleksion parimesh, aksiomash dhe normash, të cilat ishin të pakuptueshme për të huajt, por menjëherë të zbërthyeshme nga nxënësit në momentin që këto parime, aksioma e norma, u shpjegoheshin e ilustroheshin me shembuj Neofitëve nga Rishtarët Hermetikë.

Këto mësime përbënin në të vërtetë principet bazë të "Artit të Alkimisë Hermetike", i cili ndryshe nga sa besohet masivisht, merrej me Mjeshtërinë e Forcës Mendore dhe jo me Elementët Materialë. Shndërrimin e Lëkundjeve Mendore nga një lloj në një tjetër, dhe jo shndërrimin e një lloj metali në një tjetër. Legjenda e "Gurit Filozofik" i cili do të kthente metale bazë ne flori, ishte një alegori që kishte lidhje me Filozofinë

Hermetike, lehtësisht e kuptueshme nga të gjithë nxënësit e Hermeticizmit të vërtetë.

Ne pra, ju japim këtu shumë nga parimet, aksiomat e normat e Kybalion-it, të shoqëruara me shpjegime dhe ilustrime të cilat ne gjykojmë se kanë më shumë gjasë t'i bëjnë mësimet lehtësisht të kuptueshme nga nxënësi i sotëm, kryesisht për faktin se teksti origjinal është qëllimisht i mbuluar nën vellon e terminologjisë së errët.

I tillë është Ligji. Parimi Hermetik i Shkakut dhe Pasojës, nën këndvështrimin e tij të Ligjit të Tërheqjes, do të bëjë bashkë buzët dhe veshët, nxënësin dhe librin.
Kështu u bëftë!

7.**Gjithësia është mendja, Universi është mendimi**

"Universi është mendor, i përfshirë në mendjen e gjithësisë."* – Hermesi** ***(Thoti, Enoku, Kybalioni)

GJITHËSIA është SHPIRT! Por çfarë është Shpirti? Kësaj pyetjeje nuk mund t'i jepet përgjigje, pasi përkufizimi do të ishte vetë GJITHËSIA, çka nuk mund të shpjegohet e as të përkufizohet. Shpirt është thjesht emri të cilin njerëzit i japin konceptit më të lartë të Mendjes së Gjallë të Pafundme. Shpirt do të thotë "Thelb i Vërtetë", do të thotë Mendje e Gjallë më e lartë se Mendja e Jeta që njohim, ashtu siç qëndrojnë këto të fundit më lart se Energjia mekanike dhe Materja. Shpirti e tejkalon botëkuptimin tonë dhe ne e përdorim këtë fjalë thjeshtë që të kemi mundësi të mendojmë apo flasim për GJITHËSINË. Jemi të justifikuar kur mendojmë për Shpirtin si të ishte një Mendje e Gjallë e Pafundme për arsye studimi e

arsyetimi, për sa kohë pranojmë njëkohësisht se nuk mund ta kuptojmë atë plotësisht. Duhet patjetër t'i përmbahemi këtij pohimi, ose përfundimisht të mos mendojmë më mbi këtë çështje.

Le ta trajtojmë tani natyrën e Universit në GJITHËSINË e tij dhe në pjesët përbërëse. Çfarë është Universi? Kemi parë se nuk mund të ketë asgjë jashtë GJITHËSISË. Atëherë a është Universi GJITHËSIA? Jo, ai nuk mund të jetë, pasi Universi duket se përbëhet nga shumë gjëra dhe është në ndryshim të vazhdueshëm, e përfundimisht nuk përputhet as me idetë e formuluara në kapitullin paraardhës mbi GJITHËSINË, të cilat jemi të shtrënguar ti pranojmë.

Nëse Universi nuk është GJITHËSIA, atëherë është "Asgjë". Ky do të ishte përfundimi i menjëhershëm i mendjes pa arsyetuar gjatë. Por as kjo përgjigje nuk mund të jetë e kënaqshme për pyetjen tonë, pasi ne jemi të ndjeshëm ndaj ekzistencës së Universit. Atëherë nëse Universi nuk është as GJITHËSIA e as "Asgjë", çfarë mund të jetë? Le ta shqyrtojmë pyetjen. Si në rastin kur Universi ekziston vërtetë, ashtu edhe në rastin kur duket sikur ekziston, ai duhet të burojë në ndonjë farë mënyre nga GJITHËSIA, pra duhet të jetë një krijim i GJITHËSISË. Por meqenëse diçka nuk mund të vijë kurrë nga hiçi, nga çfarë mund ta ketë krijuar GJITHËSIA atë? Disa filozofë i janë përgjigjur kësaj pyetjeje duke thënë se GJITHËSIA e krijoi Universin nga VETEVETJA, domethënë nga qenia dhe nga substanca e vetë GJITHËSISË.

Por kjo nuk mund të jetë e vërtetë pasi siç e pamë, GJITHËSIA nuk mund të ndahet dhe as të hiqet diçka prej saj. Nëse do të qe vërtetë kështu, a nuk do të ishte vallë çdo grimcë në Univers e vetëdijshme për faktin se është GJITHËSIA?

GJITHËSIA nuk mund të humbë vetëdijen e as të KTHEHET në atom, forcë të verbër apo gjallesë të rëndomtë.

Njerëz të ndryshëm pasi rrokën idenë se GJITHËSIA është realisht GJITHÇKA, dhe duke pranuar që ata, njerëzit, ekzistonin, u hodhën në përfundimin se ata dhe GJITHËSIA ishin identikë, e kështu nisën të thërrisnin në kupë të qiellit "UNË JAM ZOTI", duke dëfryer turmat e duke pikëlluar të urtët. Pretendimi i një atomi "Unë jam Njeri!" do të ishte më modest krahasuar me deklaratat e tyre.

Por vërtetë, çfarë është Universi nëse nuk është GJITHËSIA, e as krijim i GJITHËSISË, duke fragmentuar vetveten në pjesë? Ç'tjetër mund të jetë, prej ç'të jetë krijuar? Kjo është pyetja e madhe. Le ta shqyrtojmë me kujdes. Vërejmë se këtu na vjen në ndihmë "Parimi i Përkimit". Aksioma e vjetër Hermetike: "Si lart, ashtu edhe poshtë", mund të bëhet e dobishme në këtë pikë. Le të përpiqemi të hedhim një shikim në çështjet e rrafsheve të epërme duke shqyrtuar ato në rrafshin tonë. Parimi i Përkimit është i zbatueshëm si në këtë rast, ashtu edhe në të tjerë.

Të shikojmë pak. Si krijon Njeriu në rrafshin e tij ekzistencial? Së pari, ai mund të krijojë duke ndërtuar diçka prej materialeve që e rrethojnë. Por kjo nuk mund të vlejë në rastin tonë, pasi nuk ka materiale jashtë GJITHËSISË me të cilat mund të krijohet diçka. Së dyti, ai shumon apo riprodhon specien e tij nëpërmjet procesit të çiftimit, që është riprodhim i përfituar nëpërmjet transferimit të një pjese të substancës së tij te filizat e rinj. Por edhe ky nuk mund të jetë rasti që kërkojmë pasi GJITHËSIA as nuk mund të transferojë apo të heqë një pjesë nga vetvetja, e as mund të riprodhojë apo shumëfishojë veten. Në rastin e parë diçka do të zbritej apo hiqej prej saj, e

në rastin e dytë GJITHËSIA do të shtohej apo shumëfishohej. Që të dy rastet pra përbëjnë absurditet. A ka vallë një mënyrë të tretë nëpërmjet të cilës Njeriu mund të krijojë? Patjetër që ka. Njeriu KRIJON MENDËRISHT. E duke vepruar në këtë mënyrë, ai nuk përdor materiale të jashtme dhe as shumëfishohet, e megjithatë Shpirti i tij përmbush Krijimin Mendor. Duke zbatuar Parimin e Përkimit, mbërrijmë në arsyetimin e justifikuar, se GJITHËSIA e krijon Universin MENDËRISHT, në një mënyrë të ngjashme me procesin nëpërmjet të cilit Njeriu krijon Imazhet Mendore. Është pikërisht këtu që zëri i Arsyes përputhet saktësisht me zërin e të Përndriturve, siç dëshmohet edhe nga mësimet e shkrimet e këtyre të fundit. Të tilla janë mësimet e të Urtëve. Të tilla ishin mësimet e Hermesit.

GJITHËSIA nuk mund të krijojë në mënyrë tjetër përveçse mendërisht, pa përdorur material (sepse nuk ka të tillë për t'u përdorur), e pa u riprodhuar (çka është gjithashtu e pamundur). Nuk ka arrati prej këtij konkluzioni të Arsyes, i cili siç e thamë më lart, është në ujdi me mësimet më të rëndësishme të të Përndriturve. Ashtu siç ju, një nxënës, mund të krijoni në mendjen tuaj një Univers tuajin, ashtu edhe GJITHËSIA krijon Universe në Mendjen e saj.

Por Universi juaj është krijim mendor i një Mendjeje të Fundme, ndërkohë që ai i GJITHËSISË është krijim i një Mendjeje të Pafundme. Të dy janë të ngjashëm në natyrën e tyre, por pafundësisht të ndryshëm në gradë. Do ta trajtojmë më nga afër procesin e krijimit dhe manifestimit teksa përparojmë më tej. Por ajo çka duhet të ngulitni në mendje në këtë pikë është: UNIVERSI DHE GJITHÇKA AI PËRMBAN,

ËSHTË NJË KRIJIM MENDOR I GJITHËSISË. Pa asnjë pikë dyshimi GJITHËSIA ËSHTË MENDJE!

"GJITHËSIA krijon në Mendjen e saj të Pafundme Universe të panumërt, të cilët ekzistojnë në amshim; e megjithatë, për GJITHËSINË, krijimi, zhvillimi, rënia dhe vdekja e një milion universeve zgjat sa një pulitje qepallash." **– Hermesi** (Thoti, Enoku, Kybalioni)

"Mendja e Pafundme e GJITHËSISË është gjiri i Universeve." **– Hermesi** (Thoti, Enoku, Kybalioni)

Parimi i Gjinisë manifestohet në të gjitha rrafshet e jetës, materiale, mendore apo shpirtërore qofshin. Por siç e kemi përmendur edhe më lart, "Gjini" nuk do të thotë "Seks". Seksi është thjesht një manifestim material i gjinisë.

"Gjinia" është "ajo çka ka lidhje me gjenerimin apo krijimin". Kurdo që diçka gjenerohet apo krijohet, në cilindo rrafsh, manifestohet doemos Parimi i Gjinisë. Dhe kjo vlen edhe për krijimin e Universeve.

Mos u hidhni në përfundimin e nxituar se po ju mësojmë që ka një Zot ose Krijues mashkull apo femër. Kjo ide nuk është tjetër veçse një shtrembërim i mësimeve të lashta mbi këtë çështje. Doktrina e vërtetë thotë se GJITHËSIA në vetvete, qëndron mbi Gjininë, ashtu siç qëndron mbi çdo Ligj tjetër, përfshirë ata të Hapësirës e Kohës.

GJITHËSIA është LIGJI nga i cili burojnë Ligjet e nuk u nënshtrohet këtyre të fundit. Por kur GJITHËSIA manifestohet në rrafshin e gjenerimit apo Krijimit, atëherë vepron në përputhje me Ligjin dhe Parimet, për vetë faktin se po zhvendoset në një rrafsh më të ulët të Ekzistencës. Si pasojë, GJITHËSIA manifeston Parimin e Gjinisë në aspektin Mashkullor e Femëror, natyrisht në rrafshin mendor.

Kjo ide mund të tingëllojë befasuese për disa nga ju që e dëgjojnë për herë të parë, por në të vërtetë, të gjithë ju e keni pranuar në mënyrë pasive në botëkuptimin e përditshëm. Ju flisni për Atësinë e Zotit dhe Amësinë e Natyrës, për Zotin, Atin e Shenjtë, e për Natyrën, Mëmën Universale, duke pranuar instinktivisht Parimin e Gjinisë në Univers.

Nga ana tjetër, mësimet Hermetike nuk nënkuptojnë një dyzim të vërtetë. GJITHËSIA është NJË. Dy Aspektet nuk janë veçse aspekte të thjeshta të manifestimit. Sipas mësimeve, Parimi Mashkullor i shfaqur nga GJITHËSIA qëndron në një farë mënyre i ndarë nga krijimi mendor ekzistues i Universit. Ai ushtron Vullnetin e tij mbi Parimin Femëror (i cili mund të quhet "Natyrë") e kështu ky i fundit nis punën e vërtetë të evolucionit të Universit, që nga "qendrat e thjeshta të aktivitetit" deri tek njeriu, dhe më tutje e më lart akoma, gjithçka në përputhje me Ligjet e ngahershme e të prera të Natyrës. Nëse preferoni mënyrën e vjetër figurative të të menduarit, mund ta mendoni Parimin Mashkullor si ZOTI, Ati, dhe Parimin Femëror si NATYRA, Mëma Universale nga gjiri i së cilës ka lindur gjithçka.

Kjo është shumë më tepër se një figurë poetike, është një ide e procesit real të krijimit të Universit. Por mos harroni kurrë se GJITHËSIA është gjithmonë NJË dhe është pikërisht brenda mendjes së saj që Universi gjenerohet, krijohet dhe ekziston. Zbatimi i Ligjit të Përkimit mbi veten dhe mendjen tuaj, mund t'ju ndihmojë të kuptoni më saktë këtë ide. Ju e dini që pjesa juaj të cilën e quani "Unë", në një farë mënyre qëndron veçmas dhe vështron krijimin e Imazheve Mendore në mendjen tuaj. Pjesa në mendjen tuaj në të cilën kryhet gjenerimi mendor mund të quhet "Mua", e dallueshme nga

"Unë" që qëndron veçmas si dëshmitar pasiv dhe vëzhgon mendimet, idetë dhe imazhet e gjeneruara nga "Mua". Mos harroni "Si lart, ashtu edhe poshtë" dhe fenomenet e njërit rrafsh të jetës mund të shfrytëzohen për të zbardhur misteret në rrafshe të tjera, më të larta apo më të ulëta.

Nuk ju duket vallë e çuditshme që Ju, bijtë, ndjeni një nderim instinktiv për GJITHËSINË, ndjenja të cilat i quajmë "fé", respekt e përulësi për MENDJEN ATËRORE? Nuk ju duket vallë e çuditshme që kur vështroni veprat dhe mrekullitë e Natyrës, përfshiheni nga një ndjenjë e fuqishme e cila i ka rrënjët thellë brenda qenies suaj?

Kjo ndodh sepse ngjisheni butë pas MENDJES AMËNORE ashtu siç bën një foshnjë pas gjirit.

Mos bëni gabimin të mendoni se kjo botë e vogël që shikoni përreth jush, Toka, e cila nuk është veçse një grimcë pluhuri në Univers, është vetë Universi. Ekzistojnë miliona e miliona botë të tilla, e më të mëdha akoma. Dha ka miliona e miliona Universe që ekzistojnë Brenda Mendjes së Pafundme të GJITHËSISË. Madje edhe në sistemin tone të vogël diellor ka zona e rrafshe jetësore shumë më të larta se tonat, e qenie krahasuar me të cilat, ne, të vdekshmit tokësorë, ngjajmë sikundër format baltake jetësore që rrojnë në shtratin e oqeanit kur krahasohen me Njeriun. Ekzistojnë qenie me fuqi dhe atribute më të larta se ato që Njeriu mund të imagjinojë se vetëm Perënditë i zotërojnë. E megjithatë, këto qenie dikur kanë qenë si ju, madje edhe më poshtë, e ju një ditë do të jeni si ato, madje edhe më lart me kalimin e kohës, sepse i tillë është shkruar Fati i Njeriut në kumtimet e të Përndriturve.

Vdekja nuk është reale as në kuptimin relativ të fjalës, ajo nuk është veçse Lindja në një jetë të re. Ju do të ngjiteni e

ngjiteni, lart e më lart në rrafshe jetësore, në përjetësinë e kohës. Universi është shtëpia juaj dhe ju do të eksploroni edhe skutën më të largët të tij përpara fundit të Kohërave. Ju jetoni në Mendjen e Pafundme të GJITHËSISË dhe keni mundësi e shanse të pafundme si në Kohë ashtu edhe në Hapësirë.

Dhe në fund të Ciklit të Madh të Kohërave, kur GJITHËSIA do të tërheqë pas brenda vetvetes të gjitha krijimet e saj, ju do të shkoni buzagaz, sepse atëherë do të jeni të aftë të njihni të Gjithë të Vërtetën e të qenit Një me GJITHËSINË. Ky është kumtimi i të Përndriturve, i atyre që kanë ecur larg përgjatë Udhës. Ndërkohë jetoni të qetë e në paqe, ndodheni të sigurt e të mbrojtur nga Fuqia e Pafundme e MENDJES ATËRORE-AMËNORE.

"Brenda Mendjes Atërore-Amënore, bijtë e vdekshëm ndodhen në shtëpinë e tyre."

"Në Univers askush nuk është pa Atë apo pa Mëmë." **– Hermesi** (Thoti, Enoku, Kybalioni)

8.Hermetizmi dhe njeriu bashkëkohor

Shkenca, si sistem më i ri për hulumtimin e së vërtetës, rëndësi kryesore u jep fakteve. Ajo përgjithësisht bazohet në frymën racionale e cila është mjaft e ngushtë në krahasim me kapacitetin e përgjithshëm që posedon qenia Njeri.

Por, hapësira e shkencës po zgjerohet për çdo ditë, me shpejtësi rapide, dhe fundi i zhvillimit të saj është i pamundur të parashihet. Mirëpo, kur shkenca dhe filozofia na denoncojnë, është plotësisht e arsyeshme që të mbështetemi në sisteme dhe forma tjera hulumtimi për ta kërkuar të vërtetën.

Sisteme dhe forma, që na mbushin hapësirën e zbrazët dhe na ofrojnë zgjidhjet e tyre përkatëse.

Diku në sferën ku gërshetohet shkenca, filozofia dhe religjioni, e gjen hapësirën e frymimit të vetë tradita hermetike. Lidhja e saj me sisteme dhe forma tjera të mendimit njerëzor është më shumë e theksuar në Lindjen e Largët se sa në Perëndim. Tradita e Lindjes së Largët është e pamundur të ndahet nga religjioni, filozofia dhe shkenca, sepse është e lidhur dhe e gërshetuar në mënyrë të pandashme me to. Ne, në këtë pjesë të globit, deri më sot kemi pasur më pak përvojë, e natyrisht edhe më pak njohuri dhe fakte në këtë drejtim.

Kërkimi i çfarëdo vlere në punimet e alkimistëve si: Paracelzusi, Elifasi Levi, Papuasi etj. përmban në vete rrezik të madh që kolegët, por edhe të afërmit, të na përqeshin, të na proklamojnë si sharlatanë ose edhe të marrë dhe të na mohojnë të gjitha vlerat, jo vetëm të lëndës që dëshirojmë ta hulumtojmë, por edhe motivet që na shtyjnë kah ajo. Për këtë arsye njerëzit vështirë vendosin për t'u marrë, së paku publikisht, me interesime të tilla.

Njerëzit që mendojnë se shkenca e kompjuterëve do t'i zgjidhë dilemat tona, mashtrohen shumë keq! Ata e shqiptojnë fjalën "shkencë" si të ishte ajo magjistare e gjithëmundshme, e cila, sikur me shkop magjik, do t'i zgjidh e shërojë problemet e shumta me të cilat përballet njerëzimi në vazhdimësi siç janë: ndjeshmëritë, traumat, urrejtjet, dhunën, konfliktet, vuajtjet etj. Por, përkundër faktit se ajo në këtë lëmi ka kontribuar mjaftë shumë, megjithatë përparimi, i shkencës dhe teknologjisë ka karaktere të dyanshme. Për anën e errët të saj, fanatikët nuk dëshirojnë as të mendojnë! Shkenca vërtet

lehtëson dhe e bënë më atraktive jetën tonë, format elementare të saj, por nuk mund t'i zgjidh dot dilemat që na preokupojnë. Bile në shumë raste, ajo na bënë që t'i ndjejmë edhe më qartë ato.

Zbritja e kozmonautëve në truallin e Hënës krijoi botëkuptim dhe ndjenja të veçanta mbi forcën njerëzore, respektivisht për forcën e produkti të mendjes së tij - shkencës dhe teknikës. Por, pak kohë pas kësaj, njeriu filloi ta ndjejë fuqishëm inferioritetin e vet, pasi u vetëdijesua për pafundësinë e Gjithësisë.

Motivet reale të këtyre shprehive, në mënyrë vizionare, i lakuriqësoi psikologu i njohur, K. G. Jungu, me fjalë të thjeshta por shumë kuptimplote:

"Fluturimet kozmike janë thjesht ikje na vetvetja, sepse më lehtë është të arrihet në Hënë ose Mars, se sa të depërtohet në qenien personale, në unin tonë".

Synimi themelor i secilës qenie njerëzore është që të zhvillohet, të shprehet dhe të krijojë në cilëndo formë a mënyrë. Forca e tij krijuese është e pakufishme. Jeta e tij është shesh ku zhvillohen procese të panumërta emocionale, mendore e trupore. Dhe në qoftë se aktivitetet e tij janë të orientuara kah një qëllimi i arsyeshëm, si dhe janë në harmoni me momentin, kohën dhe ambientin, atëherë edhe çdo lëvizje e tij, qoftë e duarve, e gjuhës apo trupit, është krijuese.

Artet në përgjithësi janë pasardhëse të drejtpërdrejta të vezullimeve shpirtërore, që burojnë thellë në ne, të cilat nëpërmjet poreve të jashtme depërtojnë në hapësirë ndërnjerëzore dhe aty, po nga ne, bëhen të njohura.

V. KYBALIONI

1.Libri *KYBALIONI* nga Tre Inicuesit apo Tre Rishtarët

Libri ***Kybalioni*** ishte shkruar në fillim të viteve 1900 nga autorë të cilët veten e identifikuan si "Tre Inicuesit" apo "Tre Rishtarët". Përse ata nuk do të japin emrat e tyre si autorët e librit, por veten e quajnë si Tre Inicuesit, Tre Rishtarët? Në ndershmërinë e tyre të përulur, ata deklarojnë në hyrje të librit që ata nuk mund të marrin kredi, emër apo lëvdatë për punën e përpilimit të librit, ata janë tepër modestë në punën dhe misionin e tyre për mbledhjen dhe përhapjen e mësimeve Hermetike të KYBALIONIT.

Është një kënaqësi e madhe për ne të sjellim në vëmendjen e nxënësve dhe hulumtuesve të Doktrinave sekrete, - shkruajnë Tre Autorët e Kybalionit, - këtë vepër të vogël të bazuar në Doktrinën e lashtë Hermetike. Qëllimi i këtij libri – vazhdojnë më tej Autorët – nuk është të shpallë ndonjë filozofi apo doktrinë të veçantë, por t'u japë nxënësve një formulim të të vërtetës që do të shërbejë në bashkërenditjen e shumë copëzave të dijes okulte.

Kybalioni u botua për herë të parë në 1908 nga Shoqëria e Publikimeve Yogi, Tempulli Masonik, Chicago 1912 dhe tani është në lexim publik , dhe mund të gjendet edhe në internet. Libri synon të jetë i bazuar në Hermeticizmin e lashtë , megjithëse shumë prej ideve të tij janë koncepte relativisht moderne që dalin nga Lëvizja e Mendimit të Ri.

Autorët e ***Kybalionit*** kanë zgjedhur që të lidhen emrat e tyre me librin, ndoshta sepse parimet dhe filozofitë që ai përshkruan nuk mund të kreditohet për çdo person.

Disa sugjerojnë që Atkinson ishte një nga autorët, pas një takimi me një udhëtar nga Lindja. Disa thonë se është vetëm një autor i librit për ***Kybalionin.*** Dijetari fetar Philip Deslippe pohon se William Walker Atkinson është autori i vetëm i librit KYBALIONI.

*****

Nuk ekziston asnjë pjesë e mësimeve okulte të zotëruara nga bota që të jetë ruajtur me kaq fanatizëm sa fragmentet e Doktrinës Hermetike, të arritura deri në ditët tona përmes dhjetëra shekujve që kanë shkuarqë nga koha kur jetonte themeluesi i madh i tyre, Hermes Trismegistus, "shkruesi i perëndive", i cili rronte në Egjyptin e lashtë në ditët kur rraca e sotme njerëzore jetonte fëmijërinë e saj. Hermesi apo Thoti, apo Enoku, apo Kybalioni (flitet gjithnjë për të njëjtin person), ishte bashkëkohës edhe i Abrahamit dhe ishte udhërrëfyes për këtë njeri të mençur e të nderuar. Hermesi ishte dhe është Dielli i Madh Qendror i Okultizmit, rrezet e të cilit kanë shërbyer për të hedhur dritë mbi më simet e panumërta të përhapura që nga koha e tij. Madje edhe mësimet më të lashta të Indisë i gjejnë rrënjët e tyre në Doktrinën origjinale Hermetike. Nga tokat e lumit Gang, shumë okultistë të avancuar u endën drejt tokave të Egjyptit dhe u ulën në këmbët e Mjeshtrit. Prej tij ata përfituan Çelësin Madhor, i cili qartësoi dhe bashkoi pikëpamjet etyre të kundërta, duke themeluar kështu qartë Doktrinën e Fshehtë. Nga vise të tjera erdhën të tjerë eruditë, të cilët pa përjashtim e konsideruan Hermesin si Mjeshtrin e Mjeshtrave, ndikimi i të cilit ishte aq i madh, sa që ende mund të gjendet një ngjashmëri themeltare në teoritë e ndryshme e shpesh kontradiktore që stidiohen sot e kësaj dite nga okultistët e këtyre vendeve të ndryshme.

Studentët e Besimeve Fetare të Krahasuara do të jenë të aftë të perceptojnë ndikimin e Doktrinës Hermetike (Thotiane) në cilindo besim fetar të denjë për këtë emër e të njohur nga njeriu, qoftë ky besim fetar i vdekur apo ende në fuqi në ditët tona. Ekziston gjithmonë njëfarë Përkimi, pavarësisht nga tiparet kontradiktore, dhe Doktrina Hermetike e Thotit të Atlantidës vepron si Pajtuesja e Madhe. Kanë ekzistuar gjithmonë në çdo brez disa Rishtarë (Inicues) në vende të ndryshme të botës, të cilët kanë mbajtur gjallë flakën e shenjtë të Doktrinës Hermetike, gjithmonë të gatshëm të përdorin pishtarin e tyre për të rindezur fenerët e dobët të botës së jashtme, kur shkëlqimi i të vërtetës është zbehur, errësuar nga pakujdesia e me fitilat fare pranë shuarjes. Kanë ekzistuar gjithmonë disa njerëz të paktë në numër të cilët janë përkujdesur me besnikëri për altarin e të Vërtetës mbi të cilin është ruajtur i ndezur Fanari i Përjetshëm i Diturisë. Këta njerëz nuk kanë harruar asnjëherë mësimin e hershëm të Hermesit, në lidhje me përçimin e fjalëve të të vërtetës teka ta të cilët janë gati t'i pranojnë, mësim ky i bërë qartë edhe në librin **Kybalioni**: *"Kur dëgjohen hapat e Mjeshtrit, veshët e atyre që janë gati për Mësimet e tij bëhen katër"*.

Dhe përsëri: *"Kur veshët e nxënësit janë gati për të dëgjuar, atëherë vijnë buzët që do t'i mbushin me Urtësi"*.

Fryma e përndjekjes nuk është shuar ende mbi tokë. Ekzistojnë disa Mësime Hermetike, të cilat, nëse do të shpalleshin publikisht do të tërhiqnin mbi kryet e mësuesve britma të rënda përçmimi e fyerjesh nga turmat, të cilat do të thirrnin përsëri me zë të lartë si dikur: *"Kqyqëzojeni! Kryqëzojeni!"*

2.Gjithësia

"Nën Universin e Kohës, Hapësirës dhe Ndryshimit, fshihet gjithmonë Realiteti Substancial, e Vërteta Themeltare." **– Kybalioni**

Substanca nënkupton "atë çka qëndronnën të gjitha manifestimet e jashtme; thelbin, realitetin thelbësor, të qenët real" etj. "Realitet" do të thotë: "të qenët real, i vërtetë, i qëndrueshëm, i mirëqenë, i palëvizshëm, i përhershëm, i pranishëm" etj.

Nën dhe pas të gjitha shfaqjeve e dukjeve të jashtme, ka gjithmonë një Realitet Substancial. I tillë është Ligji. Njeriu që studion Universin, pjesë e të cilit është edhe ai vetë, nuk sheh gjë tjetër ndryshimeve të vazhdueshme në materie, forcë dhe gjendje mendore. Ai vëren se në të vërtetë, asgjë nuk EKZISTON e pandryshuar, por gjithçka KRIJOHET dhe NDRYSHON. Asgjë nuk qëndron e palëvizur, gjithçka lind, rritet, vdes. Në të njëjtin çast në të cilin diçka arrin kulmin e saj atëherë fillon edhe e tatpjeta; ligji i ritmit vepron në mënyrë të pareshtur; nuk ka realitet, cilësi të qëndrueshme, paluajtshmëri apo substancialitet në asgjë; nuk ka asgjë të përhershme përveç Ndryshimit. Njeriu vëren se gjthçka evoluon nga të tjera gjëra dhe zbërthehet në të tjera akoma; një veprim e kundërveprim i pareshtur; një rrjedhë që qarkullon brenda e jashtë; ndërtim dhe rrëzim; krijim e shkatërrim; lindje, rritje e vdekje. Nuk ka asgjë të qëndrueshme përveç Ndrushimit. E nëse ky njeri është mendimtar, ai kupton se të gjitha këto gjëra nën ndryshim të pareshtur, nuk janë veçse

shfaqje e manifestime të një Force e cila qëndron nën gjithçka; të një Realiteti Substancial.

Të gjithë mendimtarët, në të gjitha trevat e në të gjitha kohërat, kanë pranuar domosdoshmërinë për një postulat (definicion) mbi ekzistencën e këtij Realiteti Substancial. Çdo filozofi e denjë për t'u quajtur e tillë është bazuar mbi këtë ide. Njerëzit i kanë dhënë Realitetit Substancial shumë emra. Disa e kanë quajtur HYJNI (me emra të shumtë), të tjerë "Energjia e Pafundme dhe e Përjetshme", të tjerë akoma janë munduar ta quajnë "Materie", por të gjithë e kanë pranuar ekzistencën e tij. Është i vetëkuptueshëm e nuk ka nevojë për argumentim.

Në këto mësime ne kemi ecur në hapat e disa prej mendimtarëve të mëdhenj të botës, Mjeshtra Hermetikë si të lashtë ashtu edhe bashkëkohorë, dhe e kemi quajtur këtë Forcë Themelore, këtë Realitet Substancial, me emrin Hermetik "GJITHËSIA", fjalë kjo të cilën e gjykojmë si më gjithëpërfshirësen nga të gjithë emrat e shumtë me të cilët Njeriu ka quajtur Atë çka qëndron përtej emrave, fjalëve e përkufizimeve.

Ne pranojmë e mësojmë pikëpamjen e mendimtarëve të mëdhenj Hermetikë të çdo kohe dhe atë të atyre shpirtrave të ndiçuar të cilët kanë arritur në rrafshe më të larta ekzistence, të cilët pohojnë se natyra e brendshme e GJITHËSISË është e PANJOHSHME. Kështu duhet të jetë, pasi asgjë përveç GJITHËSISË nuk mund të kuptojë natyrën dhe ekzistencën e saj.

Hermetistët besojnë dhe mësojnë se GJITHËSIA "në vetvete" është dhe duhet të jetë gjithmonë e PANJOHSHME. Ata i konsiderojnë të gjitha teoritë, hamendësimet dhe spekulimet e teologëve dhe metafizikëve mbi natyrën e

brendshme të GJITHËSISË, si përpjekje fëminore të mendjeve të vdekshme për të rrokur sekretin e Pafundësisë. Përpjekje të tilla kanë dështuar e do të dështojnë gjithmonë, pikërisht për shkak të natyrës së qëllimit që kanë. Dikush që ndjek pyetje të tilla, udhëton vazhdimisht përqark në labirintin e mendimit, derisa humb të gjithë logjikën e shëndoshë, veprimet e sjelljen e arsyeshme, duke u bërë përfundimisht i papërshtatshëm për jetën. Ai i ngjanë ketrit i cili vrapon furishëm brenda rrotës së lëvizshme të kafazit të tij, duke udhëtuar pareshtur pa arritur askund; në fund sërish i burgosur, duke qëndruar pikërisht aty ku filloi.

Akoma më mendjemëdhenj janë ata të cilët orvaten t'i veshin GJITHËSISË personalitetin, cilësitë, tiparet, karakteristikat dhe vetitë e vetvetes, duke e veshur GJITHËSINË me emocione njerëzore, ndjenja dhe veçori deri tek cilësitë më të ulëta njerëzore si xhelozia, ndjeshmëria ndaj lëvdatave e lajkave, nevoja për blatime e adhurim, të gjitha këto mbeturina nga kohët kur raca njerëzore jetonte fëmijërinë e saj. Ide të tilla nuk janë të denja për burra e gra të rritura dhe po flaken tutje me shpejtësi.

(Në këtë pikë, do të ishte e përshtatshme të saktësohej se ne bëjmë një dallim ndërmjet Besimit dhe Teologjisë; ndërmjet Filozofisë dhe Metafizikës. Besim për ne, do të thotë të kuptuarit në mënyrë intuitive e ekzistencës së GJITHËSISË dhe marrëdhënia e dikujt me të; ndërsa Teologjia nënkupton orvatjet njerëzore për t'i veshur GJITHËSISË personalitet, cilësi e karakteristika; pikëpamje mbi çështjet, vullnetin, dëshirat, planet dhe projektet e saj; dhe pretendimin e zyrës së "ndërmjetësit" midis GJITHËSISË dhe Njerëzve. Filozofi për ne, do të thotë të kërkuarit dituri mbi gjëra të njohshme e të

mendueshme; ndërsa Metafizika nënkupton orvatjen për ta mbartur këtë kërkim mbi dhe përtej kufijve, në lëme të panjohshme e të pamendueshme, dhe me të njëjtat prirje si ato të Teologjisë. Rjedhimisht, ne i gjejmë si rrënjët e Besimit ashtu edhe të Filozofisë, të hedhura në Realitet, ndërkohë që Teologjia e Metafizika i ngjajnë xunkthit të këputur në rrënjë në baltën thithëse të injorancës, të paafta të ofrojnë mbështetje të sigurt as për mendjen e as për shpirtin e Njeriut. Nuk këmbëngulim që nxënësit tanë të pranojnë këto përkufizime. Ne i përmendëm thjeshtë për të qartësuar pikëpamjen tonë. Në çdo rast, në këto mësime do të dëgjoni fare pak mbi Teologjinë e Metafizikën.)

"Ajo çka është e Vërteta Themeltare, Realiteti Substancial, në të vërtetë qëndron përtej emërtimeve, por të Urtët e quajnë GJITHËSIA." **– Kybalioni**

"GJITHËSIA është E PANJOHSHME në thelbin e saj." **– Kybalioni**

"Megjithatë, kumtimi i Arsyes duhet pritur derë çelur dhe duhet trajtuar me nderim." **– Kybalioni**

Arsyeja njerëzore, zërin e së cilës duhet ta pranojmë për sa kohë arrijmë të arsyetojmë, na kumton sa vijon për GJITHËSINË, gjithmonë pa u orvatur t'i heqë asaj vellon e TË PANJOHSHMES:

1.GJITHËSIA duhet të jetë GJITHÇKA që EKZISTON REALISHT. Asgjë nuk mund të ekzistojë jashtë GJITHËSISË, përndryshe GJITHËSIA nuk do të ishte GJITHËSIA.

2.GJITHËSIA duhet të jetë E PAFUNDME, sepse nuk ka asgjë tjetër që mund ta përcaktojë, rrethojë, kufizojë apo

mbyllë në caqe. GJITHËSIA është E PAFUNDME në kohë ose E PËRJETËSHME; duhet të ketë ekzistuar vazhdimisht, pasi nuk mund të ketë pasur kurrë diçka tjetër që ta ketë krijuar, sepse asgjë nuk mund të evoluojë nga hiçi, e nëse nuk do të "kishte qenë" qoftë edhe për një çast, nuk do të "ishte" tani. Duhet të ekzistojë vazhdimisht pasi nuk ka asgjë tjetër që mund ta shkatërrojë, e nuk mundet "të mos jetë" qoftë edhe për një çast të vetëm, pasi diçka nuk mund të kthehet kurrë në hiç. GJITHËSIA duhet të jetë e Pafundme në Hapësirë; duhet të jetë Gjithkund pasi nuk ekziston vend tjetër jashtë GJITHËSISË; nuk mund të jetë përveçse e vazhdueshme në Hapësirë, pa këputje, ndalesa, ndarje apo ndërprerje, pasi që nuk ka asgjë që ta këputë, ndalojë, ndajë apo ndërpresë vazhdimësinë e saj, e asgjë tjetër për "të mbushur zbrazëtitë". Duhet të jetë e Pafundme në Forcë ose Absolute, pasi nuk ka asgjë që mund ta kufizojë, frenojë, përmbajë, izolojë, shqetësojë apo kushtëzojë; GJITHËSIA nuk i nënshtrohet asnjë Force tjetër pasi nuk ka asnjë Forcë tjetër.

3.GJITHËSIA duhet të jetë E PANDËRRUESHME apo e patjetërsueshme në natyrën e sajt ë vërtetë, pasi nuk ekziston asgjë që mund ta ndryshojë; asgjë nga e cila mund të jetë shndërruar apo asgjë në të cilën ajo mund të shndërrohet. Asaj nuk mund t'i shtohet, e nga ajo nuk mund të hiqet asgjë; nuk mund të rritet apo të pakësohet, e as të bëhet më e madhe a më e vogël në çfarëdo pikëpamje qoftë. Duhet të ketë ekzistuar e duhet të ekzistojë gjithmonë pikërisht siç është tani, GJITHËSI. Nuk kap asur, nuk ka, e nuk do të ketë kurrë asgjë tjetër në të cilën ajo do të mund të shndërrohej.

Meqenëse GJITHËSIA është e Pafundme, Absolute, e Përjetëshme dhe e Pandryshueshme, rrjedhimisht gjithçka e

fundme, e ndryshueshme, kalimtare dhe e kushtëzuar nuk mund të jetë GJITHËSIA. Dhe përderisa nuk ka Asgjë jashtë GJITHËSISË në Realitet, atëherë të gjitha këto gjëra të fundme duhet të jenë Asgjë në Realitet. Ju kërkojmë të mos turbulloheni apo trembeni; nuk po përpiqemi t'ju udhëheqim drejt Doktrinës së Krishterë nën maskën e Filozofisë Hermetike. Ekziston një pajtueshmëri mbi këto çështje të cilat duken në kundërvënie. Bëni durim, do të arrijmë atje kur të jetë koha.

Përreth nesh shikojmë atë që quhet "Materie", e cila përbën bazën fizike materialet ë të gjitha formave. A është GJITHËSIA thjesht Materie? Aspak! Materia nuk mund të manifestojë Jetë apo Mendje, e përderisa si Jeta ashtu edhe Mendja manifestohen në Univers, Materia nuk mund të manifestojë Jetë apo Mendje, e përderisa si Jeta ashtu edhe Mendja manifestohen në Univers, GJITHËSIA nuk mund të jetë Materie, pasi asgjë nuk mund të ngrihet më lart nga ku buron, asgjë nuk shfaqet brenda pasojës pa qenë edhe pjesë e shkakut, asgjë nuk kthehet në një përfundim pa qenë edhe pjesë e asaj që paraprin.

Shkenca Bashkëkohore na meson se në të vërtetë Materia nuk ekziston; se ajo që quajmë Materie është thjeshtë "energji apo forcë e ndërprerë", pra energji apo forcë me lëkundje të ngadaltë. Ashtu siç ka thënë edhe një shkrimtar bashkëkohor: "Materia u tret në Mister". Edhe Shkenca Materiale e ka braktisur teorinë e Materies dhe tani mbështetet në bazat e "Energjisë".

Athërë a është vallë GJITHËSIA thjeshtë Energji ose Forcë? Jo Energji e Forcë në kuptimin që i japin materialistët fjalës, pasi energjia e forca e tyre janë gjëra të verbra,

mekanike, pa Jetë e Mendje. Jeta e Mendja nuk mund të evoluojnë kurrsesi nga Energjia e Forca e verbër, për arsyen që dhamë një çast më parë: "Asgjë nuk mund të ngrihet më lart nga ku buron; asgjë nuk shtjellohet pa qenë e pleksur; asgjë nuk kthehet në një përfundim pa qenë edhe pjesë e asaj që paraprin". Kështu GJITHËSIA nuk mund të jetë thjeshtë Energji apo mForcë, pasi nëse do të ishte, ekzistenca nuk do të njihte gjëra si Jeta dhe Mendja, e ne këtë e kuptojmë më së miri pasi jemi të Gjallë e duke përdorur Mendjen për të shtruar këto pyetje, po aq sa ata të cilët pretendojnë se Energjia apo Forca janë Gjithçka.

Çfarë ekziston pra në Univers e që qëndron më lart se Materia dhe Energjia? JETA DHE MENDJA! Jeta dhe Energjia në të gjitha gradët e tyre të ndryshme të shpalosjes. "Atëherë kërkoni të na thoni se GJITHËSIA është JETË dhe MENDJE?", - do të pyesni ju. PO dhe JO është përgjigja jonë. Nëse nënkuptoni Jetë dhe Mendje në mënyrën në të cilën i njohim ne, të vdekshmit e gjorë vocërrakë, përgjigja është JO! GJITHËSIA nuk është ajo. "Atëherë për çfarë Jete e Mendje bëni fjalë?", - pyetni ju.

Përgjigjja është "MENDJE QË JETON", shumë përtej kuptimit që të vdekshmit u japin këtyre fjalëve, pasi Jeta e Mendja qëndrojnë mbi forcat mekanike apo materien; MENDJE E GJALLË E PAFUNDME nëse do të krahasohej me Jetën dhe Mendjen e fundme."

Me këtë duam të themi atë çka nënkuptojnë shpirtrat e përndritur, kur shqiptojnë me nderim fjalën: "SHPIRT!"

GJITHËSIA është Mendje e Gjallë e Pafundme; të përndriturit e quajnë SHPIRT!

3.Paradoksi hyjnor

***"Gjysmë të mençurit, duke e njohur mosvërtetësinë relative të Universit, imagjinojnë se mund të mposhtin Ligjet e tij; këta të marrë nuk janë veç mendjemëdhenj e fodullë të cilët thyhen pas shkëmbinjve e copëtohen prej elementëve, pikërisht për shkaktë marrëzisë së tyre. I mençuri i vërtetë, përmes njohjes së natyrës së Universit, përdor Ligjin kundër ligjit; të lartin kundër të ulëtit; përmes Artit të Alkimisë ai shndërron atë çka është e padëshirueshme në diçka me vlerë, duke dalë kështu ngadhnjimtar. Mjeshtëria nuk qëndron në ëndërrime anormale, vegime apo ide imagjinare, por në përdorimin e forcave të larta kundër atyre të ulëta. Qëndron në largimin prej vuajtjeve të rrafsheve të ulëta duke u lëkundur në ato të lartat. Transmutacioni, e jo mohimi arrogant, është arma e vërtetë e Mjeshtrit."* – **Kybalioni**

Ky është Paradoksi i Universit që buron nga Parimi i Polaritetit i cili shfaqet kur GJITHËSIA nis të krijojë. Vërini veshin sepse ai bën dallimin midis diturisë gjysmake e diturisë së plotë. Ndërkohë që për GJITHËSINË E PAFUNDME, Universi, Ligjet e tij, Forcat e tij, Jeta dhe Fenomenet e tij janë gjëra të cilat shihen në një gjendjeje Meditimi apo në Ëndërr, për gjithçka tjetër të Fundme, Universi është Real dhe duhet trajtuar si i tillë; në përputhje me këtë duhet të bazohet mënyra e të jetuarit, mënyra e të menduarit e të vepruarit, pavarësisht nga zotërimi i të Vërtetës së Lartë. Gjithsekush në përputhje me Rrafshin dhe Ligjet e tij. Nëse me të vërtetë GJITHËSIA do ta imagjinonte Universin si Realitet, atëherë mjerë Universi sepse nuk do të kishte shpëtim dhe largim nga rrafshet e ulëta për në ato të larta; Universi do të ishte i palëvizshëm dhe nuk

do të qe më i mundur përparimi. E nëse Njeriu për shkak të diturisë gjysmake, vepron,mendon dhe jeton duke e konsideruar Universin thjeshtë një ëndërr (të ngjashme me ëndërrat e tij të fundme) atëherë vërtetë shtu bëhet Universi për të; si një somnabul ai pengohet vazhdimisht duke ardhur përqark në rrathë, pa shkuar askund, e në fund detyrohet të zgjohet nga rrëzimi i nxirë dhe i gjakosur, pikërisht mbi Ligjet e Natyrës të cilat ka shpërfillur.

Mbajeni mendjen gjithmonë tek Ylli por shikimin mbi hapat që hidhni, përndryshe mund të rrëzoheni në baltë teksa i mbani sytë kah qielli. Mos harroni Paradoksin Hyjnor sipas të cilit megjithëse Universi NUK EKZISTON, prapëseprapë AI EKZISTON. Mbani mend përherë Dy Polet e së Vërtetës, Absolutin dhe Relativin. Ruhuni nga gjysëm të Vërtetat.

Ai që Hermetistët njohin me emrin "Ligji i Paradoksit", në të vërtetë është thjeshtë një aspekt i Parimitt ë Polaritetit. Shkrimet Hermetike janë të mbushura me adresime ndaj daljes në pah të këtij Paradoksi gjatë trajtimit të problemeve të Jetës dhe Ekzistencës. Mësuesit i paralajmërojnë në mënyrë të vazhdueshme nxënësit e tyre për gabimin që bëhet duke lënë jashtë "pjesën tjetër" të çdo pyetjeje. Paralajmërimet e tyre janë të drejtuara veçanërisht në çështjen mbi Absoluten e Relativen të cilat pështjellojnë të gjithë studentët e filozofisë, e që bëjnë shumë njerëz të mendojnë e veprojnë në kundërshtim me çka njihet gjerësisht si "botëkuptimi i përgjithshëm". Ne i porosisim të gjithë nxënësit të sigurohen mirë që të kenë kuptuar në mënyrë të drejtë Paradoksin Hyjnor të Absolutes dhe Relatives, përndryshe do të ngecen në batakun e Gjysmë të Vërtetës.

Mendimi i parë që i vjen ndërmend njeriut kur njëmendëson të vërtetën se Universi nuk është veçse një Krijim Mendor i GJITHËSISË, është që Universi dhe gjithçka ai përmban është thjeshtë një iluzion, diçka jo reale, ide kjo ndaj së cilës instiktet e tij revoltohen. Por kjo, ashti si të gjitha të vërtetat e tjera të mëdha duhet të merret në konsideratë si nga pikëpamja Absolute, ashtu edhe nga pikëpamja Realative. Nga pikëpamja Absolute, natyrisht Universi ka natyrën e një iluzioni, ëndërre apo fantazmagorie nëse krahasohet me GJITHËSINË në vetvete. Këtë e pranojmë edhe në pikëpamjet tona të përditshme ndërsa i adresohemi botës si një "shfaqje teatrale kalimtare" që shkon e vjen, lind e vdes; realisht, faktori i paqëndrueshmërisë e ndryshimit, fundësisë e mosvërtetësisë, lidhet gjithmonë me idenë e një Universi të krijuar, ndërkohë që kontraston me idenë mbi GJITHËSINË, pavarësisht nga ajo që ne besojmë për natyrën e secilës. Filozofë, metafizikë, shkencëtarë e teologë janë të gjithë në ujdi mbi këtë pikë, e kjo ide gjendet në të gjitha format e mendimit folizofik dhe koncepteve fetare, si edhe në teoritë përkatëse të shkollave të metafizikës e teologjisë.

Kështu pra, megjithëse prezentimi i çështjes mund të duket befasues, Doktrina Hermetike nuk predikon mosvërtetësinë e Universit më shumë se zërat me të cilët jeni familjarizuar tashmë. Gjithçka që ka një fillim e një fund, në një farë mënyre duhet të jetë jo reale dhe e pavërtetë, e Universi i nënshtrohet këtij rregulli në të gjitha shkollat e mendimit. Nga pikëpamja Absolute, nuk ka asgjë Reale përveç GJITHËSISË, pavarësisht nga emri që i japim në mendime apo diskutime të ndryshme këtij subjekti. Qoftë i krijuar nga Materia, qoftë Kijim Mendor i GJITHËSISË, Universi mbetet jo

substancial, i paqëndrueshëm, diçka e përbërë nga koha, hapësira dhe ndryshimi. Ju kërkojmë ta shqyrtoni këtë fakt në thellësi përpara se të jepni gjykim mbi konceptin Hermetik të natyrës Mendore të Universit. Bluani në mendje të gjitha konceptet e tjera dhe gjykoni nëse nuk është ky i vërteti.

Pikëpamja Absolute nuk tregon veçse njërën anë të medaljes; mbetet ana tjetër, ajo Realative. E vërteta Absolute është përkufizuar si "Gjërat shtu siç i njeh mendja e Perëndisë", ndërkohë që e vërteta Relative është përkufizuar si "Gjërat ashtu siç i kupton logjika më e lartë Njerëzore". Kështu pra, ndërkohë që për GJITHËSINË Universi është jo real, iluzion, thjeshtë një ëndërr apo pasojë meditimi, prapëseprapë për mendjet e fundme që përbëjnë një pjesë të Universit e të cilat e perceptetojnë atë nëpërmjet aftësive të vdekshme, Universi është padyshim mjaft real dhe si i tillë duhet trajtuar. Me pranimin e pikëpamjes Absolute nuk duhet të bëjmë gabimin e të mos marrit parasysh apo të të mohuarit të fakteve e fenomeneve të Universit, në formën në të cilën u prezentohen shqisave tona të vdekshme; mos harroni, ne nuk jemi GJITHËSIA.

…O miq, për të vdekshmit ky Univers Mendor është mjaft real pa asnjë pikë dyshimi; është i vetmi që mund të njohim ndonjëherë, sido që ngrihemi nga rrafshi në rrafsh, gjithmonë e më lart brenda tij. Për ta njohur Universin ndryshe nga përvoja jonë, do të na duhej të ishim vetë GJITHËSIA. Është e vërtetë se sa më lart ngjitemi në shkallë, aq më pranë "Mendjes Atërore" qasemi, e aq më qartë bëhet natyra prej iluzioni e gjërave të fundme, por ky vegim nuk do të tretet plotësisht deri në momentin që GJITHËSIA më në fund të na tërheqë përsëri brenda vetvetes.

Kështu pra, nuk duhet t'i dorëzohemi paraqitjes së gënjeshtërt. Përkundrazi, le të njohim natyrën e vërtetë të Universit, të mundohemi të kuptojmë ligjet e tij mendore, të përpiqemi t'i përdorim në të mirën e përparimit tonë gjatë jetës, teksa udhëtojmë nga një rrafsh ekzistencial në një tjetër. Ligjet e Universit janë "Ligje të Hekurta" për shkak të natyrës së tyre mendore. Atyre u nënshtrohet gjithçka përveç GJITHËSISË. Çka gjendet NË MENDJEN E PAFUNDME TË GJITHËSISË është REALE, e tejkalohet vetëm nga Realiteti që gjendet në thelb të natyrës së GJITHËSISË.

Pra, mos u ndjeni të pasigurt e të frikësuar; të gjithë ne RUHEMI NË MËNYRË TË PATUNDUR NË MENDJEN E PAFUNDME TË GJITHËSISË; nuk ka asgjë që mund të na dëmtojë apo nga e cila duhet të kemi frikë. Nuk ka asnjë Forcë tjetër jashtë GJITHËSISË që mund të na prekë. Mund të pushojmë të qetë e të sigurt. Në çastin kur ky nocion përqafohet plotësisht, zbulohet një botë e tërë ngushëllimi e sigurie. E atëherë "të qetë e paqësorë do të flemë, të përkundur në Djepin e Thellësisë", teksa prehemi të sigurt në gjirin e Oqeanit të Mendjes së Pafundme, i cili është vetë GJITHËSIA. Vendi ku "ne jetojmë, veprojmë dhe ekzistojmë" gjendet brenda GJITHËSISË.

Materia mbetet Materie për ne ndërkohë që rrojmë në rrafshin Material, megjithëse e dimë se ajo nuk është veçse një grupim "elektronesh" ose grimcash Force, të cilat lëkunden me shpejtësi e rrotullohen përqark njëra-tjetrës duke formuar atome; atomet në radhë të tyre lëkunden e rrotullohen duke formuar molekula, e këto të fundit formojnë Materie në masë më të madhe. Materia mbetet Materie edhe kur e shtyjmë më tej hulumtimin tonë, duke mësuar nga Doktrina Hermetike se

"Forca", njësi të së cilës janë grimcat atomike, nuk është veçse një manifestim i Mendjes së GJITHËSISË, e si gjthçka tjetër në Univers, është tërësisht Mendore në natyrën e saj. Për sa kohë që jetojmë në Rrafshin Material, na duhet të pranojmë fenomenin e tij; mund ta kontrollojmë Materien (ashtu siç bëjnë të gjithë Mjeshtrit e gradëve të ndryshme), por këtë e kryejmë duke zbatuar forca mbizotëruese. Kryejmë marrëzi nëse orvatemi të mohojmë ekzistencën e Materies në pikëpamjen relative. Mund të mohojmë dominimin e saj mbi ne, dhe me të drejtë kjo, por nuk duhet të shpërfillim aspektin e saj relativ, të paktën jo për aq kohë sa rrojmë në rrafshin e saj.

Ligjet e natyrës nuk bëhen as më pak efikase apo konstante ku njëmendësojmë se edhe ato janë thjeshtë krijime mendore. Ato mbeten gjithmonë në fuqi në rrafshet e shumëllojshme.Mund të mposhtim ligjet e ulëta duke zbatuar ligje mbizotëruese, po kjo është gjithçka mundemi të bëjmë. Nuk mund t'i shmangemi Ligjit apo të ngrihemi krejtësisht mbi të. Asgjë tjetër përpos GJITHËSISË, nuk mund t'i shpëtojë Ligjit, e kjo për arsye se GJITHËSISË është në vetvete LIGJI në të cilin i kanë rrënjët të gjitha ligjet. Mjeshtrit më të përparuar mund të fitojnë fuqi të cilat njerëzit kanë imagjinuar se vetëm perënditë mund t'i zotërojnë, por prapëseprapë në hierarkinë e madhe të jetës ka shkallë të pafundme të ekzistencës, qeniet dhe fuqitë e të cilave i tejkalojnë në masë të papërfytyrueshme nga të vdekshmit. Edhe Mjeshtrit më të lartë njerëzorë; gjithsesi, si Mjeshtrit e përparuar ashtu edhe Qeniet e larta, janë të detyruara t'i nënshtrohen Ligjit e të jenë kurrgjë në sytë e GJITHËSISË. Kështu, kur edhe vetë këto Qenie të larta, fuqitë e të cilave kapërcejnë ato fuqi të cilat njerëzit mendojnë se

vetëm perënditë i kanë, i nënshtrohen detyrimisht Ligjit, atëherë imagjinoni mendjemadhësinë e shfaqur nga raca e klasa jonë, nga njeriu i vdekshëm, kur guxon të konsiderojë Ligjet e Natyrës si të "pavërteta", imagjinare dhe iluzione, vetëm e vetëm se arrin të konceptojë që Ligjet në natyrën e tyre janë Mendore dhe Krijim Mendor i GJITHËSISË. Nuk ka shmangje apo vënie në diskutim të Ligjeve sunduese të GJITHËSISË. Për sa kohë do të jetë Universi, do të qëndrojnë edhe ato, sepse Universi ekziston pikërisht falë këtyre Ligjeve, të cilat përbëjnë edhe skeletin që e mban në këmbë.

Parimi Hermetik i Mentalizmit, ndërsa sqaron natyrën e vërtetë të Universit kohor bazuar mbi parimin sipas të cilit gjithçka është Mendore, nuk ndryshon konceptet shkencore mbi Universin, Jetën apo Evolucionin. Në fakt shkenca thjeshtë konfirmon Doktrinën Hermetike. Këto të fundit na mësojnë se natyra e Universit është "Mendore", ndërkohë që shkenca bashkëkohore na ka mësuar se është "Materiale"; apo rishtazi në analizë përfundimtare, "Energji". Doktrina Hermetike nuk gabon kur pranon parimin themelor të Herbert Spencerit si postulat mbi ekzistencën e një ***"Energjie të Pafundme e të Përjetshme, prej së cilës buron gjithçka"***. Në të vërtetë, Hermetikët gjejnë në filozofinë e Spencerit përshkrimin e "jashtëm" më të mirë që është bërë dhe shpallur mbi funksionimin e Ligjeve Natyrore, si edhe besojnë se Spenceri ka qenë rimishërimi i një filozofi të lashtë që rronte në Egjypt mijëra vjet më parë, i cili më pas u mishërua si Herakliti, filozofi grek i cili jetoi vitet 500 para erës sonë. Hermetikët i vlerësojnë deklarat e tij mbi "Energjinë e Pafundme e të Përjetshme" si plotësisht në përputhje me vijën e Doktrinës Hermetike, gjithmonë duke shtuar nga doktrina e tyre se

"Energjia" për të cilën ai bën fjalë, është Energjia e Mendjes së GJITHËSISË. Të pajisur me Çelësin Universal të Filozofisë Hermetike, studentët e Spencerit do të jenë të aftë të çelin shumë dyer të koncepteve të thella filozofike të filozofit të madh anglez, puna e të cilit reflekton rezultatet e përgatitjes së mishërimit të tij paraardhës. Mësimet e tij mbi Evolucionin e Ritmin janë pothuajse në harmoni të përsosur me Mësimet Hermetike mbi Parimin e Ritmit.

Kështu pra, nxënësit të Hermetikës nuk i nevojitet të lërë mënjanë asnjë nga pikëpamjet shkencore që ushqen në lidhje me Universin.Gjithçka kërkohet prej tij, është të rrokë parimin themelor që thotë se: ***"GJITHËSIS është Mendje; Universi është Mendor, i përfshirë në Mendjen e GJITHËSISË".*** A ido të zbulojë se Gjashtë nga Shtatë Parimet do të "pajtohen" me njohurinë e tij shkencore, do t'i shërbejnë të hedhë dritë në qoshe të errëta dhe të zgjidhë pyetje të turbullta. Kjo nuk duhet të na habisë nëse njohim ndikimin e mendimit Hermetik mbi filozofët e hershëm grekë, mbi themelet e mendimeve të të cilëve prehen masivisht teoritë e shkencës bashkëkohore. Pranimi i Parimit të Parë Hermetik (Mentalizmit), është pika e vetme e rëndësishme e ndarjes midis Shkencës Bashkëkohore dhe nxënësve Hermetikë, e Shkenca, në përpjekjet e saj për një rrugëdalje nga Labirinti i errët në të cilin është endur në kërkim të Realitetit, tashmë po lëviz gradualisht drejt pikëpamjes Hermetike.

Qëllimi këtij mësimi është të ngulitë në mendjet e nxënësve faktin që sidoqoftë, në çdo rast e pa asnjë përjashtim, për Njeriun, universi, ligjet dhe dukuritë e tij janë po aq Reale sa ç'janë edhe në hipotezat mbi Materializmin apo teoritë mbi Energjinë. Në cilëndo teori, Universi në aspektin e tij

sipërfaqësor është vazhdimisht i ndryshueshëm e kalimtar, e rrjedhimisht i zhveshur nga substancialiteti e realiteti. Por (mos harroni anën tjetër të të të vërtetës) përsëri nën të njëjtat teori, ne jemi të shtrënguar të VEPROJMË DHE JETOJMË sikur këto gjëra kalimtare të ishin reale dhe substanciale. Ky është edhe dallimi i përhershëm midis teorive të ndryshme; në pikëpamjet e vjetra Fuqia Mendore nuk merret parasysh si Forcë e Natyrës, ndërkohë që në Mentalizëm ajo është Forca Kryesore e Natyrës. Dhe është ky dallim i vetëm i cili ndryshon rrënjësisht Jetën e atyre të cilët e kuptojnë Parimin së bashku me ligjet e praktikat që rrjedhin prej tij.

Kështu pra, të gjithë ju nxënës, përqafoni epërsinë e Mentalizmit dhe mësoni të njihni, përdorni e zbatoni ligjet që rrjedhin prej. Por, siç citon edhe Kybalioni, mos iu dorëzoni tundimeve që pushtojnë gjysmë të mençurit, e që bëhen shkak që këta të fundit të hipnotizohen nga mosvërtetësia në pamje të parë e gjërave, të rrojnë duke u endur në një botë ëndërrash, të lënë pasdore jetën e punën praktike, e përfundimisht "të thyhen të përplasur pas shkëmbinjve e të copëtohen nga elementët për shkak të marrëzisë së tyre". Ndiqni shembullin e të mençurit ashtu siç citohet edhe në Kybalion, "përdorni Ligjin kundër Ligjeve; të lartin kundër të ulëtit; e përmes Artit të Alkimisë shndërroni atë çka është e padëshirueshme në diçka me vlerë, duke dalë kështu ngadhnjimtarë". Le të ndjekim këshillat e Kybalionit për të evituar gjysmë mençurinë (që nuk është vetëm marrëzi), e cila lë pasdore të vërtetën që thotë se "Mjeshtria nuk qëndron në ëndërrime anormale, vegime dhe ide imagjinare, por në përdorimin e forcave të larta kundër atyre të ulëta; qëndron në largimin prej vuajtjeve të rrafsheve të ulëta duke u lëkundur në ato të lartat". Mos

harroni kurrë se "Ttransmutacioni, e jo mohimi arrogant, është arma e vërtetë e Mjeshtrit".

Ne nuk rrojmë në një botë ëndërrash, por në një Univers i cili ndërkohë që është relativ, mbetet gjithsesi real në raport me jetën dhe veprimtarinë tonë. Qëllimi ynë në Univers nuk është të mohojmë ekzistencën e tij, por të JETOJMË vazhdimisht duke shfrytëzuar Ligjet për t'u lartësuar, të bëjmë më të mirën e mundshme në rrethanat e përditshme, të jetojmë aq gjatë sa është e mundur për të përqafuar idetë dhe idealet tona më të larta. Kuptimi i vërtetë i Jetës nuk njihet nga njeriu në këtë rrafsh, por mjeshtrit më të lartë dhe intuita jonë personale, na mësojnë se nuk bëjmë gabim nëse jetojmë duke bërë më të mirën që kemi në vetvete, për aq gjatë sa kjo është e mundur, duke ndjekur prirjen Universale e duke udhëtuar në të njëjtin drejtim me të, pavarësisht nga dëshmi të dukshme për të kundërtën. Jemi të gjithë në Udhë; një udhë me vendpushime të shpeshta, por që të shpie gjithmonë e më lartë.

4.GJITHËSIA në Gjithçka

"Në të njëjtën mënyrë në të cilën Gjithçka përfshihet brenda GJITHËSISË, ashtu edhe GJITHËSIA përfshihet brenda Gjithçkaje. Ai i cili e ka kuptuar këtë të vërtetë në thelb, ka përfituar dituri të vyer". **– Kybalioni**

Sa e sa herë e kanë dëgjuar njerëzit të përsërisin shprehje sipas së cilave Hyji i tyre (i njohur me emra të ndryshëm) ishte ***"Gjithçka në çdo gjë",*** e sa pak kanë dyshuar ata mbi të vërtetën e brendshme okulte të trupëzuar në këto fjalë të shqiptuara në mënyrë të shkujdesur? Kjo shprehje e përdorur rëndom është trashëguar nga Parimi i lashtë Hermetik i cituar më lart. Kybalioni thotë: ***"Ai i cili ka kuptuar këtë të vërtetë në thelb, ka përfituar dituri të vyer".*** Për këtë arsye, le ta shqyrtojmë këtë të vërtetë përqafimi i së cilës mbartka një domethënie kaq të madhe. Në fjalët e sinqerta të kësaj Thënieje Hermetike, fshihet një nga të vërtetat më të rëndësishme filozofike, shkencore dhe fetare.

Ne ju përcollëm Mësimin Hermetik mbi Natyrën Mendore të Universit, fakti që ***"Universi është Mendor", i përfshirë në Mendjen e GJITHËSISË".*** Kybalioni në fragmentin e cituar më sipër thotë: **"Gjithçka përfshihet brenda GJITHËSISË".** Por mos anashkaloni pjesën tjetër të pohimit e cila thotë: ***"GJITHËSIA përfshihet brenda Gjithçkaje".*** Kjo deklaratë në dukje kontradiktore është e pajtueshme nën Ligjin e Paradoksit. Për më tepër, ajo përbën një shprehje të saktë të marrëdhënieve që ekzistojnë midis GJITHËSISË dhe Universit të saj Mendor. Sr në ç'mënyrë "Gjithçka ndodhet brenda GJITHËSISË", e kemi shqyrtuar më parë.

Doktrina Hermetike na mëson se GJITHËSIS është gjithmonë e pranishme, e pandarë, e përbrendshme dhe e qenësishme në Univers, në çdo pjesë, grimcë, njësi apo kombinim brenda Universit. Mësuesit e ilustrojnë shpesh këtë pohim duke iu adresuar Parimitt ë Përkimit.

GJITHËSIA ndodhet brenda krimbit të tokës, e megjithatë krimibi i tokës është larg nga të qenit GJITHËSIA. Sidoqoftë mrekullia mbetet; krimbi i tokës si një krijesë e rëndomtë, është krijuar dhe ekziston vetëm në Mendjen e GJITHËSISË, e në të njëjtën kohë GJITHËSIA është imanente brenda krimbit, ashtu si edhe në vetë grimcat të cilat përbëjnë këtë krimb toke. ***"Gjithçka ndodhet brenda GJITHËSISË dhe GJITHËSIA ndodhet brenda Gjithçkaje"***, a ka vallë mister më të mrekullueshëm se ky?

Njeriu lartësohet në shkallën shpirtërore të jetës, në përpjestim të drejtë me gradën e botëkuptimit që zotëron mbi ekzistencën e Shpirtit që qëndron në thelb të qenies së tij. Kjo është edhe domethënia e zhvillimit shpirtëror; njohja, përqafimi dhe shfaqja e Shpirtit brenda nesh. Përpiquni ta mbani mend përkufizimin e mësipërm që i përket zhvillimit shpirtëror. Përmban Esencën e Fesë së Vërtetë.

Ka rrafshme e gradë të shumta Ekzistence në Univers, nën-rrafshe të panumërta të Jetës. Gjithçka varet nga avancimi i qenieve përgjatë shkallës në fundin e së cilës vetëm një hap i ndan nga Shpirti i GJITHËSISË. Gjithçka lëviz përpara dhe lart përgjatë kësaj shkalle të jetës. Gjithçka ndodhet në një Udhë, në fundin e së cilës ndodhet GJITHËSIA. I gjithë progresi është një Kthim në Shtëpi. Çdo gjë ecën me drejtim Lart dhe Përpara, pavarësisht nga paraqitjet në dukje kontradiktore. I tillë është Mesazhi i të Përndriturve.

Mësimet Hermetike që kanë të bëjnë me procesin e Krijimit Mendor të Universit, thonë se në fillim të Ciklit Krijues, GJITHËSIA, nga aspekti i saj i "të Qenit" ushtron Vullnetin mbi aspektin e saj "të Bërit", e në këtë mënyrë nis procesi i krijimit. Thuhet se procesi konsiston në uljen e Lëkundjes derisa arrihet një nivel shumë i ulët i energjisë lëkundëse, pikë kjo në të cilën manifestohet forma më e thjeshtë e Materies. Ky proces quhet stadi i Involucionit (Përfshirjes), në të cilën GJITHËSIA "përfshihet" apo "plekset" në krijimin e tij mendor, saqë pothuajse harron ekzistencën e vetjake në kohën reale dhe "jeton brenda krijimit të tij". Ndoshta mund të japim një ide më të mirë të asaj që dëshirojmë të përçojmë, nëse fjalën "pleksur" e zëvendësojmë me fjalën "zhytyr".

Ky stad Involucionar i Krijimit quhet rëndom edhe "Vërshimi" i Energjisë Hyjnore, në të njëjtën mënyrë në të cilën stadi Evolucionar quhet "Tërheqja". Poli më i skajshëm i procesit Krijues konsiderohet si pika më e largët nga GJITHËSIA, ndërkohë që fillimi i stadit Evolucionar trajtohet si pikënisja e kthimit pas lavjerrësit të Ritmit; një koncept ky i "rikthimit në shtëpi" i cili gjendet në të gjitha Doktrinat Hermetike.

Hermetisët e lashtë përdornin fjalën "Meditim" për të përshkruar procesin e krijimit mendor të Universit në Mendjen e GJITHËSISË, duke përdorur jo rrallë në vend të saj edhe fjalën "Përsiatje". Ideja që nënkuptohet, me sa duket ka të bëjë me Vëmendjen Hyjnore, ku fjala "Vëmendje" i gjen rrënjët e saj në gjuhën Latine dhe do të thotë "zgjatje/shtrirje". Kështu, veprimi i të treguarit Vëmendje në këtë rast nënkupton "shtrirje/zgjerim/përhapje" të energjisë mendore.

Për sa i përket procesit të Evolucionit, Doktrina Hermetike thotë se GJITHËSIA, pasi ka medituar mbi procesine Krijimit, duke hedhur në këtë mënyrë themelet materialet ë Universit e duke bërë që ky i fundit të ekzistojë nëpërmjet mendimit, nis të zgjohet gradualisht nga Meditimi duke bërë që të manifestohet procesi i Evolucionit në rrafshin material, mendor e shpirtëror, sipas rradhës së njëpasnjëshme. Në këtë mënyrë fillon lëvizja me kahje lart, në drejtim të Shpirtit.

Materia nis të bëhet më pak bruto, Njësitë lulëzojnë në qenie, nisin të shfaqen ndërthurjet, Jeta manifestohet në forma gjithmonë e më të larta dhe Mendja del gjithmonë e më shumë në pah; lëkundjet sa vijnë e rriten. Shkurtimisht, i gjithë procesi i Evolucionit, në të gjitha fazat e tij, nis dhe zhvillohet në përputhje me Ligjet e procesit të "Tërheqjes".

E gjithë kjo kërkon epoka të tëra kohe Njerëzore, ku secila epokë përbëhet prej miliona e miliona vitesh të panumërta, por megjithatë, të Përndriturit na mësojnë se i tërë krijimi, përfshirë Involucionin dhe Evolucionin e një Universi, për GJITHËSINË nuk është veçse një pulitje qepallash. Në fund të cikleve të panumërta të epokave kohore, GJITHËSIA e shuan Vëmendjen, Përsiatjen dhe Meditimin e saj mbi Universin, duke qenë se Vepra e Madhe ka përfunduar; Gjithçka tërhiqet brenda GJITHËSISË prej nga edhe lindi. Por Mister mbi Misteret, Fryma e shpirtrave nuk asgjësohet por zgjerohet pafundësisht; Krijesa dhe Krijuesi shkrihen në një. I tillë është kumtimi i të Përndriturve.

Shembulli i mësipërm i "meditimit" dhe "zgjimit nga meditimi" që pason, natyrisht nuk është gjë tjetër veçse një përpjekje e Mësuesve për të ilustruar procesin e Pafund

nëpërmjet një shembulli të fundëm. Gjithsesi "Si posht, ashtu edhe lart". Dalimi qëndron vetëm në gradë. Në të njëjtën mënyrë në të cilën GJITHËSIA zgjon vetveten nga meditimi mbi Universin, ashtu edhe Njeriu (përgjatë kohës) ndalet së manifestuari në Rrafshin Material dhe e tërheq veten gjithmonë e më shumë drejt Shpirtit të Përbrendshëm, i cili është pikërisht "Ego Hyjnore".

Pyetja e cila ka lindur dhe lind në mendjen e çdo mendimtari që ka kërkuar të Vërtetën është: ***"Përse krijon GJITHËSIA Universe?"***.

Njerëzit janë munduar gjatë t'i përgjigjen kësaj pyetjeje, por ende nuk ekziston ndonjë përgjigje e denjë për t'u quajtur e tillë. Disa kanë hamendësuar se GJITHËSIA synon të përfitojë diçka në këtë mes, por kjo është absurde pasi GJITHËSIA ka gjithçka e nuk ka asgjë që ajo mund të përfitojë. Të tjerët e kanë kërkuar përgjigjen në idenë që GJITHËSIA "kërkonte diçka së cilës t'i dhuronte dashuri", e të tjerë akoma në idetë që ajo krijonte për kënaqësi, për dëfrim, ngaqë "nduhej e vetmuar" apo për të manifestuar forcën e saj; të gjitha kë to janë shpjegime dhe koncepte foshnjore të cilat i përkasin periudhës së mendimit të papjekur.

Disa të tjerë janë përpjekur ta shpjegojnë misterin duke propozuar se GJITHËSIA ndihet "e shtrënguar" të krijojë për shkak të vetë "natyrës së brendshme" të saj, apo "instiktit krijues" që zotëron. Kjo ide është më e përparuar se të tjerat, por pika e dobët e saj qëndron në konceptin e GJITHËSISË që ndihet "e shtrënguar" apo "e detyruar" nga çfarëdolloj gjëje, qoftë kjo e brendshme apo e jashtme. Nëse "natyra e brendshme" apo "instikti krijues" e shtrëngojnë atë të bëjë diçka, atëherë "natyra e brendshme" apo "instikti krijues" do

të ishin Absoluti dhe jo GJITHËSIA, kështu rrjedhimisht kjo pjesë e këtij propozimi bie. Gjithsesi, mbetet fakti që GJITHËSIA krijon dhe manifeston, e në pamje të parë duket sikur gjen njëfarë kënaqësie duke vepruar në këtë mënyrë. Është e vështirë të shmanget konkluzioni se në njëfarë niveli të pafundmë, GJITHËSIA duhet të ketë diçka që ngjason me "natyrën e brendshme" apo "instiktin krijues" njerëzor, përkatësisht me Dëshirë e Vullnet të pafundmë. Ajo nuk do të vepronte nëse nuk do të kishte Vullnetin për të Vepruar, nuk do të kishte Vullnetin për të Vepruar nëse nuk do të ndjente Dëshirën për të Vepruar dhe nuk do të ndjente Dëshirën për të Vepruar nëse nuk do të përfitonte njëfarë Kënaqësie nga e gjithë kjo. Kështu gjithçka do t'i përkiste një "Natyre të Brendshme" e do të ekzistonte në formë postulati në përputhje me Ligjin e Përkimit. E megjithatë, ne preferojmë të mendojmë për GJITHËSINË që ajo vepron krejtësisht E LIRË nga çdo ndikim, si i brendshëm ashu edhe i jashtëm. Ky është problemi që qëndron në rrënjët e vështirësisë, dhe vështirësia që qëndron në rrënjët e problemit.

Për t'u treguar rreptësisht të saktë, nuk mund të thuhet se ekziston ndonjë "Arsye", e çfarëdo lloji qoftë ajo, e cila shtynë GJITHËSINË të veprojë, pasi "arsyeja" do të nënkuptonte "shkak", e GJITHËSIA qëndron mbi Shkakun dhe Pasojën, përveç rastit kur ajo ushtron Vullnetine saj për t'u kthyer në Shkak, kohë kjo në të cilën vihet në lëvizje Parimi. Pra siç e shihni, çështja është po aq e Pamendueshme, sa ç'është edhe GJITHËSIA e Panjohshme. Nuk kemi rrugë tjetër veçse të themi që "GJITHËSIA VEPRON, SEPSE VEPRON", në të njëjtën mënyrë në të cilën themi që GJITHËSIA thjeshtë "EKZISTON". Në fund të fundit, GJITHËSIA në vetvete

përbën të gjitha Arsyet, të gjitha Ligjet, të gjitha Veprimet, e mund të thuhet me të drejtë se GJITHËSIA është Arsyeja e Vetvetes, Ligji i Vetvetes, Veprimi i Vetvetes; e më tutje akoma, GJITHËSIA, Arsyeja e Saj, Veprimi i Saj, dhe Ligji i Saj janë NJË, të gjithë emra për të njëjtën gjë.

Opinioni i atyre që po shkruajnë këto mësime për ju është se përgjigja është e kyçur BRENDA VETË GJITHËSISË, së bashku me të Fshehtën e Ekzistencës së saj. Për mendimin tonë, Ligji i Përkimit mund të arrijë deri në aspektin e GJITHËSISË të cilin e njohim si "Aspekti i të Bërit". Pas këtij Aspekti qëndron "Aspekti i të QENIT", në të cilin të gjithë Ligjet shkrihen në LIGJ, të gjithë Parimet shkrihen në PARIM, dhe GJITHËSIA, PARIMI, dhe QENËSIA janë IDENTIKË, TË NJËJTA dhe NJË E VETME.

Megjithëse disa Mësues Hermetikë të lashtë apo bashkëkohorë kanë anuar në drejtim të zbatimit të Parimitt ë Përkimit për pyetjen, duke arritur në rezultatin e "Natyrës së Brendshme", përsëri legjenda thotë se kur Hermesit, të Madhit, iu drejtua kjo pyetje nga nxënësit e tij të përparuar, ai u përgjegj duke PUTHITUR BUZËT FORT ME NJËRA-TJETRËN , e duke mos nxjerrë asnjë fjalë, duke dëshmuar kështu se NUK KISHTE PËRGJIGJE. Ndoshta qëllimi i Hermesit mund të ketë qenë zbatimi i aksiomës së filozofisë së tij: "Buzët e Urtësisë janë të kyçura, përveçse për veshët e Arsyes", për të treguar se as nxënësit e tij më të përparuar nuk zotëronin forcë Arsyetuese të mjaftueshme për të qenë të denjë për këtë Mësim.

Sidoqoftë, edhe nëse Hermesi e zotëronte Sekretin ai nuk e bëri të ditur, e për aq sa i përket botës, BUZËT E HERMESIT JANË TË MBYLLURA mbi këtë çështje. E aty ku Hermesi i Madh ngurroi të fliste, cili i vdekshëm do të guxonte të jepte mësim?

Mos harroni se cilado qoftë përgjigja e këtij problemi, nëse vërtetë ekziston një e tillë, mbetet i vërtetë fakti që "Në të njëjtën mënyrë në të cilën Gjithçka përfshihet brenda GJITHËSISË, ashtu edhe GJITHËSIA përfshihet brenda Gjithçkaje". Doktrina në këtë pikë është e prerë. Tani mund t'i shtojmë edhe fjalët përmbyllëse të citatit: "Ai i cili e ka kuptuar këtë të vërtetë në thelb, ka përfituar dituri të vyer".

VI. THOT-i DHE MAAT/MÁT-i

1.Burrë e Grua, apo…?

Edhepse nuk kishin ndonjë lidhje familjare apo triade, Thoti dhe Mati shpesh merreshin së bashku dhe poashtu së bashku ata na sjellin njohuri me vlerë për mitologjinë egjyptiane.

Thoti dhe Mati përfaqësonin të dy cilësi të intelektit (mençurinë dhe vërtetësinë), por kishte një ndryshim të madh në mënyrën e të menduarit të secilit prej tyre.

Mati, vërtetësi dhe drejtësi, nuk ishte dhe kaq e zhvilluar apo e përhapur në kuptimin mitologjik të fjalës (si karakter apo personazh nëpër rrëfenjat e historisë mitologjike) sa ishte Thoti, simbol i mençurisë.

Mati ishte personifikim i femrës, zakonisht një figurë abstrakte, edhe pse më vonë gjeti pasqyrim në pamje konkrete dhe specifike. Pamja e Matit ishte filozofike dhe teorike, ndërsa koncepti i Thotit ishte vetjak dhe praktik.

Sidoqoftë, ndryshimi dhe kontrasti midis tyre nuk është aq i thellë: Thoti, sado vetjak dhe praktik të duket në paraqitje, mishëron një koncept të rëndësishëm intelektual; dhe Mati, me gjithë paraqitjen abstrakte të saj, simbolizon një figurë konkrete, e cila me kohë u përfshi në mitet e perëndive të tjera.

Të dy, perëndi dhe perëndeshë, përfaqësonin cilësitë hyjnore të nevojshme për një jetë të kënaqshme si dhe për kalimin në botën e nëndheshme. Ata ishin vendosur si një dyshe (perëndi-çift) në varkën diellore, duke u kujdesur për

ecurinë e udhëtimit ditor, që kryhej nëpër qiej nën drejtimin e perëndisë Ra (Amon-Ra).

Edhe pse kishin detyra të rëndësishme në mitologjinë e Memfisit, të Heliopolit dhe Tebës, Thoti dhe Mati nuk shiheshin si të afërt "në gjak" me familjet e zotave në këto qytete. (Sepse ata ishin atlantidas e jo egjyptian vendas). Kur priftërinjtë krijuan pemët gjenealogjike të familjeve hyjnore, Thoti dhe Mati u lanë jashtë, duke u vendosur në një degëz të veçantë. Mrgjithatë, ata luajtën një rol të rëndësishëm ndihmës dhe u përfshinë në historitë e shumë qendrave të kultit. Në veçanti Thoti është i pranishëm në shumë mite, që nga Delta deri në thellësi të Jugut dhe për një kohë quhej ***"më i pushtetshmi i perëndive"***.

Në mitet e Egjyptit të lashtë kemi mundur të zbulojmë versione të shumta rreth krijimit të botës, perëndive dhe njerëzve të vdekshëm që jetuan në këtë botë, por një nga versionet më të pazakonta dhe njëkohësisht më interesante vjen nga qendra e vogël e banuar me emrin Hermopol, qytet pa ndonjë rëndësi politike. Qendra e kultit të Thotit ndodhej pikërisht në këtë qytezë, në Egjyptin e Mesëm, pranë qytetit të sotëm Minia. Këtu priftërinjtë përkrahën një mitologji të hershme dhe prova të këtij ndikimi mund të gjenden në *"Tekstet e Piramidës"*.

2.Thot-i

Edhe pse shumë të dhëna kundërshtuese lidhur me lindjen e Thotit provojnë mangësinë e një mitologjie sistematike për të, Siegfried Morenz mbështet një tezë sipas së cilës Thoti shoqërohej me kryeperëndinë Ra. Një dokument i lashtë e cilëson lindjen e Thotit si vepër të fuqisë së kryeperëndisë Diell: **"Unë jam Thoti, djali më i madh i RA-së, të cilin e formoi ATUMI, i krijuar nga KHEPRI... Unë zbres në Tokë me të fshehtën e atij, *të cilit i takon horizonti*".**

Fakti që ky fragment dokumenti e cilëson lindjen e Thotit jo vetëm si vepër e perëndisë Ra, por edhe e Atumit dhe Kheprit, forma të tjera të perëndisë Ra, provon se Thoti ishte i pajisur me një fuqi të trefishtë atësie dhe ishte kuptimplotë fakti që Ai erdhi në botë duke bartur të fshehta të mëdha.

Ndërsa Thoti shihej si perëndi e mençurisë, më gjerësisht ai njihej si perëndi e shkencës dhe e mjekësisë së pari sepse ai mbahet mend për gjestin e tij kur i dha Isisit fuqi tërheqëse për ta sjellë Osirisin sërish në jetë aq sa të mund të krijonte Horusin, dhe sepse më vonë ai e mjekoi Horusin e sëmurë nga kafshimi i akrepave. Thoti shihej gjithashtu si krijues i retorikës, i emrave të objekteve dhe i alfabetit. Ishte Thoti ai që e shpiku shkrimin me hieroglife, matematikën dhe astronominë. Përveç këtyre vetive të larta, Thoti mund të cilësohet si një nga perënditë më të këndshme dhe më tërheqës në tokë. Ai ishte i matur dhe elokuent, kur Isisi kishte nevojë për për ndihmën e tij në mjekimin e Horusit. Ai u hutua po kaq sa edhe çdo perëndi tjetër gjatë procesit gjyqësor

midis Setit dhe Horusit. Nga ana tjetër, ai ishte i egër dhe i rreptë kundrejt çdo perëndie që ai gjykonte se kishte gabuar.

Pjesa më e madhe e autoritetit të tij mbi njerëzit dhe perënditë i detyrohet caktimit të tij si ***zëvendës i kryeperëndisë Ra.*** Ne kemi parë se kur Ra u lodh e u plak nga jeta dhe nga punët e tij të shumta, ua kaloi disa nga detyrat perëndive tjera, duke e caktuar Thotin si ndihmës të tij:

"Për sa kohë që unë do të veproja në një mënyrë të atillë që drita të mund të ndriçojë botën e nëndheshme..., ti do të kujdesesh për rregullin dhe qetësinë e atyre që pushojnë atje dhe do të mbash nën vrojtim të gjithë ata që mund të rrebelohen kundër meje... Ti do të zësh vendin tim, do të jesh zëvendësuesi im. Kësisoj do të quhesh Thot, zëvendës i RA-së!"

Thoti ishte gjithashtu zemra e Ra-së, që do të thotë se përbënte një burim mençurie për të dhe se kishte vendin e tij të caktuar në *varkën diellore*, ku bashkë me Matin ulej dhe vrojtonte për çdo ditë.

Ra i dha Thotit hënën për të balancuar diellin e vetë Ra-së. Si perëndi e Hënës, Thoti përdori njohuritë e tij matematike për të matur kohëzgjatjen e stinëve dhe për të rregulluar kohën. Ai vrojtoi qiejt dhe planifikoi formën e Tokës: ishte Thoti ai që e vendosi Tokën dhe gjithçka ndodhej mbi të në baraspeshim. Qëndrueshmëria e Universit varej nga njohuritë e tij mbi matematikën qiellore. Të gjitha këto atribute dhe veti të larta bënë që ai të cilësohej si perëndi e shkencës.

Fuqitë e mëdha shumëplanëshe të Thotit bënë që ai të ngarkohej me shumë përgjegjësi në emër të njerëzve dhe të perëndive njëkohësisht.

Referenca më e vjetër mbi Thotin është gjetur në *"Tekstet e Piramidës"*, ku atij i caktohet një rol në botën e përtejme. Detyra e tij ishte të çonte të vdekurin përmes *"rrugës së ujshme me thëllimë"*, hipur mbi krahët e tij. Me të arritur në botën e nëndheshme, në anën tjetër të ujit, ai bëhej përfaqësues i mbretit të vdekur dhe e mbronte atë nga gjithkush që do të guxonte t'i bënte ndonjë të keqe. Më vonë, shumë vizatime *të "Librit të Vdekjes"* i japin atij më shumë detyra e përgjegjësi në botën e përtejme, duke ndenjur pranë shkallëve në sallën e gjyqit me një pendë në dorë për të shkruar vendimin mbi një rul papirusi.

Në një rol tjetër Thoti mbahej si mbrojtës dhe lajmëtar i perëndive. Detyra e tij e veçantë ishte të mbronte *Syrin e Horusit* dhe të vërtetonte nëse ishte i denjë mbreti që kërkonte pavdekësi. Ndër të tjera, ai ishte dhe përgjegjës për mbrojtjen e së drejtës dhe të sigurimit të paqes. Në *"Tekstet e Piramidës"* përfshihet një lutje-himn për të si përçues i paqes: ***"Dëgjo, o Thot, tek i cili ndodhet paqja e perëndive".*** Në një nga fjalimet në *"Tekstet e kofinit"*, thuhet se ai ishte "Demi i Drejtësisë", i aftë për të kënaqur madje edhe Horusin edhe Setin në betejat e të cilëve roli i tij si vendosës i paqes ndërmjet perëndive qe i dukshëm.

Për të përmbushur këto dhe detyra tjera, Thoti shpiku artin e të shkruarit, ndihmesën më domethënëse për kohët moderne. Ai nisi të shkruaj mbi stinët dhe gjeometrinë qiellore. Ai ishte përgjegjës për mbajtjen e shënimeve nga gjykimi i të vdekurit si dhe për shkrimin e letrave në emër të perëndive për në Heliopol. Ky funksion i tij përshkruhet në *"Librin e Vdekjes":*

"Unë kam sjellë sferën dhe kutizën e bojës, si objekte që tani janë në duart e Thotit: është e fshehtë ajo që shkruhet me to! Gjemë mua në shkrime".

Është interesant fakti që edhe aftësia e tij si shkrues përfshin njohuri të fshehta, por Thoti e përdori artin e të shkruarit jo vetëm në rolin e një sekretari perëndishë, ai ishte gjithashtu kryeautor i Heliopolit. Me kohë Thoti shihej si autori i të gjith vëllimit *"Libri i Vdekjes"*, por mendimi i përgjithshëm është se ai mund të ketë shkruar vetëm disa pjesë të tij. Një fletë papirusi e vonë thotë se Thoti shkroi pjesë të *"Librit të Frymëmarrjes"* me gishtrinjtë e tij dhe se përmes tij i aftësoi shpirtërat që të marrin frymë përjetë.

Projekti i tij më i madh i të shkruarit u quajt ***"Libri i Thotit"*** dhe përmban formulën e tij magjike, megjithëse kohëzgjatja e këtij libri mbetet një subjekt kundërshtishë. Një version i mitit pretendon se vetëm dy janë faqet e këtij libri, njëra që bën fjalë për magjitë për të ndjellë natyrën, dhe tjetra dhënja e magjisë për të kontrolluar botën e të vdekurve. Kurse një version tjetër i mitit pretendon se është fjala për 432 libra, që kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë, të shkollimit të priftërinjve, me historinë e botës, gjeografinë, hieroglifet, astrologjinë, fenë dhe mjekësinë.

Ky libër frymëzon një nga historitë e pakta mbi Thotin dhe nuk përfshin ndonjë perëndi tjetër. Një papirus i Ptolemeut na tregon për një princ me emrin *Neferkapta*, për familjen e tij dhe për kërkimet e tyre për ***"Librin e Thotit".*** Një prift e përshkroi librin magjik para princit me fjalë tepër entusiaste:

"Thoti e shkroi librin me dorën e tij dhe në të përfshihen të gjitha magjitë e kësaj bote. Nëse ju do të lexoni faqen e parë të tij, do të magjepsni qiellin, tokën, malet, vorbullat dhe detin; do të kuptoni gjuhën e zogjve në fluturim dhe do të ndieni se çfarë gjërash të mahnitshme ata i thonë tokës; do të shihni peshqit që nga thellësia më e errët e ujërave të deteve. Dhe nëse do të lexoni faqen e dytë të librit, edhe nëse do të jeni i vdekur në botën e përbindshave, ju do të ktheheni sërish në tokë në formën tuaj të mëparshme. Dhe veç kësaj, ju do të shihni diellin të shkëlqejë në qiell dhe hënën e plotë dhe yjet e do të perceptoni figurat madhore të perëndive."

3.Maat/Mat-i

Perëndesha **Mat** ishte bija e Zotit Diell, që më vonë u zëvendësua nga Zoti Një e i plotfuqishëm, Zot i çdo faraoni e çdo gjëje në Gjithësi, që në Egjypt quhej Atum. (Disa gjuhëtarë e përkthejnë me shqipen: At-um, at-me, at-ume, që do të thotë babë dhe mëmë, ndërsa fjalën Faraon me fjalën shqipe Fara jonë, Fisi jonë).

Mat-i ishte ndoshta më pak mitologjikja e perëndive në Egjyptin e lashtë, pasi që ajo ishte forma konkrete përmes së cilës paraqitej një koncept filozofik.

Forma e saj fizike ishte ajo e një gruaje, që mbante çelësin e jetës dhe skeptrin dhe shpesh identifikohej përmes puplës që mbante mbi kokë. Askush nuk e di me siguri zanafillën e shoqërizimit të saj me këtë pupël gjeldeti, por sidoqoftë cilësia e kësaj puple duket e denjë për një për një perëndeshë me vetitë e saj. Ka mendime se pupla u shndërrua në një simbol të saj, pasi është e baraspeshuar nga të dyja anët, duke paraqitur në këtë mënyrë gjykimin e drejtë që i kërkohej një perëndeshe që ulej të gjykonte në gjyqin e të vdekurve.

Cilësia filozofike që perëndesha përcillte njihej gjithashtu me emrin **"mat"** dhe përkthimi ynë e barazon me "të vërtetën", por sidoqoftë nuk ka një fjalë të vetme që do të mjaftonte për të shprehur vetë konceptin. **Mat**-i ishte çelësi i pikëpamjes së lashtë egjyptiane mbi sjelljen etike të njerëzve derisa janë gjallë, si dhe për sjelljen hyjnore në gjyqin e shpirtërave pas vdekjes së tyre.

Sipas studiuesit Siegfried Morenz, "Mat-i është orientimi i drejtë në natyrë dhe në shoqëri, siç është përcaktuar nga akti i krijimit dhe do të thotë: e drejtë, e saktë, korrekte, ligj,

rregull, sistem, drejtësi dhe e vërtetë". **Mat**-i ishte një udhërrëfyese e së drejtës, e sjelljes së përkryer që çdo njeri duhet të ketë me të tjerët.

Pikërisht për të mishëruar këtë koncept u krijua perëndesha **Mat.** Ajo ishte personofikimi i së vërtetës dhe së drejtës, ndaj dhe bartte pak cilësi njerëzore. Mitologjia e saj na tregon se ajo ka të ngjarë të ketë qenë e bija e **RA**-së dhe se është ngritur nga ujërat nga të cilat ai krijoi vetveten; kurse jashtë mitologjisë egjyptiane babai i saj shoqërohej me të për të paraqitur drejtësinë e tij.

Në ***"Tekstet e kofinit"*** gjendet një mit i shkurtër, mjaft interesant, që i sjellë të dy bashkë. **RA** ishte i plakur dhe lodhur, ndaj i kërkoi mendim e këshillë perëndisë **NUN.** Ky i fundit i tha kryeperëndisë se do të thërriste **Mat**-in pranë tij që **RA** ta puthte e të rifitonte jetë dhe gjallëri. Kurse në ***"Librin e vdekjes"*** thuhet se **Mat**-i dhe **Thoti** rrinin pranë Horusit në barkën diellore të kryeperendisë RA për çdo ditë dhe se ky i fundit mbahej në jetë bukur e mrekullisht në saje të Matit.

Me mitologjinë e saj Mat-i luajti gjithashtu një rol të rëndësishëm në botën e nëndheshme. Gjatë procesit gjyqësor të personit të vdekur Mat-i ishte gjithmonë e pranishme. Në disa vizatime penda e saj qëndron në krye të shkallëve për të garantuar drejtësi, ndërsa zemra e të vdekurit peshohej në anën e kundërt të peshores, ku ishte vendosur gjithnjë penda (pupla) e saj. Nëse zemra baraspeshonte me të drejtën dhe të vërtetën, duke mos qenë as shumë e rëndë dhe as shumë e lehtë, personi i vdekur gjykohej se e kishte kaluar provën e parë dhe se ishte pranë pavdekësisë. Më pas i vdekuri kalonte në Sallën e Mat-it apo siç quhej edhe Salla e Gjykimit, ku ai ose ajo duhej të përgënjeshtronin 42 akuzat e mëkateve dhe të

gjenin emrat magjikë të pjesëve të ndryshme të derës. Mat-i i mbikëqyrte këto veprimtari dhe , nëse i vdekuri i plotësonte këto detyra, ajo e siguronte shpirtin e tij se tani ishte gati për t'u paraqitur pranë Osirisit për pranimin përfundimtar.

Shumë prej skicave në *"Librin e vdekjes"* tregojnë për rolin e rëndësishëm të luajtur nga Mati gjatë gjykimit të të vdekurit, por ka dhe shumë tempuj që përmbajnë edhe sot e kësaj dite vizatime të saj. Që nga Abu-Simbeli e deri te Lugina e Mbretërve, në pikturat apo gdhendjet murale dallohet lehtë figura e saj, për shkak të puplës vendosur mbi kokë dhe nganjëherë duke e mbajtur në dorë. Ajo mund të shihet gjithashtu edhe në Muzeun Egjyptian në Kajro, në shumë forma dhe vizatime.

4.Rregullat e Perëndeshës MAAT/MÁT

Perëndesha Mat kishte pamjen e nji gruaje, me një pupël të vendosun në kokë e që i zbukuronte flokët. Kur faraoni bëhej drejtues vendi, ishte i detyruar të betohej për besnikëri, drejtësi e që do ndiqte rregullat e Mat. Mbas vdekjes, zemra e tij peshohej në botën tjetër me anën e peshores së perëndeshës Mat. Në njërën anë të peshores ishte zemra, në anën tjetër vihej pupla. Nëse kandari nuk rrinte në qendër, donte të thonte se faraoni nuk kishte punuar mirë. Kjo gjë pasqyrohet te pikturat e piramidave dhe është domethënëse, sepse tregon se sa të rëndësishme ishin zbatimet e rregullave të perëndeshës Mat për Faraonin dhe për popullin egjyptian, i cili e jetonte jetën e përditshme të tij të drejtuar e të rregulluar në bazë të këtyre ligjeve.

Për egjyptianët Mat ishte pamja, fytyra e Drejtësisë, ishte mishërim i së vërtetës dhe i rregullit të Gjithësisë, ishte gruaja e THOTIT. Mat u bë nismëtarja e rrymave fetare dhe shpirtërore të Egjyptit të lashtë, e, në bazë të këtyre, dhe e të gjitha rrymave fetare në botë. Rregullat e Mat ishin qendra e moralit egjyptian dhe çdo faraon, para hypjes në fuqi, duhej të betohej mbi këto rregulla që duhej t'i zbatonte gjatë qeverisjes së tij.

Sipas shkrimeve të zbuluara, jeta në Egjypt bazohej në punën e njerëzve të lirë, ku gruaja gëzonte të drejtat e saj, ku drejtuesit e vendit duhet të ishin të drejtë e të pakorruptuar. Faraoni ishte i rrethuar nga dijetarë shkencash, shpirtërorë e fetarë dhe në të gjithë veprimtarinë e tij shtetërore duhej të konsultohej me këta njerëz të ditur. Kjo qeverisje me mençuri dhe drejtësi bëri që qytetërimi egjyptian të kishte jetëgjatësinë më të madhe, ndërsa, siç e dijmë nga historia, drejtues shtetesh, që kanë udhëheqë me diktaturë ose me mashtrime, e kanë pasur të shkurtër qeverisjen dhe janë mbuluar nga harresa.

Me rregullat e perëndeshës Mat njerëzimi është njohtë pas zbulimit të Papirit të Anit, i shkruar me hieroglife korsive dhe i takon dinastisë XVIII të Egjyptit të vjetër. Në këtë papir janë shkruar 42 rregulla të njohura si RREGULLAT E MAT.

Këto 42 rregulla përmbanin betimin e Faraonit dhe drejtonin ligjet e Egjyptit. Do të shohim se shumë nga këto rregulla do jenë familjare, të dëgjuara nga veshët e lexuesit, sepse janë përsëritë nga fe të ndryshme. Mendohet të jenë shkruar 3500 vjet para Erës së Re dhe 2000 vjet para Mojsiut (Musait).

Këto rregulla janë:

1. Mos vrit e mos lejo që ndonjëri ta bëjë këtë gjë!
(E njëjtë me urdhëresën nr. 5 të Mojsiut)
2. Mos tradhto bashkëshortin! (Mos shkel kurorën!)
(E njëjtë me urdhëresën nr 6 të Mojsiut)
3. Mos ji inatçi!
4. Mos shkakto tmerre (terror)!
5. Mos sulmo e mos i shkakto dhimbje të afërmit!
6. Mos shfrytëzo të afërmin!
7. Mos bëj dëme që mund t'u krijojnë dhimbje njerëzve dhe kafshëve!
8. Mos shkakto derdhje lotësh!
9. Rrespekto të afërmin!
10. Mos vidh atë që nuk të takon!
(E njëjtë me urdhëresën nr. 7 të Mojsiut)
11. Mos merr ushqim më shumë se sa të takon!
12. Mos dëmto natyrën!
13. Mos i hiq të drejtën ndonjërit për atë që ai don!
14. Mos bëj dëshmi të rreme!
(E njëjtë me urdhëresën nr. 8 të Mojsiut)
15. Mos gënje që t'i bësh keq tjetrit!
16. Mos ua impono idetë tuaja të tjerëve!
17. Mos vepro kur mund të bësh keq!
18. Mos përfol gjërat e të tjerëve!
19. Mos dëgjo fshehtas (mos përgjo)!
20. Mos nënvleftëso të vërtetën dhe drejtësinë!
21. Mos gjyko keq për tjetrin pa e njohtë!
22. Rrespekto vendet e shenjta!
23. Nderoje dhe ndihmoje atë që vuan!
24. Mos u zemëro pa një shkak të vlefshëm!
25. Mos pengo rrjedhën e ujit!

26. Mos shpërdoro ujin!
27. Mos dëmto Tokën!
28. Mos ju lut Zotit bosh! (Pa u përqendruar tee lutja.)
(E njëjtë me urdhëresën nr. 2 të Mojsiut)
29. Mos urre besimin e të tjerëve!
30. Mos përfito nga besimi i tjetrit për t'i bërë keq.
31. Mos u lut pak, por edhe shumë, shumë mos iu lut Zotit!
32. Mos përfito në përvetësimin e gjërave të fqinjit!
(E njëjtë me urdhëresën nr. 10 të Mojsiut)
33. Rrespekto të vdekurit!
34. Rrespekto ditët e shenjta, edhe nëse nuk beson!
(E njëjtë me urdhëresën nr. 3 të Mojsiut)
35. Mos vidh ndihmat që i janë bërë Zotit e që do të përdoren për ty!
36. Mos urrej ceremonitë e shenjta!
37. Mos vra kafshët e shenjta pa ndonjë qëllim!
38. Mos u sill si i paturp!
39. Mos u sill me mendjemadhësi!
40. Mos të të rritet mendja nga gjendja e mirë ekonomike!
41. Rrespekto detyrat tuaja!
42. Rrespekto ligjet dhe mos i shpërdoro ato!

*****

Tani do të njihemi me përkthimin e PAPIRIT TË ANIT:

Ky papir shërbente si dokument që shoqëronte të vdekurit për në jetën tjetër dhe u vihej atyre te sarkofagu. Bie në sy se aty i vdekuri duket sikur u përgjigjet urdhëresave që janë shkruar te rregullat e MATIT.

Papiri i Anit është shkruar shumë më vonë se rregullat e Matit. (Mbi 1300 vjet ma vonë e rreth 200 vjet para Mojsiut (Musait)). Ruhet në një muzeum të Londrës dhe është përkthyer si më poshtë:

- Çfarë do të thuhet te hyrja e Odave të dy Mat nga mbikëqyrësi i pallatit dhe i thesarit NU: të bëjë valë pastruese e të jetë pastruar nga të gjitha të këqijat e bëra nga ai, dhe pastaj të shohë Fytyrën e Zotit.

- Të përshëndes ty, o Zot, më i madhi nga të gjithë te odat e dy të vërtetave!

- Unë kam ardhë ke ti, o Zoti im, i dërguar nga vala pastruese, për të pa përsosmërinë tënde. Unë të njoh vetëm Ty dhe emrin Tënd.

- Unë njoh të 42 ligjet hyjnore që ekzistojnë bashkë me Ty, në këtë Odë të Dy të Vërtetave, që janë krijuar për të kontrolluar ata që bëjnë mëkate e që po pijnë gjakun e tyre.

Në gjykimin me cilësi në prani të Unnefer (Besoj që quhet: Unë Neferi), Zonja të dy të Vërtetave, në emrin e Zotit:

- Unë kam ardhë te ti dhe kam sjellë të vërtetën e perëndeshës Mat.

- Unë i kam heqë mëkatet për ty e nuk i kam bërë keq njeriu.
- Nuk jam sjellë keq me miqtë.
- Nuk kam shpërdoruar të vërtetën e drejtësinë.
- Nuk kam bërë gjëra pa vlerë.
- Nuk kam bërë keq.
- Nuk kam pranuar që çdo ditë të kem persona të tepërt për të më shërbyer.
- Nuk më ka ardhë urdhëri të komandoj shërbyesit e mi.
- Nuk e kam përbuzë përjetësinë.
- Nuk u kam heqë të varfërve mjetet e jetesës.

- Nuk kam pasë asnjë urrejtje ndaj Zotave.
- Nuk kam ofenduar shërbyesit e Zotit.
- Nuk i kam shkaktuar hidhërim njeriu.
- Nuk kam shkaktuar vdekje nga uria.
- Nuk kam bërë njeri të qajë.
- Nuk kam vra.
- Nuk kam dhënë urdhën me vra.
- Nuk i kam shkaktuar vuajtje ndonjeriu.
- Nuk kam marrë ushqimin e faltoreve.
- Nuk kam dëmtuar propozimet e miratuara nga Perënditë.
- Nuk kam marrë ëmbëlsirat e dhuruara shpirtërave të shenjtë.
- Nuk kam kryer marrëdhënie homoseksuale.
- Nuk kam kryer veprime të pista në vende të shenjta.
- Nuk kam marrë nga fqinji pronat e atij që nuk më takojnë.
- Nuk kam hy pa leje te pronat e tjetrit.
- Nuk kam shtuar peshë gjatë peshimit.
- Nuk kam peshuar mangut gjatë peshimit.
- Nuk kam marrë qumësht nga goja e fëmijëve.
- Nuk kam penguar bagëtitë në kullotat e tyre.
- Nuk i kam kthyer mbrapsht bagëtitë e çuara në kullotë nga pronarët e tyre.
- Nuk kam kapë në lak zogjtë te pyjet e zotërive.
- Nuk kam peshkuar me grep duke përdorë peshq të vegjël.
- Nuk kam devijuar ujin në sezon vaditjeje.
- Nuk kam shuajtë flakën kur ajo ndriste.
- Nuk kam bërë diga për të devijuar ujin në favorin tim.
- Nuk kam shkelë detyrën në ditën e shenjtë të dhuratave ushqimore.
- Nuk kam qenë kundër gjërave të shenjta gjatë ceremonive fetare.

- Jam kthyer katër herë në gjendje pastrimi.
- Pastërtia ime është pastërtia e shumë të madhit Herakleopolis.
- Në të vërtetë unë jam hunda e Zotit të erës, që i jep jetë gjithë njerëzimit, në këtë ditë e deri në mbylljen e syve të Horus (Heliopolis), ditën e fundit të muajit të dimrit.
- Në prani të Zotit të kësaj toke, unë kam qenë ai që zgjodhi mbylljen e syve të Horus.
- Asgjë e keqe nuk më ndodh në këtë Tokë, në Odat e dy Mat, sepse i njoh me emër këta që banojnë këtu, admirues të Zotit të Madh.

*****

Mojsiu (Musai), që ishte rritë e shkolluar në oborrin e Faraonit, i njihte mirë Rregullat Mbretërore dhe bazat e të Drejtave Civile e Penale egjyptiane dhe Librin e të Vdekurve. Kur u largua nga Egjypti, bashkë me simpatizantët e vet, ai u gjend pa ligje e rregulla, me një "popull" (sepse ishin disa qindra) të dërrmuar e gjysëm të egër. Në këto kushte Mojsiu duhej të bënte rregulla e ligje për të krijuar një trup të ri juridik që të drejtonte e të kontrollonte këtë popull të sapodalë nga Egjypti. Këto ligje i gjeti të gatshme te librat e Egjyptit, me të cilat njihej populli i tij dhe ai vetëm sa i bëri disa korrigjime të vogla. Sipas Biblës, Mojsiu shkoi te mali i Sinait dhe atje i zbritën dhjetë urdhëresat e Zotit, por në të vërtetë nuk ishte ashtu.

Pas daljes në Dritë të Rregullave të MAT-it, studiusve u lindi pyetja: Me të vërtetë Mojsiut (Musait) i zbresin nga Zoti ligjet dhe urdhëresat, apo ai i kopjoi nga rregullat e Mat-it,

duke transformuar betimin e egjyptianëve në një seri urdhëresash që i shërbenin popullit të tij.?

Duke analizuar shkrimet e kohës ebreje dhe ato egjyptiane, ata dalin në konkluzionin se Mojsiut nuk i kanë zbritë nga Zoti të Dhjetë Urdhëresat e Zotit, por i ka kopjuar nga librat e shenjtë të Egjyptit. I mori ligjet egjyptiane dhe i modifikoi në favor të tij, dhe për më shumë se 3300 vjet i ka bërë më shumë se gjysmën e botës të besojnë se i kanë zbritur nga Zoti ligjet e shenjta.

VII. ENOKU dhe MOISIU

1.Dituria e humbur Enokiane/Thotiane

Sekretet e Thotit dhe Çelesat e Enokut

Që nga publikimi i shpikjes së një radari i aftë të penetrojë nëntokën disa vite më parë, janë zbuluar të dhëna të mahnitshme mbi ekzistencën e një kompleksi labirinthesh dhe sistemi të nëndheshëm në pjesë të ndryshme të botës.

Në vende si Guatemala në Amerikën e Jugut janë hedhur në hartë tunele që shtrihen poshtë kompleksit të Piramidave Maja në Tikal dhe që zgjatohen për më shumë se 800 km në krahun e kundërt të vendit. Studiuesit kanë theksuar se, tani është e mundur të kuptohet sesi gjysëm milioni indianësh Maja u fshehën dhe i shpëtuan shkatërrimit të kulturës së tyre.

Në të njëjtën mënyrë radari (i quajtur SIRA) u përdor në Egjipt që në vitin 1978, duke bërë të mundur hedhjen në hartë të një kompleksi të jashtëzakonshëm të nëndheshëm poshtë Piramidave të Egjiptit. Mbas marrëveshjeve të arritura me Presidentin Egjiptian, Sadat, rezultuan në gërmime sekrete për pothuajse 3 dekada që të arrihej të penetrohej në sistemin e nëndheshëm

Në një takim të kohëve të fundit në Australi, njëri nga shkenctarët kryesore në projektin Giza, Dr. Jim Hurtak, tregoi filmime të punimeve që po kryeshin të titulluar Dhomat e Thellësisë, i caktuar për t'u bërë publik në fund të shekullit.

Filmi tregon zbulimin e një metropoli të gjerë megalitik, 15 mijë vjeçar që zbret në disa nivele poshtë nën pllajën e Gizës. Ndërsa, pjesa tjetër e New Age spekulon mbi

ekzistencën e një dhome të fshehtë nën putrën e majtë të Sfinksit, legjendari "Qyteti i Zotave" dergjet nëntokë. I kompletuar me një sistem hidraulik të nëndheshëm, filmi tregon për statuja masive të të njëjtës përmasë me ato të Luginës së Nilit.

Studiues, duke rrezikuar jetën e tyre, me kamera dhe elektrikë dore hetuan me kujdes dhe detaje brigjet e thepisura përreth lumenjve të nëndheshëm dhe liqeneve të gjerë mbi një kilometër për të penetruar dhomat e mbyllura që ndodheshin përtej tyre. Dhe mundi nuk shkoi kot. U gjetën një sasi e pamasë dokumentash dhe artifaktesh.

Dokumentat flasin për trashëgiminë e një civilizimi dhe niveli teknologjik shumë përtej këtij që jemi ne tani. Një teknologji e aftë që të krijojë qytete të mëdhenj të nëndheshëm, për të cilat Sfinksi dhe Piramidat janë vetëm shenjat e sipërfaqes.

Shkencëtari i projektit Dr. Hurtak, e lidh këtë zhvillim me kontaktin me një rracë të avancuar jashtëtokësorësh. Ai e përshkruan këtë si një zbulim të një kulture të Rrënjës së Katërt, të ashtuquajturin civilizimin Atlantas, i shkatërruar nga çrregullimi i fundit i Tokës.

Filmimi paraqet evidenca të pakundërshtueshme që të gjitha gjuhët, kulturat dhe fetë kanë një burim të përbashkët, atë që Dr. Hurtak e quan si "Civilizimi Mëmë".

Teknologjia e zbuluar është shumë përtej asaj që njohim ne. Ashtu siç tha njëherë me shaka Arthur C. Clark, "çdo teknologji që është përtej kësaj tonës, do të na duket si magji".

Sipas Dr. Hurtak kjo ka qenë një kulturë, e cila arriti të zbërthente kodin gjenetik dhe zotëronte çelësat e spektrit fizik, "Fizikën e Dritës Superiore" të antikëve... çdo gjë e lashtë, të

cilën Gilgameshi (Në Epikën e Gilgameshit-Darius) shkoi për ta kërkuar në udhëtimin e tij të famshëm në "Qytetin e Zotave" për të zbuluar tunelet poshtë Malit Mashu në shkretëtirë.

Hurtak në materialin e tij i referohet një "gjuhe të dritës" dhe shkencëtari-prift madhështor të asaj kohe të lashtë i quajtur Enok, emri i të cilit është i lidhur me ndërtimin e kompleksit të Piramidave të Mëdha. Hurtak aludon për një shkencë të një karakteri spiritual madhështor, një shkencë, e cila përshkruan shkallën gjenetike për te yjet.

Prifti-shkencëtar Enok është një partriark i epokës para përmbytjes, njëri prej më të famshmëve të karaktereve të asaj epoke. Babai i Methuselah dhe stër stër gjyshi i Noahs, Enoku, përshkruhet në Bibël si arkitekti i Zionit, legjendari "Qyteti i Yahweh" si dhe shpikësi i alfabetit dhe kalendarit.

Enok po ashtu është dhe astronauti i parë në histori, ai që "u morr në qiell nga Perëndia" dhe ju treguan "sekretet e tokës dhe të qiellit". Ai kthehet në Tokë i pajisur me diturinë për "peshën dhe matjet" për gjithë njerëzimin.

I njohur tek egjiptianët me emrin Thoth, "Zoti i Magjjisë dhe Kohës" dhe tek grekët si Hermes, "mesazheri i perëndive", ai përmendet dhe në traditën e kulteve si magjistari enigmatik Merlin, i cili zhduket mbi degët e një molle në Avaloin mitik në përpjekje për të kërkuar sekretin e pavdekësisë dhe për t'u rikthyer.

Pra, si një njëri që përfitoi pavdekësinë, sekretin sesi ne "mund të bëhemi si zotat", Thoth/Enok premtoi të rikthehej në përfundim të kohëve "me çelësat për në portat e tokës së shenjtë".

Në një nga dokumentet e diskutuara të Detit të Zi, që flet për Librin e humbur të Enokut, i hequr qëllimisht nga Bibla

nga liderët e hershëm fetarë, Enok përshkruan një civilizim madhështor të të kaluarës, të cilët përzien çelësat e njohurisë së madhe dhe nuk ishin në gjendje të ruanin veten e tyre nga kataklizma e fundit. Të dy, realisht dhe në mënyrë figurative ata humbën "çelësat", ata humbën të gjithë njohurinë e lartë.

Por sidoqoftë Enok, edhe në shumë tradita të tjera madje edhe tek legjenda e Majave për Kecalkoatlin, premton rikthimin e kësaj diturie në "Fundin e Kohërave", fundin e ciklit aktual kohor. Apokalipsi Biblik premton se, çdo gjë do të mësohet në fund të botës aktuale.

Zbulimet e jashtëzakonshme në Egjipt dhe në pjesë të tjera të botës flasin jo vetëm për një teknologji të avancuar, por edhe për një shteg evolutiv shumë përtej gjendjes sonë aktuale.

Një ekzaminim i kujdesshëm shkencor i zonës ku gjenden piramidat zbulon se ato janë struktura të sofistikuara harmonike, jo vetëm pasqyrë e pozicionit të planeteve dhe sistemeve diellore, por të dizenjuara për të imituar chakrat dhe zgavrat harmonike të trupit të njeriut. (Chakra janë pika të energjisë në sistemin trup/energji të njeriut, nëpërmjet të cilave rrjedh forca dhe energjia jetësore. Ka me mijëra pika të tilla në trupin e njeriut, por vetëm shtatë ose tetë prej tyre janë më kryesorët.).

Madje, çdo gur në Piramidën e Madhe është i akorduar harmonikisht sipas një frekuence të caktuar toni muzikor. Sarkofagu që ndodhet në qendër të Piramidës së Madhe është i intonuar sipas frekuencës së rrahjes së zemrës së njeriut.

Eksperimentet e mahnitshme që u kryen nga Dr. Hurtak dhe kolegët e tij në Piramidën e Madhe dhe në zona të tjera në Amerikën e Jugut provojnë, se piramidat janë "kompjutera gjeofizikë" që aktivizohen sipas tingullit zanor. (Kujtoni

mënyrën sesi D H.Lewis dhe anëtarët e tjerë të ekspeditës arritën të futen në brendësi të Piramidës).

Duke intonuar disa tiguj specifik të lashtë, grupi shkencor prodhoi valë të qëndrueshme drite, mbi dhe nën piramidat dhe ishin në gjendje që të penetronin edhe në dhoma deri më sot të papenetrueshme. Zbulimet e mëpasme tregojnë që shkencëtarët-priftërinj të lashtë kishin ndërthurur një lloj teknologjie tingujsh harmonik përbrenda strukturës së tempujve.

Dituria e humbur Enokiane tregon se, gjuha mëmë ishte "Gjuha e Dritës". E njohur tek antikët si Hiburu, është gjuha e parë e krijuar në fillimin e këtij cikli kohor. Studimet moderne konfirmojnë faktin, se gjuha më e vjetër është një formë e Hebraishtes si një gjuhë natyrale, pasi tingujt dhe alfabeti buron nga një vazhdimësi apo rrjedhje e përhershme e fosfenit në trurin njerëzor.

E njëjta formë që lind nga një vorbull në lëvizje të pandërprerë. Është një gjuhë e vërtetë drite që përshkon sistemin tonë nervor.

Duke çkoduar gjeometrinë e formave natyrale të valëve në botën fizike, Hiburu është një gjuhë harmonike që imiton karakteristikat e formës valore të dritës. "Çelësat", për të cilët flet Enok dalin se janë çelësa zanore, çelësa të një njohurie matriksi vibracional të vetë realitetit, mitikja "Fuqia e Botës".

Dituria Enokiane përshkruan ekuacione zanore të koduara fjalët e lashta dhe emrat e perëndive, të aftë për të ndikuar direkt në sistemin nervor dhe të prodhojnë një efekt të fortë shërues dhe një gjendje të lartë ndërgjegjeje. Siç deklarojnë tekstet e lashta, "Nëse doni të flisni me zotat, më parë duhet të mësoni gjuhën e zotave".

ADN, kabalistika antike, Pema e Jetës të përshkruara këto në Torah Biblike, tani po bëhen më të qarta për shkenctarët që duhet të konsiderohen si një strukturë e gjallë vibruese dhe jo me një diçka amorfe dhe thjesht numerike. Shumë shkencëtarë modernë e konsiderojnë ADN si një veshje, si konfigurim formë valore, e aftë të modifikohet nga drita, radioaktiviteti, fusha magnetike apo pulset zanore.

Trashëgimia që na vjen nga Thoth/Enok tregon se kjo gjuhë e Dritës ose shkenca antike harmonike mund të ndikojnë direkt ADN-në. Evidencat në Egjipt tregojnë se kjo ka qenë një eksperiment gjenetik 6 mijë vjeçar i tentuar nga egjiptianët, kalvari për pavdekësi dhe shkuarja tek yjet, një kalvar i nisur shumë kohë më parë nga Gilgamesh.

Egjiptianët nuk ishin të fiksuar me idenë e mbas vdekjes siç mendohej nga përkthyesit e hershëm kristianë, por ishin të përqendruar në krijimin e një qenie më të lartë njerëzore. Sëbashku me kultura të tjera të lashta ata besonin se, ADN vinte nga yjet dhe ishte e destinuar të kthehej tek ato.

Dituria e Thoth/Enok le të kuptohet se, njerëzimi është i destinuar që të evolojë përtej formës aktuale tokësore, ashtu siç na thotë Bibla "ne mund të bëhemi më madhështorë se ëngjëjt".

Dokumentat historike egjiptiane kanë të rregjistruara "Udhëtarë të Yjeve", individë të rastësishëm, të cilët si Enok udhëtuan "përtej Syrit të Madh të Orionit" dhe u kthyen për të ecur si zota në radhët e njerëzve.

Pavarësisht nga zbehja e qenieve gjysëm-perëndi në ndërgjegjen moderne, a ka mundësi që siç e thonë dhe tekstet e lashta, ne jemi të destinuar të "bëhemi si perëndi"? A janë "Zotat e Dritës" së Majave dhe "Të Ndriçuarit"

egjiptian/tibetian me të vërtetë një formë më e avancuar njerëzore?

Duke iu referuar shumë legjendave të lashta të Tokës, qenie të tilla supozohet se do të kthehen rregullisht në fillim dhe fund të çdo cikli kohor, gjysma prej 12.960 vjetësh e orbitës zodiakale të sistemit tonë diellor përreth qendrës së galaksisë që kryhet në çdo 25.920 vjet. [Precedenti i Ekuinoksëve].

Për shkak të gjendjes në orbitën e galaktikës sonë, këto 12.960 intervale vjetore ose "bote" duket se janë të ndara nga ngjarje kataklizmike.

Sipas "kalendarit në gur" të Piramidës së Madhe, i cili përshkruan të ashtuquajturën "Ciklin Feniks" ose Phoenix të orbitës së galaktikës sonë, periudha kohore aktuale përfundon (e konvertuar sipas kalendarit tonë) në vitin 2012. (E njëjta shifër që gjejmë dhe tek Kalendari i Majave). Fjala greke Feniks ka rrjedhur nga fjala egjiptiane pa-hanok që do të thotë "Shtëpia e Enokut".

Dituria Enokiane sugjeron se këto ndryshime të rregullta kataklizmike veprojnë si një faktor provokues evolucionar për të përshpejtuar format jetësore në fazën tjetër të evolucionit. Evolucioni njerëzor mund të procedojë më shpejt sesa mendohej më parë.

Evidencat që kanë dalë tani tregojnë, se civilizimeve përpara këtij tonit perfeksionuan kontiniumin fizik dhe progresuan përtej kësaj botë. Pati dhe nga ata që dështuan. Vetë ne kemi të njëjtën mundësi, t'ja arrijmë ose të shkatërrojmë çdo gjë.

Zbulimet e zhvarrosura nga Egjipti përshkruajnë një sistem mbarë botëror piramidash, tempuj në kohët

prehistorike, të vendosura si antena në pikat kyçe të energjisë nëpër meridiane dhe që kontrolloheshin nga priftërinjtë-shkenctarë si një sistem muzikor për të stabilizuar pllakat tektonike të planetit ose më mirë të themi shmangur kataklizmat gjeologjike.

Nga gjuha mëmë, fjala Jedaiah që do të thotë "Rruga e Botës" ose "Fuqia e Botës", priftërinjtë e lashtë Jedai përdornin gjuhën e Dritës për të akorduar planetin si të ishte një këmbanë gjigande harmonike.

Shumë gjëra po rizbulohen në ditët e fundit të këtij cikli kohor. Sipas fjalëve të Dr. Jay Franz i Fondacionit Omega "edhe sikur ne të mos guxojmë ta përmendim, ekziston një ndjesi universale që diçka do të ndodhë në shkallë botërore".

Ky ishte materiali në lidhje me zbulimet e Dr. Hurtak. Siç lexohet qartë, janë shumë gjëra që mbahen të fshehta nga publiku madje dhe vetë arkeologët apo egjyptologët nuk vihen në dijeni ose fshehin faktet me qëllim për të mos dëmtuar pozicionet e tyre. Një lëvizje në kah të kundërt do të thotë hedhje në koshin e plehrave të historisë së botës që kemi mësuar deri tani dhe rishkrimi i saj, duke shkuar mijëra vjet prapa në kohë.

2.Kush ishte Moisiu / (Musai)?

Mendohet (me dyshim!) se ishte fëmijë ebre, i braktisur në ujërat e lumit Nil nga prindët e tij. (Në lashtësi, braktisja e fëmijve bëhej kur ata lindnin me të meta fizike). E gjen bija e faraonit dhe e rrisin si fëmijën e tyre, me gjithë të mirat dhe i japin arsim të plotë, por ai në moshë të pjekur vret një roje të faraonit dhe për t'i shpëtuar drejtësisë, edhe pse ishte si një djalë i faraonit, arratiset nga Egjypti. Martohet, krijon familje dhe i lindin dy djem. Bën një jetë klandenstine me emër të ndryshëm. Në moshë të vjetër (Mendohet të ketë qenë 80 vjeç), për hakmarrje o për urrejtje, për jetën e keqe që po bënte ose ngaqë nuk do ta kenë falur për fajin e bërë, pasi ka mësuar shumë gjëra për magjinë, ose do i ketë mësuar nga priftërinjtë e Thotit kur trajtohej si bir i faraonit, rikthehet në Egjypt dhe vendos t'i largojë nga Egjypti ebrejtë e tij. Largimi nga Egjypti përshkruhet me saktësi te Bibla, që sigurisht tregon fajtorë egjyptianët dhe të pafajshëm Mojsiun dhe ebrejt e tij që po braktisnin vendet e punës dhe vendbanimet.

Ligjvënësit e shteteve duhet të dinë të vlerësojnë në këtë rast se kush ishte fajtori: Mojsiu që vrau nji njeri, dhunoi ligjin duke mos u dorëzuar dhe jetonte ilegal e i kërkuar nga ligji i Egjyptit. Më vonë kthehet dhe nxit revoltën atje, duke i nxitë njerëzit të braktisin vendin në mënyrë masive. Me anë të magjive të tij i shkaktoi shumë vuajtje Egjyptit dhe popullit të tij. Në këtë rast, çfarë duhej të bënte drejtuesi i shtetit, faraoni? E rriti dhe e arsimoi, e mbajti si çunin e vet dhe ai dihet se si ia shpërbleu! Kush ishte fajtori? A ishte me të vërtetë fëmijë ebreu? Apo u shpall më vonë nga ebrenjtë si i atillë, ngaqë i

largoi ata nga Egjypti dhe i formoi si komb më vete, duke u pranuar si profeti i tyre?!

Nga zbulimet e fundit dhe nga përkthimet e bëra këtu, shohim që egjyptianët e lashtë besonin plotësisht në Zot dhe i faleshin Atij sipas mënyrës së tyre dhe jo ashtu siç na janë paraqitë deri më sot: si besimtarë paganë. Këtë besim Mojsiu e përvetësoi dhe ia predikoi popullit ebre, duke i thënë se i kishin zbritur nga Zoti. Në fakt, pas leximit të shkrimeve të Thotit, shofim se mënyra e faljes që bëjnë sot ebrenjtë është ashtu siç e rekomandon Thoti: luten në këmbë pas murit të shenjtë, me tundje energjike para e prapa derisa kalojnë në trans.

Shkencëtarët kanë vrojtuar se i njëjti fenomen që përshkruhet te Bibla, për historinë e Mojsiut, është përsëritur në SHBA, shekullin e kaluar, pas një shpërthimi të një vullkani, nga i cili u helmuan peshqit e bretkosat dhe kafshët e lumit që filluan të dekompozoheshin në breg. Afër lumejve që morën ngjyrë të kuqe, nga zhvillimi i nji lloj alge të kuqe, njerëzit dhe kafshët filluan të sëmureshin e të vdesin nga një sëmundje lëkure e panjohur dhe për shkak të kafshëve të ngordhura, u shtuan shumë insektet e mizat e zeza, kështuqë fuqia magjike e Mojsiut, në këtë rast del fallso.

Në Bibël thuhet se pas thirrjes së Mojsiut, u hap deti dhe ebrenjtë kaluan lirisht dhe ushtarët e faraonit u mbytën pas tyre. Sipas studiuesve edhe kjo nuk është e vërtetë, sepse ata kanë kaluar në cektinën e një kënete që e kanë quajtë det, rrugën e të cilës e njihnin mirë, ndërsa ushtarët e faraonit, që në atë kohë po i shihnin nga afër ebrenjtë, që po largoheshin nëpër këtë kënetë, sulen drejt tyre pa u menduar gjatë, por fundi i kënetës, me barishte e lym, nuk i mbajti dot karrot

ushtarake të faraonit dhe aty u mbytën shumë ushtarë bashkë me karrot e kuajt e tyre.

Studiusit vënë re se disa pika të urdhëresave janë modifikuar në krahasim me rregullat e perëndeshës Mat. Mojsiu flet në shumës, sepse i drejtohet popullit të tij, ndërsa Mat flet në njejës, sepse merr në pyetje Faraonin dhe ai i përgjigjet: Nuk kam vjedhë. Ndërsa Mojsiu i thotë popullit të vet: Mos vidhni!

Po të shohim të dhjetë urdhëresat të pasqyruara te Katekizmi Katolik, vëmë re se nga dhjetë urdhëresa që janë shkruar te Bibla e Shenjtë, në Katekizmin Katolik në fakt janë nëntë. Urdhëresa e dytë është prishë dhe urdhëresa e dhjetë është nda në dy urdhëresa për të plotësuar dhjetë urdhëresat. Kështu, urdhëresa e dytë te Katekizma Katolike është e treta, e treta, është e katërta e deri te e nënta dhe e dhjeta te Katekizma Katolike, janë njësoj me pikën e dhjetë të Biblës së Shenjtë.

Le të shohim tani "dhjetë" urdhëresat sipas Katekizmës Katolike:

Unë jam Zoti yt.

1. Mos kesh tjetër Zot, veç meje!
2. Mos përmend emrin e Zotit i papërqendruar (bosh)!
3. Kujtohu të shenjtërosh festat!
4. Ndero babën e ëanën!
5. Mos vra!
6. Mos kryej vepra të pista!
7. Mos vidh!
8. Mos bë dëshmi të rreme!
9. Mos dëshiro gruan e tjetrit!
10. Mos dëshiro gjërat e tjetrit!

Sipas Biblës së Shenjtë shkruhet:

1. Unë jam Zoti, që të kam bërë të dalësh nga Egjypti, nga vendi i skllavërisë. Nuk duhet të kesh tjetër Zot, përveç meje!

2. Mos bë skulptura, as piktura të pamjeve që janë në qiell e poshtë në tokë, o në ujë ose poshtë tokës! Mos u përkul para atyre e mos i shërbe, sepse unë, Zoti jot, jam nji Zot xheloz, dënoj padrejtësitë e prindërve ndaj fëmijëve të tij deri në të tretin, të katërtin brez ata që më urrejnë dhe përdor të mirat e mia deri në njëmij breza, në drejtimt të atyre që më duan dhe shohin urdhëresat e mia. (Këtë urdhëresë, Mojsiu (Musai) e shtoi kur një pjesë e popullit të tij po kthehej në fenë pagane duke iu falur Viçit të Artë).

3. Mos përmend emrin e Zotit bosh (jo me gjithë zemër), sepse Zoti të quan fajtor po ja përmende emrin bosh!

4. Kujtohu për ditën e pushimit për t'u shenjtëruar! Puno gjashtë ditë e bëji të gjitha punët, por dita e shtatë është ditë pushimi, për të shenjtëruar Zotin tënd!

5. Nderoje babën tënd e nënën tënde, derisa ditët tuaja të jenë zgjatë në tokë, që Zoti yt po të jep!

6. Mos vra!

7. Mos shkel kurorën!

8. Mos vidh!

9. Mos bë dëshmi të rreme kundër të afërmit tënd!

10. Mos dëshiro shtëpinë e të afërmit tënd; mos dëshiro gruan e fqinjit, as shërbyesit, as shërbyeset, as buajt, as gomarët dhe çdo gjë të të afërmit tënd!

Me heqjen e urdhëresës së dytë kisha katolike është treguar praktike, sepse ka shpëtuar nga shkatërrimi që mund t'i bënin fanatikët, të gjitha veprat kulturale: statuja, piktura etj., të cilat zbukurojnë të gjithë Europën e botën, njëkohësisht

dhe tërhiqte njerëzit e kthyer nga fetë pagane, që u dukeshin familjare statujat. Rrespektimi nga fanatikët e kishës ortodokse në fillimet e saj, i urdhëresës së dytë ku thuhet:

"Mos bë skulptura, piktura,… etj., e mos ju fal atyre", ka dëmtur dhe shkatërruar gati të gjitha faltoret e Greqisë së lashtë dhe veprat e artit që ajo kishte, si dhe në gjithë Bizantin. Në vendin tonë, që kaloi gati një mijë vjet nën sundimin e Bizantit dhe të Turqisë, nuk ngeli asgjë nga kultura e vjetër përveç pak gjërash që ishin hedhë e braktisë nëpër tokë dhe ishin mbuluar nga dheu, si dhe shumë kisha të vjetra bizantine të padëmtuara, ose të kthyera në faltore myslimane.

Kjo urdhëresë është dhe te feja myslimane. Në fillim të viteve të mijëvjeçarit të tretë, talebanët hodhën në erë statuja e vepra arti të randësisë botërore, të shtyer nga kjo urdhëresë.

Sipas historisë së Biblës, Mojsiu (Musai) e shtoi këtë ligj, kur pa se një pjesë e popullit të tij po i falej Viçit të Artë e nuk po rrespektonte ligjet që ai kishte kopjuar nga egjyptianët. (Ai thotë se i zbriti nga qielli).

Në Bibël nuk flitet për Thotin.

Në Kuran Thoti barazohet me profetin Idriz, pasuesit e të cilit janë sufinjtë e bektashinjtë.

Sipas studiuesve të feve, në moshën 30 vjeçare, profeti Muhamed, para se të bëhej profet, njihet në një guvë të malit Hira, afër Mekës, me një njeri të shenjtë (eremit, dervish, sufi etj.), të vjetër e të mençëm, të quejtur Ben Kazi, i cili i mësoi atij shumë të fshehta, të trashëguara qysh nga kohët e Thotit, si t'i lexojë e interpretojë librat fetare, si dhe sekretet se si të kalonte në gjendje mendore autohipnoze e transi e të hynte në lidhje me Zotin, gjë të cilën ai e realizonte shumë herë. Pas pak

vjetësh, ky njeri i shenjtë vdiq dhe profeti vazhdoi ta frekuentonte këtë shpellë i vetëm duke iu kushtuar Zotit.

Në ndryshim nga saçerdotët e Thotit, nga eremitët e sufinjtë, që i deklaronin sekretet e fshehta shpirtërore vetëm atyre që u betoheshin për besnikëri dhe i faleshin Zotit nëpër guva e shpella, profeti Muhamed në moshën 40 vjeçare mori përsipër t'ia zbulojë këto të fshehta gruas së vet, e cila e inkurajon dhe të afërmve të tij që e mirëpresin dhe nis të drejtojë me sukses popullin e tij në rrugën e besimit monoteist (Në Allah) deri në fund të jetës së tij e që po vazhdon deri më sot në të gjithë botën. Njerëzit mund t'i faleshin Zotit në vende të shenjta (xhamia) si dhe nëpër shtëpitë e tyre ose kudo që të ndodheshin, mjaft që të ktheheshin në drejtim të Mekës e të pastroheshin fizikisht para faljes.

Pasuesit e Thotit u bënë pjesë e besimit mysliman dhe profeti i tyre Idrizi, u quajt profeti më i vjetër, kështuqë, bektashinjtë janë pasardhës direkt të Thotit dhe vendosja e Kryegjyshatës së tyre në Shqipëri, është rikthimi i Thotit dhe mësimeve të tij në vendin e origjinës, në gjirin e popullit të vet: Atlashtëve – Shumerëve – Pellazgëve – Ilirëve – Shqiptarëve.

Të admirosh një skulpturë ose një pikturë të bukur, një vepër arti ose arkitetkure, të jep kënaqësi, por nuk do të thotë që ato duhet të mos ekzistojnë. Në piramida janë të shumta pikturat dhe skulpturat, por ato janë një gjuhë që shprehin gjendjen kulturale e shoqërore të kohës kur ato u krijuan. Artistët dhe arkitektët, në kërkim të së bukurës dhe harmonikes, kanë arritë të krijojnë vepra të admirueshme, përndryshe do ishim akoma nëpër shpella.

THOTI, në të gjitha shkrimet e tij, na mëson që të studiojmë e të përsosemi, sepse sa më shumë të studiojmë, aq

më shumë e kuptojmë sa të vegjël e të parëndësishëm jemi para Gjithësisë dhe Zotit.

Edhe besimet fetare, nga njëri shekull në tjetrin, kanë evoluar, janë zhvilluar e kanë bërë shtesa ose pakësime në dobi të situatës që i shërbejshin: p.sh., koncepti i Parajsës dhe Ferrit në fenë kristiane u fut në fund të shekullit të parë të Erës së Re dhe koncepti i Xhenetit e Xhehnemit, në shekullin e shtatë të erës së re. Kjo bëhej që për masat e paditura e pa arësim të popullit, besimi në fe të bëhej më real e mër i pëlqyeshëm për besimtarët, sidomos për luftëtarët, të cilët, po të vriteshin në luftë duke i shërbye atdheut të tyre, e kishin vendin në Parajsë.

Pas vdekjes, besimtarëve të denjë u premtohej jeta e pafundme, me gjithë të mirat që gjenden në parajsë: nga vendi i banimit me lulishte përherë të lulëzuara e me ajër të shëndetshëm, pa sëmundje e pa vdekje, ushqimet, pijet, parfumet e çdo gjë që të dëshirosh, të bollshme e si t'i kërkosh, e deri te dëshira për seks, që të plotësohet si ta dëshirosh në sasi e në cilësi; ndërsa Ferri ose Xhehnemi ishin vendi ku digjen në zjarr e flakë ata që bënin mëkate e nuk besonin në fe.

Në besimet pagane ekzistonte besimi për jetën pas vdekjes, për këtë qëllim të vdekurit varroseshin me disa gjëra që do t'i shërbenin pas vdekjes: luftëtarët shoqëroheshin me armët e tyre, zanatçinjtë me veglat e tyre të punës dhe të gjithë me disa enë me ushqime, që do i shërbenin për t'u ushqyer në botën tjetër. Sipas tyre, jeta pas vdekjes do ishte e pafundme. Vdekje tjetër nuk do të kishte. Qysh nga ato kohë ka ngelur shprehja: **"Një vdekje kemi për të bërë"**.

Në fetë budiste e në disa monoteiste, përderisa shpirti kalon nga një njeri te tjetri ose nga njerëzit te kafshët ose

anasjelltas, len të kuptosh që shpirti ka lindë vetëm një herë e nuk ves deri në pafundësi, duke u transformuar, ashtu siç transformohet materja.

Në shkrimet e THOTIT **shpirti bëhet një me Gjithësinë.** Në fillim, në fenë kristiane engjujt parafytyroheshin me pamje fëmijësh, femra e meshkuj dhe është shkaktuar shumë grindje midis kristianëve, derisa u vendos që engjujt të jenë vetëm me pamje fëminore, por pa seks të përcaktuar. Në fenë myslimane meleqt (meleket) paraqiten pa seks të përcaktuar, por me emra mashkullore.

Edhe synetia deri në shekullin VII ka qenë aplikuar dhe nga kristianët, por u hoq me urdhër të drejtuesve kristianë të asaj periudhe. Ebrenjtë, myslimanët e disa sekte të tjerë, vazhdojnë ta zbatojnë edhe sot. Aq i fortë është presioni ndaj skulpturave, pikturave e, tashti edhe ndaj fotografive, saqë të gjithë atyre njerëzve që ekspozojnë këto gjëra në shtëpitë e tyre u thuhet se do t'u mungojnë engjujt (meleqt) mbrojtës. E gjitha kjo bëhet që njerëzit të frikësohen e t'u kujtohet rreziku që çon, kur ai fillon të adhurojë këto gjëra, në shkëputjen nga besimi në fenë monoteiste dhe rikthimi në atë pagane.

Në shkrimet e THOTIT nuk flitet për engjuj por për zotërinj hijerandë e të shumëditur, të krijuar nga drita, që janë ndërmjetësit midis njerëzve, mësuesve dhe Zotit.

Ndryshimi midis feve që janë pasardhës të Mojsiut (Musait) dhe feve pagane të Greqisë së lashtë e asaj romake është i madh. Nëse feja pagane predikonte zhvillimin e trupit, mendjes dhe shpirtit të pandarë, si për së gjalli ashtu dhe pas vdekjes, fetë pasardhëse të Mojsiut (Musait) predikojnë zhvillimin e shpirtit dhe trupit në mënyrë të pavarur. Për këto fe trupi është një vendqëndrim i përkohshëm ku qëndron

shpirti. Pas vdekjes trupi e humb ekzistencën, ndërsa shpirti vazhdon të jetojë.

Nëse në antikitet zhvillimi trupor është paralel me zhvillimin shpirtëror, në fetë monoteiste zhvillimi shpirtëror merr më përparësi se ai trupor, kështuqë e humbin vlerën palestrat e stërvitjeve fizike. Ekspozimi i trupave të bukur filloi të quhej një gjë e turpshme dhe skulpturat me sportistë të zhveshur filluan të thyheshin e të dëmtoheshin. E njëjta gjë ndodhi dhe për pikturat e këtyre llojeve.

Njerëzit në fetë monoteiste u kushtohen lutjeve dhe jetës pasive dhe e humbin vlerën ushtrimet fizike që bëheshin nëpër palestra për zhvillimin e fizikut. Aq i rëndë u bë ky problem për fenë islame, ku besimtarët i kushtoheshin lutjeve natë e ditë, duke lënë pas dore punën dhe problemet e tjera të jetës, saqë profeti Muhamed, bashkë me drejtuesit e lartë të Mekës, u detyruan të vendosnin gurin e kufirit, pas të cilit njerëzit të mbaronin lutjet e t'i shtroheshin punës.

Ky problem duhet të ketë qenë dhe në kohën e Thotit, i cili në pikën nr.31 të rregullave të Perëndisë së drejtësisë Mat, thotë:

- Mos ju lut Zotit pak, por dhe shumë, shumë, jo!

Mësimet e feve pagane me ato monoteiste mund të krahasohen sot me shkollën e marinsave dhe me ato fetare. Shkollat e marinsave predikojnë zhvillim fizik të fuqishëm dhe aspak mëshirë, ndërsa shkollat fetare predikojnë përsosmëri të shpirtit, mëshirë e dhembshuri dhe nuk i vihet rëndësi zhvillimit të fizikut.

Dihen luftërat e egra që bënin gladiatorët në lashtësi, por asnjërit nuk i bënin përshtypje vrasjet e tmerrshme që ndodhnin në arenë, por dëfreheshin duke parë se si vriteshin

njerëzit midis tyre. Nëse falej ndonjëri gjatë dyluftimeve, kjo bëhej nga simpatia që kishin për atë gladiator dhe jo nga mëshira. Të atilla ishin edukata dhe morali i asaj kohe. Njerëzit duhej të ishin me trup të fuqishëm e me shpirt të fuqishëm, që të përballonin tmerret e luftërave.

Influenca e paganizmit dhe instiktet e lashta e të egra njerëzore, pasqyrohen dhe sot, kur nuk kanë fund luftërat dhe njerëzimi ka akoma kënaqësi kur sheh filma me vrasje e krime nga më të rëndat.

VIII. "THOTI..." i Katapanos, NJË VEPËR SHKENCORE

E njihja Shqipërinë pak, shkruan autorja e këtij shkrimi, për mua ka qenë një tokë e largët e panjohur pavarsisht se ajo gjeografikisht është shumë afër me vendin tim, pavarsisht se në krahasim me vendet e tjera kemi një histori komune që na lidh në të gjitha pikat e vështrimit historik. Shqipëria ky vend i shqiponjave afërsisht prej dy vjetësh kur rash në kontakt me gazetën historiko – kulturore dy gjuhëshe "Rrënjët" po më shtyn që të punojë pa rreshtur për ta njohur më nga afër këtë vend. Në disa studime që kam nisur dhe ato që kam shkruajtur për këtë truall dhe njerëzit e tij kam konstatuar se ky vend në të ardhmen do të jetë një pikë referimi i gjithë studjuesve, historianëve, gjuhëtareve, arkeologëve mbarë botëror për të zbuluar enigmat dhe plotësuar ato boshllëqe që tashmë dihen nga të gjithë mbi origjinën, historinë dhe qytetërimin e njerëzimit. Pikërisht ky refleksion rreth librit Thot me autor Giuseppe Catapano do të jetë një nxitje dhe një reflektim i cilitdo historiani ose hulmutuesi bashkëkohor.

Giuseppe Catapano, i Frashinetos, kërkimtar i kujdesshëm i kulturave Primitive inkuadrohet në numrin e madh të glotologëve, filologëve, historianëve që kanë bashkëpunuar mbi diturinë e misterit tërheqës të njerëzimit. Ai dedikon librin e tij **"*Thot fliste shqip*"** arbëreshëve të pesëdhjetëepesë komunave albanofone të Siçilisë, të Puljes, të

Kampanies, të Molizit, të Lukanies, të Kalabrisë, ndaj të cilave është i lidhur nga një miqësi e lashtë dhe nga kujtime të përzemërta dhe të forta. Lidhje të tilla janë përforcuar gjatë "Kursi i Kulturës së Lartë" i mbajtur në Rodi në 1936, nën kujdesin e Shoqërisë Kombëtare Dante Aligieri. Pati mundësinë, ndërkohësisht, të njihte personalitete të larta të botës shkencore dhe kulturore.

Vizita e monumenteve të mëdhaja, si Sphinxi (Sfinksi) dhe Piramidat i shkaktuan një emocion aq të thellë sa e tërhoqën tek ndjenja fetare, të cilën mbarte edhe Thoti, si kumtar i Dritës dhe të Mirës së Epërme, Zotit. Thoti prezantohet si krijuesi i shkencës antike, burim njohjeje për dijetarët më të mëdhenj të njerëzimit. Sipas studimeve shumëvjeçare, Catapano dikton tek Thoti përcjellësin e kulturës iliro-shqiptare në Meslindje deri në Egjypt. Metoda e kërkimit të tij bazohet mbi krahasimin shkencor të rrënjëve të shumë gjuhëve të lashta si Eskuera baskisht (E- Shkuera në shqip = gjuhë e të shkuarës), shqip, hitit, hebraisht, koptisht (gjuhë liturgjike e të Krishterëve të Egjyptit).

Studime të drejtpërdrejta në fusha të ndryshme: filozofi , teozofi , histori, arkeologji, etnologji, mitologji, matematik, kimi, fizik, natyralizëm. Nëpërmjet këtyre studimeve përfundon tek koncepti i: borea (etimoni i saj është borë, fjalë iliro-shqiptare, pra: borë e maleve më të larta, dëlirësi e zemrave, nga të cilët në kohët e lashta zbritën paraardhësit tanë, duke zënë gradualisht të gjitha rajonet e Europës e

shumëpjesë të Azisë. Në këtë mënyrë ai përmbyt besimin tradicional, sipas të cilit qytetërimi nilotik gjente prejardhjen nga kryqëzimi midis racës të kuqe dhe të zezë dhe më pas të kësaj me atë të bardhë dhe të verdhë.

Arët i përkasin kësaj familjeje të lashtë; fjala që i emërton ka të njëjtin etimon e të njëjtave zëra iliro-shqiptare: Ar-i = ar; Are = të korrat, elbi, gruri, me kuptim 1) ngjyrën e flokëve bjondë dhe të lëkurës ngjyrë ari i sfumuar; 2) të verdhat e të korrave, që simbolizojnë të Mirën si melodi e Kozmit, e mirë e arritur ndërmjet një pune të pandërprerë dhe të lodhshme, me nënkuptimin e qartë të lirisë, si çlirimi nga e keqja. Koncept që ai përfshin dhe shpiegon në formulën izoterike të teoremës së Pitagorës; sipas këtij kalkulimi matematik, fuqia e një njeriu, fuqia për të mposhtur Fatin është rezultati i dy përbërësve në fuqinë e dytë të forcës së Providencës+Fatit. Psh.: AB dhe BC = masat e katetit në fuqi të dytë dhe AC = hipotenuza në fuqi të dytë, pra AB + BC në fuqi të dytë = AC në fuqi të dytë.

Thoti besohet të jetë paraardhësi i profetëve biblik, i filozofëve si Pitagora, Sokrati, Platoni, të cilët studionin dhe u mësonin të tjerëve konceptimin e tyre mbi njeriun si objekt kozmik për të arritur më vonë në njeriun që aspiron sferat trashendentale. Pra, Thoti, iliro-shqiptar, ka përcaktuar linjat e punës fizike dhe metafizike në Shkollat e shumta të Eladës dhe të Athinës, të përhapura më vonë në Kalabrinë tonë. Thoti, në fakt, kishte mësuar shkencat në tempujt dhe shenjtëroret e

Egjyptit, ku Faraonët përfaqësonin fuqinë hyjnore dhe sphinx-et mbartnin kuptimin e Diturisë e të shkuarës.

Catapano përcakton Thotin si një kumtar hyjnor dhe e përafërson me Muhamedin dhe profetët e ndryshëm. Tashmë është i nevojshëm një reflektim: i vështirë ka qenë në të kaluarën dhe akoma i tillë ngelet mundimi për kërkimin e të Mirës epërore. E sigurt është që për të arritur diturinë e Trashendentit, duke filluar nga bota e prekshme nevojitet përkushtimi ndaj ushtrimit të vazhdueshëm të perfeksionimit të gjendjes së vet psikofizike dhe shpirtërore, edhe nëpërmjet heqjes dorë, nëse duhet. Një koncept i tillë është akoma i përhapur në besimet perëndimore. "Per aspera ad astra" ("Nëpërmjet vështirësive tek yjet"). Veç kësaj, qëllimi i Giuseppe Catapano-s është ai i vërtetimit mbi çfarë u tha sipër, pra: ***Thoti, Përcjellësi i gjuhës së folur dhe më pas së shkruar shqip në tokat më perëndimore të Anatolias dhe të Egjyptit.***

Konfirmim i prekshëm u tregua gjetja e "Gurit të Rozetës", në Rashid, lokalitet i ndodhur në Egjypt, në të majtën e lumit Nil, në 1799, gjatë punës së përforcimit të linjës ndarëse midis protektoratëve anglez dhe francez. Mbi këtë ndodhi, është e dobishme ti njihet merita një gjenerali të madh arbëresho-francez, Napoleon Bonapartës, meritën e rrethimit të vetes me arkeologë të vlefshëm dhe glotologë me kulturë, si Kapiteni Bouchard dhe Champollion. Kapiteni Bouchard vuri re që ai gur i zi bazalti paraqiste tre nënshkrime; pati përshtypjen që kishte të bënte me një test unik: greqisht,

hieroglifik, ghierati, dy gjuhët e fundit ishin, faktikisht, përkthimi i greqishtes. Më pas Champoillon iu dedikua me shumë zell studimit e tre karakterave. Kuptoi që gjuha egjyptiane nuk mund të ishte zhdukur komplet sidomos në zonën e gjuhës arabe, ku kultura egjyptiane kishte dominuar për shumë kohë. Ai njihte disa gjuhë europiane dhe meslindore, studioi atëherë edhe arabishten, gjuhët semite, kopton, gjuhën liturgjike të të krishterëve të Egjyptit. Kuptoi edhe që hieroglifet egjiptiane ishin tre herë më shumë se ata greke. Pra, përmbyti besimin që çdo hieroglif përfaqësonte një koncept të plotë, por vetëm një letër. Ndërkohë suedezi Akerblad kishte njohur në tekstin demotik midis hieroglifit dhe greqishtes emërin e Kleopatrës në një nga pllakat arabe të Gurit të Rozetës. Zbulimi në radhë i të dy obeliskëve të vegjël që përmbanin emërin e Ptolomeut dhe nga krahasimi i tyre u shfaq menjëherë që një nga pllakat përmbante karaktere pak a shumë të njëjtë me ata të "Gurit të Rozetës". Ky u tregua çelësi i njohjes së vlerës së hieroglifeve egjyptiane, "veçantitë" e kuptimit midis gjuhës egjyptiane dhe shqipes. P.sh. disa simbole egjyptiane përkthenin fjalën mirë, shqip, mere kopte, kuptimi i të cilës është Mirë, me të duar, dashuruar, nga vjen: dua mirë = dashuroj. A, tingull latin, "a"; A: letra e parë e Ain = në shqip Shqiponjë. Një shembull tjetër: GJ (tingull shqiptar "gj") = gji, prehër, mitër, simbol i organit femëror për prokreimin. "A" = Atë, princip i parë; J = Folja Krijuese; "N" = Ji = Zot. Zoti, për shkak të përhapjes së dashurisë, lejon të

kalohet nga Fuqia në Akt. Ja pra ku shfaqet lidhja e ngushtë midis simboleve egjyptiane dhe shenjat arbërisht, që tregojnë vlerën e Thotit si përhapësi i iliro-shqipes në të gjithë zonën kulturore të meslindjes dhe jugperëndimit. Çështja e të mirës kozmike dhe individuale si harmoni e bazuar mbi koherencën dhe sakrificën në një impenjim të vazhdushëm është gjithmonë një karakteristikë e Giuseppe Catapano-s, që ai transferon në edukimin e të rinjëve të kohës sonë, ndaj moralit të së cilës është një vëzhgues i kujdesshëm dhe sheh një mungesë miëqenieje morale që shpesh i tërheq drejt një arritjeje tunduese të disa modeleve sjelljeje të gabuara ose akoma më keq imoral, dhe largohet nga koncepti i pastër i lirisë, liri, jo arbitër, por si çlirimi nga e keqja, ku ai përsërit vlefshmërinë e mësimeve të Thotit, kumtar i së Mirës, i Dritës Hyjnore. Megjithatë pikësynimi i tij themelor është pohimi i fortë i vlerës së Thotit, përhapësit të gjuhës shqip dhe të kulturës të një populli që një kulturë të tillë e ka trashëguar nga Atlantida e dikurshëme, qëllim i ndikuar nga dëshira e njohjes së veprës ndërmjetëse të një race që dëshmon në mënyrë funksionale identitetin e tij ndërmjet gjuhës së folur dhe shkruar të Grekëve, Etruskëve romakë, dhe nga arrin krenaria e tij e të qenit Arbëresh.

Maria Teresa Pisani - Grottaferrata
Burimi: Gazeta historiko–kulturore
(arbërisht-italisht) "Rrënjët", 7 shkurt 2010

IX. Portrete, Skica, Piktura, Gravura, Ballina Librash…, të Thotit, Enokut, Hermesit, Kybalionit, Matit



RA (Amon Ra – Zoti Egjyptian i Diellit)



THOTI

MAAT / MATI

THOTI i Atlantidës, duke u lutur/falur,me maskën e shpendit Ibisit në kokë dhe me simbolin e Dritës përballë.

教 宗
High Priest

Thoti i Atlantidës

Thoti i Egjyptit të Faraonëve
pa maskën e shpendit të Ibisit


THOTH


Thoth
Hermes Trismegistus
MERCURY.


The Bringers of Knowledge
Kundalini - Coiled Snakes
Hermes - Greece
Thoth - Egypt
Mercury - Rome

Emri i THOTIT në kohë të ndryshme,
te popuj të ndryshëm.



Pamje nga Libri i të Vdekurve, shkruar nga Thoti

XHUZEPE KATAPANO
THOT-i
FLISTE SHQIP
BOTIMET ENCIKLOPEDIKE

SKËNDER HUSHI



THOTI
I PAVDEKSHËM NA ZBULON ATLANTIDËN

HERMESI pellazgo-ilir me plis në kokë

AEGYPTIVS HERMES

HERMES.


The
Divine Pymander
of
Hermes

THE SECRET HISTORY OF
HERMES TRISMEGISTUS

Hermeticism from Ancient to Modern Times

FLORIAN EBELING

Foreword by JAN ASSMANN


THE AUDIO SEMINARS OF PRS
DOCTRINES OF HERMES TRISMEGISTUS
MANLY PALMER HALL

The Kybalion of
Hermes Trismegistus
Buddyhuggins.com


MIND OF THE ALL HERMETIC CLASSICS
The Kybalion
THREE INITIATES


el
Kybalion
TRES INICIADOS


Tres Iniciados
El Kybalión


TRES INICIADOS
EL
KYBALIÓN


EL
KYBALION
TRES INICIADOS

EL
KYBALIÓN
POR TRES INICIADOS


El
Kybalión

THE KYBALION
A Study of The Hermetic Philosophy
of Ancient Egypt and Greece

LITERATURA, BURIMET DHE ARTIKUJT E PËRZGJEDHUR NË KËTË LIBËR

(sipas kapitujve)

1.Xhuzepe Katapano: THOTI FLISTE SHQIP - Tiranë 2007 (Giuseppe Catapano: Thot parlava Albanese – Roma1984), Përktheu: Qemal Velija

2. Skënder Hushi: THOTI I PAVDEKSHËM NA ZBULON ATLANTIDËN

3.Robert A. Armour: ZOTAT DHE MITET E EGJIPTIT TË LASHTË – Tiranë 2006
Përktheu: Vjollca Lisi, Kajro 2002

4.Fragmente nga LIBRI I ENOKUT – Botim suedisht - Stockholm 2010

5. Fragmente nga libri elektronik: Tre Rishtarët - KYBALIONI, Përktheu: Adrian Kosturi, Tiranë 2011

6.Tre Inicuesit: KYBALIONI, http://www.kybalion.org

7.Enciklopedia **-** WIKIPEDIA në Shqip dhe Suedisht

8.Pjesë nga shkrimet e studiuesëve, publicistëve dhe përkthyesëve:

Qemal Velija, Nezir Myrta, Adnan Abrashi, A.Ajgeraj, Skënder Rizaj, Berat Kega, Adrian Kosturi**,** Anastas S. Shuke, Maria Teresa Pisani – Grottaferrata, Stephan A. Hoeller, Jack Courtis**…**

P Ë R M B A J T J A

Hyrje
1.Atlantida – Atdheu i Thotit……..5
2.Ngritja dhe rënia e Atlantidës……..13
3.Atlantida dhe Shqiptarët……..30
4. Z. Katapano: "THOTI FLISTE SHQIP"
(Fragment nga Parathënia e Librit të tij)…….40
5. Maurice Doreal: Origjina e Pllakave
prej Smeraldi të Thotit……50
6.Disa fjalë nga Alessandro Marcon…….55

I. ZANAFILLA JONË KOMBËTARE
1.Historia jonë e fshehur dhe e cunguar!……..56

II. THOTI I ATLANTIDËS DHE I PELLAZGJISË
1.Thoti – Profeti i Parë i Njerëzimit……68
2.Alfabeti/Hieroglifet e Thotit……78

III. PLLAKAT E THOTIT PREJ SMERALDI
Parathënie……99
Pllaka – I
1.Historia e Thotit nga Atlantida……105
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën I……111
Pllaka – II
2.Odat e Amentit……117
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën II……123

Pllaka – III
3.Çelësi i Pleqësive/Mençurive/Diturive…….....…..129
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën III…….…135
Pllaka – IV
4.Lindja e Hapësirës……...…..……..……..…140
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën IV……...…...145
Pllaka –V
5.Banori i Undalit…….…….....……..……146
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën V…….…..…..……..154
Pllaka – VI
6.Çelësi i Magjive…….…….....……..…158
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën VI……...……...163
Pllaka – VII
7.Shtatë Zotrinjtë…….…….....……..……..……166
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën VII…….……...…..172
Pllaka – VIII
8.Çelësi i Misterit…….....…….……..……176
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën VIII...……...……182
Pllaka – IX
9.Çelësi për të qenë i lirë nëpër Hapësirë…….....……185
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën IX……..…….....191
Pllaka – X
10.Çelësi i Kohës…….……..……...193
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën X……...…..199
Pllaka – XI
11.Çelësi për te Bota e Sipërme dhe për te e Poshtmja….....201
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën XI……...…..207
Pllaka – XII
12.Çelësat e Profecisë…….…….……....209
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën XII…….....214

Pllaka – XIII
13.Çelësi i Jetës dhe i Vdekjes…….…….…..216
- Shpjegimi i Dorealit për Pllakën XIII……..220
Pllaka –XIV
14.Shtesë…….…….…….....…..…..…….…….……....221
Pllaka – XV
15.Sekreti i Sekreteve……...…….…….……....228

IV. HERMESI
1.Hermes Trismegistus
(Hermesi Tri herë i Madh – Tri herë i Rilindur)….....232
2.Hermesi dhe Hermetizmi…….…….....238
3.Ligji i Hermesit…….…….…….240
4.Shtatë parimet Hermetike…….…….…….……....243
5.Transmutacioni Mendor…….…….…….…….……..254
6.Një studim i Filozofisë Hermetike
të Egjyptit të Lashtë dhe të Greqisë…….....257
7.Gjithësia është mendja, Universi është mendimi……262
8.Hermetizmi dhe Njeriu bashkëkohor…….…....269

V. KYBALIONI
1.Libri Kybalioni nga Tre Inicuesit apo Tre Rishtarët……....272
2.Gjithësia…….…….…….…….…….……..275
3.Paradoksi hyjnor…….…….…….…….…….……...282
4.Gjithësia në Gjithçka…….…….…….…….…….....…292

VI. THOTI DHE MAAT/MÁT

1.Burrë e Grua, apo…?.....300
2.Thoti.....302
3.Mati.....307
4.Rregullat e Perëndeshës Maat.....309

VII.ENOKU dhe MOISIU

1.Dituria e humbur Enokiane/Thotiane.....317
2.Kush ishte Moisiu?.....325

VIII. "THOTI…" i Katapanos: Një vepër shkencore 335

IX. Skica, Portrete, Piktura, Gravura, Ballina librash…,
të Thotit, Enokut, Hermesit, Kybalionit, Matit.....341
- Literatura/Burimet.....378
- Përmbajtja.....379

SHEFKI OLLOMANI
THOTI I ATLANTIDËS

Lektura, korrektura, realizimi kompjuterik dhe kopertina
ShGB "Shkupi"

Tirazhi
300 copë

Shtypi
Shtypshkronja
"FURKAN Ism"-Shkup

CIP-Katoligizimi në Bibliotekën
"Sh. Klimenti i Ohrit" – Shkup
CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
"Св. Климент Охридски", Скопје
2-264(3)
111:2-277.2(3)
133:2-277.2(3)
323.1(=18)(091)
39(=18)
OLLOMANI, Shefki
Thoti i Atlantidës / Shefki Ollomani. - Botim i 2-të i plotësuar.
- Shkup : Shkupi, 2019. - 383 стр. : илустр. ; 21 см
Bibliografi -Библиографија: стр-fq. 378
ISBN 978-608-224-136-4
a) Mitologjia dhe religjioni - Религија и митологија –
-Koha e lashtë -Стар свет
b.б) Hermeneutika – Koha e lashtë - Херменевтика - Стар свет
c.в) Shqiptarët – etnogjeneza - Албанци - Етногенеза
COBISS.MK-ID 110645514